

NË VEND TË PARATHËNIES

Ilmihali zë një vend me shumë rëndësi në jetën **besimore** e fetare të muslimanëve. Pavarësisht nëse përgatiten në formë të gjatë apo të shkurtër, në vartësi të kohës, kushteve dhe kërkesave, në përgjithësi, ilmihalet përmbajnë njohuritë e domosdoshme për muslimanët që të mund ta praktikojnë fenë e tyre në jetën e përditshme. Prandaj synimi i ilmihaleve është mbajtur i kufizuar gjithmonë me këto praktika ditore të përballura. Kurse detajimi i të gjitha urdhrave dhe ndalimeve të fesë u është lënë studimeve më gjithëpërfshirëse. Dhe kjo, në masë të madhe, është e lidhur me kërkesat dhe përpjekjet e posaçme të atyre që dëshirojnë të arrijnë një njohje më të thellë të parimeve të sjella nga feja islame për individin, familjen dhe shoqërinë, për çështjet shoqërore dhe universale. Dhe më shumë njohje, në mënyrë mjaft të natyrshme, do të sjellë në literaturën islame thellimin. Prandaj, libri që keni në duar përmban kryesisht domosdoshmëritë dhe praktikën e fesë islame. Gjithsesi, domosdoshmëritë e fesë islame, këshillat, porositë, propozimet dhe direktivat e saj nuk janë të kufizuara me këto. Por duhet thënë se edhe pse ky studim përmban çështje të kufizuara e përparësore, jep njohuritë themelore të domosdoshme që duhet të marrë e të përvetësojë një musliman. Më saktë, ky libër është përpjekje për ta paraqitur në mënyrë rrënjësore dhe lehtësisht të kuptueshëm mesazhin e sjellë nga Islami me dimensionet e tij **besimore**, **adhurimore** dhe morale.

Feja përbëhet nga bazat e besimit, konkluzionet praktike (adhurimet dhe marrëdhëniet civile) dhe morali.¹ Në këtë libër janë bërë përpjekje për trajtimin e këtyre tri çështjeve themelore të fesë. Por nuk i është hyrë çështjes së marrëdhënieve civile e cila është një çështje studimi më vete.

Në libër janë bërë përpjekje për t'u përqendruar në mënyrë të gjithanshme e të thellë mbi bazat e besimit, që janë themeli dhe baza e fesë islame. Sepse çdo gjë është e lidhur me besimin dhe bindjen. Adhurimi, marrëdhëniet civile dhe morali realizohen mbi themelin e besimit. Feja ka ardhur për t'u përfutur njerëzve një natyrë të dytë. Kjo natyrë është një formësim i ri me bosht ndërgjegjen. Ky formësim do të thotë që besimi të qëndrisë portretin e vet në ndërgjegjen e njerëzve që besojnë. Dhe rruga e kësaj kalon nëpërmjet kryerjes me seriozitet të adhurimeve duke filluar me namazin, agjërimin, zekatin dhe haxhin. E shprehur ndryshe, bashkimi tërësor ose njësimi i besimit me natyrën e njeriut, shndërrimi i tij në cilësi të thellësisë së natyrës së njeriut bëhet duke i jetuar urdhrat e Islamit, gjë që, me shprehjen e saj të përgjithshme, quhet "punë e mirë".² Nga ana tjetër, besimtari mund të qëndrojë afër Allahut, mund ta ruajë afërsinë ndaj Tij dhe mund ta fitojë kënaqësinë e Tij aq sa besimi i tij mbështetet në punë të mira dhe adhurim. Prandaj, besimi është baza e vetme e pamënjanueshme për aktin (punën, veprimin, adhurimin), kurse akti është mur kalaje, serë, dëshmitar dhe siguresë e besimit.

Nisur nga kjo, në këtë libër, pas pjesës mbi bazat e besimit, janë bërë përpjekje për trajtimin e pjesës mbi adhurimet, pra, mbi namazin, agjërimin, zekatin dhe haxhin. Konkluzionet mbi adhurimet janë si një udhëzues me prejardhje hyjnore që duhet të ndjekë muslimani gjatë kryerjes së adhurimeve.

Gjatë trajtimit të çështjeve, nuk është mjaftuar vetëm me dhënien e njohurive të karakterit të ilmihalit, por, me sa ka qenë mundësia, janë bërë përpjekje për të qëndruar edhe mbi aspektet e "urtësisë" së tyre. Natyrisht, para së gjithash, nënshtrimi dhe bindja ndaj çdo urdhri të fesë së dërguar nga ana e Allahut dhe të paraqitur gjithë njerëzimit si një model jete me prejardhje hyjnore nëpërmjet kumtimit dhe përfaqësimit të profetit Muhamed (s.a.s.), është parim. Në themel, bashkë me këtë besim

¹ Në origjinal, me radhë: *iman esaslar* (bazat e besimit); *amelî hükümler* (konkluzionet praktike); *ibadât* (adhurimet); *muamelât* (marrëdhëniet civile); *ahlâk* (moral, morali dhe etika). **Përkthyesi.**

² Në origjinal: *amel-i salih*.

dhe nënshtrim, edhe përpjekja për t'i kuptuar, për t'i parë e për t'i ndjerë urtësitë e të gjitha urdhrave dhe ndalimeve të fesë së dërguar nga Zoti i Lartmadhëruar, janë rezultat i natyrshëm i besimit ndaj Tij. Në çdo gjë të urdhëruar nga Allahu ka urtësi të panumërta, sepse Allahu është Hakim, i Urtë; në çdo urdher të Tij ka një sërë urtësish që i dimë apo s'i dimë. Ne mund t'i njohim urtësitë dhe qëllimet e urdhrit të Zotit me sa na e lejon horizonti njohës i mendjes sonë. Është mjaft e rëndësishme që të njihen urtësitë e adhurimeve të kryera në mënyrë që njeriu të arrijë ngopje dhe kënaqësi me mendjen, arsyen, ndjenjat dhe të gjitha kapacitetet e tij shpirtërore. Veçanërisht në ditët e sotme është e nevojshme të shpjegohet me sa të jetë e mundur dimensionin e urtësisë dhe qëllimit të çdo çështjeje të fesë islame.

Një dimension i rëndësishëm i fesë është edhe morali. Morali është shndërrimi i besimit me anë të adhurimeve në cilësi thellësie të natyrës njerëzore ose shfaqje e formësimit me bosht ndërgjegjen. Morali është fryt i besimit. Feja i përfaqëson vlerat morale në atë nivel që është bërë pjesë e natyrës dhe vetvetes së njeriut. Në kuptim të përkryer, morali është zbatimi nga muslimani i detyrave dhe përgjegjësisë të veta me mendimin se e sheh Allahun dhe shihet prej Tij.

Morali është esenca dhe baza e fesë si dhe parimi më i rëndësishëm i mesazhit hyjnor. Të jesh i moralshëm e i virtytshëm është heroizëm. Cilësia më e shquar e të qenit musliman i vërtetë është të jesh i moralshëm. Për ata që mundën të shohin me syrin e arsyes dhe urtësisë, Kur'ani dhe Suneti janë, ajet për ajet dhe fragment për fragment, moral. Morali i Trupëzuar dhe Personaliteti i Lartë³ që ka thënë se "**të qenët musliman është bukuri shprehje**", e ka parashtruar këtë të vërtetë në formën më koncize. Duke u nisur nga kjo konsideratë mbi moralin, pjesa mbi moralin është trajtuar me një gjerësi që i kapërcen kufijtë e ilmihalit klasik.

Ja pra, në këtë studim është përpjekur që këto tri baza themelore të fesë të trajtohen nën emrin e ilmihalit.

Gjatë përgatitjes së ilmihalit, me sa që e mundur, nuk u panë detajet kontradiktore. Kjo vepër u përgatit duke u marrë për bazë shkolla juridike-besimore hanefi (medhhebi hanefi). Vende-vende u është drejtuar edhe qëndrimeve të shkollave të tjera, kryesisht të shkollës shafii Në fund të fundit, dallimet **doktrinare** në Islam e kanë prejardhjen jo nga baza e fesë, por nga detajet teknike, nga fushat e ndryshme të jetës shoqërore, natyrisht nga dallimet konceptuale kulturore dhe nga dallimet në trajtimin e bazave të Islamit. Dhe që të gjitha dallimet doktrinare janë formuar vetëm në fusha ideore⁴ të përshtatshme ndaj interpretimit, domethënë, të hapura ndaj ndryshimit dhe zhvillimit.

Është e kuptueshme dhe e pranueshme se është krejt e pamundur që brenda kufijve të ilmihalit të trajtohen të gjitha çështjet dhe detajet e fushave shoqërore, individuale, familjare, shpirtërore dhe morale. Ndoshta këto njohuri kanë vënë si synim të japin praktikën lidhur me bindjen fetare⁵, adhurimin ditor dhe marrëdhëniet shoqërore të personave që njihen për herë të parë me Islamin. Prandaj, pa dyshim, do të jetë e pamundur që brenda një studimi libror të tillë mjaft të ngushtë dhe me kufij të caktuar, të gjenden përgjigje për çdo problem për të cilin ndjehet nevojë ose me të cilin përballohet. Në dashtë Zoti, këtë studim të përmbledhur e ndjek një studim tjetër më i gjerë dhe, ndoshta, enciklopedik. Po që se problemet me të cilat përballlet dhe reagimet i përcillen shtëpisë botuese përkatëse, mund të bëhen rregullime të reja të karakterit të ilmihalit si dhe shkrime origjinale. Pra, çështja varet tërësisht nga interesimi i lexuesve të vëmendshëm dhe të kujdesshëm.

³ Këto dy attribute i kushtohen profetit Muhamed.

⁴ *ixhtihadî*, domethënë e fushës së ideatimit juridiko-fetar, që i përket superstrukturës së fesë, jo bazës së fesë.

⁵ itikad.

Një specifikë tjetër është se, gjatë përgatitjes së ilmihalit, ndarja në tema dhe nëntema (tematizimi dhe nëntematizimi) është bërë në atë mënyrë që të sigurojë lehtësi komunikimi dhe kuptimi sipas botës mendore e kulturore të një lexuesi mesatar. Domosdoshmëritë fetare, urdhrat dhe ndalimet, specifikat lidhur me hallallin (lejueshmërinë dhe bekueshmërinë) dhe haramin (palejueshmërinë dhe pabekueshmërinë) janë klasifikuar pa i detajuar tepër. Lexuesit kureshtarë e të interesuar do të përballen me një ilmihal me strukturë dhe përmbajtje origjinale.

Zoti ynë i Lartë mos na largoftë nga pëlqimi, kënaqësia dhe rruga e Tij dhe na mbrojtë nga fjalët, qëndrimet dhe sjelljet që nuk përshtaten me frymën e fesë islame!

Ekipi i Studimeve Akademike

HYRJE

Një çështje si fillim

Ilmihali është udhëzuesi i jetës **adhurimore** të një muslimani. Udhëzuesi i këtij studimi që kemi përgatitur ne, përbëhet nga këto pjesë: *bindja fetare-itikad* (bazat e besimit-iman), *adhurimi-ibadet* (namazi, agjërimi, zekati, haxhi dhe kurban), *moral-ahlak*. Duke menduar se *marrëdhëniet civile-muamelat* dhe *penaliteti-ukubat* janë tema studimi të veçanta, nuk janë trajtuar në këtë libër. Dhe tani, para se të kalojmë në trajtimin e çështjeve, dëshirojmë të qëndrojmë mbi një pikë.

Njerëzit bisedojnë me koncepte, mendojnë me koncepte dhe konkludojnë me koncepte. Çdo shkencë, çdo disiplinë shkencore ka konceptet e veta të vëna nga specialistët e asaj fushe duke marrë për bazë referencat e veta themelore. Kur konceptet dhe kuptimet që u ngarkohen koncepteve përkatëse nuk kuptohen në mënyrë të drejtë, ndodhin gabime, rrëshqitje dhe devijime ideore.

Për shembull, kur trajtohet një temë çfarëdo lidhur me mjekësinë, çështjet parashtrohen me anë të terminologjisë së kësaj dege të shkencave të natyrës dhe bëhen përpjekje për ta kuptuar ngjarjen apo dukurinë në kornizën e këtij parashtrimi. Po që se vihet diagnozë për një sëmundje duke i ngatërruar konceptet dhe kështu fillohet mjekimi i saj, nuk është e vështirë të merret me mend se me ç'pasoja të rënda do të shoqërohet gabimi i bërë për shkak të ngatërrimit të koncepteve.

Nga ky këndvështrim, përdorimi me vend dhe kuptimi i drejtë i shprehjeve lidhur me fenë islame dhe zbatimin e saj në jetë në tërë spektrin e identitetit të saj, ka rëndësi të madhe. Konceptet e terminologjisë islame janë formuar duke marrë për bazë dy burimet qiellore: Kur'anin dhe Sunetin. Megjithëse termat përkatëse të temave dhe çështjeve që do të trajtohen në libër, do të shpjegohen në vendin e duhur, mendojmë se do të ishte e dobishme që disa koncepte të përdorura shumë shpesh të trajtoheshin që këtu.

Ç'është feja?

Fjala arabishte *din* (fe) ka këto kuptime leksikore: ndëshkim, llogari, aksident (akcidencë), politikë, bindje, shpërblim, nënshtrim, konkludim, adhurim i pranueshëm, komb, ligj etj.

Dijetarët tanë e kanë përkufizuar fenë si "manual ligjesh hyjnore që i shtynjë njerëzit në të mirën absolute me vullnetin dhe pëlqimin e tyre të lirë". Ky manual ligjesh hyjnore është përfaqësuar dhe kumtuar nga profetët, njerëz të pajisur në mënyrë të jashtëzakonshme, të dërguar nga ana e Allahut.

Llojet e feve

Sipas specialistëve të historisë së feve, fetë ndahen në:

- a) fe me burim revelativ
- b) fe pa burim revelativ

Fetë me burim revelativ (hyjnore) kanë qëndruar mbi të njëjtat baza themelore dhe kanë theksuar të njëjtat të vërteta. Çdo profet i dërguar nga ana e Allahut, përse u përket disiplinave themelore - brenda kornizës së përshtatshmërisë ndaj kushteve të asaj **dite** dhe nevojave të kohës - është sjellë si

vazhduesi, plotësuesi, përkryerësi i paraardhësit, e ka përsëritur mesazhin e profetëve para tij, ka bërë plotësime sipas situatave dhe kushteve, i ka shtjelluar specifikat që kanë kërkuar hollësi, ka bërë rinovime në çështjet që kanë kërkuar rinovim dhe është përqendruar gjithë po mbi të njëjtat tema. Besimi monoteist, profetësia, ringjallja dhe adhurimi janë bërë çështjet më parësore të çdo profeti.

Allahu i Lartë u ka dhënë profetëve direktiva private në hollësitë dhe ka vënë për ta ligje të posaçme, të gjitha këto sipas nivelit të dijes dhe aftësisë kuptimore përfshirëse të popullatave ku i ka dërguar, sipas cilësisë së problemeve dhe llojit të nevojave të tyre.

Ja pra, në vartësi të kësaj ideje themelore, në mesazhet e të gjithë profetëve, të dërguarve dhe dishepujve të tyre nga profeti i parë gjer te i Dërguari i Fundit, profeti Muhamed (s.a.s.) - lidhur me temat dytësore - bie në sy gjithmonë një ndryshim në zhvillim, por asnjëri nga ndryshimet nuk e prek frymën e mesazhit bazë dhe nuk e kapërcen kornizën e hollësive.

Edhe në një hadith të profetit Muhamed (s.a.s.) thuhet: "Profetët janë vëllezër të një babe dhe feja e tyre është një!" (Buhari, Enbija, 48; Muslim, Fedail, 143) Islami e ka pranuar besimin në origjinën e feve të dërguara profetëve si njërin prej bazave themelore të besimit. Mbi këtë temë do të qëndrohet shpesh edhe në kapitujt e mëtejshëm.

Megjithëse feja e të gjithë profetëve është Islami, me profetin Muhamed feja islame arriti përkryerjen, u vu pika e fundit mbi fetë: "Sot e përkreva fenë tuaj, plotësova dhuntinë time për ju dhe zgjodha Islamin si fe për ju!" (Maide, 5/3)

Të gjithë profetët, krahas kumtimit të fesë së vërtetë, e kanë përfaqësuar atë duke e jetuar thellë dhe në mënyrë tejet të dallueshme nga çdo njeri tjetër. Fesë së sjellë nga profeti Musa iu dha më vonë emërtimi "hebraizëm". Në të njëjtën mënyrë, edhe "krishterim" është emërtimi i mëvonshëm i fesë së sjellë nga profeti Isa. Këto emërtime s'i kanë njohur e s'i kanë përdorur as profeti Musa e as profeti Isa.

Për faktin që ka burim hyjnor dhe që e ka ruajtur formën origjinale, Islami është fe e vërtetë. Ndërsa mbështeten në revelacionin hyjnor, hebraizmi dhe krishterimi nuk i kanë ruajtur dot origjinalet e tyre qiellore. Megjithëkëtë, pikat e përbashkëta dhe paralelizmat mes librave të tyre dhe Kur'anit nuk janë të pakta.

Hebrenjve dhe krishterëve u thuhet edhe *njerëz të librit*⁶. Disa i pranojnë edhe zoroastrianët⁷ si *njerëz të librit*, megjithëse është e dyshimtë nëse ata kanë pasur libër apo jo.

Kurse fetë që nuk mbështeten në revelacionin hyjnor, janë fe bestypte, false, supersticioze ose, thjesht, supersticiozitet, bestytëni.

Janë edhe disa sisteme të organizuara me pamjen e një bindjeje shpirtërore, si meditacionizmi dhe jogizmi që nuk mbështeten në themel as në ndonjë profet e as në revelacionin hyjnor.

Feja islame

Me lidhje fjalëformuese e semantike me fjalët *silm* (paqe, **paqëtim**) dhe *selamet* (sukses, shpëtim), *islam* do të thotë dorëzim i robit te Zoti, ndjekje e urdhrave të Tij, hyrja në një rrugë të qetë, në paqe e siguri dhe ecje drejt suksesit dhe shpëtimit, premtim sigurie kujtdo, madje gjithçkaje, moskrijim shqetësimi për askënd.

⁶ *ehli kitap*, njerëz të librit, pasues të librit, zotërues të librit hyjnor të dërguar atyre nga Zoti.

⁷ *mexhusi*, adhurues të zjarrit.

Islam është titulli i fesë qiellore me bazat të mbështetura në mesazhet e Allahut, Zotit të gjithësisë, të kumtuar e të përfaqësuar si dhe të jetuar vetë e të mundësuar edhe për të tjerët për t'u jetuar nga profeti Muhamed (s.a.s.).

Feja islame përbëhet nga konkluzionet *besimore-itikadî* (bazat e besimit), *praktike-amelî* (adhurimet, marrëdhëniet civile, penaliteti) dhe *morale-ahlakî* (morali dhe etika).

Ja pra, *fe* është titulli hyjnor i qenies së Islamit jetë për jetën me të gjitha konkluzionet, ndarjet dhe fakultetet e tij. Nisur nga kjo, quhen të vetëgënijyer ata që e shohin fenë vetëm si identitet të besimit fetar.

Themeli dhe kreu i Islamit është *besimi* dhe *kuptimi*. Domethënë të besosh në të vërtetën hyjnore në mënyrë të palëkundur, pa i dhënë mundësi të kundërtës dhe lidhja e zemrës pas të Vërtetës, Zotit. Ndërsa maja dhe kulmi i saj është zbatimi i përgjegjësive me ndjeshmërinë më të lartë sikur ta kishe Zotin para, ta shihje Atë e të shiheshe prej Tij, gjë që quhet në terminologji *ihsan*, *mirësi*, si dhe kryerja e çdo akti me bosht fitimin e miratimit dhe pëlqimit të Zotit, gjë që quhet në terminologji *ihlas*, *principialitet* dhe *sinqeritet*.

Institucionaliteti fetar: Është shndërrimi i besimit fetar dhe fesë në jetë, pra, përfaqësimi dhe zbatimi në jetë. Besimtari i fesë islame quhet muslim, musliman dhe nënkupton njeriun i cili u është dorëzuar dhe nënshtruar mesazheve të Islamit, i cili përfaqëson qetësinë, paqëtimin, suksesin dhe shpëtimin. Këtë emër, besimtarit islam ia ka dhënë Allahu i Lartë në Kur'an: "Është Ai që jua ka dhënë këtë emër edhe më parë, edhe në Kur'an." (Haxh, 22/78)⁸

Besimtari: Fjala *mu'min* (besimtar) do të thotë njeri i besueshëm, me personalitet të shëndoshë, që jep siguri, që i beson Allahut dhe e vërteton Atë, që e pohon besimin me ndërgjegje dhe e ndjen me zemër. Me kuptimin e vet të posaçëm, është njeriu që i beson fesë së Allahut të përcjellë nga profeti Muhamed (s.a.s.) dhe që e vërteton këtë fe. Megjithëse emërtimet *mu'min* dhe *muslim* kanë dallime nuancash kuptimore mes tyre, përdoren në vend të njëri-tjetrit.

Po qe se i shtjellojmë pak këto përkufizime, *mu'mini* ose *besimtari*, për nga këndvështrimi i faktit që me arsyen e shëndoshë dhe mirëkuptimin, me zgjuarsinë dhe aftësinë parashikuese, me mendjen e pastër e të kthjellët të ndriçuar nga revelacioni hyjnor, me botëkuptimin e gjerë dhe objektiv, me vështrimin e shëndoshë dhe gjithëpërfshirës, me ndjeshmërinë dhe korrektesën në përgjegjësitë, me vendosmërinë dhe qëndrueshmërinë kundër të këqijave, gjatë gjithë jetës është në ndjekje të gjërave të larta e sublime e kapet pas tyre, që me ndjenjën, vetëdijen dhe vullnetin të cilët mundet t'i mbajë të gjallë çdo kohë, me hetimin për të arritur kompetencën në thelbin e çdo gjëje dhe kuptimin e thellë në interpretimin e ngjarjeve dhe dukurive, i bindet Allahut dhe ka siguri te Ai dhe mes njerëzve njihet si njeri i besueshmërisë e i sigurisë, që e vërteton të Vërtetën (Zotin) dhe i mbetet gjithmonë besnik, që njihet si njeri besnik ndaj amanetit dhe kujtohet si njeri të cilit mund t'i drejtohesh gjithmonë për t'i lënë një amanet, që njihet dhe pranohet si i tillë nga ndërgjegjja publike, që bëhet pretekst kudo që ndodhet e dëgjohet për përmendjen e të Vërtetës (Zotit) dhe që i orienton me fjalët e qëndrimet e veta për tek e Vërteta (Zoti) të gjithë ata që i shkojnë pranë ose shoqërohen me të, për nga këndvështrimi i të gjitha

⁸ Këtu është një fjali që ne s'e përkthym (sepse nuk ka lidhje me konceptualitetin dhe realitetin shqiptar), ku thuhet se *nuk është e drejtë që muslimani të quhet islamxhi*. Por edhe termi *muslimanizëm* që përdoret në këtë libër, në realitetin turk, por edhe në atë shqiptar, nuk është i drejtë ose, më saktë, është një shtrembërim konceptual për shkaqe të ndryshme, disa herë edhe për naivitet. Përkthyesi.

këtyre fakteve, pra *besimtari*, mbështetur në parimin e "përkushtimit gjer në vetëmohim ndaj përkryerjes së fjalës absolute", është një hero i vërtetë i vërtetimit, shpjegimit dhe përfaqësimit të besimit!

Fetar: Njeri fetar quhet personi që e beson duke e jetuar dhe përfaqësuar fenë islame me të gjitha elementët e saj të besimit, veprimit dhe moralit.

Akti (adhurimor ose civil) pa besim është hipokrizi, kurse besimi pa akt është defekt (mangësi gjer në mëkat). Ndërsa hipokrizia është një mohim (kufr) i fshehtë, për pasojë, me pamundësi faljeje, defekti dhe mëkati e ka gjithmonë të hapur mundësinë e faljes me anë të pendimit, pendesës dhe rikthimit kah Zoti. Nisur nga kjo, po qe se dikush, edhe pse nuk kryen detyrat fetare, pra nuk e vë fenë në jetë, nuk e nënvleftëson atë, për të duhet menduar gjithmonë pozitivisht dhe nuk duhet nxituar për të konkluduar për mohim (kufr) për të. Përkundrazi, po qe se dikush, jo vetëm që nuk i kryen detyrat fetare, por edhe i nënvleftëson dhe i përbuz muslimanët ngaqë janë muslimanë, sigurisht që për të është e pamundur të mendohen të njëjtat gjëra pozitive!

Allahu ia ka favorizuar njerëzimit një udhëzues që do ta çonte njeriun edhe në këtë botë, edhe në jetën e pasme (ahiret) në qetësinë e vërtetë e të përhershme në kënaqësinë pa dhimbje, me anë të kumtimit dhe përfaqësimit të profetit Muhamed (s.a.s.). Islami është emri i këtij favoriti dhe e kësaj mirësie të pashoqe. Në këtë fe, sipas arsyes së shëndoshë dhe mendimeve të drejta, jo vetëm nuk ka ndonjë boshllëk dhe mungesë përgjigjeje për dëshirat, kërkesat dhe pritjet e njeriut, por as është bërë fjalë për ndonjë kontradiktë në urdhrat e krijimit dhe në interpretimin e tyre. Veçanërisht, krahas të gjitha këtyre, me premtimet për lumturinë shpirtërore, pëlqimin e Zotit dhe mundësinë për ta parë Atë, Islami është një sistem hyjnor përjashtimisht i zgjedhur, i planifikuar sipas karaktereve, kapaciteteve, qëllimeve dhe prirjeve tona!

Islami i flet gjithë njerëzimit

Feja islame është e fundit e feve hyjnore dhe feja e vetme që vazhdon ta ruajë origjinalitetin e saj. Edhe profeti Muhamed (s.a.s.) i cili e ka kumtuar dhe përfaqësuar Islamin, është hallka e fundit e profetësisë. Profeti Muhamed ka thënë fjalën e fundit në emër të fesë. Profetësia e tij nuk është për një shoqëri dhe komb të caktuar, por për gjithë njerëzimin. Profetët e mëparshëm, duke iu drejtuar vetëm shoqërisë për të cilën qenë dërguar, kanë thënë, "o fisi im", "o njerëzit e mi". Kurse profeti Muhamed (s.a.s.), siç përmbahet në shumë vende të Kur'anit, i është drejtuar gjithë njerëzimit, duke thënë, "o njerëz".

Ka shumë ajete dhe hadithe që bëjnë të ditur universalitetin e Profetit dhe të mesazhit të tij. Për shembull, në këto ajete shprehet qartë se Profeti ynë është dërguar për të gjitha kohërat dhe vendet: "Ne të dërguam ty mëshirë për të gjitha botët!" (Enbija, 21/107) "Thuaj: "O njerëz! Unë jam një lajmëtar i dërguar nga Allahu për të gjithë ju!" (A'raf, 7/158)

Këtë veçori të tij të njoftuar në Kur'an, Profeti (s.a.s.) e ka shprehur në hadithe të ndryshme: "Çdo profet iu dërgua popullit të vet, kurse unë iu dërgova gjithë njerëzimit!" Konkluzionet e fesë islame të kumtuar prej tij janë të përgjithshme dhe kanë gjerësinë dhe pasurinë e duhur për të përballuar nevojat e të gjithë popujve dhe shoqërive njerëzore që do të jetojnë në çdo kohë e në çdo vend. Feja islame i pranon të gjithë profetët e dërguar para saj si dhe të gjithë librat e shenjtë të komunikuar atyre. Kur'ani është mesazhi më i fundit e më i përkryer që mund t'u japë përgjigje nevojave të të gjithë njerëzimit gjer në kiamet. Ai është i vetmi libër hyjnor që ruan origjinalitetin dhe freskinë e kohës dhe formës kur u

zbrit. Mjafton që ata që i besojnë Kur'anit, duke i mbajtur parasysh veçoritë e tij universale, ta kumtojnë dhe përfaqësojnë atë në dimensione universale!

Si e sheh Islami jetën

Njeriu dërgohet në këtë botë për t'u marrë në provë. Jeta e njeriut është një provë. Kjo specifikë shumë e rëndësishme është shprehur në Kur'an në mënyrë shumë të qartë: "Është Ai që e ka krijuar vdekjen dhe jetën me qëllim për të provuar se kush nga ju do të bëjë punë më të mirë!" (Mulk, 67/2) Bota nuk është vend ku mund të rrihet përgjithmonë, por një shtëpi pritjeje. Njeriu qëndron këtu për një kohë, pastaj shkon në vendin e përjetësisë. Bota është vendi ku fitohet përjetësia. Këtu njeriu provohet me vlerat materiale-shpirtërore që ia ka favorizuar Allahu. Kështu, jeta e njeriut është një kapital. Trupi, mendja, mundësitë që zotëron, që të gjitha veç e veç janë kapital për njeriun. Allahu i propozon njeriut t'ia kthejë sërish këto të mira që ia ka favorizuar duke ia shitur në shkëmbim të xhenetit. "Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre në shkëmbim të xhenetit!" (Tevbe, 9/11) Le ta mendojmë për një çast mëshirën dhe dhembshurinë e gjerë të Allahut. Jetën, pasurinë, jetëgjatësinë që ia dha vetë njeriut si favor, Allahu kërkon t'ia blejë në shkëmbim të xhenetit. Fundja, a s'është Allahu që jep? Po që se njeriu e vlerëson jetën në një mënyrë të pëlqyeshme për Allahun, mund ta fitojë lumturinë edhe këtu, edhe përtej. Besimi është mirësia më e madhe e Allahut për njeriun. Besimi është si bërthama e xhenetit. Një jetë me besim dhe në lidhje të vazhdueshme me Allahun, është burim qetësie dhe lumturie të vërtetë.

Duke bërë adhurim në atë mënyrë siç ka urdhëruar Allahu dhe duke u ruajtur nga haramet, njeriu e përdor kapitalin trup në një tregti me fitim. Ai e bën këtë tregti me fitim duke dhënë zekatin dhe sadakanë e mallit dhe të të ardhurave. Shkurt, po që se njeriu e vlerëson dhe e shfrytëzon çdo të mirë që ia ka falur Allahu me synimin për të fituar pëlqimin e Tij, fiton. Islami është ai që e çon njeriun drejt pëlqimit të Allahut!

Marrëveshja shkencë-fe

Qysh në krye të herës, njerëzimi ka vlarë mendjen vazhdimisht mbi qenien, njeriun, Krijuesin e Lartë dhe marrëdhëniet e këtyre me njëri-tjetrin, është përpjekur të kuptojë marrëdhëniet e fshehta mes tyre. Qenia (gjithësia) është një libër i shkruar nga Zoti me fuqinë dhe vullnetin e vet. Ky është libri i materies dhe i dukurive të vëna në rregull nga Allahu sipas një plani, programi, mase dhe ekuilibri. Krahës kësaj është edhe libri i Kur'anit i ardhur nga atributi *Fjalë*⁹ i Allahut. Temat kryesore të Kur'anit janë besimi monoteist (tevhid) ku trajtohen ekzistenca dhe uniteti i Allahut, profetësia (nubuvvet), ringjallja (hashr) dhe adhurimi (ibadet). Me këtë perspektivë themelore, Kur'ani ua shpjegon njerëzve gjithësinë, u bën dritë materies dhe dukurive në gjithësi. Allahu i Lartë që e ka krijuar gjithësinë brenda një rregullsie dhe harmonie të caktuar, këtë regjim rregullsie dhe harmonie të ngritur prej Tij e deklaron në Kur'an. Edhe njeriu është trajta e shkruar ndryshe e këtyre dy librave. Kur'ani, gjithësia dhe njeriu janë nga një libër më vete ku shfaqen në trajta të ndryshme emrat dhe atributet e Allahut. Të lidhur me njëri-tjetrin me një lidhje të brendshme të mrekullueshme, këta e shpjegojnë dhe e interpretojnë njëri-tjetrin. Mes tyre ka përputhshmëri dhe harmoni.

⁹ Në original: kelam.

Duke i shqyrtuar librat gjithësi dhe njeri, shkenca përcakton disa të vërteta në përfundim të provave dhe eksperimenteve. Po qe se njohuritë e arritura në përfundim të vëzhgimeve, provave dhe eksperimenteve të ndryshme, fitojnë vlerë kategorike, kësaj i thonë shkencë. Kurse njohuritë që s'kanë fituar vlerë kategorike, mbeten si teori ose vështirim teorik.

Shkencat e vërteta janë identitet i raporteve të nxjerra nga veprimtaria ekzekutive e Allahut në gjithësi, nga marrëdhënia mes ligjeve hyjnore në gjithësi me materien dhe dukuritë. Dhe, ndërsa e vërteta qëndron kështu, si mund të ndodhë që këto ta eliminojnë njëri-tjetrin dhe si mund të mendohen veç nga njëri-tjetri?

Shkencat e zhvilluara në fusha të ndryshme, janë në mirëkuptim me Islamin. Nuk është me vend që çdo teori t'i adoptohet Kur'anit dhe Sunetit që janë burimet kryesore të fesë islame, sepse në këto kushte, një pikëpamje ende e paprovuar pranohet si themelore dhe ajetet dhe hadithet interpretohen sipas saj. E drejtë dhe e saktë është që njohuritë e arritura nga shkenca të trajtohen sipas kriterit se sa përputhen me Kur'anin dhe Sunetin autentik. Sepse nuk është e qëlluar dhe e saktë që të bëhen përpjekje për t'ua adoptuar të vërtetat e njoftuara me rrugë qiellore teorive të pavërtetuara duke i pandehur këto si të vërteta shkencore!

Feja me shkencën e vërtetë janë si dy fytyrat e të **njëjtës të vërtetë**. Feja e shëtit njeriun në rrugë të vërteta dhe i jep mundësi të arrijë në përfundime që do ta bënin të lumtur. Kurse shkenca me qëllim dhe synim të qartë, si një pishtar në këto rrugë, ia ndriçon atij atë çka para.

Detyrën për të dhënë njohuri mbi njeriun, qenien dhe Krijuesin, kompetencën e fjalës mbi këta, Allahu ua ka dhënë profetëve. Këta njerëz të zgjedhur, të pajisur në mënyrë të veçantë e të jashtëzakonshme, kanë marrëdhënie të posaçme me Fuqinë e Pafundme. Ata kanë bërë shpjegimet dhe interpretimet më të drejta mbi kuptimin dhe natyrën e paraskenës dhe prapaskenës së qenies.

Sa e sa të vërteta të parashtruara sot nga shkencat moderne ka, të cilat profetët, duke u mbështetur në atë botën e tyre shpirtërore të gjerë të hapur ndaj revelacionit hyjnor dhe thellësive të zgjuarsisë së tyre të pangjashme, me anë të një vështrimi gjithëpërfshirës, i kanë parashtruar shumë më parë qoftë edhe në formën e hipotezave të përgjithshme. Pavarësisht se në ç'pozicion ndaj të vërtetave të parashtruara prej tyre janë qendrat studimore të ditëve të sotme që punojnë me laboratorë modernë dhe teknologji shumë të përparuara, ende sot miliona njerëz e vlerësojnë çdo gjë në kornizën e mesazheve dhe interpretimeve të tyre, posaçërisht në çështjen njeri-gjithësi-Allah, i ndjekin dhe u shkojnë pas atyre pa kusht.

Me burimet e tij themelore Kur'anin dhe Sunetin autentik, Islami u ka hapur horizonte shkencave dhe i ka nxitur besimtarët të vrapojnë e të punojnë në këto horizonte. Profetët e dërguar me një pajisje të veçantë si udhëzues të çdo çështjeje për njerëzit, janë dhe mbeten udhëzues si në lartësimin moralo-shpirtëror, ashtu dhe në përparimin material. Për herë të parë me dorën e tyre ua ka dhuruar Zoti njerëzve mrekullitë e qytetërimit. Si anija, një mrekulli e profetit Nuh (a.s.) dhe ora, një mrekulli e profetit Jusuf (a.s.).

Me anë të mrekullive të profetëve, Kur'ani ka shënuar kufijtë e fundit ku mund të arrijnë shkencat. Për shembull, siç përshkruhet në suren Bekare, në kohën e profetit Musa (a.s.), një njeri i vdekur është

ngjallur përkohësisht.¹⁰ Kjo do të thotë se shkenca e mjekësisë do të zhvillohet gjër në një pikë të tillë që të jetë në gjendje t'i japë vdekjes ngjyrën e një jete të përkohshme.¹¹

Edhe profeti ynë Muhamed (s.a.s.), në shumë hadithe të tij, ka shënuar pikat ku mund të arrijnë shkencat. I Dërguari i Allahut ka bërë të ditur se ka për t'u jetuar një epokë përsheptimi.¹² Duke bërë të ditur se intervali kohor mes projektimit dhe aksionit do të ngushtohet shumë, se largësitë do të tkurren dhe se synimi do të arrihet me shpejtësi, ai ka treguar se në shkencat do të kryhet një zhvillim tejte i shpejtë. Veçanërisht në fushën e ndërlydhjes dhe komunikacionit, shekuj më parë është njoftuar se do të ndodhin zhvillime marramendëse.

Le të japim një shembull tjetër. Profeti (s.a.s.) ka paralajmëruar se do të ndodhë që një grup njerëzish të hanë e të ngopen me një kokërr shegë.¹³ Kjo do të thotë se në bujqësi do të bëhen përmirësime **varietore**, si rezultat i të cilave, do të krijohen, për shembull, shegë aq të mëdha që mund t'i mbarojnë së ngrëni njëzet vetë, se lëkura e një shege do të mund t'i bëjë hije një njeriu! Siç shihet, në këtë hadith profetik është shënuar se sa do të zhvillohet teknologjia e gjeneve, mbi të cilën sot sapo është nisur të punohet. Veç këtyre shembujve të dhënë, në Kur'an dhe në shumë hadithe është aluduar mbi degë shkencore të ndryshme dhe kufijtë ku do të mund të arrijnë ato, që ne sot nuk mundemi t'i dimë apo t'i shohim, por që në të ardhmen do të duken patjetër. Jo vetëm janë shënuar apo aluduar këto zhvillime, por është nxitur njerëzimi për t'i arritur këto objektiva. Këto do të duken dhe arrihen dhe, atëherë, duke ia ripohuar profetit Muhamed se është i Dërguari i Allahut, lydhja pas tij do të rinohet e do të fitojë forcë. Shekujt po e vërtetojnë atë dhe të gjitha thëniet e tij po dalin një e nga një në dritë të ditës!

Shkenca shqyrton dhe studion mënyrën e krijimit dhe ekzistencës së botës materiale, jetës dhe, veçanërisht njeriut. I gjen dhe i nxjerr lyget hyjnore që veprojnë në këtë gjithësi. Në sajë të këtyre ligjeve, përgatit mundësi që njerëzimi të përparojë edhe më tej në teknikë dhe qytetërim. Kurse feja parashtron se pse janë krijuar gjithësia dhe bota materiale dhe kush është krijuesi i tyre. Veçanërisht, përcakton pozitën speciale të njeriut mes qenieve, qëllimin final të krijimit të tij dhe natyrën e detyrës së tij në këtë botë.

Në këto kushte, shkenca dhe feja janë dy çelësa që hapin kutitë e fshehtësive të botës ekzistente. Ndërsa shkenca parashtron formën e krijimit të qenieve, natyrën dhe përbërjen materiale të tyre, feja shpjegon shkakun dhe qëllimin final të krijimit të tyre. Nga ky këndvështrim, në këtë mes nuk ka ndonjë situatë kontradiktore në të cilën shkenca dhe feja të konfrontohen, përkundrazi, ato plotësojnë njëra-tjetrën.

Në mënyrë të veçantë, feja, me burimet informative brenda saj, në tema dhe çështje që e kapërcejnë horizontin e informacionit shkencor, si fillimi i krijimit, jeta pas vdekjes, etj., është një udhëzues me stil të hapur që nuk të gënjen.

Ata që kanë pandehur se, me zhvillimin e shkencës, pikëpamjet fetare do të falimentojnë, në këtë pikë janë vetëmashtruar. Çdo hap i hedhur para nga shkenca, çdo zbulim i ri e ka afruar edhe më shumë njerëzimin që mendon dhe arsyeton, ndaj vlerave fetare dhe e ka treguar edhe më nga afër madhështinë e Allahut, Zotit të gjithësisë. Kështu, shkencat që janë identitet i zbulimit të ligjeve ku mbështetet rregullsia dhe harmonia ekzistente në gjithësi dhe i kërkimit dhe studimit të rrugëve për të përfutur

¹⁰ Bakara, 2/73.

¹¹ Shih. Fjala 20.Pozita 2, Said Nursi.

¹² Buhari, Fitn, 25; Muslim, 11.

¹³ Muslim, Fitn, 110; Tirmidhi, Fitn, 59.

nga këto ligje, janë provat dhe dëshmitarët më të fuqishëm të ekzistencës së Allahut që e ka ngritur dhe e bën të funksionojë këtë rregullsi dhe harmoni. Mohimi i ekzistencës së atij Krijuesit të lartë, i fuqisë së pashoqe të Tij, mund të bëhet vetëm duke mohuar rregullsinë dhe harmoninë ekzistente që shihet me sy. Dhe po të mohohet rregullsia dhe harmonia në fjalë, s'mbetet më shkencë në mes. Nga ana tjetër, shkencat, ngaqë merren me shqyrtimin dhe studimin e universit të qenieve të krijuar nga Allahu, parashtrajnë mrekullitë, llogaritë dhe kriteret e imta të krijimit dhe dashje pa dashje, bëjnë fjalë mbi emrat dhe atributet hyjnore që shfaqen mbi qeniet. Nga ky këndvështrim, secila nga shkencat, si pasqyra të emrave të Allahut, mbështeten në një emër të Allahut. Këtë specifikë, Bediuzzaman Said Nursi e shpjegon kështu: "Çdo përkryerje, çdo shkencë, çdo përparim, çdo teknologji ka të vërtetën e vet të lartë e cila mbështetet në një emër hyjnor. Duke u mbështetur në atë emër që ka një spektër të gjerë elementësh përbërës dhe shfaqjesh, ajo teknologji, ajo përkryerje, ai art gjen përsosmërinë e vet dhe bëhet një e vërtetë. Ndryshe, gjëja gjysmake është thjesht një hije. Për shembull, gjeometria është një shkencë. E vërteta dhe pika fundore e saj, duke arritur emrat Adl (i drejtë, i saktë) dhe Mukaddir (vlerësues, përcaktues) të Zotit, bën që në pasqyrën e shkencës së gjeometrisë të vëzhgohen në tërë madhësinë e shkëlqyer të tyre shfaqjet sunduese të nuancave të atyre emrave.

Për shembull, mjekësia është një shkencë dhe një art. Edhe fundi dhe e vërteta e saj mbështetet në emrin Shafi (shërues) të Mjekut Absolut dhe me shikimin e variacioneve Mëshiruese në mjetet shëruese të faqes së tokës që është barnatorja e Tij e madhe, mjekësia gjen përsosmërinë e saj dhe bëhet një e vërtetë.

Për shembull, urtësia e materies që bën fjalë mbi të vërtetën e ekzistencës, e sheh shfaqjen madhështore të emrit Hakim (i Urtë) të Zotit në materien me karakter të matur e edukues, në interesat dhe qëllimet e saj dhe duke e arritur dhe u mbështetur në atë emër, kjo e vërtetë bëhet e vërtetë. Ndryshe, ose shndërrohet në supersticiozitete dhe bëhet një gjë e kotë, ose i hap rrugë deviacionit që i ngjet filozofisë së natyrës.

Ja pra, tre shembuj për ty. Krahasoni ti përsosmëritë dhe shkencat e tjera me këta tre shembuj!"¹⁴

Horizonti i fesë

Një anë të dashurisë për të vërtetën e përbën shkenca, kurse anën tjetër, feja. Sigurisht, në njërën anë të lidhjes dhe marrëdhënies mes qenies është zbulimi dhe përcaktimi i të vërtetës me anë të aftësisë njohëse dhe vetëdijes së njeriut, në anën tjetër është qëndrimi që duhet përcaktuar ndaj asaj të vërtete. Specifikën e parë e ndjek shkenca, përfshi edhe burimet informative të fesë. Kurse specifikën e dytë e përcakton feja. Shkenca që nuk ka në themelet e saj analizën dhe shpjegimin e qenies dhe ekzistencës, dëshirën dhe pasionin për zbulimin e të vërtetës, është e verbër; po kështu, edhe përcaktimet e saj nuk janë pa kontradikta. Ashtu siç ndodh që shkenca për përvetësimin e së cilës bëhen përpjekje të nisura nga konsiderata interesash individuale, familjare e shoqërore, është e paracaktuar të përballlet çdo kohë me një sërë ngeçjesh e bllokimesh, ashtu dhe komplikimi herët a vonë i informacionit apo njohurisë së arritur në mënyrë të kushtëzuar nga një mendësi, një ide, një parti e një doktrinë, është i pashmangshëm. Meqë me burimet informative brenda saj, feja është një basen i gjerë dijeje, është edhe një element jetësor dhe një dinamikë me rëndësi për sa i përket dashurisë dhe pasionit për të vërtetën, si dhe në çështjet që

¹⁴ Nursi, Fjalët, Fjala 20.

e kapërcejnë horizontin e informacionit dhe njohurisë, një udhëzues me stil tregues të hapur, por me pamje të thellë që s'të gënjen kurrë!

Por ç'e do se ashtu siç është e mundur në çdo kohë që shkenca, duke u flijuar për ide të caktuara, për rryma të caktuara dhe për doktrina të caktuara, duke e miopizuar, të shndërrohet në diçka mëngjarashe apo më keq, në një demon agresiv, grindavec dhe që ia pret rrugën të vërtetës, ashtu dhe është e mundur në çdo kohë që edhe feja e cila është një e vërtetë qiellore, të tregohet në dorën e mendimit fanatik si burim ndjenjash urrejtjeje, neverie, zemërimi dhe shpagimi; si përfytyrimi dhe projektimi i një objekti në mënyrë të përmbysur! Ç'kontradiktë e madhe!

Mendoni, tani, një çerdhe shkencore - që, në të vërtetë, është po aq e shenjtë sa një tempull - të marrë nëpër këmbë, madje të marrë rob në këtë apo atë mënyrë nga një rrymë filozofike. Aty shkenca është një i arrestuar në dorën e një ideje jo të lirë, fanatike dhe po aq të mallkuar sa injoranca më e mallkuar! Dhe mendoni një fe që kërkohet të bëhet mjet për interesat e disa klikave politike apo jopolitike. Tashmë tempulli është bërë banesa e ngushtë e asaj klike, kurse adhurimi aty është shndërruar në një lloj ceremonie protokollare dhe, në këto kushte, nuk ka dyshim se edhe feja, edhe institucioni dhe jeta fetare, edhe karakteri sublim i fesë janë vrarë keqas!

Sigurisht, po qe se në një shoqëri disa flasin për shkencë dhe, ndërkaq, i përdorin çerdhet shkencore, siç përdorin vilat e veta, si vitrina të dëshirave, pasioneve dhe ideologjive të veta, ato çerdhe shkencore prej kohësh kanë mbaruar së qeni tempuj, për t'u kthyer në arena ku mprihen dëshirat, pasionet dhe urrejtjet. Gjithashtu, po qe se në një shoqëri disa flasin për besimin, fenë dhe vënien e saj në jetë dhe, ndërkaq, atyre që s'mendojnë si ata vetë, që, për pasojë, nuk ndajnë me ta të njëjtat konsiderata politike, u atribuojnë herezi, materializëm dhe hipokrizi, feja në përfaqësimin e njerëzve të tillë - mëkati i kësaj u takon këtyre përfaqësuesve sharlatanë - kthehet në gjendjen e një fobie krejtësisht kundërshtare të synimit të zbritjes së saj (fesë), si largimi i njerëzve nga Allahu, nxirja e zemrave të tyre dhe mbyllja mu në sy atyre e dyerve të shpresës. Ç'është e drejta, në ç'masë që të jetë armiqësia kundër besimit dhe fesë në gojët që shkumëzojnë me urrejtje, neveri dhe zemërim dhe në penat që nxijnë shpirtrat, një fanatizëm dhe një dhuratë e ofruar djallit që e kënaq atë, grushtet e ngritur në ajër të shtrënguar fort në emër të kritikës ndaj kësaj pikëpamjeje apo asaj ideje ndërsa pretendohet për besim dhe fe, janë në po atë masë një mediokritet dhe fanatizëm, si dhe një model injorance që do t'i mbyste në dëshpërim banorët e qiellit!

Pavarësisht nga pamja, po qe se njeriun që nuk e di se ç'është besimi i vërtetë, se me ç'gjuhë flet ndërgjegjja, që s'ka pjesë nga afërsia dhe dashuria hyjnore, që nuk i pranon për të mëdha gjërat e konsideruara të mëdha dhe për të vogla gjërat e konsideruara të vogla tek Allahu, shihet si fetar i plotë, kjo duhet të jetë mungesa më e madhe e respektit ndaj hyjnitetit dhe universalitetit të fesë. Armiku më i madh edhe i fesë, edhe i shkencës, është paraqitja e një pjese dëshirash dhe pasionesh tona diku si ide shkencore dhe diku si besim fetar. Kjo specifikë është te njerëzit një boshllëk me truall të gjerë dhe burimi i këtij boshllëku janë dobësitë e tyre dhe, në krye të këtyre dobësive, vijnë dobësia për t'u dukur mbi atë se ç'jemi dhe dobësia për t'iu hyrë pritjeve shumë kate mbi kapacitetin tonë. Është pikërisht kjo dobësi e dyfishtë që bëhen përpjekje për ta mbushur me një sërë vlerash shkencore dhe fetare të pranuar si të shenjta nga ndërgjegjja e përgjithshme. Më saktë, prej disave, feja kërkohet të përdoret pikërisht si një lëndë mbushëse për të mbushur boshllëqet e veta. Arma më e fuqishme e lidhur fort pas të vërtetës e ndërgjegjes përballë një dobësie njerëzore të tillë, është pasioni për të vërtetën dhe dashuria për dijen dhe shkencën. Sigurisht, nëse ka një eliksir që të fshijë myshkun e mendjeve të dukura si të ditura dhe ndryshkun e mendimeve të dukura si përkrahëse të fesë, ai është, pa dyshim, dashuria pasionante për Allahun, dashuria për të gjithë qenien si rrjedhojë e dashurisë për Të dhe pasioni për të

vërtetën. Kur zemrat të marrin vrull me pasion dhe shpirtrat të ngrihen kas me dashuri, të gjitha boshllëqet dhe dobësitë njerëzore ose bëhen pluhur e hi, ose shndërrohen në eliksir, në pije jetëdhënëse!¹⁵

BAZAT E BESIMIT

BESIMI

Fjala *iman* do të thotë besim, siguri. Si terminologji e fesë islame, *iman* (besim) do të thotë miratim dhe vërtetim i profetit Muhamed (s.a.s.) në konkluzionet fetare të njohura si kategorike (dharurat-i dinije) të sjella prej tij nga Allahu i Lartë, pranim pa lëkundje i gjërave të lajmëruara prej tij, besim me zemër se ato janë të drejta e të vërteta, do të thotë pohim i ndërgjegjshëm dhe *ndjerje* me zemër. Në lidhje me përkufizimin e besimit, ka pasur nga ata që, krahas miratimit me zemër, kanë shtuar edhe shprehjen "pohim me gojë". Ndërkaq, shumica e dijetarëve, pohimin (deklarimin me gojë) e kanë konsideruar kusht vetëm për zbatimin e konkluzioneve materiale-temporale. E thënë ndryshe, pohimin e kanë parë jo si thelbin dhe të vërtetën e besimit, por si kusht të tij. Duke u nisur nga kjo, edhe nëse një njeri që ka besuar me zemër, në disa situata, nuk e pohon dot besimin me gojë, besimi i tij vazhdon të jetë i vërtetë dhe i vlefshëm. Bie fjala, ashtu siç besimi i memecit është i vlefshëm, edhe besimi i personit i cili, përballë detyrimit për mohim ose herezi dhe rrezikut të jetës, mohon me gojë, vazhdon të mbetet i vërtetë. "Përveç atyre që, duke e pasur zemrën të ngopur plot besim, detyrohen ta mohojnë fenë dhe e thonë fjalën e mohimit vetëm me gojë, për ata që, pasi e kanë besuar Allahun, mohojnë duke ia hapur zemrën mohimit, shtresojnë në të herezinë, ka, nga ana e Allahut një ndëshkim të rëndë!" (Nahl, 16/106)

Politeistët kurejshë e shtrënguan Jasirin dhe familjen e tij të ktheheshin nga feja. Kur Jasiri me të shoqen, Sumeje, nuk pranuan, politeistët i copëtuan me anë të deveve. Amari (r.a.) që e pa se ç'pësuan i ati me *t'ëmën*, e tha me gojë atë që deshën politeistët. Profeti (s.a.s.) bëri të ditur se Amari përdori lejen e dhënë. Ajeti i mësipërm është zbritur për të njoftuar këtë leje.

Besimi është një pishtar që ndez Allahu brenda vetes së njeriut në përfundim të përdorimit nga njeriu të mendjes (arsyes) ose në përfundim të meditimit të universit dhe të vetvetes.

Besimi është edhe dritë, edhe fuqi. Njeriu që arrin besimin e vërtetë, mund ta sfidojë gjithësinë dhe, sipas fuqisë së besimit që ka, mund të shpëtojë nga trysnia e ngjarjeve dhe dukurive.

Të vërtetën e besimit, e cila është çështja më me rëndësi e njerëzimit, mund ta trajtojmë nga këndvështrime të ndryshme:

a. Besimi sipas çështjeve ose bazave që duhen pohuar

Specifikat që duhen besuar, Profeti (s.a.s.) i ka përmbledhur në gjashtë baza: besimi te Allahu, besimi te engjëjt e Allahut, besimi te librat e Allahut, besimi te të dërguarit e Allahut, besimi në botën tjetër dhe besimi te kaderi i Allahut.¹⁶ Në këtë *deklaratë profetike* të njohur si *hadithi Xhebrail*, besimi

¹⁵ M.Fethullah Gülen, *İflâh-ın Göründüğü Ufuk*, f. 10.

¹⁶ Shih. Muslim, *Iman*, 1; Ebu Davud, *Sunne*, 15.

trajtohet së bashku me konceptet islam dhe ihsan. Si i fundit i tre koncepteve të përmendura njëri pas tjetrit këtu, *ihsan* përcaktohet si *vetëdije e adhurimit sikur ta shihje Allahun*. Kjo na tregon këtë të vërtetë: për të kapur një horizont të tillë vetëdijeje, njeriu, para së gjithash, duhet t'i ngrejë mendimet dhe përfytyrimet mbi një besim të shëndoshë, bazat e të cilit i ka përcaktuar feja. Dhe këtë besim duhet ta ngulisë dhe thellojë me vlerat praktike të Islamit, si namazi, agjërimi, dhurimi etj.

b. Besimi sipas shtresimit në zemër

Asgjë nuk mund të dalë në fushën e ekzistencës në botën e jashtme e në vetveten tonë (në botën tonë të brendshme) pa e njohur Allahun, pa u mbështetur në fuqinë e Tij. Deklaratat e Kur'anit në formën "Krijuesi i çdo gjëje është Allahu"¹⁷, na mësojnë se çdo formim, ndryshim dhe transformim objektiv-subjektiv në ekzistencë, fiton ekzistencë me anë të aktit krijues të Tij. Prandaj themi se është Allahu që i jep ekzistencë besimit dhe orientimit të shfaqur **në subjektin (zemrën, vetveten)** e njeriut. Kjo e vërtetë është shprehur kështu në Kur'an: "Allahu jua bëri të dashur besimin dhe jua zbukuroi ndër zemra." (Huxhurat, 49/7) "Kë ta orientojë Allahu, ai është orientuar..." (Isra, 17/97)

Allahu (xh.xh.) nuk ia vë me zor në zemër besimin atij që nuk e kërkon besimin duke përdorur vullnetin e vet. Dhe le ta pohojmë menjëherë se nga kjo përjashtohen ata që Allahu i orienton me favorin detyrues (determinues) mbështetur mbi shumë urtësi të Tij që i dimë apo nuk i dimë. Dhënia njeriut besim dhe orientim nga Allahu varet nga zelli dhe përpjekja që ka për të treguar njeriu për këtë. Parashtrimet e bëra nga dijetarët suni nga ky këndvështrim mbi besimin mund t'i përmbledhim në këtë mënyrë: "Besimi është një dritë e ndezur ose e krijuar nga Zoti në zemrën e njeriut pasi njeriu të ketë përdorur vullnetin e vet të pjesshëm!"

c. Besimi sipas vlerave dhe mundësive që i ka përftuar njeriut

Besimi është një burim drite që, duke e çliruar njeriun nga kufijtë e ngushtë, statikë dhe mbytës të botës fizike, e bashkon atë në një të vetëm me botët jashtë tij dhe e ndriçon atë.

Duke u nisur nga fakti që besimi e bën personin bashkëbisedues të Allahut, i cili është zotëruesi i vetëm i tërë ekzistencës, dhe e lidh pas Tij, është një burim i madh force që i jep njeriut qetësi dhe nder.

¹⁷ Shih. En'am, 6/102; Ra'd, 13/16; Zumer, 39/62; Gafir, 40/62.

ALLAHU (XH.XH.) - QENIA ME E LARTE QE E KA KRIJUAR GJITHESINE DHE E ADMINISTRON ATË

Kuptimi i fjalës së lartë 'Allah'

Lidhur me fjalën e lartë 'Allah', duke marrë për bazë deklaratat e Allahut me të cilat Ai ua ka bërë të njohur veten njerëzve, robve të vet, dijetarët muslimanë kanë thënë kështu: "Allah është emri i **qenies** më të lartë me ekzistencë në vetvete (vaxhibul vuxhud - qenie e domosdoshme) dhe të denjë për të gjitha lavdërimet dhe falenderimet. Cilësimi kushtëzues "ekzistent në vetvete" në këtë përkufizim shpreh faktin se mosekzistenca e Allahut nuk mund të mendohet, se, për të ekzistuar, Ai s'ka nevojë për ndihmën dhe mbështetjen e një qenieje tjetër, për rrjedhojë, se Ai është krijuesi, drejtuesi dhe administruesi i gjithësisë. Kurse cilësimi kushtëzues "i denjë për të gjitha lavdërimet dhe falenderimet" tregon se Allahu zotëron emra dhe attribute që shprehin përsosmëri dhe transcendentalitet. Në tekstet islamike, fjala e lartë Allah ka ardhur duke u përdorur qysh në krye të herë si emër i posaçëm dhe i përveçëm i të adhuruarit (**qenies** që i bëhet falje, lutje e adhurim) të vërtetë dhe i krijuesit të vetëm. Për këtë shkak, ky emër nuk i është dhënë ndonjë qenieje tjetër veç Tij, si dhe në gjuhën e kombeve muslimane nuk është përdorur në ndonjë mënyrë në shumës.

Kuptimi i besimit te Allahu

Besimi te Allahu, **qenia** e vetme dhe më e lartë që e ka krijuar gjithësinë, që e administron dhe të Cilit i bëhet falje, lutje e adhurim, është e para dhe themeloria e bazave të besimit. Në të gjitha fetë hyjnore, ekzistenca dhe uniteti i Allahut (Zotit të gjithësisë) është bërë baza besimore më e rëndësishme, sepse të gjitha bazat fetare mbështeten mbi besimin te Allahu dhe parimin e unitetit të Tij.

Kuptimi i besimit te Allahu do të thotë:

- besim se Ai ekziston dhe është një;
- besim se Ai zotëron attribute të larta dhe transcendentale;
- besim se Ai s'ka të bëjë me asnjë cilësi dhe ngjashmëri që bën aluzion për mangësi dhe të metë.

Njohja e Allahut është synimi i krijimit tonë dhe qëllimi final i natyrës sonë. "Atëherë, ti, duke u larguar nga fetë e shtrembra, ktheje fytyrën dhe qenien tënde në drejtim të Islamit që është feja e drejtë dhe e vërtetë, pra, vepro në përputhje me atë natyrë që Allahu e bëri parim në krijimin e njerëzve. Dhe askush nuk mund ta ndryshojë krijimin e Allahut. Ja, kjo është feja e drejtë dhe e vërtetë, por shumica e njerëzve nuk e kuptojnë këtë, nuk e dinë!" (Rum, 30/30)

Njeriu është krijuar për ta njohur Zotin e tij që e ka krijuar, për ta besuar dhe për ta adhuruar Atë. Në ajetin kur'anor, për këtë specifikë është tërhequr vëmendja në këtë mënyrë: "Unë i krijova xhindët

dhe njerëzit që të më njohin vetëm mua si Zot dhe vetëm mua të më falen e të më adhurojnë!" (Dhariat, 51/56)

Këtu Allahu, duke ua tërhequr vëmendjen njerëzve dhe xhindëve që i quajnë për Zot gjërat veç Allahut, thotë: "Unë i krijova ata jo për t'iu falur të tjerëve, por për të më adhuruar mua!" Shkaku që këtu flitet vetëm për njerëzit dhe xhindët ndërsa Allahu ka krijuar tërë gjithësinë, është ky: të gjitha qeniet në gjithësi janë vazhdimisht në gjendje faljeje, lutjeje dhe adhurimi ndaj Allahut. Kjo gjendje nuk është për ta e zgjedhshme dhe e vullnetshme, kurse njerëzve dhe xhindëve u është dhënë e drejta e zgjedhjes dhe e vullnetit. Ata duhen parandaluar që të mos drejtohen nga sendet e tjera duke rënë, kështu, në politeizëm.

Njerëzimi dhe besimi te Allahu

Është pothuaj e pamundur të gjesh në histori ndonjë popull jobesimtar. Çdo popull apo shoqëri ka besuar në një fuqi të lartë. Fundja, besimi në një fuqi të lartë përmbahet në natyrën e njeriut.

Sot, studimeve antropologjike të kryera vazhdimisht qysh herët nga ana e specialistëve të historisë së feve për çështjen e besimeve të para mbështetur mbi fetishizmin, totemizmin dhe animizmin, i është shtuar edhe një e re. Studimet e fundit të kryera mbi fiset primitive në juglindje të Australisë, që i takojnë formës më të thjeshtë të jetës njerëzore, kanë parashtruar faktin se ata i besojnë një qenieje të lartë. Studimet e reja të kryera në fushën e historisë së feve, dokumentojnë se edhe në shoqëritë primitive ekziston një konsideratë e mbështetur mbi ekzistencën dhe unitetin e Zotit, se politeizmi ka dalë më vonë si një deviacion. Nga dita e ekzistencës së parë të njeriut e gjer më sot, ky shpjegim dhe përshkrim besimi ka ekzistuar gjithmonë edhe pse në forma të ndryshme. Prania ose, të paktën, dukja e këtij besimi në të gjitha sistemet e mendimit të djeshme e të sotme, brenda të cilave ndodhet njeriu, tregon se në asnjë periudhë njerëzimi s'është privuar nga ky mesazh. Kur'ani na njofton se njeriu qysh nga fillimi nuk është lënë i paorientuar e pa qëllim: "... dhe nuk ka asnjë bashkësi që të mos i ketë ardhur një i dërguar për ta paralajmëruar." (Fatir, 35/24)

Dhe përsëri lidhur me këtë specifikë, në një ajet tjetër thuhet kështu: "Të gjithë njerëzit përbënin një umet, bashkësi. Pasi mes tyre filluan mosmarrëveshjet, Allahu u dërgoi atyre nga mesi i tyre lajmëtarë si përgëzues e paralajmërues." (Bekare, 2/213)

Edhe ky ajet na njofton se nga Profeti Adem, njeriu i parë dhe profeti i parë mbi tokë, e gjer më sot, njerëzit kanë pasur vazhdimisht mundësinë për t'u ndodhur dhe zhvilluar nën vëzhgimin e një profeti. Njerëzit e parë qenë një bashkësi në sajë të profetëve të parë. Me ndikimin që linte në ndërgjegjet e tyre fakti që vinin prej një origjine e prej një rrënje, ata qenë një e tërë dhe një bashkësi, nuk qenë të pafe, të egër e agresorë. Por më vonë, për një sërë shkaqesh simptomatike, ranë në mosmarrëveshje e në kundërshtim me njëri-tjetrin dhe e prishën bashkimin.

Fuqia e Pafundme që nuk e ka lënë milingonën pa kryetar dhe bletën pa mbretëreshë, edhe njerëzimin kurrë nuk e ka lënë pa profet. Profetët, si njerëz të pajisur në mënyrë të posaçme u kanë kumtuar njerëzve se si mund të jetohet një jetë në përputhje me pëlqimin e Allahut. Dhe të vërtetat që kumtuat, i jetuan thellësisht dhe para gjithë të tjerëve, gjë që quhet përfaqësim me anë të shembullit personal.

Duke u dhënë njerëzve shpresë me rezultatin e të mirës dhe duke ua treguar fundin e të keqes, profetët u kanë treguar atyre rrugët që shkojnë për tek pëlqimi i Allahut.

Allahu ka dërguar profetë njëri pas tjetrit me qëllim që ta përshtatin ndaj origjinale natyrën njerëzore të programuar në themel të pastër e të orientuar dhe për të eliminuar pengesat mes zemrës së tij dhe të vërtetave dhe e ka mbushur njeriun me shpresë me anë të rezultateve të të mirës dhe e ka ftuar për maturi dhe syçelësi duke i treguar fundin e të keqes. Por ç'e do se ngaqë disa nuk kanë shpëtuar dot nga robëria e dëshirave dhe pasioneve të veta, kurse disa të tjerë, nga rënia në rrjedhat e mendjemadhësisë, padrejtësisë dhe dhunës, në çdo periudhë të re, duke i ndryshuar pak mosmarrëveshjet dhe kontradiktat mes tyre, por me siguri duke i shumëfishuar, kanë ecur në rrugë të veçanta.

A është i mundur mohimi i Allahut?

Njeriu që nuk mundet ta mendojë as fshatin, vendbanimin më të vogël, pa kryeplak, si mund ta mendojë gjithë këtë gjithësi pa drejtues? Njeriu që e di se edhe një shtëpi-barakë nuk mund të bëhet pa një plan dhe projekt, a mund ta mendojë se si është formuar pa plan, në mënyrë spontane, arkitektura e kësaj gjithësie pa anë e pa fund?

Vetëm se është një e vërtetë se nga krijimi i njeriut gjer më sot, krahas atyre që e kanë besuar Zotin, ka pasur edhe mosbesimtarë dhe nga ata që e kanë mohuar Atë. Siç ka ndodhur dje, ashtu edhe sot, të dyja këto pole kanë përfaqësuesit e vet. Ç'mund të jetë, vallë, shkakun që madje edhe njerëz në dukje shumë të zgjuar zënë vend në radhët e mosbesimit? Na duhet të qëndrojmë mbi këtë pikë.

Faktorët që e çojnë njeriun në mohim mund t'i trajtojmë nën katër nëntituj:

a. Vështrimi sipërfaqësor: Njeriu i krijuar në themel me një konstitucion të përshtatshëm për t'i kuptuar të vërtetat lidhur me qëllimin e ekzistencës, disa herë, si rezultat i një vështrimi sipërfaqësor, nuk **tregon lëkundje** për ta pranuar një gjë të pamundur. Ai e sheh të pamundurën të mundur, të shtrembrën, të vërtetë. Por po qe se i njëjti njeri do ta vështronte thellësisht të njëjtën gjë, ndoshta nuk do të **tregonte lëkundje** për ta hedhur poshtë pohimin që pati bërë pak më parë. Për shembull, në botën fizike, njohuritë që mund të fitojë mbi diametrin e diellit njeriu që s'ka asnjë njohuri mbi këtë, që nuk ndjen nevojën për të pyetur ndonjë që di dhe duke e vëzhguar diellin nga larg me sy të lirë, janë të qarta; për të, dielli do të jetë një trup qiellor i ndritshëm në madhësinë e një topi.

Si kjo, edhe njeriu që e sheh gjithësinë me vështrime sipërfaqësore, të pavëmendshme dhe indiferente, nuk mund ta dallojë se gjithësia funksionon me një regjim më të ndjeshëm dhe të përpiktë se një fabrikë ose makineri dhe se ka një bukuri magjepsëse. Ai nuk e sheh dot diturinë dhe fuqinë që e ka krijuar këtë gjithësi që ka një rregullsi të mrekullueshme dhe bie në mohim.

b. Sjellja imituese që buron nga nënvleftësimi i mendimit: Një tjetër specifike që i shtyn njerëzit në mohim është imitimi. Shumë njerëz i pranojnë gjërat që shohin nga etërit e nga mjedisi pa u bërë asnjë kritikë, kurse do të duhej që zakonet dhe traditat si dhe pikëpamjet e personave që u dëgjohet fjala, të testoheshin duke marrë për bazë kriteret hyjnore. Po qe se këta njerëz do të arrinin të mendonin se çdo thënie e çdo njeriu nuk mund të jetë e drejtë dhe e besueshme, se mendja e njeriut është e paaftë për ta konceptuar e vetme çdo gjë të drejtë, nuk do të binin në këtë gabim. Me të vërtetë, a nuk është një argument i hapur i këtij fakti që, gjatë gjithë historisë, veçanërisht filozofët kanë bërë deklaratatë të tilla që e kanë hedhur poshtë njëri-tjetrin, që asaj që dikush i ka thënë e bardhë, tjetri i ka thënë e zezë? Ja

pra, Zoti ka dërguar udhëzues (profetë) të pajisur me kritere hyjnore me qëllim që njerëzit të mos e humbin toruan, që ta gjejnë të drejtën, të mirën e të bukurën.

c. Qëndrimi me paramendim ose i kushtëzuar: Ata që, duke e trajtuar shfaqjen e ekzistencës, i kanë ngritur apo i ngrenë teoritë e tyre duke thënë se "dimensioni transcendental nuk është racional", i mbyllin qysh në fillim të gjitha rrugët e mundshme që çojnë në një dimension të tillë, me pretendimin se "nuk është racional".

Në të përgjithshmen e botëkuptimit shkencor materialist, ekzistenca e një krijuesi të padukshëm kundërshtohet dhe hidhet poshtë në mënyrë paraprake. Pra, qysh në krye, zhvillohet një metodë e ashtuquajtur "shkencore" (!), sipas së cilës, "nuk ka krijues, nuk ka dimension transcendental, çdo gjë duhet zgjidhur brenda marrëdhënies shkak-pasojë". Më qartë, mendësia materialiste e fillon punën duke thënë "nuk ka Zot". Ç'ndodh pastaj? Meqë materialistët ua zënë shtegun të gjitha pyetjeve me mundësi për të kaluar në çështjen e dimensionit transcendental duke thënë "nuk është shkencore", vërtiten brenda një rrethi vicioz në kornizën e kufijve të përvijuar nga vetë ata pa i gjetur përgjigje përfundimtare asnjë pyetjeje. Në themel, këta njerëz nuk kanë bërë ndonjë përpjekje për ta dëgjuar zërin e arsyes. Si rrjedhojë e faktit që janë pozicionuar qysh në fillim kundër besimit, kanë shpikur **këllëfe** të tillë si "shkencor - joshkencor" dhe "racional - joracional". Meqë kanë vështuar të kushtëzuar nga paragjykimi se arsyeja nuk e pranon ekzistencën dhe domosdoshmërinë e një fuqie transcendentale, nuk e kanë parë dot të vërtetën.

Duke u nisur nga këto, mund të themi se shqetësimi i vërtetë i mendësisë së kushtëzuar në mohimin e Zotit nuk është ta përdorë arsyen për ta gjetur të vërtetën, por ta përdorë arsyen kundër të vërtetës së fesë hyjnore. E thënë ndryshe, arsyeja në duart e tyre është mjet që e përdorin për të kundërshtuar të vërtetat e njoftuara nga **revelacioni** hyjnor. Sa herë që të shfaqet domosdoshmëria për ta shpjeguar me dimension transcendental çështjen që e kanë marrë për ta trajtuar, përgjigjen e kanë gati: "Por kjo nuk është shkencore!" "Ky nuk është qëndrim racional!" Shihet se ata që e kanë vendosur paraprakisht të mohojnë, kanë përgatitur një metodë shkencore sipas tyre për një qëllim të paracaktuar dhe pastaj, çdo lloj qëndrimi apo trajtimi që e përgënjeshtrojnë këtë qëllim të paracaktuar, e kundërshtojnë dhe e hedhin poshtë duke thënë se "s'është shkencore"!

Materialistët, të cilët, duke ia mbyllur qysh në krye zemrën të vërtetës së ekzistencës së një Krijuesi të padukshëm, të fshehtë, përpiqen ta shohin çështjen vetëm nga një këndvështrim, në fund të këtij qëndrimi të tyre mbeten të detyruar ta kërkojnë "Krijuesin" mes gjërave ose materies së krijuar. Për shembull, një shkencëtar materialist vëzhgon gjithësinë dhe ekzistencën, vëzhgon ngjarjet dhe dukuritë dhe fillon interpretimin duke vendosur që më parë me anë të parapranimit "nuk ka gjë tjetër veç këtyre që po shoh". Ai nuk jep vetëm informacion mbi gjërat që ka vëzhguar. Bie fjala, sheh një qelizë dhe, lidhur me strukturën e DNA-së në bërthamën e asaj qelize, nxjerr një "konkluzion" të përgjithshëm, sipas të cilit, "në kushte të caktuara, DNA-ja kopjon vetveten", gjë që, më shumë se një dhënie njohurie lidhur me situatën në fjalë, është interpretim i lindur nga një kushtëzim ideor, një konkluzion i dhënë para kohe. Ky konkluzion është një pandehmë.

Duke mos qenë një mundësi e fuqishme e arritur nga arsyeja e shëndoshë si përfundim i një përpjekjeje teorike të saj, kjo pandehmë është një dëshirë e formësuar nën trysinë e paragjykimëve dhe e dobishme për të mbrojtur pasionet e atyre paragjykimëve. Kështu, në vende të ndryshme, Kur'ani thotë kështu:

"... ata vetëm sa bëjnë sipas disa pandehmave dhe vetëm sa nxjerrin nga koka e tyre..." (Junus, 10/66)

"Ata vetëm bëjnë sipas pandehmave të veta dhe dëshirave dhe pasioneve të nefsit (vetvetes, egos) të tyre." (Nexhm, 53/23)

Duke e dënuar arsyen për të menduar dhe gjykuar qysh në krye me këmbëngulje në një drejtim, arrihet në një gjendje të tillë që personi të mos i dëgjojë më fjalët (revelacionin) që janë në pozitën e udhëzuesit të mendimit dhe gjykimit dhe pse s'i dëgjon, nuk është në gjendje të mendojë e gjykojë. Shikimi i kushtëzuar i vlerave besimore dhe islame, duke nisur me të vërtetën e teuhidit, është pengesë për orientimin. Ky është edhe njëri prej mesazheve të faktit që Kur'ani është udhëzues i rrugës së drejtë për ata që ruhen nga gabimet, të këqijat dhe mëkatet. Nga ana tjetër, mendja dhe arsyeja janë vetëm një mjet. Kur këto ndriçohen me dritën e revelacionit hyjnor, e kryejnë funksionin e tyre të vërtetë nën shoqërimin e zemrës. Ndryshe, njeriu që del në rrugë duke i besuar vetëm mendjes (arsyes), mbetet në gjysmë të rrugës.

d. Frika nga humbja e kënaqësive të jetuara. Kokat që me një sërë motivesh egoiste nuk duan ta pranojnë ekzistencën e Allahut, përpiqen që, pasi ta mohojnë Allahun, t'i gjejnë vetes argument qetësues, sepse ata mendojnë se, po t'i besojnë Allahut dhe ringjalljes, do të privohen nga të gjitha kënaqësitë që përjetojnë. E thënë ndryshe, meqë e dinë se besimi te një autoritet (ose fuqi) i lartë që do t'u kërkonte llogari, kërkon shmangien dhe veçimin nga kënaqësitë jolegjitime me të cilat janë lidhur ngushtë, e shohin mohimin si strehim. Sepse ata kërkojnë t'i vazhdojnë kërkesat dhe dëshirat sipas qejfit të vet pa u marrë në llogari. Dhe për këtë bëjnë sikur s'e shohin çdo të vërtetë që nuk u përshtatet këtyre dëshirave ose kërkojnë - me këllëfe gjoja shkencore - rrugë për t'i eliminuar ato të vërteta. Ja, ky është motivi më i fuqishëm që shtrihet në themelin e të gjitha mendësive mohuese. Me të vërtetë, në Kur'an thuhet kështu:

"Po qe se nuk e pranojnë këtë ftesën tënde, dije se ata vetëm sa bëjnë sipas dëshirave dhe pasioneve të veta. Mirëpo, a mund të ketë njeri më të hutuar e të prapësuar se ai që shkon pas dëshirave dhe pasioneve të veta pa pasur ndonjë argument nga Allahu?" (Kasas, 28/50)

Ky dhe ajete të ngjashëm portretizojnë njerëzit të cilët, ashtu siç ka ndodhur në të shkuarën, edhe në ditët tona, në vend të të vërtetës, e lidhin zemrën pas një sërë fantazish dhe utopish. Në të vërtetë, në themelin e të gjitha konsideratave materialiste ka një kërkim me bazë ikjen nga feja. E thënë ndryshe, është fjala për një pasion materialist mbështetur mbi dëshirën për të bërë një jetë të pakushtëzuar dhe sipas vetes, duke ikur nga përgjegjësia e dhënies llogari për jetën e jetuar.

ARGUMENTET E EKZISTENCËS SË ALLAHUT

Ekzistenca e Allahut është aq e qartë sa të mos ketë nevojë për argument. Mirëpo Krijuesi i Lartë, ekzistenca e të cilit është më e qartë se çdo gjë, për sa i përket Individualitetit, është një Qenie e lartë dhe e pashoqe, aq sa sytë të mos mund ta shohin vetë Atë, të mos mund ta njohin dot Atë. Nisur nga kjo, Krijuesi i Lartë kërkon të na e bëjë të njohur veten jo me anë të Individualitetit, por me anë të veprave që ka krijuar dhe udhëzuesve që ka dërguar. Argumentet (provat) që na flasin për Të ose që na çojnë tek Ai, janë të panumërt. Argumentet më të mëdha janë:

- a) Gjithësia
- b) Kur'ani
- c) Profeti ynë (s.a.s.)

a) Gjithësia

Gjithësia, e cila është një vepër arti e shkëlqyer, zotëron hollësi, bukuri dhe fshehtësi që do t'i ngacmonin me të tepërt të gjitha ndjesitë racionale dhe sentimentale të njeriut. Në këtë gjithësi, për sytë që mund të shohin, çdo gjë e deklaron me të madhe dhe në një mënyrë që nuk do të linte vend për dyshim ekzistencën e Tij:

"A mund të ketë dyshim për ekzistencën e Allahut që ka krijuar qiejt dhe tokën?" (Ibrahim, 14/10)

Çdo mendje (arsye) e pakushtëzuar për të mohuar, duke u nisur nga arkitektura **syverbuese** e gjithësisë dhe funksionimi harmonik marramendës i saj, mundet të përftojë të dhëna objektive nga gjithësia dhe mundet ta lexojë atë fletë-fletë pothuaj si një libër.

Rregulli dhe harmonia në një vend a nuk tregojnë për dikë që e ka ngritur atë rregull dhe harmoni? Arti në një vepër, a nuk tregon për artistin e tij? Gjithashtu, bujaria dhe mikpritja në një vend, a nuk tregojnë për bujarin dhe mikpritësin e atij vendi? Duke u nisur nga kjo, po qe se njeriu mundet ta vështrojë këtë gjithësi me syrin e mendjes e të zemrës të padëmtuar nga indiferentizmi dhe parakushtëzimi, do të arrijë t'i shohë të vërtetat e saj, si artin, rregullin, harmoninë, planin dhe bujarinë dhe do të besojë se këto janë nga një argument ose provë më vete që tregojnë ekzistencën e një Krijuesi me dituri, fuqi dhe bujari të pafund. Ndërkaq, këtu duhet ta kujtojmë edhe këtë që, edhe nëse kjo harmoni dhe bukuri janë të mjaftueshme për të kuptuar qenien e një krijuesi, janë në vetvete të pamjaftueshme për të kuptuar veçoritë e Krijuesit, mënyrën se si mund t'i afrohem Atij, se si mund t'ia shprehim Atij ndjenjat tona për gjithë këto të mira që na ka dhuruar. Janë profetët e dërguar prej Tij dhe revelacioni hyjnor që na japin mësim mbi Krijuesin e Lartë dhe si duhet ta adhurojmë Atë.

b) Kur'ani

Kur'ani është nga argumentet dhe provat më të mëdha të ekzistencës së Allahut. Një libër kaq gjithëpërfshirës, që bën fjalë për të kaluarën, për të ardhmen, për ringjalljen dhe jetën e pasme, që jep udhëzime mbi gjithësinë dhe jetën e pasme të pasosur, para së gjithash pohon me të madhe Individualitetin e Lartë që e ka dërguar. Në Kur'an janë përgjigjet e pyetjeve që kanë qëndruar para njeriut të çdo periudhe: "Kush jam unë?" "Pse jam ky që jam dhe ku po shkoj?" "Ç'punë kam në këtë botë nga e cila jam i detyruar të ndahem me anë të vdekjes?" "Kush më dërgoi në këtë botë dhe ç'kuptim kanë këto vende ku kam ardhur jashtë vullnetit tim?" "Megjithëse nuk dua të largohem që këtu, pse nuk mbetem dot?" "Ç'është vdekja?" "A ekziston jeta e përtejme?" Nëse ekziston, si është?"

c) Profeti ynë (s.a.s.)

Me Librin që iu shpall dhe me mënyrën e jetesës që e parashtrroi dhe e praktikoi vetë personalisht sipas atij Libri si dhe me synimet që tregoi, profeti Muhamed (s.a.s.) është një shembull i gjallë që e bën të njohur Allahun. Fakti që ai formoi nga fiset beduine të shkretëtirës një shoqëri që ngriti qytetërime që do t'u flisnin shekujve dhe fakti që lëvizjen që i dha ai njerëzimit e bëri dinamike që të ndikonte thellësisht edhe ditët tona, është një argument i fuqishëm që i ndihmon njerëzit për ta njohur Allahun.¹⁸

¹⁸ Më tutje do të qëndrohet sërish si mbi Kur'anin, ashtu dhe mbi Profetin.

PSE NUK E SHOHIM DOT ALLAHUN?

Janë shumë shkaqe për të cilat ne nuk mundemi ta shohim Allahun. Këto mund të përmbliken në katër pika:

- Ne jemi krijuar me një kapacitet që s'na jep mundësi ta shohim Allahun
- Allahu nuk ka të ngjashëm e të kundërt
- Allahu fshihet nga intensiteti i shfaqjes
- Kështu e kërkon bota e **provës**

Le të përpiqemi t'i shtjellojmë shkurt këto katër pika.

Ne jemi krijuar me një kapacitet që s'na jep mundësi ta shohim Allahun

Ne nuk mund ta shohim Allahun sepse krijimi ynë ose, ndryshe, forma në të cilën jemi krijuar, nuk është e përshtatshme për këtë gjë. Edhe një profet i madh si Musai (a.s.) nuk e pati duruar dot shfaqjen e Allahut në mal dhe qe rrëzuar pa ndjenja.¹⁹

Me kapacitetin tonë të kufizuar, ne, në këtë botë, jo vetëm Allahun, por edhe shumë qenie të krijuara prej Tij nuk mundemi t'i shohim. Numri i qenieve apo gjërave që mundemi t'i shohim në këtë botë fizike, mbetet shumë i vogël ndaj numrit të qenieve apo gjërave që nuk mundemi t'i shohim. Kur me këto shqisa të kufizuara nuk mundemi ta përfshijmë as gjithësinë e krijuar nga Allahu, si mund ta përfshijmë Krijuesin e saj?²⁰ Megjithëkëtë, në jetën e pasme, besimtarët do ta meritojnë ta shohin Allahun me përjashtim të përmasave cilësore dhe sasiore të Tij.

Allahu nuk ka të ngjashëm e të kundërt

Një shkak tjetër i rëndësishëm që nuk e shohim dhe nuk e njohim dot Allahun, është se Allahu nuk ka të ngjashëm e të kundërt me vetveten. Çfarëdo që të shohim e çfarëdo që të njohim te një qenie, e shohim dhe e njohim sepse ekzistojnë të ngjashmet apo të kundërtat e saj. Për shembull, po të mos ekzistonte të ftohtit, kurrë nuk do ta dinim dhe kuptonim ç'është të nxehtit, po të mos ekzistonte hidhësira, kurrë nuk do ta dinim dhe kuptonim ç'është ëmbëlsira, po të mos ekzistonte drita, kurrë nuk do ta dinim dhe kuptonim ç'është errësira. Kështu, ne njerëzit, kur dikush na tregon për diçka që s'e kemi parë dhe njohur kurrë më parë, atij që na tregon i bëjmë pyetje të tilla, si "si është?", "ç'gjëje i përngjet?", duke u përpjekur të kapim shenja mbi përbërjen e gjësë për të cilën po na flitet.

¹⁹ *Shih. A'raf, 7/143.*

²⁰ Duke u shprehur si në vijim, Kur'ani bën të ditur se sytë nuk mundën ta shohin Allahun: "*Shikimet nuk mund ta shohin Atë, por Ai i sheh shikimet!*" (En'am, 6/3)

Të gjitha këto tregojnë se njeriu ka dy rrugë për ta njohur materien. E para, përpjekja për ta njohur një gjë që s'e kemi parë e s'e kemi njohur duke u nisur nga gjërat e tjera të ngjashme me të, të cilat i kemi parë dhe njohur; e dyta, përpjekja për ta njohur një gjë që s'e kemi parë e s'e kemi njohur, duke u nisur nga gjërat e tjera të kundërta me të, të cilat i kemi parë dhe njohur.

Ja, prandaj ne njerëzit e kemi të pamundur ta konceptojmë Allahun, sepse në ekzistencë Ai nuk ka as të ngjashmin, as të kundërtin e vet. Kështu na e njeh veten Allahu në suren Ihlas të Kur'anit. Kurse në një ajet tjetër thuhet kështu: "*Lejse ke mithlihi shej'un*", "**Nuk ka gjë që t'i përngjasë Atij!**" (Shura, 42/11)

Allahu fshihet nga intensiteti i shfaqjes

Allahun nuk e shohim dot sepse Ai fshihet ose bëhet i padukshëm për shkak të intensitetit të shfaqjes. Le të përpiqemi ta tregojmë se ç'do të thotë kjo duke marrë si shembull diellin. Le ta supozojmë se dielli do ta mbulonte tërë horizontin, veç tij s'do të shihnim dot mbi krye asgjë tjetër dhe, pra, s'do të kishte as natë, nuk do të dinim ç'është drita dhe nuk do të flisnim dot për dritën. Kështu, edhe dielli, edhe drita e tij, për shkak të pranisë së tyre të vazhdueshme dhe intensive, do të bëheshin të padallueshëm, të shmangshëm nga vëmendja, për pasojë, të fshehur e të padukshëm.

Edhe Allahu, jashtë administrimit të të cilit nuk mund të mendohet as dhe një çast i vetëm, e bën ekzistencën e vet të ndjehet me anë të attributeve si jeta, dituria, mëshira, vullneti dhe fuqia, çdo çast dhe pandërprerë aq intensivisht në gjithësi, saqë për indiferentët bëhet që të mos u shkojë nëpërmend e të mos ta kujtojnë.

Kështu e kërkon bota e provës

Një shkak tjetër i rëndësishëm që nuk e shohim dot Allahun, është se kjo botë është botë prove. Po qe se Allahu do të na kishte krijuar ndryshe nga struktura jonë ekzistente, me një konsistencë që të mund ta shihnim dhe vëzhgonim Atë, atëherë, e fshehta e provës do të **prishej**. Meqë çdo njeri do ta shihte Allahun me sytë e ballit, çdo njeri pa përjashtim do ta besonte dhe, atëherë, s'do të lindte as qëllimi për provë. Kjo do t'i ngjiste rastit të atij mësuesit që pasi të jepte pyetjet e provimit, të shkruante në dërrasë të zezë përgjigjet e pyetjeve. A nuk ishte qëllimi i kësaj bote që të dilnin në shesh besimtari me mosbesimtarin, e mira me të keqen? Prandaj, ndërsa na e ka fshehur veten nga sytë e ballit sepse kështu e kërkon prova e kësaj bote, Allahu, me veprat që ka krijuar, pra, me veprat e artit që i ka ekspozuar në panairin e gjithësisë dhe me librat dhe profetët që ka dërguar, na e ka treguar ekzistencën për sytë e zemrës. Në këto kushte, ata që, duke parë veprat e ekspozuara para tyre me qëllim për t'i shqyrtuar dhe kuptuar, munden ta shohin krijuesin e tyre artist dhe që u vënë veshin profetëve prijës e udhëzues që shpjegojnë qëllimin e krijimit dhe ekzistencës së këtyre veprave, do ta fitojnë provën, kurse ata që nuk shohin apo nuk duan të shohin gjë, do ta humbin provën!

Allahu (xh.xh.) e tregon veten

Ne mund ta njohim Allahun veçse në atë masë që të na e tregojë Ai veten, sepse është prapë vetë Ai që e njeh më mirë veten dhe që e tregon më mirë veten.

Surja Ihlas (Singeriteti) ka një shprehje tejet koncize dhe të mrekullueshme që tregon për ekzistencën, unitetin dhe pangjashmërinë e Allahut. Çdo ajet është rrjedhojë logjike e ajetit paraardhës dhe të gjitha ajetet janë si argumente të njëri-tjetrit.

Kjo sure është quajtur "ihlas", sepse e shpreh në mënyrën më të qartë e më të bukur teuhidin, besimin monoteist islam mbi **Allahun, Zotin e gjithësisë**, që është parimi themelor i fesë islame. Kjo sure na jep njohuritë më të qarta e më të kulluara mbi çështjen e ekzistencës dhe unitetit të Allahut, larg çdo mendimi të ngatërruar e të gabuar që nuk i përshtatet hyjnitetit të Tij. Kuptimi i sures është kështu:

"Thuaj: Ai, Allahu është Ehad (një i vetëm).

Allahu është Samed (nuk ia ka nevojën asgjëje).

Nuk ka lindur kënd dhe nuk është i lindur.

Asgjë dhe askush nuk është identik me Të!"²¹

Allahu është Ehad. Cilësimi *ehad* në këtë ajet na tregon neve se Allahu është një dhe i vetëm. Edhe nëse shumë qenie që e kanë cilësinë e unitetit janë një si numër, që të gjitha janë të krijuara, janë krijesa, u përkasin llojit të qenieve të krijuara. Kurse Allahu i vetmi Një, i pashoqi dhe i pakrahasueshmi Një, i ndryshëm në cilësi nga të gjitha cilësitë që mund të mendohen, që mund të marrin formë në fantazi, që mund të imagjinohen dhe përshkruhen. Është Një-shi që zotëron të gjitha atributet e përsosmërisë. Për rrjedhojë, është dhe Një-shi i denjë për t'iu falur e për ta adhuruar.

Allahu është Samed. Çdokush dhe çdo gjë ka nevojë për Të, ndërsa Ai s'ka nevojë për askënd dhe për asgjë. Në gjithësi ka një rregullsi të mrekullueshme dhe është e pamundur që kjo rregullsi të jetë e vetvetishme. Çdo gjë e gjallë dhe jo e gjallë ka nevojë të pamënjatueshme për Allahun si për të dalë nga e paqena në fushën e qenies dhe ekzistencës, ashtu dhe për ta vazhduar qenien dhe ekzistencën e vet. Allahu e ka krijuar gjithësinë jo se është nevojtar për të, por për ta bërë të njohur veten, për të treguar madhësitinë e tij dhe për të **bërë mirësi dhe favor**. Çdo gjë qëndron në këmbë në sajë të Tij, kurse Ai që nuk është nevojtar për asgjë (Samed), qëndron në këmbë, ekziston në mënyrë të vetvetishme e të vetëmjaftueshme.

Allahu nuk ka lindur kënd. Me këtë ajet është shkukur nga rrënjët dhe fshirë çdo **lloj shirku dhe kufri (politeizmi dhe mohimi)**. Ky ajet është përgjigje për shumë mendime dhe ide të gabuara që kanë të bëjnë me politeizmin. Më së pari, me kuptimin e parë që vjen ndërmend të këtij ajeti, u bëhet e ditur njerëzve se *Allahu kurrsesi s'është si njerëzit, që ka grua e fëmijë*. Kurse në mënyrë konvencionale tregohet se ekzistenca, gjithësia nuk është një gjë e ndarë prej Tij ose e dalë si produkt ose teprice prej Tij, siç pretendojnë një pjesë filozofësh. Kështu tërhiqet vëmendja për faktin se qeniet apo gjërat që lindin qenie apo gjëra të tjera, që pjesëtohen, që shtohen e shumohen duke nxjerrë produkte e teprica dhe që pësojnë ndryshime, nuk mund të jenë zot.

Allahu nuk është i lindur. Siç nuk ka lindur kënd, Allahu s'është as i lindur, pra nuk ka dikush apo diçka që ta ketë lindur Atë. E thënë në mënyrë më të përgjithësuar, ashtu siç qenia dhe ekzistenca nuk janë pjesë e individualitetit të Tij, nuk janë gjë e dalë prej Tij, ashtu dhe nuk ka ndonjë qenie, vullnet dhe fuqi tjetër që të jetë shkak për qenien dhe ekzistencën e Tij. Sepse Allahu është *Vaxhibul Vuxhud, Qenie* e Domosdoshme, i vetëqenë dhe vetekzistent. Ai nuk është një qenie e lindur nga dikush *më pas* dhe e sjellë në ekzistencë *më pas*. Ekzistenca e tij është e paraqenë²². Nuk ekziston çasti kur Ai të mos ketë qenë.

²¹ Ihlas, 112/1-4.

²² ezeli.

Askush dhe asgjë nuk është identik me Allahun. Allahu nuk ka të ngjashëm as në individualitet, as në attribute, as në akte. Ai nuk ka shok, nuk ka ndihmës, nuk ka partner, nuk ka as ekuivalent, as antagonist, as analog. Gjërat e *pasqena* janë që të gjitha vepër e Tij dhe këto vepra, sado të përsosura që të jenë, si Ai nuk mund të jenë!

Ai nuk i ngjan asgjëje. Ai s'ka të bëjë me asgjë që mund të imagjinohet, që mund të marrë formë në mendje, sepse çdo gjë e tillë është e krijuar. Ato i kanë të krijuara edhe cilësitë që zotërojnë. Kurse Allahu është i pafillim e i pafund me individualitetin, atributet dhe aktet e Tij.

Ai që u ngjet krijesave të veta, nuk mund të jetë Zot. Krijesat janë vetëm si pasqyra që tregojnë (pasqyrojnë) emrat dhe atributet e Tij. Ashtu siç tregon një robot i mrekullueshëm diturinë, planin, mjeshtërinë dhe fuqinë e shpikësit ose artistit të vet, ashtu dhe çdo krijesë në këtë gjithësi, me artet e tij të larta e të pashoqe, tregon diturinë, fuqinë, urtësinë dhe vullnetin e pafund të Allahut.

Allahu është pakrahasimisht epror ndaj çdo gjëje. Fuqia e Tij është e pafundme. Ai e krijon një galaktikë po me atë lehtësi që krijon një atom. Ai e krijon pranverën me lehtësinë e krijimit të një luleje. Një punë apo një akt i Tij nuk bëhet pengesë për një punë ose për një akt tjetër të Tij. Ai bën në të njëjtin çast punë të panumërta pa i ngatërruar me njëra-tjetrën. Asgjë nuk mund të mbetet jashtë administrimit dhe **regullimit** të Tij. Ndërsa çdo gjë ndodhet pafundësisht larg prej Tij, Ai ndodhet pafundësisht afër çdo gjëje. Sigurisht, një Zot i tillë nuk ka partner, nuk ka të ngjashëm dhe identik të vetes. Asnjë krijesë nuk mund t'i ketë këto cilësi. Kush nuk i ka këto cilësi, pra, kush ka partner, të ngjashëm dhe identik me veten, nuk mund të jetë zot!

Mesazhet që jep surja Ihlas mbi çështjen e **hyjnitetit**

Surja Ihlas që ka cilësinë të jetë përmbledhje e ajeteve që e tregojnë Allahun (xh.xh.), është përgjigje për çdo lloj botëkuptimi politeist.

Duke bërë të ditur në këtë ajet se Allahu është *Ehad* (një i vetëm), kundërshtohen dhe hidhen poshtë qysh në krye botëkuptimi zoroastrian, sipas të cilit, në gjithësi ndodhen zota të veçantë që krijojnë të mirën dhe të keqen, të ashtuquajtur, sipas këtij botëkuptimi, **Hurmuz** dhe **Ehriman**, si dhe botëkuptimet e ngjashme me këtë.

Duke u thënë në këtë sure se Allahu është *Samed* (i vetëmjaftueshëm dhe vetekzistent), janë kundërshtuar dhe hedhur poshtë idhujt e vështuar si ndihmës dhe si ndërmjetës mes Allahut dhe njerëzve, robve të Tij. Me këtë, i është dhënë një shuplakë e fortë çdo botëkuptimi që i vjen era politeizëm, i cili, me dashje ose pa dashje, i sheh shkaqet si ortakë ose partnerë për të cilët Allahu ndjen nevojë në veprimtarinë e Tij.

Gjithashtu, në këtë sure, duke u thënë "lem jelim ue lem juled" (nuk ka lindur dhe nuk është i lindur) hebrenjve që e shohin Hz. Uzejrin si bir të Zotit, krishterëve që e pranojnë Profetin Isa si bir të Zotit dhe politeistëve idhujtarë që i mendojnë engjëjt si vajza të Zotit, ua kujton atyre se janë larguar shumë nga besimi monoteist konsekuent.

Interpretimi i sures Ihlas nga këndvështrimi i kauzalitetit mes ajeteve

Siç e thamë edhe në hyrjen e çështjes, fjala "ihlas", për sa i përket kuptimit leksikologjik, bart kuptimin e qëndrimit të thjeshtë, të kulluar e pa mbishtresime ndaj diçkaje. Kurse sipas përdorimit të

posaçëm, "ihlas" do të thotë që njeriu, në adhurimet e tij, të mbyllet ndaj çdo gjëje tjetër veç urdhrave, kërkesave dhe mirësive të Zotit, që t'i kryejë detyrat dhe t'i plotësojë përgjegjësitë që i takojnë, sepse ka urdhëruar Zoti, që, duke i kryer detyrat e duke i plotësuar përgjegjësitë, të ketë për synim pëlqimin dhe miratimin e Zotit. Kjo specifike është shprehur kështu në Kur'an: "Lutiu Allahut duke e bërë adhurimin nga zemra dhe vetëm për Të!" (Gafir, 40/14-65; Bejjine, 98/5) Në këtë pikë, rob (njeriut) i ka hije që, duke menduar se Allahu ndodhet i gatshëm dhe vëzhgues në çdo çast dhe pikë të kohës dhe hapësirës, të mos kërkojë pranë Tij interesimin e tjetërkujt veç Tij. Sepse të shohësh nga të tjerët ndërsa ndodhesh para Tij, të kërkoksh shpëtim nga të tjerët, është në kundërshtim me etikën e asaj pranie. Ja, kjo është përmbledhja më thelbësore e *ihlasit* (singeritetit, principialitetit).

Po të vështrohet nën dritën e këtyre që u thanë, shihet se *e kundërta e ihlasit* është *shirku*. Sepse principialiteti e bën të domosdoshme që atributet hyjnitet dhe zot t'i jepen vetëm Allahut që është zotëruesi vërtetë i tyre. Kurse në politeizëm, atributet hyjnitet dhe zot u jepen disa partnerëve njëkohësisht, besimi i kulluar turbullohet. Ndërsa principialiteti e bën të domosdoshme që të vihet si qëllim vetëm pëlqimi i Allahut, politeizmi shtyn në kërkimin e pëlqimit të të tjerëve nën pamje të tilla si hipokrizia dhe interesi. Principialiteti e bën të domosdoshme dashurinë vetëm për Të, kurse dashurinë për të gjitha gjërat e tjera, në emër të dashurisë për Të. Dashuria për gjërat e përkohshme e të **asgjësueshme** jo në emër të Tij, por për vetë ato, e turbullon këtë dashuri të shenjtë. Nga ky këndvështrim, njeriu ose është principial ose, ndoshta pa i rënë në të, i ngatërruar në politeizma të fshehta ose të hapura. Politeizmi është situata më e rrezikshme përballë një njeriu që ka besuar. Të gjitha rrugëtimet që zgjaten për në mohim, kundërshtim dhe herezi, nisen nga stacioni i politeizmit. Ja pra, edhe pse surja Ihlas (Principialiteti) në dukje nuk ka asnjë fjalë mbi ihlasin (principialitetin), na ofron neve recetën e principialitetit. Mbështetur mbi rëndësinë e kësaj sureje, profeti Muhamed (s.a.s.) ka thënë se kush e këndon tri herë radhazi këtë sure, arrin mirësinë sikur ta kishte kënduar tërë Kur'anin. (Buhari, Fedailu'l-Kur'an, 13) Në këtë mënyrë, Profeti ka tërhequr vëmendjen se, nga një aspekt, kjo sure ka vlerën e bërthamës së mësimin të përgjithshëm të paraqitur nga Kur'ani.

Dhe tani le të kalojmë në interpretimin e kauzalitetit mes emrave dhe fjalive që përmban kjo sure.

Në suren që fillon me fjalët, "Thuaj: Ai, Allahu, është Ehad...", Allahu i Lartë para së gjithash bëhet i njohur me emrin Ehad (një i vetëm). Në pamje të jashtme, duket sikur emri Ehad (një i vetëm) bart të njëjtin kuptim me emrin Vahid (një). Mirëpo mes të dyve ka një nuancë kuptimore të imtë. Ndërsa emri Vahid shpreh se krijuesi i çdo gjëje është Allahu, emri Ehad shënon se Allahu është krijuesi i çdo gjëje së bashku me të gjitha veçoritë që duken te ajo gjë. Nga ky këndvështrim, emri Ehad ka një rëndësi jetësore. Mendja e njeriut që thotë se "është Allahu që e krijon çdo gjë", nuk mundet t'i përfshijë të gjitha gjërat menjëherë. Mes këtij konkluzioni të përgjithshëm ndodhen gjëra që i shpëtojnë prej syrit dhe vëmendjes. Ja pra, këto gjëra që i shpëtojnë vëmendjes mundet që madje pa i rënë më të, të jenë njeriu vetë, shkaqet, natyra, rastësia. Dhe djalli që e përdor këtë rast ose mundësi, duke bashkëpunuar edhe me nefsin (vetveten, egon) tonë, na hedh ne në politeizmin e nefsit ose të shkaqeve. Kurse emri Ehad kërkon që çdo gjë të shihet drejtpërdrejt në emër të Allahut. Nëse është me vend të shprehemi kështu, nuk mjaftohet vetëm duke shkruar në hyrjen e panairit të gjithësisë "Kjo është prona e Allahut", por mbi çdo gjë që ndodhet brenda panairit, vë veç e veç vulën, etiketën e Tij, bën që çdo gjë të lexohet dhe përdoret në emër të Tij. Në rastin e parë, domethënë, në rastin kur vetëm dihet se krijuesi i ekzistencës është Allahu, mundet që djalli të bëjë vjedhje në emër të nefsit dhe shkaqeve. Duke iu atribuuar pasuria dhe veprimtaria e Allahut shkaqeve ose gjërave të tjera, mund të devijohet nga teuhidi (besimi monoteist konsekuent) pa e kuptuar. Në rastin e dytë kjo është e pamundur.

Prandaj, rruga e vetme e qëndrimit larg shirkut dhe, për rrjedhojë, e afrimit të principialiteti, kalon nëpër shikimin e çdo gjëje me dylbinë e emrit Ehad. Ja pra, Krijuesi i Lartë, në ajetin e parë të kësaj sureje, duke u shprehur për vete "Ai Allahu është Ehad (një i vetëm)", na mëson kushtin e parë të principialitetit. Pra, na e bën të ditur qartë se një pranim i përgjithshëm si "është Allahu që e krijon çdo gjë", është i pamjaftueshëm për t'iu shmangur shirkut, politeizmit. Në këto kushte, përvetësimi i principialitetit është i mundur me arritjen e vetëdijes që e kërkon koncepti Ehad. Pra, është i mundur që krahas njohjes se krijimi i qenies dhe ekzistencës është prej Tij, të pranohet se edhe administrimi, funksionimi dhe edukimi i tyre mund të bëhen vetëm prej Tij pa u përzier në këtë asnjë dorë tjetër!

Në ajetin e dytë të sures, Allahu bëhet i njohur me emrin Samed. Siç dihet, ky emër ka kuptimin "çdo gjë është nevojtare për Të, por Ai s'është nevojtar për asgjë". Në një vështrim, emri Samed është rezultat i pashmangshëm i emrit Ehad. Dikush që sheh nga dritarja e emrit Ehad se të gjitha veçoritë e një diçkaje janë shfaqje e emrave të Allahut, se i përkasin Atij, se e kanë prejardhjen prej Tij dhe se e bëjnë të njohur Atë, dashje pa dashje do të arrijë te emri Samed. Meqë çdo gjë ekziston vetëm me Të, vetëm në sajë të Tij, atëherë, çdo gjë është nevojtare për Të!

Prandaj, dikush që thotë "Allahu është Ehad (një i vetëm)", detyrimisht do të thotë "Allahu është Samed (i vetëmjaftueshëm, vetekzistent)". Duke thënë kështu, krahas njohjes së Allahut me emrat dhe atributet Absolute të Tij, do të pranojë se ai vetë si dhe e gjithë materia janë në vetvete të dobët dhe nevojtarë. Ja pra, ky është edhe kushti i dytë i pashmangshëm për t'u shmangur dhe ndenjmur larg politeizmit të egos dhe shkaqeve dhe për të qenë plotësisht principial në besim.

Ajeti i tretë thotë për Allahun: "Lem jelim ue lem júled", "Nuk ka lindur dhe nuk është i lindur". Me një shprehje më të përgjithshme, as Allahu është një qenie që ka lindur (është shkëputur, është ndarë apo veçuar) nga një qenie tjetër, as kjo ekzistencë që shihet është një gjë e lindur ose e ndarë prej Tij. Pra, ata që janë të lindur vetë dhe që kanë lindur të tjerë, nuk mund të jenë zot. Ashtu siç është ajeti i dytë përfundim i domosdoshëm i ajetit të parë, edhe ky ajet është përfundim i domosdoshëm i ajetit të dytë, sepse veçoria e të qenit i lindur dhe lindës është e posaçme vetëm për ata që janë nevojtarë për dikë apo diçka tjetër.

Qeniet që linden dhe lindin janë edhe pasojë e një gjëje, edhe shkak i një gjëje tjetër. Në këto kushte, pasojat (rezultatet, përfundimet) kurrë nuk mund t'u lihen shkaqeve në kuptimin e vërtetë të fjalës, sepse çdo shkak për të cilin pandehet se ka lindur një pasojë, është vetë pasojë e një shkakut tjetër. Dhe kjo është argument i faktit se veçoritë që kërkohet t'i atribuohen shkakut në fjalë nuk janë element përbërës dhe karakterizues i tij. Pra, çdo qenie që jeton (ekziston) në botën e shkaqeve nuk ka fuqi krijuese në vetvete ose të vetën. Në këto kushte, themi se qenia që edhe lindet, edhe lind nuk mund të jetë zot, sepse Zoti që zotëron veçori absolute dhe posaçërisht individuale (të papërsëritshme te dikush ose diçka tjetër), qëndron mbi të gjitha qeniet dhe gjërat: nuk lindet dhe nuk lind!

Dikush apo diçka që lindet dhe lind, ka të kaluarën e vet kur nuk ka ekzistuar dhe të ardhmen e vet kur nuk do të ekzistojë më, kurse dikush apo diçka që nuk lindet dhe nuk lind, nuk ka as të kaluar kur nuk ka ekzistuar, as të ardhme kur nuk ka për të ekzistuar më. Allahu është pafillimisht i parë dhe pafundësisht i fundit²³. Prandaj koha dhe hapësira janë në dorë të Tij. E shprehur ndryshe, çdo gjë që zë një fragment kohor të caktuar dhe një vend të caktuar brenda kohës dhe hapësirës dhe që ka të kaluarën kur nuk ka ekzistuar dhe të ardhmen kur nuk do të ekzistojë më, e ka ekzistencën prej Allahut, ekziston në sajë të Tij. Sepse ekzistenca e secilës gjë që ekziston, që të ekzistojë, kërkon një fuqi që "t'i shkojë fjala" në tërë gjithësinë dhe një dituri që të njohë lëvizjet dhe rregullsinë e të gjitha krijesave. Por për gjërat që

²³ Euuel, Ahir.

linden dhe lindin, pra, që janë fragmentare dhe të vdekshme, nuk mund të mendohet që të zotërojnë fuqi dhe dituri absolute. Zotëruesi i këtyre është vetëm Allahu, zotëruesi i attributeve Ehad dhe Samed.

Shkurt, shprehja "Ue lem juled", "nuk është i lindur dhe nuk ka lindur", i shfuqizon të gjitha shkaqet që linden dhe lindin nga pretendimi i "ndikimit të vërtetë dhe autorësisë" mbi përfundimet, dhe e bën të domosdoshme njohjen e faktit se çdo gjë, së bashku me shkakun dhe përfundimin e saj, është vepër dhe pronë e Allahut.

Allahu urdhëron respektimin e shkaqeve. T'u drejtohesh shkaqeve përkatëse për realizimin e një pune është një lutje për realizimin e rezultatit të kërkuar. Bashkimi i shkaqeve do të thotë që ato t'i bëjnë Allahut një lloj lutjeje dhe kërkesë në emër të krijimit të përfundimit. Për shembull, bashkimi i ujit, nxehtësisë, dheut dhe dritës duke respektuar shkaqet, me qëllim që një farë të nxjerrë filiz e të bëhet pemë, është një lutje. Shkaqet luten: "O Krijuesi ynë, bëje pemë këtë farë!" Pema që është një prej mrekullive të fuqisë së Zotit, nuk mund t'u lihet atyre lëndëve të thjeshta, të ngurta e të pavetëdijshme, autorësia e tyre mbi pemën është absurditet. Kjo do të thotë se bashkimi i shkaqeve është një lloj lutjeje. Krijuesi është Allahu. T'u njohësh shkaqeve ndikim të vërtetë, është shirk, politeizëm. E kundërta, të mos u njohësh shkaqeve ndikim të vërtetë, i mbyll dyert e politeizmit. Me mbylljen e dyerve të politeizmit, dera e besimit monoteist (tevhid) dhe e principialitetit (ihlas) hapet fletë më fletë.

Në ajetin e fundit, Allahu (xh.xh.) na e bën të njohur veten me shprehjen "Ue lem jekun lehu kufuven ehad", "Asgjë dhe askush nuk është identik me Të!".

Ashtu siç secili prej tri ajeteve ishte përfundim i domosdoshëm i një ajeti më parë, edhe ajeti i katërt është përfundim i domosdoshëm i ajetit të tretë. Ai që është Ehad, është, domosdoshmërisht Samed. Ai që është Samed, është, domosdoshmërisht i palindur e që s'lind. Ai që s'ka lindur dhe që s'lind, domosdoshmërisht nuk ka identik me vetveten. E shprehur ndryshe, ai që është i krijuar, pra që ka fillim dhe fund (ose një pikë kohore kur s'ka ekzistuar dhe një pikë kohore kur nuk do të ekzistojë më), nuk mund të jetë i tillë si Krijuesi. Ai që është i fundmë nuk mund të bartë të njëjtën cilësi me atë që është i pafundmë. I dobëti nuk mund të jetë ekuivalent me të fuqishmin.

Ky ajeti i fundit na thërret ta ngremë drejt ekuacionin krijim-krijesë, fuqi-dobësi, hyjnitet-adhurim dhe pronësi-pronë. Njeriu që mundet ta ngrejë drejt këtë ekuacion,

- nuk sillet ndaj asnjë krijese si të ishte krijues,
- nuk i hap duart ndaj asnjë të dobëti si të ishte zotërues i një fuqie në vetvete,
- nuk e sheh si Zot askënd që është rob ashtu si dhe vetë,
- nuk bie në gabimin për ta parë veten pronar të vërtetë dhe zotëri mbi diçka që është pronë e dikujt tjetër.

Po qe se duhet shprehur shkurt, njeriu që e ngre drejt këtë ekuacion, të gjitha atributet, si krijues, i fuqishëm, zot dhe pronar ia lë vetëm Allahut dhe vetëm Atij i nënshtrohet. A nuk është kjo principialiteti?

Përgjithësisht, kjo sure shumë e shkurtër, si një sure-bërthamë që përmbledh në radhë të parë të vërtetën e teuhidit që kërkon Kur'ani ta shtresojë në mendjet tona, pastaj edhe mesazhet e tjera të tij, na mëson neve bazën e besimit monoteist konsekuent (tevhid) dhe të principialitetit (ihlas) si dhe rrugët për të arritur tek ta.

Allahu (xh.xh.) tregon lidhjen e Tij me gjithësinë

Krijuesi i Lartë i cili në shumë ajete na informon për veprimtarinë dhe administrimin e Tij që përfshijnë gjithësinë, në suren Bekare (ajeti 255) na tregon në mënyrë të denjë për hyjnitetin e vet, lidhjen (raportin) e Tij me gjithësinë. Ky ajet është quajtur "Ajeti Kursi". Ky ajet shpreh një parashtrim tejet të hapur e të përmbledhur të sundimit të Allahut. Në një rivajet bëhet e ditur se ajeti më i madh i Kur'anit është ky ajet. (*shih*. Ibn Hanbel, Musned, V, 142, 178)

Kuptimi i shkurtër i këtij ajeti të gjatë është kështu:

"Allahu është Zoti, veç të cilit nuk ka zot tjetër.

Ai është Hajj (i gjallë).

Është Kajjum (vetekzistent).

Allahu nuk dremet e nuk fle.

Çdo gjë në qiej e në tokë është e Tij.

Kush mund të ndërmjetësojë për falje pranë Tij pa lejen e Tij?

Ai di gjithçka që ndodhet para e pas robve që i ka krijuar.

Qeniet e krijuara prej Allahut nuk mund të kuptojnë nga dija e Tij veç asaj që dëshiron Ai.

Katedra (zotërimi dhe administrimi) e Tij i përfshin tërësisht qiejt e tokën.

Ai nuk e ka të vështirë t'i mbrojë e të kujdeset për qiejt dhe tokën.

Ai është aq i madh e aq i lartë! (Bekare, 2/255)

Allahu është Hajj (i gjallë)

Allahu, veç të cilit nuk ka zot tjetër, ka një formë jete të posaçme për individualitetin e Tij të lartë. Ai ka një formë jete të tillë që të gjitha qeniet me jetë e marrin jetën prej Tij. Ai s'ka të bëjë me humbjen dhe asgjësimin. Duke qenë zotëruesi i një jete absolute e të pasosur nga pafillimi në pafundësi, për Të nuk ka vdekje.

Allahu është Kajjum (vetekzistent)

Allahu, ekzistenca e të cilit është e vetvetishme, e administron vetë tërë gjithësinë e krijuar prej Tij. Çdo gjë është nevojtare ndaj Tij për qenien dhe ekzistencën e vet dhe për vazhdimin e ekzistencës së vet. Allahu, veç të cilit nuk ka zot tjetër, "çdo çast, me shfaqje të reja (të ekzistencës së vet), ndodhet në krye të punës". (Rahman, 55/29)

Allahu e drejton këtë gjithësi me anë të ligjeve. Ndërkaq, ligjet nuk janë gjëra të veçanta vetekzistuese, të cilave Allahu u ka lënë drejtimin dhe administrimin e qenieve dhe ekzistencës. Ligjet janë vetë veprimtaria dhe akti ekzekutues hyjnor. Gjëja që ne i themi regjimi i rregullt dhe harmonik i gjithësisë ose ligjet e natyrës është pamja që na reflektohet neve e trajtës me të cilën është krijuar dhe merr vazhdimësi materia, jo përcaktuesi i asaj trajte. Pra, ligjet ekzistojnë pse materia është krijuar në një trajtë të caktuar, jo materia ekziston në një trajtë të caktuar pse ekzistojnë ligjet. E shprehur ndryshe, çdo veprimtari e rregullt dhe harmonike që shohim në funksionimin e gjithësisë nga mikrobota në makrobotë, është shfaqje e zakonit të Allahut²⁴. Këtë veprimtari të rregullt dhe harmonike të zhvilluar

²⁴ Në origjinal: âdetullah. Përkthyesi.

në mënyrë të pandërprerë nga Krijuesi në linjën shkak-përfundim, ne e kuptojmë si "ligje" apo "ligjshmëri". Në këto kushte, themi se ligjet s'janë gjë tjetër veç pamjes të reflektuar tek ne të nxjerrjes së materies në gjendje zinxhirore në fushën e ekzistencës.

Shkencat ia detyrojnë ekzistencën e vet rregullsisë dhe harmonisë së ligjeve të vëna nga Allahu, rregulli dhe harmoni e cila quhet zakoni i Allahut. Po qe se Krijuesi i Lartë nuk do ta kishte krijuar qenien (ekzistencën) dhe nuk do t'i jepte asaj vazhdimësi në linjën shkak-përfundim dhe brenda një vazhdimësie të rregullt e harmonike, kurrë nuk do të bëhej fjalë për shkencat.

Do të jetë me dobi sikur të qëndrojmë pak mbi këtë specifikë që ka lidhje të drejtpërdrejtë me besimin monoteist konsekuent (tevhid). Në këtë çështje, si në të kaluarën, ashtu dhe në ditët tona, kanë dalë në shesh kuptime dhe qëndrime të gabuara në kundërshtim me besimin monoteist konsekuent. Me gjithë shprehjet mjaft të hapura e të qarta të Kur'anit dhe haditheve, edhe në botën islame të mendimit, madje, nuk kanë munguar ata që, me dashje a pa dashje, kanë parë tek materia dhe shkaqet aftësi ndikuese të vërtetë. Mirëpo lidhja midis shkaqeve dhe përfundimeve nuk është lidhje shkak-pasojë. Kjo lidhje nuk është horizontale, por vertikale. Në gjithësi ka një rregullsi, por kjo rregullsi nuk mund të reduktohet në lidhjet shkakësore të detyrueshme mes vetë materies.

Si të pretendojmë se mund ta gjejmë me mendjen tonë përfundimin duke parë shkaqet, si të pretendojmë se përfundimi është bërë nga ana e shkakut duke vëzhguar me anë të provave se lidhjet shkak-përfundim ndodhen brenda një rregullsie, në themel, të dyja këto pretendime mbështeten po në të njëjtin vetëmashtrim.

Po ta vështrojmë çështjen nga këndvështrimi i Kur'anit, shohim se ne nuk zotërojmë ndonjë argument dhe arsye serioze që të na vlejë për të menduar ndryshe. Të katër forcat (forca tërheqëse-shtytëse, forca elektromagnetike, forcat e dobëta e të fuqishme janë identitetet e shfaqjes së vetekzistencës hyjnore²⁵ të reflektuar tek ne në një vazhdueshmëri të rregullt në linjën shkak-përfundim.

Emërtimi i pandehmës se shkakut dhe përfundimi janë të lidhur me njëri-tjetrin ose varen nga njëri-tjetri me anë të ligjeve racionale ose ligjeve natyrore të domosdoshme (të detyrueshme, të pamënjanueshme), është determinizëm. Edhe shkaqet, edhe përfundimet janë të krijuara. Shkaqet nuk zotërojnë asnjë cilësi individuale që do t'u jepte mundësi për t'i dhënë vazhdimësi (për ta mbajtur në këmbë dhe për ta vazhduar më tej) rregullsinë dhe harmoninë në gjithësi. Në krijim vepron (është veprues, efektiv) zakoni i Allahut²⁶. Po qe se ligjet e vendosura në gjithësi nga Allahu do të ndryshonin vazhdimisht, nuk do të kishte stabilitet, për pasojë, as shkencat do të formoheshin, as jeta do të bëhej e mundur. Krijimi është monoton se kështu e ka dashur në mënyrë volitive Allahu; për më tepër, në krijim, s'ka asgjë që ta bëjë të domosdoshëm (të detyrueshëm) krijimin e Allahut jo në tjetër formë (ose mënyrë), por pikërisht në këtë formë (mënyrë). Allahu mund ta ndryshojë kur të dojë çdo gjë që të dojë. Për shembull, nga kati i sipërm i një apartamenti dhjetëkatësh bie një fëmijë e nuk vdes. Në fatkeqësi të tilla si tërmetet, shihni se shumë fëmijë krejt të paaftë për t'u vetëmbrojtur, pas shumë ditësh dalin shëndoshë e mirë nga poshtë gërmadhavë!

Krijuesi i Lartë ka dëshiruar në mënyrë volitive krijimin brenda linjës shkak-përfundim me qëllim që ne të kemi mundësi ta kuptojmë gjithësinë, për rrjedhojë, ta njohim Atë. Krijuesi nuk ka nevojë për shkaqet për të krijuar përfundimet, por ne kemi nevojë për një formë (mënyrë) krijimi të vazhdueshme (të pandërprerë) të varur nga shkaqet me qëllim për ta kuptuar se si ka krijuar Ai. Është për këtë arsye që Krijuesi i Lartë, për të treguar emrat e Tij, ka ngritur në gjithësi mes gjërave dhe dukurive një lidhje

²⁵ Në origjinal: «İlahî Kayyumiyet (ilahî kajjumijet), vetekzistencë hyjnore. Përkthyesi.

²⁶ Në origjinal: sunetullah (adetullah). Përkthyesi.

dhe reciprocitet me kuptim që shihet me sy. E gjithë materia (të gjitha gjërat) dhe shkaqet janë si nga një pasqyrë më vete që na i pasqyrojnë neve emrat dhe atributet e Tij. Çdo krijesë (çdo gjë e krijuar) e madhe dhe e vogël, e tërë dhe pjesë, me gjuhën e qenies së vet janë argumente që njoftojnë lartësinë e Tij sublime, pra, kurrë nuk mund të mendohen si ortakë (partnerë) në veprimtarinë e Tij.

Funksionimi i ekzistencës që vazhdon brenda rregullsisë (brenda një regjimi të rregullt e harmonik) mund të shpjegohet vetëm e vetëm me drejtimin dhe administrimin e drejtpërdrejtë të një Krijuesi që zotëron attribute të tilla, si vullneti (dëshira volitive), dituria, fuqia, urtësia dhe mëshira, sepse të gjitha aktet e përgjithshme (të plota) që evidentohen në ekzistencë tregojnë se janë shfaqje të një fuqie që përfshin gjithçka.

Ekzistenca dhe qëndrueshmëria²⁷ e të gjithë trupave që ndodhen qoftë në kozmos (qiell), qoftë në tokë, varet nga ky ligj i vetekzistencës hyjnore. Po qe se Allahu që është *Kajjum* (vetekzistent, në këmbë, çdo çast në krye të punës) do të hiqte për një çast urdhrin (për krijim dhe ekzistencë), miliona trupa qiellorë dhe, në të vërtetë, gjithçka, do të "binin" në asgjësim, sepse gjërat e krijuara nuk zotërojnë asgjë që do t'i ndihmonte ta vazhdonin ekzistencën e tyre më vete. Le t'ia vëmë pikën kësaj specifike me këto ajete të Kur'anit:

"Sa e lartë është fama e Allahut që ka në dorë drejtimin dhe administrimin e çdo gjëje!" (Jasin, 36/83)

"Një tjetër argument i ekzistencës së Tij është se qielli dhe toka janë në këmbë (ekzistojnë) me urdhrin e Tij, se ndodhen në krye të detyrës në vendin e caktuar për ta!" (Rum, 30/25)

"E vërteta është se ai që i mbron qiejt dhe tokën nga asgjësimi, është Allahu. Po qe se ata do të shembeshin, nuk do të mundej t'i mbante dot askush veç Allahut!" (Fatir, 35/41)

Shkurt, as qenia është bërë e qenë dhe ekzistente në vetvete, as dhe, pasi është krijuar, i është thënë, "eja, tani, shih punën", duke e lënë në rrjedhën e saj. Vullneti (dëshira volitive) hyjnor dhe fuqia hyjnore e ekzekutojnë urdhrin e vet në gjithësi për çdo çast. Çdo gjë është në dorën e Tij dhe nën administrimin e Tij. Asgjë s'është jashtë fuqisë së Tij. Vetëm Ai është zotëruesi dhe drejtuesi i çdo gjëje.

Allahu nuk dremet e nuk fle

Allahu është vetekzistent (*kajjum*) në atë nivel që ekzistenca e çdo gjëje, po ashtu dhe vazhdimi i ekzistencës së vet prej çdo gjëje varen prej Tij. Çdo gjë është në çdo çast nevojtare për Allahun. Kurse ekzistenca e Allahut është e vetvetishme dhe në vetvete. Në këtë çështje, nuk mund të bëhet fjalë që, qoftë edhe për një çast, një dremetje ose indiferentizëm të krijojë një të çarë ose të hedhë hije mbi sundimin e Tij. Ai e njeh çdo gjë dhe ka njohuri për çdo gjë të pronës së Tij.

Çdo gjë në qiej e në tokë është e Tij

Qenia dhe ekzistenca me dimensionet e saj fizike dhe metafizike është tërësisht e Tij. Çdo ekzistencë (gjë ekzistente) pothuaj kryen detyrën e një pasqyre që, me dobësitë e saj, tregon fuqinë e Tij, me natyrën e saj të pavetëdijshme, tregon diturinë e Tij, me nevojat e saj, pasurinë dhe favorin e Tij, me përkohshmërinë e saj, përhershmërinë e Tij, etj.

²⁷ Në origjinal: *beka*, permanencë, qëndrueshmëri. Përkthyesi.

Çdo gjë që duket apo s'duket lartë e poshtë është vepër e vullnetit (dëshirës volitive) dhe fuqisë së Tij. Në ekzistencë nuk ka gjë për të cilën të thuhet dhe është e pamundur të thuhet se "është e dikujt tjetër". Sepse gjithësia është një e tërë e pandashme. Çdo gjë, brenda së cilës çdo pjesë e saj nuk është më prioritare ndaj të tjerave, varet prej secilës gjë që së bashku formojnë të tërën. Pra, nëse nuk ka çdo gjë, nuk ka as asgjë. Kushdo apo cilido qoftë që është përgjegjës për diçka, duhet të jetë përgjegjës edhe për të gjitha gjërat. E thënë ndryshe, në realitet, të gjitha gjërat që përbëjnë materien janë të lidhura e të varura me njëra-tjetrën në atë mënyrë që një gjë nuk mund të ekzistojë në mënyrë të pavarur nga çdo gjë tjetër në gjithësi; një gjë mund të ekzistojë vetëm brenda tërësisë së gjithësisë. Atëherë, themi se për të bërë diçka, duhet zotërimi i një dijeje dhe fuqie që do ta mbante çdo gjë në gjithësi nën kontroll dhe zotëruesi i kësaj dijeje dhe fuqie është Allahu!

Kush mund të ndërmjetësojë për falje pranë Tij pa lejen e Tij?

Nuk ka asnjë forcë që mund të ndërhyjë verbalisht ose praktikisht në administrimin dhe zotërimin e Tij. Ky ajet tregon, para së gjithash, sundimin, administrimin dhe zotërimin e Allahut në gjithësi. Atëherë, shefaati i Tij këtu do të ishte më e përshtatshme të trajtohej në mënyrë përparësore në pikën e funksionimit të ekzistencës (nga këndvështrimi kozmologjik). Folja *she-fe-a* ka këto kuptime leksikore: *ndërmjetësim*, *ndërhyrje*, etj. Nisur nga kjo, këtë ajet, krahas kuptimit tjetër të njohur, mund ta komentojmë kështu: Pranë Tij - pavarësisht nga Ai - kush mund të ndërhyjë në pronën dhe funksionin e Tij? Nuk mund të ketë ndonjë ortak (partner) dhe kujdestar që mund të përzihet në punën e Tij, që mund të ndërhyjë pa lejen e Tij në urdhërimin dhe administrimin e qenies. Kjo pronë është tërësisht e Tij dhe nën urdhrin e Tij. Çdo ndërhyrje që bën njeriu mbi qenien, realizohet me lejen e Tij. Një sërë suksesesh të arritura sot në fushën shkencore, nuk kanë ndodhur pavarësisht nga Ai, por me lejimin e Tij. Për shembull, le të qëndrojmë mbi dukurinë e *klonimit* që i lë të mahnitur njerëzit tanë. Thelbi i kësaj dukurie të emërtuar edhe *kopjim*, është kështu: Për të kryer procesin e kopjimit, përdoret DNA-ja e kafshës që do të kopjohet. DNA-ja që ndodhet në qelizën e kafshës, merret nën mikroskop dhe vendoset në qelizën vezore të një kafshe tjetër të po atij lloji. Menjëherë pas kësaj zbatohet një goditje dhe sigurohet fillimi i ndarjes së qelizës vezore. Embrioni që vazhdon të ndahet, vendoset në mitrën e një kafshe tjetër të të njëjtit lloj dhe pritët të zhvillohet e të lindë. Po të ndiqet me vëmendje, të gjitha materialet biologjike të përdorura gjatë këtij procesi, të gjitha pjesët jetësore të gjallesës, si qelizat, bërthama qelizore, membrana qelizore, mitokondria, DNA-ja, janë marrë të gatshme nga një kafshë për t'u transplantuar te kafsha tjetër. Kjo nuk është shfaqje e gjallesës nga materiale jo të gjalla, por bartja e një qenie të gjallë në një tjetër qenie të gjallë duke përdorur mundësitë teknologjike. Rezultati i marrë pas bartjes krijohet përsëri me anë të aktit krijues të Krijuesit të Lartë. Ajo çka bëjnë këtu shkencëtarët, është kryerja e bartjes dhe pritje e rezultatit. Rezultati nuk krijohet me anë të aftësive të tyre, rezultati krijohet përsëri nga ana e Allahut.

Në këto kushte, kjo dukuri e të ngjashme me këtë, krijohen me anë të lejimit nga Allahu të përpjekjeve të robve të Tij në këtë botë, të cilët i përdorin shkaqet në mënyrë metodike, si dhe të dhënies atyre të shpërblimit të punës së tyre. Sepse Allahu e ka dërguar njeriun si përfaqësues e zëvendës²⁸ të Tij mbi tokë. (Bekare, 2/30) Veprimtaria përfaqësuese e njeriut të nderuar me pozitën për të qenë zëvendës i Zotit mbi të gjithë qenien, zhvillohet në një kuadër jashtëzakonisht të gjerë, nga besimi te

²⁸ Në origjinal: halife: kalif, zëvendës, përfaqësues. Përkthyesi.

Allahu dhe adhurimi i Tij, te njohja e të fshehtës së materies dhe dukurive, gjer te ndërhyrja dhe veprimi mbi natyrën.

Ndërkaq, fakti që Allahu jep leje për një gjë dhe krijon rezultatin e saj, nuk do të thotë gjithmonë se Ai e miraton atë gjë. Sepse Ai i ka lënë robtë e Tij në këtë botë të lirë të zgjedhin atë që duan vetë me vullnetin e tyre të lirë. Ai e krijon çdo akt të zgjedhur si të mirë apo të keq nga robtë e Tij, të cilët mbajnë përgjegjësi për zgjedhjen që bëjnë me vullnetin e tyre të lirë. Sepse kjo botë është vend prove!

Ai di gjithçka që ndodhet para e pas robve që i ka krijuar

Pasi tërheq vëmendjen se gjithësia dhe ekzistenca me gjithçka janë nën urdhrin dhe administrimin e Tij, Krijuesi i Lartë, duke e sjellë fjalën te njerëzit, na kujton se edhe ata ndodhen krejtësisht nën vëzhgimin dhe kujdesin e Tij. Allahu di çdo gjë për robtë e Tij: ç'dinë e nuk dinë, të kaluarën dhe të ardhmen e tyre si dhe çdo gjë të hapur a të fshehtë të tyre. Fundja, kjo është domosdoshmëri e ekskluzivitetit hyjnor²⁹.

Për Të nuk ka të shkuar e të ardhshme. Këto koncepte janë për njeriun, mendja e të cilit është gatuar me konceptin e kohës dhe vartësisë ndaj saj. Ai i sheh e i di të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen si të shihte e të dinte një pikë, një çast.

Qeniet e krijuara prej Allahut nuk mund të kuptojnë nga dija e Tij veç asaj që dëshiron Ai

Njerëzit e kanë të pamundur ta përfshijnë e ta njohin diturinë e pafundme të Allahut si dhe informacionin e emetuar nga dituria e Tij absolute dhe e pakushtëzuar. Por mund të rrokin dhe kuptojnë aq sa dëshiron Ai.

Në fakt, ato që dinë njerëzit, janë ato që i di dhe i bën të ditura Ai. Diturinë që Allahu ua jep ose bën të ditur njerëzve, mund ta vlerësojmë në dy grupe:

E para është dituria që u ka dhënë Allahu robve të tij të zgjedhur mes njerëzve, zbulesa hyjnore që u ka ardhur profetëve. Zbulesa hyjnore (vahji-revelacioni hyjnor) është një komunikim i posaçëm i Zotit për profetët, njerëz te pajisur në mënyrë të posaçme. Dhe është i lartë sa nuk mund të krahasohet me asnjë kapacitet në botë. Kësaj mund t'i shtojmë njohuritë dhe të fshehtat që ua zbulon Allahu me anë të frymëzimit disa robve të Tij në raport me kapacitetin e tyre si dhe afërsinë e tyre ndaj Tij, por, ndërsa zbulesa hyjnore është transparente, e regjistruar me dëshmitar (Xhebrailin), objektive dhe kushtëzuese, frymëzimi (ilham) është vetiak, i hapur ndaj interpretimit, i padëshmuar dhe, prandaj, i pakushtëzuar. Ashtu si profeti, edhe i urti³⁰ e merr frymëzimin nga Zoti, vetëm se të urtit nuk i zbret Xhebraili, për rrjedhojë, një mesazh i tillë nuk konsiderohet një komunikim kushtëzues. Frymëzimi është një ngjarje subjektive dhe ndërgjegjeje, prandaj dhe nuk është e detyrueshme për të tjerët. Frymëzimi shihet i denjë për pranim në raport me përshtatshmërinë ndaj shprehjeve me kuptim të drejtpërdrejtë³¹ të Kur'anit dhe Sunetit autentik si dhe shpreh një vlerë të caktuar në kuadrin e përshtatshmërisë ndaj bazave të fesë.

²⁹ Në origjinal: she'n. Përkthyesi.

³⁰ Në origjinal: veli, shenjtor, i urtë. Përkthyesi.

³¹ Në origjinal: muhkemat, shprehje me kuptim të drejtpërdrejtë, jo figurativ (kund. muteshabihat, figuracion). Përkthyesi.

E dyta është dituria lidhur me të fshehtat e materies që u zbulon dhe u jep Allahu robve të Tij si shpërblim për përdorimin metodik të shkaqeve nga ana e tyre. Ekzistenca e cila është fusha e shfaqjes së diturisë hyjnore, është pothuajse si një katalog shifrash. Ja, pra, është përsëri Allahu që u favorizon robve të vet, në vartësi të zellit dhe përpjekjeve të tyre, frymëzimin ose mbështetjen që do të ndihmonte për zgjidhjen e këtyre shifrave. Për shembull, në një çast kur një shkencëtar mbetet në gjendje të pashpresë për shkak se nuk di se ç'të bëjë në lidhje me një studim që kurrë nuk do ta përballonte dot me kapacitetin e vet, bëhet i merituar i një frymëzimi që ka të bëjë me zgjidhjen e asaj situate të bllokuar. Gjithashtu, një shkencëtar që bën përpjekje në një fushë të teknologjisë, duke zhvilluar kërkimin e vet, disa herë zbulon diçka krejt të kundërt me synimin e vet. Kjo është një favor i Allahut për njerëzimin në personin e atij shkencëtari, qoftë besimtar apo mohues, i cili i përdor shkaqet në mënyrë metodike. Jemi të mendimit se nuk do të kishte ndonjë pengesë sikur ta mendonim në një perspektivë të tillë të gjerë ajetin në vijim: “Lexo! Zoti yt është bujar i pafund. Është Ai që ia ka mësuar njeriut të shkruajë me kalem. Ia ka mësuar ato që s’i dinte!” (Alak, 96/4-5)

Katedra (zotërimi dhe administrimi) e Tij i përfshin tërësisht qiejt e tokën

Fjala *kursi* (katedër) që përdoret në këtë fjali në origjinal, është një fjalë që shpreh sundimin e Allahut. Megjithëse Krijuesi i Lartë e ka parashtruar në krye të kësaj shprehjeje marrëdhënien e Tij me gjithësinë, na e paraqet edhe këtu me një shprehje koncize e përfshirëse administrimin e Tij mbi ekzistencën dhe na jep këtë mesazh: Dijeni mirë këtë se në këtë gjithësi ku ndodheni të rrethuar nga të gjitha anët, nuk ka asnjë pikë ku vullneti dhe fuqia e Zotit tuaj të mos ushtrojnë vendimin e Tij!

Ai nuk e ka të vështirë t’i mbrojë e të kujdeset për qiejt dhe tokën

Ai është aq i madh e aq i lartë

Kjo fjali ka cilësinë t’i shpërndajë të gjitha dyshimet që mund të fusë shejtani, djalli, në mendjen e njeriut në lidhje me çështjen e fuqisë dhe forcës së Allahut. Këtu, Krijuesi i Lartë sikur na thotë neve: “Në asnjë mënyrë mos u kapni pas mendimeve të tilla, që ju shtyjnë të dyshoni se si mund të bëhen kaq punë nga ana e një personi të vetëm!” Sepse për Atë nuk ka gjë të lehtë apo të vështirë. Shprehje të tilla të përdorura herë pas here prej Tij në Librin e Tij, janë si rrjedhojë e kujdesit të Tij për nivelin e neve, robve të Tij.

Fakti që për vullnetin dhe fuqinë hyjnore nuk bëhet fjalë për asnjë pengesë, është një specifikë mbi të cilën Kur’ani është përqëndruar duke e theksuar në mënyrë të veçantë. Pothuaj në çdo sure, si një përmbledhje në fund të shumë ajeteve, Allahu (xh.xh.) na e kujton këtë të vërtetë duke urdhëruar: “Pa dyshim, Ai ka mundësi për çdo gjë!”³² Kurse ajeti “Po të dëshirojë për diçka që të bëhet, Ai i thotë vetëm “bëhu!” dhe ajo menjëherë bëhet!” (Jasin, 36/82), që parashtron si shprehje absolutitetin e fuqisë së Allahut (xh.xh.), është, në lidhje me këtë çështje, në nivelin kulmor të shprehjes!

Sipas fuqisë së Zotit, yjet krijohen me lehtësinë e krijimit të një grimce, pranvera, me lehtësinë e krijimit të një luleje, pema, me lehtësinë e krijimit të një fare!

³² Shih. Al-i Imran, 3/29, Maide, 5/40.

Ai është i tillë i madh e i lartë

Madhështia e tij nuk është një madhështi abstrakte që mbetet në fjalë. Ai është i vetmi i lartë i vetmi i madh. Ai është një Qenie e lartë, i madh sa kurrësesi s'mund ta masin peshoret e mendjes dhe arsyes. I madh, Allahu është! Fakti që gjithë universi, nga mikrokozmosi në makrokozmos, - larg çdo konfuzioni dhe kaosi - drejtohet brenda një rregullsie e harmonie marramendëse, ka cilësinë për të na dhënë neve në këtë pikë një ide të mjaftueshme!

Mesazhet e shprehura nga Ajeti Kursi mbi qetësinë dhe lumturinë e një rob i beson

Më së pari, Allahu i Lartë kërkon që ne të kapemi fort pas ligjeve të vëna prej Tij dhe shkaqeve, dhe t'i respektojmë ato. Por kur të kapemi pas shkaqeve dhe të mos arrijmë një përfundim, me deklaratën e Tij, sipas të cilës, "Ai është Kajjum; gjithësia që e ka krijuar, është çdo çast nën administrimin dhe përdorimin e Tij", na kujton neve këtë: drejtimi i kësaj prone është në dorën e Tij. Portat që i shihni mbyllur, Ai i hap në çastin kur dëshiron për ju; gjënë që e shihni të pamundur, mund ta sjellë në gjendje të mundshme për ju. Atëherë kur shkaqet të rrëzohen plotësisht e të heshtin, mos bini në pesimizëm duke thënë se, "tashmë çdo gjë ka mbaruar"! Mbështetuni te Zoti juaj sepse Atij i mjafton fuqia për të bërë ç'të dëshirojë!

Kurse me fjalinë "Atë s'e zë as dremitja, as gjumi", Allahu i Lartë u jep robve të Tij këtë mesazh: Rrini të qetë e të sigurtë, sepse Zoti juaj që e besuat dhe që iu nënshtruat, nuk është i painformuar qoftë edhe për një çast të vetëm për asnjërën nga gjërat e bëra që kanë lidhje me ju. Mos u frikësoni se mos "ndërsa jeni duke fjetur, armiku ju bën ndonjë të keqe"! Jam Unë që kurrë nuk fle, që ju kam nën vëzhgim e kujdes! Ju merrini masat e duhura si njerëz që jeni, tjetrën lërmani mua!

Ibrahim Hakiu e ka shprehur këtë në mënyrë koncize, kështu:

Aty ku i pashpresë mbetet në vend,

Hapet një perde papritmas, menjëherë

Dhe bëhet shpëtim për çdo mjerim;

Të shohim Zoti ç'bën; në bëftë, e bën si më mirë!

Me shprehjen "Ç'të ketë në qiej e në tokë, janë (të gjitha) të Tij", siguria dhe qetësia të pranishme në zemrën që beson, forcohen edhe më shumë. Allahu i Lartë këtu sikur i thotë robit: Pse ke frikë? A mos për ushqimin që mendon se nuk do ta sigurosh dot nesër, apo për ndonjë punë që mendon se nuk do ta kryesh dot nesër? Mos e nxirr nga mendja këtë që, ç'të ketë në qiej e në tokë, të gjitha janë të miat; kujt të dua ia jap, kujt të dua, ia marr prapë! Ti bëje atë që të bie sipër, pastaj ki besim te Unë, sepse Unë u jap pjesë edhe atyre që s'më besojnë, madje, kurse ti më beson dhe më bindesh!

Me deklaratën se "kush mund të ndërhyjë pranë tij pa lejen e Tij", Allahu i Lartë (xh.xh.), duke na kujtuar se pranë Tij askush nuk do të mund të ndërhyjë mbi dikë tjetër pa lejen e Tij, thotë kështu: Mos ki frikë nga askush në këtë botë, sado që të jetë i fuqishëm! Askush nuk mund të të bëjë ndonjë të keqe pa lejen time dhe në kundërshtim me dëshirën time! Po qe se je përballur me ndonjë dhimbje dhe vështirësi, dije se ky është vlerësimi im për ty, prandaj ti mendo vetëm detyrën tënde dhe mos dysho për më tej!

Shprehja "Zoti i di të gjitha ç'janë para dhe pas robve (që i ka krijuar), u thotë robve besimtarë: Kurrë të mos pandehni se nuk e di se ç'ndodh dhe se gjëra planifikohen për ju! Unë i di të gjitha gjërat

e tyre të hapura ose të fshehura. Të mos frikësoheni se mund të ndodhë diçka që të mos e marr vesh unë! Atëherë, nga se ke frikë ti, o robi im?

EMRAT DHE ATRIBUTET E ALLAHUT

A. Emrat e Allahut

Po qe se do t'i kishim marrë emrat që kemi, jo duke na i vënë prindërit që në lindje, por më vonë, sipas aftësive dhe mjeshtërive tona, dikush do të quhej "murator", dikush "marangoz", dikush "mësues", dikush tjetër rrobaqepës e kështu me radhë. Mirëpo emrat na vihen jo sipas mjeshtërive që fitojmë kur rritemi, por sipas dëshirës së prindërve tanë qysh kur lindim. Madje, disa herë ndodh që të na vihen emra që s'na përshtaten aspak ose që s'kanë të bëjnë aspak me ne.

Një përngjasim i tillë që po përdorim për të ardhur te shpjegimi i emrave të Allahut mund të duket, në vështrim të parë, vulgar dhe i papëlqyeshëm, por ç'e do se në përshkrimin e të vërtetave abstrakte, qysh në krye të herës është vepruar po në këtë rrugë duke përdorur thjeshtimin dhe vulgarizimin³³ e shprehjeve.

Emrat e Zotit na janë mësuar neve nga vetë Ai me ndërmjetësimin e robve të Tij të zgjedhur duke u mbështetur në veprimtarinë e Tij në gjithësi. Për shembull, në gjithësi është një bukuri që e shohim krejt hapur. Këto bukuri, si ylberi, të ndërthurura me njëra tjetrën, e kanë mbështjellë tërë ekzistencën. Në mal e në fushë, në pranverë e në lule, në sy e në vetulla sundon një valle bukurish. Ka mijra vjet që, për ta shprehur mahnitjen për këto bukuri vetëm duke parë pamjen e tyre të jashtme, mijra shkrimtarë e poetë janë përpjekur vazhdimisht për t'i bërë epike këto bukuri dhe, megjithëkëtë, shumë pak gjëra kanë mundur të thonë në krahasim me ato që mund të thuhën! Të gjitha këto bukuri që nuk do të mund

³³ Në origjinal: tenezzülat (osm.). Përkthyesi.

të mbaronim duke i përmendur dhe përshkruar, sigurisht që mbështeten në një emër të Zotit që e shpreh këtë kuptim, që është emri "Xhemil", "I Bukur".

Gjithashtu, në natyrë bëhet një dhënie dhe shpërndarje furnizimi³⁴ brenda një rregulli dhe rregullsie të imtë. Nga qeliza te rinoceronti, çdo gjallesë ushqehet me një furnizim dhe racion ushqimor në përshtatje me natyrën e saj. Ndërsa engjëjt furnizohen dhe ushqehen me ibadete dhe tesbihe³⁵, njeriu furnizohet dhe ushqehet me mish, kurse xhindët, me kocka! Ja, pra, kjo veprimtari që e shohim me sy, pa asnjë dyshim, vërteton emrin Rezzak të Allahut, Zotit të gjithësisë!

Po që se ne nuk do t'i kishim ditur emrat Xhemil dhe Rezzak të Allahut, pasi të vërenim veprimtarinë e Tij do t'i thonim: "Ti je Xhemil", Ti je "Rezzak"! Po kështu, duke i vënë re dhe kuptuar veprimtaritë e tjera të Allahut, do t'i drejtoheshim me emërtimet e atyre veprimtarive. Ja, pra, pasi na ka treguar veprimtarinë e Tij në gjithësi, për të mos na lejuar ne që të bëjmë gabim, Allahu e ka emërtuar veten me këta emra. Ndërkaq, emrat hyjnorë janë induktivë dhe të fiksuar³⁶. Ne vetë nuk mund të sajojmë emra për Individualitetin Hyjnor.

Këta emra mbështeten në disa cilësi dhe attribute që i reflektojnë ata. Po të shprehemi përsëri me shembuj krahasues si më sipër, është e pamundur që dikush i cili nuk është marangoz, të quhet marangoz, ose i cili nuk është bukëpjekës, të quhet bukëpjekës, ose i cili nuk është rrobaqepës, të quhet rrobaqepës, e kështu me radhë. Ja, pra, emri "Xhemil", "I Bukur", i Zotit, që e pranojmë se ekziston tek Ai dhe që e vërejnë disa njerëz të një niveli të caktuar, mbështetet në atributin "Xhemal", "Bukuri" që është burimi i të gjitha bukurive. Si ky, të gjithë emrat mbështeten në një cilësi apo atribut që u bëhet burim dhe, të gjithë atributet mbështeten në ekskluzivitetin hyjnor të emërtuar, në terminologjinë përkatëse, "she'n"; po që se e përdorim këtë term për njerëzit, do të thotë kapacitet, aftësi, talent, attribute, këto, që nuk është me vend të përdoren për Zotin. Kjo do të thotë se aktet mbështeten në emrat, emrat në atributet, atributet në ekskluzivitetin hyjnor³⁷ dhe ekskluziviteti hyjnor mbështetet në Individualitetin e Zotit. Atëherë, ndalojmë këtu dhe themi si i Dërguari i Allahut: "Nuk të njohëm dot ashtu siç është e vërteta, o i Gjithëditur!" Gjithashtu themi po si Ebu Bekri: "Të jesh i paaftë për të të kuptuar Ty, do të thotë të të kuptosh Ty!" Dhe përkulemi më dysh me drojtje e edukatë!"³⁸

Sunitët kanë ditur t'i lidhin në afërsi të gjitha qeniet në gjithësi me Allahun. Në të vërtetë, janë profetët ata që na e kanë mësuar neve se ç'është marrëdhënia e cilësisë së materies me Zotin, se shfaqje e cilëve emra dhe attribute është cilësia e gjërave që përbëjnë materien. Ajo ç'kanë bërë sunitët, është që, duke i formuluar këto të vërteta, t'i shprehin në nivelin e horizontit të njohjes sonë.

Emrat e Allahut ne mundemi t'i dimë vetëm me anë të deklaratave të profetit tonë, Hz. Muhamed (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Në Kur'an, për emrat e Allahut është bërë fjalë me shprehjen "esma-ul husna" që do të thotë "emrat më të bukur": "Ai Allah që, përveç Tij nuk ka zot tjetër. Emrat më të bukur janë të tijët!" (Taha, 20/8; Hashr, 59/24) Siç bëhet e ditur në ajet, emrat më të bukur dhe që argumentojnë kuptimet më të larta, i përkasin Allahut!

Allahu (xh.xh.) ka shumë emra që përmenden në Kur'an dhe hadithe. 99 prej këtyre janë bërë të ditur në hadithet profetike. Në një hadith, Profeti ka thënë kështu: "Allahu ka 99 emra. Ai që i mëson e

³⁴ Në origjinal: رزق, rizk; racion ushqimor minimal i domosdoshëm për jetesë, racion ushqimor, prandaj, siç do të shihet në vijim të shpjegimit të mësipërm, Allahu quhet Rezzak, furnizues, ushqyes. Përkthyesi.

³⁵ Kështu në origjinal. Ibadet: adhurim; tesbih: madhërim i Allahut. Përkthyesi.

³⁶ Në origjinal: istikra': induktiv; tevkif: epagogjik (frëngj. épagogique), i fiksuar. Përkthyesi.

³⁷ Në origjinal: Shuunat-i ilahije. Përkthyesi.

³⁸ Fethullah Gylen: Lëkundjet që solli shekulli, 3, f. 62.

i thotë përmendësh këta, që, në sjelljen e tij ndaj Allahut, duke i ruajtur kufijtë e emrave të bukur, bën adhurim duke i ruajtur kufijtë e emrave të bukur dhe duke i respektuar siç duhet ata, hyn në xhenet!" (Tirmidhi, Daavat, 82; Buhari, Tevhid, 12) Në vazhdimin e hadithit janë bërë të ditur 99 emrat e Allahut, që janë:

Allah: emri i përveçëm e i posaçëm i Zotit që argumenton Individualitetin i cili përmbledh në vetvete të gjithë emrat dhe atributet e vet.

Rrahman (mëshirues): tregon mëshirë për të gjitha krijesat e veta, besimtarë e jobesimtarë dhe u jep të mira.

Rrahim (shumë mëshirues, bamirës, shpërblyes): ky atribut shpreh mëshirën e posaçme të Allahut për ata që favorin e Allahut me anë të atributit rahman e vlerësojnë bukur me anë të besimit.

Melik (sundimtar): sundimtari i vërtetë i ekzistencës.

Kuddus (i shenjtë): Allahu s'ka të bëjë me asnjë lloj të mete e mungese, është i pakufizueshëm e i papërshkrueshëm, është i përsosur në çdo veçori të Tij dhe krejt e pastër.

Selam (shpëtues): Allahu është burimi i çdo shpëtimi e paqeje, i pastër nga të metat e mangësitë, ai që i nxjerr robtë e vet në shpëtim e paqe.

Mu'min (besues, besimtar, i besës): Allahu jep besim dhe siguri, largon dyshimet dhe lëkundjet, u jep besim atyre që mbështeten te Ai, u jep siguri atyre që kanë frikë dhe i mbron.

Muhejmin (mbrojtës, ruajtës, marrës nën ruajtje): Allahu vëzhgon, është dëshmitar për çdo gjë dhe merr nën ruajtje e mbrojtje çdo gjë.

Aziz (i çmuar, i vyer, i shenjtë): Allahu është zotërues i fuqisë më të lartë dhe fitimtar absolut.

Xhebbbar (shtrëngues, detyrues): Allahu i rregullon punët dhe gjendjen e krijesave të Tij; me vullnetin e vet, Ai i drejton ata si të dojë; Allahu është i pakundërshtueshëm në zbatimin e urdhrit të Tij.

Mutekebbir (madhështor): Allahu e tregon se sa i madh është, në çdo gjë dhe në çdo ngjarje, Ai është posaçërisht i madh e i lartë dhe kjo është e drejta e tij ekskluzive.

Halik (bërës, krijues): Allahu e krijon çdo gjë nga asgjëja, e bën të qenë çdo gjë nga e paqena.

Bari (hyjni): Allahu krijon në mënyrë të rregullt dhe harmonike, i bën krijesat e veta të rregullta dhe harmonike.

Musavvir (projektues): Allahu i projektton në mënyrë të posaçme gjërat dhe qeniet që krijon.

Gaffar (falës i fajeve): Allahu ua mbulon dhe ua fal mëkatet robve të vet, Allahu është falës i madh e i gjerë.

Kahhar (prishës, shkatërrues, persekutues i kundërshtuesve): Allahu është sundues absolut, i cili i drejton krijesat ashtu siç do dhe i dënon e i shkatërron kundërshtuesit.

Vehhab (falës, dhënës pa shpërblim): Allahu favorizon dhe jep me shumicë pa shpërblim.

Rrezzak (furnizues, ushqyes): Allahu u siguron të gjitha krijesave racionin bazë jetësor si dhe i furnizon ato siç do vetë.

Fettah (ngadhnjyes): Allahu është ngadhnjyes; Ai ngadhnjen mbi të gjitha vështirësitë dhe hap dyert e mirësive.

Alim (dijetar): Allahu di gjithçka.

Kabd (rrëmbyes i shpitrave): Allahu i merr shpitrat si domosdoshmëri e urtësisë dhe favorit të Tij.

Bast (zgjerues i të mirave): Allahu i zgjeron të mirat, i zgjat jetët.

Hafid (poshtërues i mohuesve): Allahu përmbys kë të dojë, Allahu i ul dhe poshtëron të këqinjët, faraonët, dhunuesit, mohuesit.

Rafi (lartësues): Allahu ngre lart, lartëson kë të dojë.

Muiz (vlerësues, lartësues): Allahu e lartëson, i jep vlerë dhe e bën të çmuar kë të dojë.

Mudhil (zhvlerësues): Allahu zhvlerëson dhe turpëron kë të dojë.

Semi' (dëgjues): Allahu dëgjon çdo gjë.

Basir (shikues): Allahu sheh çdo gjë.

Hakem (gjykues, ndarës i të mirës prej të keqes): Allahu gjykon; Ai e diferencon dhe e ndan të mirën nga e keqja.

Adl (i drejtë): Allahu është i drejtë.

Latif (favorizues; detajues): Allahu bën mirë, favorizon dhe di çdo gjë me hollësi.

Habir (i informuar): Allahu është i informuar për çdo gjë.

Halim (sjelljebutë): Allahu është sjelljebutë, Ai nuk ngutet për të ndëshkuar.

Adhim (madhështor): Allahu është i lartë e madhështor.

Gafur (falës i gjerë): Allahu është mbulues dhe falës i gjerë i gabimeve dhe mëkateve.

Shekur (shumë falenderues): Allahu jep shpërblim të madh për pak akte të mira të robve të vet, Ai i shumëfishon mirësitë.

Ali (i lartë): Me fuqinë e Tij, Allahu është i lartë dhe epror ndaj krijesave.

Kebir (i madh, madhështor): Allahu është i madh, Ai karakterizohet nga madhështia hyjnore e posaçme vetëm për Të.

Hafidh (roje, ruajtës): Asgjë s'mbetet e fshehtë për Allahun, Ai shënon çdo gjë që bëjnë robtë e vet, me fuqinë e Tij mban në ekzistencë qiejt dhe tokën, Ai i mbron njerëzit dhe kujdeset për ta.

Mukit (përgatitës furnizimi): Allahu ka mundësi për çdo gjë, kujdeset për këdo e çdo gjë dhe u jep ushqim të gjitha gjallesave që ka krijuar e krijon.

Hasib (llogarikërkues): Allahu llogarit dhe kërkon llogari.

Xhelil (i lartë në cilësi): Allahu është aq i lartë dhe i përplotësuar, saqë asgjë nuk mund të qëndrojë dot para dhe përkundër Tij, saqë mund të shkatërrojë dhe asgjësojë çdo gjë.

Kerim (shumë bujar): Allahu është bujar dhe mirëbërës i madh.

Rakib (vëzhgues, ndjekës): Allahu kontrollon dhe shënon të gjitha bëmat e njerëzve.

Muxhib (pranues i lutjeve): Allahu i pranon lutjet dhe dëshirat dhe u përgjigjet atyre.

Vasi (i gjerë në dije dhe mëshirë): Dituria dhe mëshira e Allahut mbështjell çdo gjë.

Hakim (i urtë): Allahu është i urtë, Ai e bën çdo gjë me kuptim, urtësi dhe ashtu siç duhet.

Vedud (dashamirës): Allahu është dashamirës.

Mexhid (i lartë në nder): Allahu është i famshëm dhe bujar i pakufishëm.

Baith (ringjallës, dërgues): Allahu është ringjallës; Allahu është dërgues profetësh.

Shehid (dëshmues): Asgjë nuk mund të fshihet nga Allahu; Allahu është dëshmitar për çdo dhe nuk harron asgjë.

Hak (i vërtetë): Allahu i vetëqenë, prandaj është vetë e vërteta; Allahu nuk mund të mohohet.

Vekil (dorëzanës): Allahu kujdeset për çdo gjë duke marrë përsipër çdo gjë; asgjë s'është e fshehtë prej Tij; drejtimi dhe ushqyerja e qenieve i përket Atij.

Kavi (i fuqishëm, i fortë): Ai është i vetmi zotërues fuqie dhe force te i cili në asnjë mënyrë nuk mund të shfaqet dobësi.

Metin (i fortë): Allahu është zotërues i fuqisë së përkryer dhe i pushtetit të plotë.

Veli (kujdestar): Allahu është mik dhe ndihmës i atyre që e besojnë, Ai merr përsipër punët e gjithësisë dhe krijesave.

Hamid (i denjë për lavdërim): Allahu është i denjë për çdo lavdërim dhe falenderim.

Muhsi (numërues): Allahu numëron dhe ruan çdo gjë një për një.

Mubdi (bërës nga e paqena): Allahu i krijon krijesat pa model dhe nga hiçi.

Muid (vdekjdhënës dhe ringjallës): Allahu i rikrijon qeniet pasi u jep vdekjen.

Muhji (ngjallës, jetëdhënës): Allahu është jetëdhënës.

Mumit (vdekjdhënës): Allahu është që jep vdekjen.

Hajj (i gjallë): Allahu është i gjallë me një gjallëri që është e posaçme vetëm për Të dhe e përhershme.

Kajjum (që qëndron në këmbë dhe që e mban çdo gjë në këmbë): Allahu ekziston pafundësisht dhe e mban në këmbë çdo gjë.

Vaxhid (zbulues): Allahu zbulon dhe nxjerr në shesh çdo gjë që do dhe në atë çast që do.

Maxhid (i famshëm): Allahu ka famë të lartë.

Vahid (një i vetëm): Allahu është një i vetëm dhe i pashoq.

Samed (i vetëmjaftueshëm e i përplotësuar): Allahu është i vetëmjaftueshëm dhe i përplotësuar; ndërsa çdokush e çdo gjë ka nevojë për Të, Ai s'ka nevojë për askënd dhe asgjë.

Kadir (zotërues): Allahu zotëron dhe ka mundësi për çdo gjë; te Ai nuk mund të shfaqet dobësi në asnjë formë.

Muktedir (fuqiplotë): Allahu është fuqiplotë, për Të s'ka asgjë të pamundur dhe kundërvënia ndaj Tij është e pamundur.

Mukaddim (priorizues): Allahu i jep përparësi, prioritet çdo gjëje dhe çdokujt që dëshiron.

Muahhir (prapësues): Allahu prapëson dhe lë pas çdo gjë.

Evvel (i parë, i paraqenë): Allahu është i paraqenë, Ai ekziston në mënyrë të pafillimtë para gjithçkaje.

Ahir (i pasqenë): Allahu është i pasqenë, Ai s'ka fund; Allahu është mbetës edhe kur të mos ekzistojë më asgjë.

Dhahir (i dallueshëm): Allahu qëndron dhe dallohet mbi çdo gjë, Ai është i dallueshëm me anë të akteve dhe provave të Tij.

Batn (i fshehur, i brendshëm): Allahu është i fshehur dhe i brendshëm, i pranishëm në çdo gjë në atë mënyrë që nuk mund të perceptohet dhe të përfytyrohet.

Vali (administrues): Allahu administron dhe zotëron tërë gjithësinë.

Muteali (i tejzakonshëm, transcendental): Në ndryshim dhe në mënyrë të dallueshme nga çdo gjë, Allahu është i tejzakonshëm, transcendental.

Berr (fjalë e punëkthjelltë): Allahu është i kthjelltë të fjalë e në aktet e Tij, i dhimbsen shumë robtë e Tij dhe u bën shumë të mira atyre.

Tevvab (pranues i pendesës): Allahu i pranon pendimet e robve të vet.

Muntakim (shpagimtar): Me drejtësinë e Tij, Allahu u jep fajtorëve ndëshkimin e merituar.

Afuvv (falës): Allahu është falës ndërsa ka mundësi të ndëshkojë.

Rauf (i dhembshur): Allahu është shumë i dhembshur.

Malikul Mulk (pronari i mallit): Allahu është pronari i vërtetë i ekzistencës, i cili vepron si të dojë në pronën e tij.

dhul Xhelali vel Ikram (I Madh dhe Dhurues): Allahu është zotëruesi i madhështisë dhe bujarisë.

Muksit (synues): Allahu është synues, Ai i kryen të gjitha aktet me një synim të caktuar dhe në mënyrë të përkryer.

Xhami (përmbledhës, bashkues): Allahu është përmbledhës dhe bashkues i çdo gjëje që dëshiron në vendin e duhur dhe në kohën e duhur.

Gani (i pasur): Allahu është aq i pasur sa nuk ka nevojë për askënd dhe për asgjë.

Mugni (pasurues): Allahu e bën të pasur kë të dojë.

Mani (pengues): Allahu i bëhet pengesë kujt të dojë dhe ç'gjëje të dojë. Ai i mbron robtë e Tij të bindur nga të këqijat duke e penguar të keqen ndaj tyre.

Darr (dëmtues): Allahu krijon gjërat që shkaktojnë dhimbje dhe dëm dhe e provon me anë të këtyre atë që dëshiron.

Nafi (dobisjellës): Allahu krijon gjërat që sjellin të mira e dobi dhe bën që të përfitojë nga këto ai që dëshiron.

Nur (dritë): Allahu është ndriçues i botëve dhe zemrave.

Hadi (orientues): Allahu është orientues dhe udhëzues në udhën e drejtë.

Bedi (novator): Allahu është novator në krijim.

Baki (i gjithëqenë, permanent): Allahu ka ekzistencë të përhershme.

Varith (trashëgimtar): Allahu është trashëgimtari i vërtetë i çdo gjëje.

Reshit (udhërrëfyes): Allahu e çon çdo gjë me urtësi dhe rregull në synimin e vet; Allahu është udhërrëfyes.

Sabur (durimtar): Allahu është durimtar, Ai nuk ndëshkon menjëherë, por jep kohë dhe duron.

Emrat hyjnorë nuk janë vetëm këta që u përmendën këtu. Diskutimi në hadithin profetik i numrit 99 nuk tregon një kufi, nuk do të thotë se nuk ka emra hyjnorë veç këtyre. Këta janë emrat më të njohur. Allahu ka emra të panumërt.

Ne nuk i dimë të gjithë emrat hyjnorë. Në një lutje që na mëson profeti ynë, Hz. Muhamedi (s.a.v.) për ta bërë dikush kur shqetësohet si pasojë e fatkeqësive, thotë: "Allahu im, unë jam një robi yt, jam bir i një burri dhe një gruaje. Perçeja ime është në dorën e fuqisë tënde. Vendimi yt për mua është në fuqi, vlerësimi yt është i drejtë. Për nderim të çdo emri tënd që e ke përmendur në Librin tënd, që ia ke mësuar dikujt nga krijesat e tua ose që ia ke lënë vetes në dijen tënde të fshehtë (që s'ia ke njoftuar askujt), të lutem të ma bësh Kur'anin pranverën e zemrës sime, dritën e syve të mi, lehtësuesin e anktheve dhe shqetësimeve të mia!" (A. Hanbel, Musned, 1/391; Hakim, Mustedrek, 1/690).

Kjo do të thotë se nuk janë vetëm emrat që i dinë njerëzit, që janë përmendur në libër, por janë edhe emrat që i janë njoftuar vetëm një robi të mirë, një xhindi ose një engjëlli, si dhe emrat që nuk i janë njoftuar askujt por janë caktuar si të posaçëm vetëm për dijen hyjnore.

Lutja me Emrat e Bukur të Allahut

Lutja është esenca e adhurimit. T'i lutesh Allahut nga zemra dhe me sinqeritet, t'ia hapësh zemrën Atij është çështja më jetësore që e bën njeriun njeri, që i përfton njeriut vlera përmbi vlera. Këtë të vërtetë, Kur'ani e ka shprehur kështu: "Po të mos bëni lutje, ç'vlerë do të keni? Thuaju: "Po të mos luteni, pse Allahu t'ju japë vlerë?" (Furkan, 25/77)

Është shumë e rëndësishme që, kur të bëhet lutje, të bëhet me emrat e Allahut. Allahu i Lartë kërkon që robtë t'i luten me anë të emrave të bukur të Tij. "Emrat më të bukur janë të Allahut. Lutuni, pra, Atij, me emrat më të bukur!" (A'raf, 7/180)

Njeriu si njeri që është bërë i merituari i shumë emrave hyjnorë, që është ngarkuar me përgjegjësinë e kryerjes së shumë detyrave dhe që është vënë në provë me shumë armiq, si nefsi, shejtani, etj., duhet t'i bëjë lutje Allahut edhe për t'u mbrojtur nga e keqja e armiqve të vet, edhe për të arritur ato që do; ai duhet t'i lutet Allahut si ai lypësi që kërkon patjetër t'i shkëpusë diçka dikujt! dhe në lutjet dhe përgjërimet e tij duhet t'i përmendë emrat e Allahut.

Kur të keni mbetur ngushtë dhe kur të ndjeni nevojë, mund t'i bëni thirrje Zotit me ndonjë fjalë çfarëdo. Pavarësisht se ç'fjalë është ajo, me atë zë të brendshëm dhe me shprehjen e zemrës, ju, pa i rënë në të aspak, mund të shqiptoni njërin nga ata emra që janë lënë të fshehur ose një emër të pranueshëm si Emri i Madh. Për shembull, ju thoni: "Unë jam një shkaktar varfërie, kurse Ti je ai që i mban për dore të varfërit e të pafuqishmit!" Ne nuk njohim ndonjë emër hyjnor që t'i përgjigjet kësaj, por ky koncept mund të jetë njëri ndër emrat hyjnorë! Gjithashtu, ju mund të thoni: "Unë jam një nevojtar i mbetur ngushtë, kurse Ti je ai që ua plotëson nevojat atyre që mbeten në ngushticë!" Dhe këtë mund ta përdorni në vend të shprehjeve "Ja, Farixhe'lhemm, ja Kashife'lgamm" që përshekohen në Xhevshen. Po të jeni të sinqertë e ta keni me gjithë zemër, Zoti jua zgjidh gjuhën dhe ju bën që ta shqiptoni Emrin e Madh edhe pa i rënë në të ju aspak. Por nëse gjuha nuk ju është interprete e zemrës, edhe sikur ta thoni Emrin e Madh, keni lënë diçka mangët në këtë mes!

Ja, është si rrjedhojë e kësaj që miqtë e të vërtetës kanë thënë se vetëm në atë masë që lutjet dhe përgjërimet të bëhen me besnikëri (sinqeritet dhe përzemërsi), arrihet afrimi me Emrin e Madh, arrihet në kulmin e mëshirës dhe bëhet pranimi i tyre. Sigurisht, sinqeriteti, përzemërsia dhe besnikëria ndikojnë pothuaj si eliksir i Emrit të Madh. Atyre që e patën pyetur se cili është Emri i Madh, Bejazid Bistami u qe përgjigjur kështu: "Tregomëni ju emrin më të vogël ndër emrat e Allahut, t'ju them unë se cili është emri më i madh!" Dhe pati vazhduar: "Sipas meje, nëse ka një gjë që të bëjë efekt si Emri i Madh, pa dyshim, ajo gjë është besnikëria! Çfarëdo emri që të thuhet me besnikëri (sinqeritet dhe përzemërsi), ai bëhet Emri i Madh!³⁹"

Po, njeriu duhet t'i drejtohet Zotit i sinqertë dhe Emrat Hyjnorë duhet t'i vlerësojë si shkallë me shumë rëndësi për t'iu afruar Atributeve të Larta, duhet të pranojë se njohja e Individualitetit Hyjnor

³⁹ Në origjinal: Ism-i Adham, Emri i Madh. Përkthyesi.

është e mundur vetëm nëpërmjet njohjes së Emrave Hyjnorë dhe duhet t'i ndjekë ata me tërë zemrën. Ai duhet t'i njohë dhe përmendë këta emra si një njeri i zemrës!⁴⁰

Marrëdhënia Xhefshen - Emrat Hyjnorë

Bediuzzamani ka tërhequr vëmendjen te "el-Xhevshenu'l-Kebir"-i dhe ka bërë këtë përcaktim të jashtëzakonshëm:

Xhevsheni është një përgjërëm i vërtetë dhe i plotë që përmbahet në Kur'an dhe që na e ofron Kur'anin, është një përmbledhje e Kur'anit e dalë prej Kur'anit.

Xhevsheni **është një përgjërëm i profetit tonë**, Hz. Muhamedit (alejhissalatu vesselam), i cili është njeriu më i përkryer, **drejtuar Allahut me një mijë e një emrat e Tij**, është mbështetje te Allahu nga zjarri i xhehenemit!⁴¹

Pra, Xhevsheni është përgjërëmi i profetit tonë drejtuar Allahut me një mijë e një emrat e Tij. Xhevsheni përmban një mijë e një emra hyjnorë. Personi që këndon Xhevshenin do të thotë se i përgjërohet Allahut me një mijë e një emrat e Tij!

B. Atributet e Allahut

Atributet e Allahut janë trajtuar, përgjithësisht, në dy grupe: attribute individuale dhe attribute qenësore (pozitive).

Atributet individuale (dhatí)

Janë gjashtë attribute të posaçme vetëm për Individualitetin e Allahut, të cilat nuk është e lejueshme dhe e mundshme t'i jepen cilitdo nga krijesat e Tij.

Ekzistencë (vuxhud): Allahu është i qenë, ekziston. Ekzistenca e Tij është e një forme të posaçme vetëm për Të. Ekzistenca e tij është në vetvete. Mosqenia si e kundërta e qenies, nuk mund të diskutohet për Allahun.

Paraqenie (kidem): Allahu është i paraqenë, domethënë, ka ekzistuar gjithmonë, ekzistenca e Tij nuk ka fillim. Sado pas që të shkohet, nuk mund të gjendet një çast kur Ai të mos ketë ekzistuar.

Pasqenie (beka): Allahu është i përhershëm, ekzistenca e tij nuk ka fund. Sado para që të shkohet, nuk mund të mendohet një çast që Ai të mos ekzistojë.

Pangjashmëri me qeniet e krijuara (muhalefetun li'l-havadith): Allahu është krejt i ndryshëm prej qenive të krijuara e të përkohshme që janë krijuar në një pikë kohore të përkohshme e do të marrin fund në një pikë kohore të caktuar. Individualiteti i Tij është përtej çdo gjëje që mund të na shkojë ndërmend.

Njësi (vahdanijet): Allahu është një i vetëm në individualitetin, atributet dhe aktet e Tij, Ai s'ka partner dhe të ngjashëm.

⁴⁰ Fethullah Gülen, *Körk Testi*, 374-375.

⁴¹ Shih. 24. Söz, 1. Dal; 25. Söz, Emirdaë Çiçeî.

Ekzistencë në vetvete (kijam binefsihi): Allahu ekziston nga vetvetja dhe në vetvete. Nuk ka ndonjë qenie tjetër, ndonjë vullnet dhe fuqi që të jetë shkak i ekzistencës së Tij. Ekzistenca e Tij është domosdoshmëri e individualitetit të Tij.

Atributet qenësore, pozitive (thubutî)

Edhe pse të ngjashmet e këtyre u janë dhënë njerëzve si të kufizuara dhe të ndërmjetshme, atributet qenësore (pozitive) të Allahut kanë karakter të pakufizuar dhe janë të drejtpërdrejta. Atributet qenësore të Allahut janë tetë.

Jetë (hajät): Allahu ka jetë, është i gjallë. Allahu ka një jetë të posaçme vetëm për Të dhe është i pavdekshëm.

Dituri (ilm): Allahu ka dituri, dituria e Tij përfshin gjithçka. Allahu di çdo gjë që ka ndodhur, ndodh dhe do të ndodhë.

Dëgjim (semi'): Allahu dëgjon gjithçka të hapur e të fshehtë.

Shikim (basar): Krijuesi i Lartë sheh gjithçka. Asgjë s'mbetet e fshehtë prej Tij.

Vullnet (irade): Allahu ka vullnet, Ai bën ç'të dëshirojë.

Fuqi (kudret): Allahu është zotëruar i fuqisë së pakufizuar e të pafundme.

Fjalë (kelam): Allahu flet; e folura e Tij është e posaçme vetëm për Të.

Krijim (tekvin): Allahu ka aftësi krijuese. Ai krijon nga asgjëja, ai e nxjerr qenien nga mosqenia. Krahu esh'arit i sunnizmit e trajton këtë atribut brenda atributit fuqi (kudret) pa e përmendur si atribut të veçantë.

LUMTURIA E PASHOQE E BESIMIT TE ALLAHU

Si në planin individual, ashtu dhe në planin shoqëror, shkakun më i parë e më i rëndësishëm që qëndron nën të gjitha vuajtjet, padrejtësitë, shfrytëzimet, shpërdorimet, grindjet dhe luftërat, mosmarrëveshjet, konfliktet dhe përleshjet që u nënshtrohet tërë njerëzimi, është fakti se Allahu nuk njihet si duhet, nuk njihet e nuk duhet dhe se nuk njihet shija shpirtërore e dashurisë për Të. Shija pa dhimbje rrjedh nga besimi. Prandaj njerëzimi ka nevojë më shumë se kurrë ta njohë Allahun, ta besojë Atë, ta zbulojë sërishmi se ç'është ky besim, ta ndjejë dhe provojë këtë besim.

Vetëm me anë të këtij besimi është e mundur që njeriu të mund ta kuptojë si qenien e vet, ashtu dhe përbërjen dhe synimin e botës ku jeton. Nisur nga kjo, do të përpiqemi që vlerën që shpreh besimi te Allahu për njeriun, ta përmbledhim në disa pika.

Ky besim, para së gjithash, siguron që njeriu të bëhet një qenie e drejtë dhe e virtytshme. Personi që i beson Allahut, meqë beson se suksesi dhe shpëtimi do të jenë të mundur vetëm me anë të mësimave të mirësisë dhe bukurisë që ia ka bërë të ditura Ai, kapet pas këtyre si parime dhe përpiqet që jetën ta vazhdojë gjithnjë në këtë vijë. Sa për mohuesit, meqë nuk besojnë në ekzistencën e asnjë qenieje të lartë të cilës t'i drejtohen dhe para të cilës të mbajnë përgjegjësi, veç vetes, i vlerësojnë të mirën e të keqen vetëm sipas nefsit (frymës, egos) dhe interesit të vet. Kështu, nuk shohin ndonjë pengesë për të plotësuar

çdo dëshirë e për të bërë çdo lloj teprimi pa bërë dallim mes drejtësisë dhe padrejtësisë, hallallit dhe haramit. Sepse zoti i tyre janë dëshirat dhe kërkesat e tyre!

Duke shtresuar tek njeriu besimin në vetvete, ndjenjat e thjeshtësisë dhe përlulësisë, ky besim e mban njeriun larg nga krenaria dhe mendjemadhësia që marrin nëpër këmbë qetësinë dhe bashkëjetesën e njerëzimit. Ai që i ka besuar siç duhet Allahut, kurrë nuk bëhet krenar dhe mendjemadh. Sepse ai e di se çdo gjë që ka, përfshirë edhe aftësitë, i përkasin Allahut, se Allahu ka mundësi ta marrë prapë çdo gjë që e ka dhënë. Kurse mohuesit, ngaqë mendojnë se çdo gjë që e shohin si pronë të vetën, është drejtpërdrejt vepër e forcave dhe aftësive të veta, nuk mundën të gjejnë asnjë autoritet për ta falenderuar. Ata shohin vetëm veten, e ngrenë lart vetëm veten, gjë që u vë dinamitin ndjenjave të dashurisë dhe respektit për të cilat ka nevojë njerëzimi për të bashkëjetuar.

Në sajë të këtij besimi njeriu sheh dhe kupton se, pavarësisht nga çdo gjë, jeta është e mbushur plot me bukuri dhe gëzime dhe se nuk humbet asgjë prej vlerave të saj. Njeriu që beson, duke menduar se edhe nën ngjarje të hidhura të jetës, si vdekjet, fatkeqësitë, sëmundjet, dhimbjet e dëshpërimet, funksionon një dorë urtësie dhe dhembshurie, nuk mbytet në dhimbje e vuajtje. Duke kujtuar se tek ato ngjarje ka mësim që duhen marrë, vazhdon në rrugën e vet. Sepse duke menduar se asgjë në gjithësi nuk vepron spontanisht e pa qëllim, u vë gjoksin me durim fatkeqësive që i bien sipër; gjithashtu, duke menduar se Allahu nuk i ngarkon njeriut barrën që s'mund ta mbajë⁴² dhe se njeriu vihet në një provë pas së cilës ka një shpërblim moral-shpirtëror⁴³, i pret ngjarjet me durim e qëndresë. Duke menduar se, sado të shqetësuar ta ketë botën e vet, para i ndodhet një jetë ku lulet nuk vyshken, ku diejt nuk perëndojnë, ku nuk ka më dhimbje e vuajtje, njeriu mund t'i harrojë në çast të gjitha dhimbjet. Kurse ai që s'ka besim, vjen një çast që duke mos i bërë dot ballë edhe një fatkeqësie të vogël, mund të tentojë të vrasë veten!

Njeriu që e sheh ekzistencën nga dritarja e besimit, e sheh gjithësinë si një ekspozitë hyjnore ku janë shtruar veprat e Krijuesit të Lartë, kurse veten, si një nëpunës i ngarkuar me detyrën që të shqyrtojë ato vepra arti të përsosura, secila prej të cilave është një mrekulli, dhe nga çdo gjë që sodit, merr një shije moral-shpirtërore. Me qeniet të cilat, po të shihen nga dritarja e mosbesimit, duken, secila, të huaja dhe armiqësore, ai ngre lidhje si rrjedhojë e Zotit të tyre dhe, kështu, gjen mundësinë për ta shndërruar ndjenjën e të huajit ndaj tyre në një lloj miqësie. E thënë ndryshe, njeriu që beson, ngaqë, si rrjedhojë e Krijuesit, mundet ta shohë çdo krijesë me dashuri dhe miqësi, merr kënaqësi nga jeta e jetuar bashkërisht me ta!

Ndërsa njeriu mosbesimtar, kur i hedh vështrimin gjithësisë dhe sheh se si miliarda yje rrotullohen me një shpejtësi marramendëse, shqetësohet e trembet, ai që beson, e di se ata lëvizin jo rastësisht, spontanisht dhe në vetvete, por nën kontrollin e një Komandanti të lartë me dituri dhe fuqi të pafundme, dhe i sodit me dashuri dhe hare; gjithashtu, në këtë kuadër, ndërsa një zemër pa besim që e sheh botën si një anije pa kapiten dhe pa drejtues e nisur në detin kozmik, e zë frika dhe tmerri, zemra besimtare që e sheh botën si anije turistike që lëviz me një program hyjnor dhe që ka brenda çdo lloj ushqimesh e veshmbathjesh, e falenderon Zotin e vet e qetë dhe e kënaqur!

Kohën e shkuar e cila në sytë e mosbesimtarit i përngjet një varreze të errët e të frikshme, besimtari e sheh ndryshe: banorët e saj nuk janë asgjësuar, vetëm vend kanë ndërruar, kanë shkuar në një botë më të bukur, më të ndriçuar!

⁴² Shih. Bakara, 2/286; En'am, 67/152; A'raf, 7/42.

⁴³ Shih. Bakara, 2/155.

Ndërsa dikush që s'ka besuar, përpëlitet mes një egërsie (vetmie), tmerri dhe pesimizmi të madh para tablllove që ia vë para mosbesimi i vet, personi besimtar, duke menduar se të gjithë të afërmit dhe miqtë e vdekur jetojnë në një botë më të shkëlqyer, qetësohet dhe ndjen një gëzim të thellë dhe prehje shpirtërore.

Ndërsa njeriu mosbesimtar, ngaqë ka bindjen se të gjitha qeniet asgjësohen me vdekjen, mendon se edhe vetë ai është udhëtari i të njëjtës rrugë dhe bëhet si i çmendur, njeriu besimtar e sheh këtë si një udhëtim të dashur, sepse, në vështrimin e tij, vdekja është udhëtim nga një botë e përkohshme dhe e vdekshme, në një botë të pavdekshme e të përhershme, është shpëtim nga mundimi për të arritur mëshirën, është përfundim i detyrës së robit dhe adhurimit ndaj Zotit dhe vajtje për të marrë pagesën!⁴⁴

Shkurt, besimi te Allahu është pikëmbështetja më e madhe për njeriun, i cili i ka nevojat të pafundme, kurse kapitalin, po aq të pakët, armiqtë, të panumërt, kurse fuqinë tejet të kufizuar, kërkesat, të pafundme, kurse dorën, po aq të shkurtër! Ja, pra, që qenia me emrin njeri, të mund t'i përballojë këto nevoja, të dalë fitues mbi armiq të panumërt dhe të shpëtojë nga frika dhe dyshimet, duhet të lidhet dhe mbështetet patjetër pas një fuqie të lartë me fuqi dhe pasuri të pafundme që është Allahu!

⁴⁴ Shih. Al-i Imran, 3/195; Murselat, 77/44.

QENIET METAFIZIKE / DRITESORE: ENGJEJT

Koncepti engjëll

Fjala "engjëll" ka kuptime të tilla, si lajmëtar, përfaqësues, forcë, fuqi. Kurse në terminologjinë islame, engjëlli përkufizohet si "një qenie dritësore dhe e tejdukshme e krijuar nga Allahu, e cila s'ka gjini dhe nuk e ndërpret adhurimin ndaj Allahut".

Domosdoshmëria e besimit të engjëjt

Me aspektin e tyre të ndërtimit jomaterial që mund të perceptohet me anë të shqisave tona të jashtme, engjëjt janë qenie që i përkasin botës së padukshme e të fshehtë⁴⁵. Prandaj, për engjëjt merret njohuri jo me anë të ndijimeve, por me informacionet e dhëna nga profetët.

Në librin e Tij të zbritur profetit të fundit, Hz. Muhamedit (sal'lallahu alejhi vesel'lem), na bën fjalë neve për engjëjt dhe e përmend besimin për ekzistencën e tyre mes bazave të besimit:

"I Dërguari i i besoi asaj që iu zbrit nga ana e Zotit të tij, po kështu, edhe besimtarët. Secili i besoi Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij!" (Bekare, 2/285)

Personi që nuk u beson engjëjve, ngaqë mohon konkluzionin e ajeteve përkatëse, nuk quhet se ka besuar. Në fakt, të mos u besosh engjëjve, do të thotë t'i mohosh anasjelltas komunikimin hyjnor dhe zbulesën hyjnore, profetin, librin e sjellë nga profeti dhe fenë e kumtuar prej tij. Sepse feja u është komunikuar profetëve me ndërmjetësinë e engjëjve. Kështu, në Kur'an thuhet:

"... Kush i mohon Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij dhe ditën e ahiretit, do të thotë se ka rënë në perversitet të plotë!" (Nisa, 4/176)

Ekzistenca, natyra dhe veçoritë e engjëjve

Në planetin tonë që zë një vend shumë të vogël në gjithësi, ekzistojnë me mijra forma jete dhe mënyre jetese. Mu në këtë pikë, në mendje mund të vijë një pyetje e tillë: Në qoftë se ndodh kështu në tokë, po në yjet, planetet dhe sistemet shumë më të mëdhenj se toka, a ka qenie të gjalla e të vetëdijshme në përshtatje me kushtet e tyre? Sigurisht, përgjigjja "jo" që do t'i jepej aty për aty kësaj pyetjeje, do të ishte mashtruese. Nuk është aspak e arsyeshme që, duke marrë për bazë vetëm kushtet e jetesës të botës sonë, t'i shohim yjet dhe planetet e tjerë pa qenie të vetëdijshme. Në këto kushte, në tema dhe çështje si kjo që nuk i njohim, duhet t'u besojmë gjërave që na thonë neve specialistët e kësaj fushe, profetët, personat e zgjedhur të pajisur në mënyrë të posaçme.

⁴⁵ Në origjinal autori përdor fjalën arabishte *gajb* që do të thotë edhe *e papranishme*, edhe *e padukshme*, edhe *e fshehtë*. Ndërkaq, kur bëhet fjalë për botën shpirtërore, kuptimi i kësaj fjale është *e fshehtë dhe e pakapshme me asnjë lloj teknologjie* (pikërisht sepse struktura e qenieve të botës shpirtërore është jomateriale). Për shembull, ajri është i padukshëm, por perceptohet qoftë edhe duke i bërë fresk fytirës me dorë ose me ndonjë mjet tjetër. Vijat e forcës së fushës magnetike perceptohen me anë të aparateve. Etj. Përkthyesi.

Le të përpiqemi ta trajtojmë temën me një analogji të mbështetur mbi shembullin. Le të mendojmë një mbret që ka thesare të panumërta dhe mrekulli artistike të pashoqe. Ky sulltan ka ngritur një qytet me pallate të ndryshme që do t'i quanim të pashembullta, dhe në një skaj të këtij qyteti të shkëlqyer ka bërë një ndërtesë-banesë të vogël sa një kolibe. Ne vëshgojmë personalisht me sytë tanë se në atë ndërtesë ka një lëvizje dhe veprimtari të madhe. Pastaj i kthejmë sytë nga ato pallate të shkëlqyera, por atje nuk shohim dot askënd. Pamundësia jonë për të parë ose dalluar gjë, mund të burojë nga tri shkaqe kryesore: nga dobësia jonë e shikimit, ngaqë banorët e atyre pallateve fshihen prej nesh, ngaqë atje s'ndodhet askush.

Ja, pra, ndërtesa e vogël në shembullin e "qytetit të shkëlqyer" që u përpoqëm t'ua ofrojmë me qëllim për ta përshtatur çështjen për mendjet tona, është bota jonë. Kurse pallatet e mëdhenj të këtij qyteti janë yjet dhe sistemet jashtë botës sonë. Dhe tani le të mendojmë jashtë shembullit tonë. A do të ishte e drejtë që dikush, i cili vëzhgon dhe bëhet dëshmitar i valles së mijra ngjyrave e zërave dhe i veprimtarisë së vazhdueshme në një pikë të vogël - në një ndërtesë të vogël me emrin "botë" të qytetit gjithësi, t'i pandehte bosh pallatet e shkëlqyer prej yjesh? Sigurisht që jo! Sepse edhe në to ka jetë dhe banorë me vetëdije. Fakti që ne nuk i shohim nuk do të thotë detyrimisht se nuk janë! Fakti që nuk i shohim është pasojë ose e dobësisë dhe paafësisë së syve tanë, ose e faktit që ata ekzistojnë në një dimension tjetër.

Në këto kushte, fakti që engjëjt janë të padukshëm, të paperceptueshëm me anë të organeve të shqisave, nuk përbën arsye për mohimin e tyre. Sepse padukshmëria e tyre nuk është pasojë e mosekzistencës ose padukshmërisë absolute të tyre, por e faktit që ne nuk jemi krijuar me aftësi dhe kapacitet për t'i parë ata. E thënë ndryshe, padukshmëria e engjëjve është pasojë e faktit që ata janë qenie metafizike që mbeten jashtë fushës sonë të interesimit të mbështetur në vëzhgim, provë dhe eksperimentim. Sot ka shumë qenie, ekzistenca e të cilave është provuar shkencërisht ose ndjehet, të cilat ne nuk i shohim dot me sy të zhveshur.

Kur'ani që na i bën të njohur engjëjt neve me anë të shumë veçorive të tyre, nuk na jep njohuri se prej ç'lloj elementi janë krijuar ata. Këtë njohuri mbi ta ne e shohim në hadithet e Hz. Muhamedit (sal'lallahu alejhi vesel'lem). Në një hadith profetik bëhet e ditur se xhindët dhe shejtanët (djajtë) janë krijuar prej zjarri, Hz. Ademi, prej balte (dheu), kurse engjëjt janë krijuar prej drite. (Muslim, Zuhd, 10)

Te engjëjt nuk ka ndjenja negative, si zemërimi, furia, urrejtja, zilia dhe smira; gjithashtu, engjëjt janë mbrojtur edhe prej ndjenjave dhe prirjeve të tjera njerëzore. Për rrjedhojë, për ta nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë mëkat si kundërshtimi dhe kryengritja.

Në lidhje me këtë, në Kur'an thuhet kështu për engjëjt:

"Ata nuk i kundërshtojnë gjërat për të cilat i ka urdhëruar Allahu dhe kryejnë atë për të cilën janë urdhëruar!" (Tahrim, 66/6)

Pozita e engjëjve, të cilët janë qenie shpirtërore që s'kanë të bëjnë me veçori njerëzore, si ushqyerja, seksi, martesë, është e fiksuar, gjithashtu, tek ta nuk bëhet fjalë për marrjen e ndonjë shpërblimi, por ata marrin një kënaqësi të brishtë dhe një shije të këndshme për çdo urdhër që kryejnë në emër të Allahut. Ata marrin begati shpirtërore sipas shkallëve të lartësimit para Allahut. Me aspektin e tyre si qenie dritësore, edhe ushqimet për të cilat ndiejnë nevojë, janë shpirtërore. Ata marrin shije nga zikri, tesbihet, lavdërimet dhe bukuritë dritësore të afërsisë dhe dashurisë për Allahun dhe, në adhurimin ndaj Tij, as mbahen në të madh, as mërzhiten e lodhen:

"... Ata që ndodhen në praninë e Tij, nuk mbahen më të madh e nuk lodhen në adhurimin ndaj Tij. Ata e bëjnë tesbih Allahun natë e ditë pa ndërprerje lodhje e mërzi!" (Enbija, 21/19-20)

Në mënyrë të veçantë, si pasojë e strukturës së tyre të posaçme të tejdukshme e dritësore, engjëjt janë qenie që lëvizin me shpejtësi tejet të madhe dhe që kanë ndikim të përsosur. Në Kur'an, duke përshkruar këto veçori të engjëjve, thuhet:

"Engjëjt dhe shpirti ngjiten te Ai (te arshi i Tij) brenda një dite (sa pesëdhjetë mijë vite tokësore)!" (Mearixh, 70/4)

"Lavdi Allahut që ka krijuar qiejt e tokën dhe që i ka bërë engjëjt lajmëtarë me krahë dyshe, treshe e katërshe!" (Fatir, 35/1)

Për krahët e engjëjve flitet si në Kur'an, ashtu dhe në hadithet profetike. Ndërkaq, s'mund të themi se krahët e engjëjve janë të njëjta me krahët e kafshëve të botës sonë. Po qe se mbahet parasysh se engjëjt janë qenie dritësore që bëjnë një jetë të dimensioneve të tjera, duket sheshit se nuk do të ishte e saktë që krahëve të tyre t'u visheshin cilësi materiale si të krahëve të zogjve apo aeroplanëve. Engjëjt kanë një strukturë të tillë që s'mund të njihet me anë të mjeteve perceptuese e njohëse të njeriut. Prandaj, natyrën dhe cilësitë e krahëve të engjëjve i dinë vetëm Allahu si dhe profetët që i kanë parë.

Një specifikë tjetër që duhet ditur mbi krahët e engjëjve, është edhe kjo: për krahët e engjëjve, në Kur'an përdoret fjala "xhenah". Ndërkaq, kjo fjalë që nuk përdoret në mënyrë specifike dhe vetëm për të emërtuar krahët e engjëjve, ka edhe kuptime të tjera, si anë, krah (anësi) dhe veçanti. Duke u nisur nga kjo, shprehjen "uli exhniha" që përdoret në Kur'an, mund ta kuptojmë si "llojshmëri të veçorive si fuqia dhe shpejtësia të dhëna engjëjve" ose si "gradë të engjëjve para Allahut".

Engjëjt janë qenie që marrin forma dhe trajta të ndryshme me urdhrin dhe lejen e Allahut. Engjëjt janë parë nga profetët edhe me formën dhe trajtën e tyre origjinale, edhe me forma dhe trajta të tjera. Për shembull, Xhebraili (alejhissalatu vesselam) i është shfaqur Hz. Merjemes në trajtë njeriu.⁴⁶ Edhe engjëjt që i patën shkuar Hz. Ibrahimit (alejhissalatu vesselam) me sihariqin për një djalë, i qenë shfaqur në trajtë njerëzish. Duke i pandehur për miq vizitorë, Hz. Ibrahim u pati nxjerrë për të ngrënë dhe, kur ata s'patën ngrënë, e pati kuptuar se qenë engjëj⁴⁷ dhe qe trembur. Nga ajeti përkatës ku përshkruhen këto ngjarje, nxirret edhe përfundimi se engjëjt nuk hanë e pinë, pra, nuk ushqehen. Po kështu, siç bëhet e qartë edhe në rivajetin e njohur si "hadithi Xhebrail" ku bëhet përkufizimi i koncepteve iman (besim), islam dhe ihsan (mirësi), Xhebraili është parë nga sahabet në trajtë njeriu. (Muslim, Iman, 37; Ebu Davud, Sunet, 15)

Ndryshimi mes engjëllit dhe njeriut për sa i përket njohjes së Allahut

Me aspektin e tyre si dëshmitarë më të afërt të madhështisë dhe enigmave hyjnore, engjëjt qëndrojnë para njerëzve për sa i përket njohjes së veçorive të Individualitetit Hyjnor të Zotit. E thënë ndryshe, engjëjt qëndrojnë para njerëzve në njohjen e attributeve dhe emrave të Allahut. Ndërkaq, njerëzit, si rrjedhojë e të qenit pasqyrë përfshirëse që reflekton gjithë emrat dhe atributet e Allahut, konsiderohen më të lartë se engjëjt për sa u përket vlerave potenciale.

Engjëjt janë krijuar me një strukturë që mund t'u bëhet pasqyrë emrave dhe attributeve të Krijuesit të Lartë vetëm me anën dritësore-shpirtërore të tyre, kurse njerëzit janë krijuar me veçori që mund të pranojnë shfaqjet e emrave dhe attributeve hyjnore nga dy kënde të veçanta: edhe materiale, edhe shpirtërore.

⁴⁶ Shih. Merjem, 19/16-17.

⁴⁷ Shih Hud, 11/69-70.

Detyrat e engjëjve

Detyrat që u janë dhënë engjëjve nga ana e Krijuesit të Lartë, mund t'i radhisim kështu nën dritën e ajeteve të Kur'anit dhe disa haditheve profetike:

a) Të deklarojnë se Allahu s'ka të bëjë me asnjë konsideratë të mangët e të gabuar, ta lavdërojnë dhe falenderojnë Atë ditë e natë dhe ta lartësojnë në një mënyrë të përshtatshme për Të!⁴⁸

b) T'u komunikojnë njerëzve të zgjedhur nga Allahu si profetë, fjalën hyjnore.⁴⁹

c) T'i lartësojnë profetët me salat dhe selam (falje e përshëndetje) dhe të luten për të gjithë njerëzit në botë.⁵⁰

d) T'u bëhen mbështetje me një forcë moralo-shpirtërore profetëve dhe besimtarëve, t'i qetësojnë ata në çaste shqetësimi dhe dëshpërimi, ndërsa t'i fusin mohuesit në shqetësim.⁵¹

e) Si ndjekës të njerëzve të cilët i ruajnë, në një kuptim, t'u shërbejnë njerëzve.⁵²

f) Të shënojnë aktet e njerëzve.⁵³

g) Të shërbejnë si mjet për veprimtarinë hyjnore që zhvillohet lidhur me gjithësinë.⁵⁴

h) Të kryejnë detyra lidhur me krijimin dhe vdekjen e njeriut.⁵⁵

i) Të kryejnë detyra si funksionarë të ekzekutimit të ndëshkimeve hyjnore.⁵⁶

Numri dhe llojet e engjëjve

Numrin e engjëjve e di vetëm Allahu. Në Kur'an dhe në hadithet profetike nuk ka ndonjë informacion të qartë mbi numrin e engjëjve. Ndërkaq, duke u nisur nga deklaratat, si "ushtritë e qiejve e të tokës janë të Allahut"⁵⁷, mund të themi se numri i engjëjve është i madh në mënyrë të pallogaritshme.

Disa engjëj ne i njohim sipas emrave dhe veprimtarive të tyre. Kurse disa të tjerë, vetëm sipas llojit të detyrës me të cilën janë ngarkuar dhe me anë të titullit të dhënë të gjithëve së bashku. Për engjëjt nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë kompetencë në kuptimin e vërtetë të fjalës. Ata janë vetëm në pozitën e vëzhguesve dhe duartrokitësve të veprimtarisë hyjnore. Një mendim i kundërt nuk përputhet me

⁴⁸ Shih. Bakara, 2/30; A'raf, 7/206; Nahl, 16/50; Enbija, 21/19, 27; Shura, 42/5; Tahrim, 66/6.

⁴⁹ Shih. Nisa, 4/163; Haxh, 22/75; Shuara, 26/193-194.

⁵⁰ Shih. Shura, 42/5; Mumin, 40/7-9; Nexhm, 53/26. Kurse në një hadith bëhet fjalë edhe për shefaatin e engjëjve (për ndërhyrjen e engjëjve për falje). Shih. Buhari, Tevhid, 24.

⁵¹ Shih. Bakara, 2/87; Al-i Imran, 3/124-125; Maide, 5/110; Enfal, 8/12; Nahl, 16/28; Fussilet, 41/130-132; Muxhadele, 58/22.

⁵² Shih. Ra'd, 13/11.

⁵³ Shih. Ra'd, 13/11; Kaf, 50/17-18; Infitar, 82/10-12; Tarik, 86/4.

⁵⁴ Shih. Naziat, 79/5.

⁵⁵ Shih. Buhari, Bed'u'l-Halk, 6; En'am, 6/39; Sexhde, 32/11.

⁵⁶ Shih. Bakara, 2/210; Enfal, 8/50; Furkan, 25/21-26; Muhamed, 47/27; Hixhr, 15/7-8.

⁵⁷ Shih. Fetih, 48/4-7. Po kështu, shih. Tevbe, 9/26; Ahzab, 33/9.

parimin e tevhidit, besimit monoteist islam mbi Allahun si Zoti i vetëm i gjithësisë. Nisur nga kjo, sipas detyrave themelore, engjëjt mund t'i shqyrtojmë në këto grupe:

Katër engjëjt e mëdhenj

Xhebraili

Është emri i përveçëm i engjëllit të vahjit (revelacionit hyjnor, zbulesës hyjnore). Përmendet në tri vende të Kur'anit si *Xhibril*.⁵⁸ Veç kësaj, në ajete, Xhebraili përmendet edhe me emra, si "ruh", "ruhena", "resulun kerim", "resulu rabbik", "ruhul emin", "ruhul kudus".⁵⁹ Kurse në një hadith, veç këtyre, emërtohet edhe si "en-Namus".⁶⁰

Mikaili

Si njëri prej katër engjëjve të mëdhenj, është caktuar nga ana e Allahut si ndërmjetës për administrimin e ngjarjeve në gjithësi dhe të furnizimit të krijesave me ushqimin jetësor (rizk). Në Kur'an i përmendet emri vetëm në një ajet.⁶¹

Israfil

Emri i këtij engjëlli nuk përmendet hapur në Kur'an. Në ajete vetëm njoftohet se do t'i fryhet bririt (sur).⁶² I përmendet emri në hadithe si njëri nga emrat e katër engjëjve të mëdhenj.⁶³

Azraili

Detyra e tij është të marrë në dorëzim shpirtat e atyre që u ka ardhur çasti i fundit. Në Kur'an është përmendur si "engjëlli i vdekjes".⁶⁴

Engjëjt kiramen katibin (engjëjt shkrues)

Është emërtimi i dy engjëjve që ndodhen në të djathtë e në të majtë të njeriut. Engjëlli në të djathtë ka për detyrë të shënojë aktet dhe sjelljet e mira, kurse engjëlli në të majtë ka për detyrë të shënojë aktet

⁵⁸ Shih. Bakara, 2/97, 98; Tahrir, 66/4.

⁵⁹ Shih. Mearixh, 70/4; Nebe, 78/38; Kadr, 97/4; Merjem, 19/7; Tekvir, 81/19; Merjem, 19/19; Shura, 26/193; Bakara, 2/87, 253; Maide, 5/110; Nahl, 16/102.

⁶⁰ Shih. Buhari, Bed'u'l-Vahj.

⁶¹ Shih. Bakara, 2/98.

⁶² Shih. En'am, 6/73; Kehf, 18/99; Taha, 20/122; Jasin, 36/51.

⁶³ Shih. Buhari, Rikak, 43.

⁶⁴ Shih. Sexhde, 32/11.

dhe sjelljet e këqija. Këta engjëj që emërtohen edhe engjëj të kujtesës, do të dëshmojnë edhe për punët gjatë llogaridhënies ditën e kiametit.⁶⁵

Engjëjt mukarrebun (engjëjt e afërm, konfidentë)

Këta engjëj të përmendur edhe si *il'lijjun* dhe *kerubijjun*, të ngarkuar me detyrën e kujtimit dhe madhërimit të Allahut, ndodhen pranë Tij dhe në një pozitë të nderuar në lartësinë e Tij.⁶⁶

Engjëjt hamele-i arsh (hamallët e arshit)

Është emri i engjëjve që bartin arshin (rezidencën hyjnore). Në Kur'an flitet kështu për ta:

"Ata (engjëjt) që e bartin arshin dhe që ndodhen rreth tij, e madhërojnë Zotin e tyre me lavdërim dhe falenderim, shfaqin besimin ndaj Tij!"⁶⁷

Munker dhe Nekir

Janë dy engjëj të ngarkuar me detyrën e hetimit pas vdekjes, në varr. Munker dhe Nekir që do të thonë "i panjohur, i padalluar, i papëlqyer", i kanë marrë këta emra për shkak se i shkojnë njeriut në varr në një mënyrë krejt të padallueshme. Këta dy engjëj e pyesin të vdekurin në varr, "kush është Zoti yt?", "kush është profeti yt?", "kush është libri yt?", dhe pastaj e trajtojnë njeriun sipas përgjigjeve që marrin prej tij.⁶⁸

Në hadithet profetike tërhiqet vëmendja edhe për engjëjt që i frymëzojnë njeriut në zemër të drejtën dhe të vërtetën,⁶⁹ për engjëjt që thonë "amin"⁷⁰ në fund të Fatihasë së bashku me njerëzit që falin namaz, për engjëjt që ndodhen çdo ditë bashkë me njerëzit në namazet e agimit dhe pasditës (ikindisë),⁷¹ për engjëjt që zbresin mbi tokë gjatë këndimit të Kur'anit,⁷² për engjëjt që vizitojnë kuvendet e diturisë dhe dhikrit⁷³ dhe lutën për mëshirë për besimtarët.⁷⁴

Mbrojtja e njerëzve nga ana e engjëjve

Allahu e mbron njeriun drejtpërdrejt, por mundet ta mbrojë edhe me anë të engjëjve; para së gjithash, kjo varet nga dëshira e Allahut. Disa herë ndodh që një fëmijë të bjerë nga kati i dhjetë dhe të

⁶⁵ Shih. Kaf, 50/17-18; Infitar, 82/10-12; Dhuhruf, 43/80.

⁶⁶ Shih. nisa, 4/11, 72.

⁶⁷ Mu'min, 40/7; po kështu, shih. Hakka, 69/17.

⁶⁸ Shih. Tirmidhi, Xhenaiz, 70; Musned, 3/126.

⁶⁹ Tirmidhi, Tefsir, 3.

⁷⁰ Buhari, Ezan, 11; Muslim, Salat, 18.

⁷¹ Buhari, Mevakit, 16; Muslim, Mesaxhid, 37.

⁷² Buhari, Fedailu'l-Kur'an, 15; Muslim, Musafirin, 36.

⁷³ Buhari, Daavat, 66; Muslim, Dhikr, 8.

⁷⁴ Tirmidhi, Ilm, 19.

mos pësojë asgjë. Për njerëzit, besimi i tyre, nënshtrimi ndaj Allahut, paisja shpirtërore, afërsia ndaj Allahut, konfidenca ndaj botëve metafizike, gjendja ku ndodhet janë faktorë të ndryshëm që ndikojnë pozitivisht për të qenë në dialog me engjëjt dhe për të marrë ndihmën e tyre.

Siç kuptohet edhe nga shprehjet e haditheve profetike, ngritja e lidhjeve shpirtërore nga engjëjt me njerëzit dhe shërbimi si mbështetës i tyre varet nga sjelljet, qëndrimet dhe punët e mira që do të shfaqnin njerëzit.

Ndikimet e besimit te engjëjt në jetën e njeriut

Ashtu si besimi te Allahu dhe te jeta e pasme (ahiret), edhe besimi te ekzistenca e engjëjve pasohet me reflektime dhe ndikime shumë të rëndësishme në jetën e njeriut.

Këto mund t'i përmbledhim kështu:

Personi që u beson engjëjve asnjëherë nuk e ndjen veten të vetmuar. Edhe në kohët kur është më i vetmuar, ai e di se ka pranë engjëjt dhe, me anë të frymëzimit shpirtëror që ndjen nga prania e tyre, e kthen vetminë një afërsi të ngrohtë. Duke krijuar një lloj shoqërie shpirtërore me ata miq të padukshëm, njeriu gjen prehje e qetësi.

Me aspektin si frenues i pasioneve sensuale dhe egoistike të njeriut besimtar, për rrjedhojë si lehtësues i marrjes nën kontroll të jetës nga ana e tij, besimi te engjëjt ka një ndikim të rëndësishëm. Besimtari që e di dhe mendon se ndodhet çdo çast nën kontrollin dhe shoqërimin e engjëjve, edhe do të ketë turp, edhe do të druhet të ecë drejt mëkatit.

Si simbol i bukurisë shpirtërore dhe i delikatesës morale, besimi te engjëjt zotëron edhe një ndikim të rëndësishëm nxitës dhe inkurajues në synimin e besimtarit për t'u ngjarë engjëjve. Fakti që, në praktikë, për njerëzit që bëjnë jetë të pastër, që kanë një natyrë të butë e që sillen me butësi ndaj tjerëve, përdoret shprehja "si engjell", tregon ndikimet pozitive të besimit te engjëjt në jetën e njeriut.

Qeniet e tjera jomateriale (metafizike)

Ashtu si engjëjt, edhe xhindët dhe shejtanët (djajtë) janë qenie që nuk mund të perceptohen me anë të organeve të shqisave njerëzore dhe që për ekzistencën e tyre njoftohet hapur si në Kur'an, ashtu dhe në hadithet profetike. Nisur nga kjo, mohimi i ekzistencës së tyre merr kuptimin e mohimit të ajeteve dhe haditheve me kuptim të drejtpërdrejtë (jofigurativ) dhe krejt të hapur.

Xhindët

Një nga qeniet jolëndore e metafizike janë edhe xhindët. Kuptimi leksikor i fjalës *xhind* (arab. *khin*) është *i mbuluar*, *i mbyllur*. Kurse kuptimi terminologjik është kështu: "Xhindët janë qenie të tejdrukshme të krijuara prej zjarri, të cilët mund të marrin forma dhe trajta të ndryshme dhe që kryejnë akte të dukura si të çuditshme (nga ana e njerëzve). Siç ndodh me njerëzit, edhe ndër xhindët ka besimtarë dhe mohues.

Në Kur'an, atje ku bëhet fjalë për krijesat, xhindët dhe njerëzit trajtohen së bashku. Për shembull, në një ajet thuhet kështu: "Allahu e krijoi njeriun prej argjile të pjekur, kurse xhindin e krijoi prej zjarri të pastër (prej flakës pa tym)!" (Rrahman, 55/14-15)

Duke u nisur nga shprehja e këtij ajeti, "min marixhin min nar", që mund ta përkthejmë "zjarr i pastër" ose "esencë zjarri", xhindët janë krijuar prej një lloji zjarri, por ky zjarr s'është as rrezatim, as zjarr që digjet me ndriçim, as zjarr me tym. Ky zjarr që është esencë lëndore, është zjarr që shpërndan shkëndija. Ja, prej një zjarri të tillë janë krijuar xhindët.⁷⁵

Sa për ngjashmërisë që kanë xhindët me njerëzit për sa u përket përgjegjësisë, edhe xhindët, si njerëzit, janë krijuar për adhurim. Kështu, në një ajet, Allahu (xh.xh.) urdhëron: "Unë i krijova xhindët dhe njerëzit për të më adhuruar mua!" (Dharijat, 51/56)⁷⁶ Gjithashtu, si njerëzit, edhe xhindët janë qenie të vullnetshme që bëhen bashkëbisedues të komunikimit hyjnor. Edhe xhindve u kanë ardhur mesazhe hyjnore që përmbajnë urdhra dhe ndalime, për rrjedhojë, me anë të këtyre mesazheve, edhe ata janë përgjegjës. Si konsiderimi i njerëzve bashkë me xhindët si bashkëbisedues të komunikimit hyjnor me shprehjen "o xhindë dhe njerëz",⁷⁷ si tërheqja e vëmendjes që u bëhet atyre mbi përgjegjësinë para Zotit me ajetet "atëherë, ç'dhunti të Zotit tuaj po e mohoni"⁷⁸, të gjitha këto, në suren Rrahman, e ndriçojnë në mënyrë të mjaftueshme specifikën në fjalë se njerëzit dhe xhindët janë qenie të krijuara me qëllimin e caktuar të adhurimit ndaj Allahut, të vullnetshme, bashkëbiseduese të komunikimit hyjnor dhe të ngarkuar nga Allahu me përgjegjësi të caktuara me anë të mesazheve të dërguara atyre nga ana e Tij.

Xhindët nuk e njohin të fshehtë. Faktin që xhindët nuk e njohin të fshehtë, Kur'ani e shpreh kështu në një ajet ku bën fjalë për vdekjen e Profetit Sulejman (alejhisalatu vesselam), nën urdhrin e të cilit punonin xhindët:

"Pasi vendosëm për vdekjen e Sulejmanit (që xhindët nuk e kuptuan dot), vdekjen e tij ua bëri të qartë vetëm krimbi që i hante shkopin ku qe mbështetur. Kur shkopi (i ngrënë nga krimbi) u thye dhe ai u rrëzua përtokë, doli në shesh se po ta njihnin xhindët të fshehtë, nuk do të vazhdonin t'i shërbenin Sulejmanit duke iu nënshtruar një mundimi poshtërues për ta!" (Sebe, 34/14)⁷⁹

Një specifikë tjetër që duhet theksuar si e fundit në lidhje me xhindët, është kjo: Xhindët nuk janë krijesa që ndodhen në fushën e shikimit tonë. Në këto kushte, ne e kemi të pamundur t'i shohim ata në natyrën e tyre origjinale. Ç'kanë parë njerëzit, janë trajta precedenciale të tyre, domethënë, dimensione të tyre mundësisht të perceptueshme prej njerëzve. Xhindët zotërojnë aftësinë për të marrë si trajta njerëzore, ashtu dhe trajta kafshësh. Kështu, në hadithe të ndryshme Profeti (sal'lallahu alejhi vesel'lem) ka porositur, në lidhje me gjarpërinjtë që dalin nëpër shtëpi, që në fillim t'i thuhet, "nëse je xhind, dil jashtë!", pastaj, po të mos dalë, të vritet. Kjo porosi⁸⁰ është argument i aftësisë së xhindve për të marrë trajta të ndryshme.

Shejtanët (djajtë)

⁷⁵ Siç kuptohet nga shpjegimi i bërë në këtë paragraf si dhe nga shpjegimet leksikore përkatëse që jepen në literaturë, kuptohet se zjarri nga i cili janë krijuar xhindët është i tipit të shkëndijës elektrike ose të harkut elektrik - që është e njëjta gjë - domethënë, nga një rrymë elektronesh inkandeshente. Përkthyesi.

⁷⁶ Faktin që në këtë ajet, xhindët përmenden para njerëzve, mund ta vlerësojmë si pasojë të faktit që xhindët janë krijuar para njerëzve.

⁷⁷ Rahman, 55/33. Po kështu, shih. En'am, 6/130.

⁷⁸ Rahman, 55/34.

⁷⁹ Nga ky ajet kuptohet se kufoma e Sulejmanit ka mbetur për një farë kohe në këmbë e mbështetur në shkopin e tij. Xhindët qenë caktuar nën urdhrin e profetit Sulejman për të kryer punë të ndryshme. Nga shprehja "mundim poshtërues" që përdoret në këtë ajet, mund të themi se ishin xhindët mohues që e kuptonin kështu detyrën që u ishte caktuar nën urdhrin e Hz. Sulejmanit. Ngaqë nuk e patën kuptuar dot vdekjen e profetit Sulejman, ata patën vazhduar edhe për një kohë të kryenit punët që nuk i pëlqenin, sikur ai të vazhdonte të ishte gjallë.

⁸⁰ Muslim, Selam, 139; Ebu Davud, Edeb, 174.

Ka dy pikëpamje lidhur me kuptimin leksikor të fjalës *shejtan*. Sipas pikëpamjes së parë, kjo fjalë është e prejardhur nga rrënja "sh-t-n" dhe do të thotë "rri larg", "kundërshtoj". Kurse sipas pikëpamjes së dytë, fjala shejtan rrjedh prej rrënjës "sh-j-t" dhe do të thotë "digjem me furi". Në literaturën islame, emri shejtan u jepet qenieve "ekspansive e mendjemëdha të krijuara nga zjarri, të cilat, me anë të dyshimeve dhe lëkundjeve që shkaktojnë tek njerëzit, përpiqen vazhdimisht t'i prapësojnë ata".

Në Kur'an bëhet fjalë me emrin Iblis për shejtanin e parë dhe thuhet: "... Iblisi ishte nga xhindët; ai doli jashtë urdhrit të Zotit tënd!" (Kehf, 18/50) Kështu, njoftohet se ai ishte një xhind. Një tjetër argument që tregon se Iblisi ishte xhind, është se për të bëhet e ditur se edhe ai, si xhindët e tjerë, është krijuar prej zjarri. (A'raf, 7/12)

Iblisi, shejtani i parë dhe më i madhi, të cilit në fillim i ishte dhënë vend mes engjëjve, më pas, duke u mundur nga mendjemadhësia e vet, ra në pozicionin e qenies që i bën opozitë Allahut.

"U patëm thënë engjëjve t'i bënin sexhde Ademit. Përveç Iblisit, të gjithë ranë në sexhde, kurse ai nuk pranoi, u mbajt më të madh dhe u bë ndër mohuesit!" (Bekare, 2/34)

Me një dialektikë që do të mund ta quanim "logjikë e palogjikshmërisë", shejtani i është përgjigjur në këtë mënyrë Zotit që e ka pyetur se "pse nuk kishte rënë në sexhde para Ademit megjithëse e kishte urdhëruar": "Unë jam më i lartë se ai. Mua më krijoje prej zjarri, kurse atë, prej balte!" (A'raf, 7/12) Kështu, ndërsa krijimi i Iblisit është bërë i determinuar, jashtë vullnetit të atij vetë, kthimi i tij në shejtan ka ndodhur me vullnetin e vet të tij si dhe si pasojë e gabimit të vet.

Nuk ka dyshim se kjo qenie e mallkuar dhe e përzënë nga mëshira hyjnore që nuk ka asnjë vlerë dhe çmim vetiak përse u përket aspekteve të tij personale, është krijuar mbështetur mbi shumë urtësi. Pa asnjë dyshim, njëra nga këto urtësi, mbase më e para, është roli që luan shejtani në lartësimin dhe poshtërimin e xhindve dhe njerëzve.

Krijuesi i Lartë e ka bërë shejtanin, në botën e shkaqeve, pretekst për lartësimin moral-shpirtëror, përparimin dhe përkryerjen e njeriut. Zhvillimin e shumë ndjenjave të natyrës krijimore të njeriut, Zoti e ka varur nga lufta me shejtanin. Ndërkaq, është një e vërtetë e përgjithshme se, atje ku s'ka luftë e përpjekje, s'ka zhvillim dhe përparim. Kështu, tek engjëjt, mbi të cilët shejtani nuk vepron, nuk ka përparim dhe lartësim shpirtëror.

Ashtu siç bëhet, dashje pa dashje, skifteri që e kërcënon vazhdimisht trumcakun, shkak për aftësimin e tij gjithnjë e më të madh për fluturim, edhe shejtanët bëhen dashje pa dashje shkak për lartësimin moral-shpirtëror të njerëzve.

Në botën e provës, pas sukseseve në zhvillimin e një sërë aftësish e mundësish si rezultat i luftës kundër shejtanit, njeriu bëhet i denjë e i merituar i xhenetit, parajsës. Kurse ata të cilët, aftësitë dhe mundësitë që ua ka dhënë Zoti, i vënë në punë sipas sugjerimeve dhe kërkesave të shejtanit, bëhen të merituar të xhehenemit, skëterrës.

As mohuesit dhe as besimtarët nuk e kanë të drejtën për të kundërshtuar në formën "pse është krijuar shejtani?" ose "a nuk do të ishte më mirë sikur të mos ekzistonte?". Më së pari, mohuesi që nuk i beson Krijuesit si dhe specifikave të njoftuara prej Tij, nuk ka asnjë të drejtë t'i paraqesë çështjet që s'i beson, si çështje rezerve apo kundërshtimi. Kurse për besimtarin bëhet fjalë për nënshtrimin e tij ndaj paravlerësimit dhe paracaktimit⁸¹ të Krijuesit. Në esencë, si qenie të krijuara nga hiçi së bashku me gjithësinë ku ndodhemi, ne, njerëzit, nuk kemi të drejtë "të pretendojmë për të drejtë" kundër Krijuesit të Lartë! Sepse ne nuk kemi diçka që t'ia kemi dhënë Atij (xh.xh.), që të pretendojmë për ndonjë të drejtë

⁸¹ Në origjinal, takdir: paravlerësim dhe paracaktim hyjnor. Përkthyesi.

ndaj Tij! Prandaj, ndaj Tij ne kemi vetëm përgjegjësitë tona, detyrat tona dhe falenderimet për të mirat që na ka dhënë e na jep!

Edhe xhindët e tjerë mohues që përpiqen t'i prapësojnë njerëzit, si Iblisi, emërtohen shejtanë. Madje, Kur'ani i konsideron shejtanët dy llojesh, prej njerëzish dhe prej xhindësh duke e mbështetur në cilësinë e tyre të përbashkët të sugjerimit njerëzve të mohimit dhe të çdo mendimi e ideje bestypte e të mbrapshtë që përmban mohim. Për shembull, në një ajet thuhet: "... Kështu, për çdo profet krijuam armiq nga njerëzit dhe xhindët!" (En'am, 66112) Ndërkaq, ndërsa shejtanët-njerëz që përpiqen t'i largojnë njerëzit nga Allahu dhe nga parimet dhe vlerat e vëna prej Tij, e bëjnë këtë sy më sy, shejtanët-xhindë i bëjnë sugjerimet e tyre dhe u fusin njerëzve dyshime e lëkundje nga një pozicion i padallueshëm prej nesh. Kështu, në një ajet, Iblisi trajtohet kështu bashkë me shejtanët, llojit të të cilëve u përket:

"Sepse ai dhe fisi i tij ju shohin ju nga një vend prej nga ju s'i shihni dot. Pa dyshim, Ne i bëmë shejtanët miq të mosbesimtarëve!" (A'raf, 7/27)

Lidhur me interpretimin e këtij ajeti, Fethullah Gylen ka një trajtesë subjektive në veprën e tij, "Dimensioni metafizik i ekzistencës" (Varlë'n Metafizik Boyutu). Sipas tij, shejtani dhe farefisi i tij preokupohet pa u ndalur me dobësitë e njerëzve dhe përpiket t'i largojë ata nga Allahu. Bie fjala, kur ai e godet njeriun me anë të epshit, do të thotë se ka gjetur rrugën më të shkurtër. Sepse epsi është arma më e rrezikshme që e mpin vullnetin e njeriut dhe e bën atë lodër në duart e shejtanit. Ai u afrohet njerëzve me shumë dredhi të tjera, por, në shumicën e kohës, njerëzit nuk e shohin, nuk e ndjejnë dot këtë. Sepse shejtani i vëzhgon njerëzit nga vendi ku ata s'e shohin dot, pra, nga dobësitë dhe boshllëqet e tyre. Njerëzit nuk i shohin dhe nuk i ndjejnë dot as fisin e tij. Sepse ata janë pozicionuar në një mënyrë që njerëzit të mos i shohin dot, të mos i ndjejnë dot. Ata mund ta godasin njeriun në zemër krejt papritur, në një çast kur ai s'e pret aspak. Veçanërisht, në këtë ajet thuhet: "Ne i bëmë shejtanët miq të mosbesimtarëve!" Kjo na tregon neve këtë: Njeriu mund ta përbuzë shejtanin dhe mund t'i kundërvihet atij në raport me besimin që ka. Sa më shumë t'i dobësohet⁸² besimi, aq më shumë i forcohen lidhjet e miqësisë me shejtanin.⁸³

Në një ajet tjetër, Kur'ani e bën shejtanin të tregojë me gojën e vet se ç'plane ka për njerëzit dhe se ç'qëllime ushqen ndaj tyre. Kur qe përzënë si ndëshkim për kundërshtimin dhe paturpësinë e tij, shejtani qe krenuar në këtë mënyrë para Allahut:

"... Për t'i prapësuar ata, unë do të ulem mu në mes të rrugës tënde të drejtë dhe pastaj do t'u futem atyre para e pas, nga e djathta e nga e majta dhe shumicën e tyre nuk ke për t'i gjetur ndër falenderuesit!" (A'raf, 7/16-17)

Në këtë ajet bëhet fjalë për faktin që shejtani i cili nuk heq dorë në asnjë mënyrë nga puna për t'i prapësuar dhe nxjerrë njerëzit nga rruga e drejtë, u afrohet dhe u futet njerëzve nga katër drejtime.

"Pastaj do t'u afrohem njerëzve nga para." Shejtani u shkakton njerëzve dyshime dhe lëkundje mbi çështje të së ardhmes, domethënë, të jetës së pasme, ahiretit. Ai i bën njerëzit të mos besojnë në ringjalljen dhe jetën e pasme, në xhenetin dhe xhehenemin. Për pasojë, njerëzit nuk mendojnë ta rregullojnë jetën sipas besimit në jetën tjetër dhe, duke e interpretuar çdo gjë rreth interesave të veta, jetojnë si materialistë dhe pragmatistë.

"Dhe do t'u afrohem nga pas." Shejtani u sugjeron njerëzve se dëfrimet dhe kënaqësitë e vërteta që kërkojnë, nuk janë përtej, se duhet t'i heqin vështrimet nga bota përtej për t'i kthyer pas dhe se çdo gjë

⁸² Në origjinal është përdorur fjala *azald>kça* (sa më shumë që t'i pakësohet), ndërsa duhej përdorur fjala *zay>flad>kça*, siç e kemi përkthyer ne. Sipas akaidit, shkencës islame të besimit, besimi nuk shtohet apo pakësohet, por forcohet apo dobësohet. Përkthyesi.

⁸³ Fethullah Gülen, Varlë'n Metafizik Boyutu, 2/411.

që kërkojnë ndodhet në jetën që jetojnë. Shejtani ua tregon njerëzve të mirat e kësaj bote aq të bukura, sa të mos njohin bukuri të tjera. Kështu, në ta s'mbetet asnjë dëshirë dhe asnjë interesim për ta parë Bukurinë e Përjetshme dhe bukuritë e përjetshme!

"Dhe do t'u afrohem nga ana e majtë." Shejtani u çon ftesa njerëzve duke nxitur dhe inkurajuar të shtrembrën, duke i zbukuruar të gjitha mëkatet dhe të këqijat dhe duke ua treguar të mira e të bukura atyre. Veçanërisht, duke ua gudulisur botën e brendshme, ua nxit epshin. Duke ua lëshuar femrën meshkujve dhe mashkullin femrave, ua prish nderin dhe pafajësinë.

"Dhe do t'u afrohem nga ana e djathtë." Shejtani u përzjën njerëzve shejtanllëqe (djallëzi) edhe në mirësitë që bëjnë. Edhe veprimet më të vogla që edukata s'i pranon, ua imponon atyre si të ishin pjesë të fesë dhe, duke i përhapur bindjet e sajua, i bën që ta harrojnë frymën e fesë.⁸⁴

Për sa u përket marrëdhënieve të shejtanëve-xhindë me njerëzit, e shohim si të dobishme këtu të përcjellim nga Hz. Aisheja një hadith të rrëfyer.

"Natën, i Dërguari i Allahut u largua prej meje, kurse unë u zemërova nga zilia. Kur u kthye dhe më kuptoi se ç'më kishte ngjarë, më pyeti: "O Aishe, ç'ke që zemërohes?" Kurse unë i thashë: "Si mund të mos e ketë zili e të mos zemërohet një njeri si unë me një njeri si ti?" Ai më pyeti: "A mos të erdhi shejtani?" Unë iu përgjigja: "O i Dërguari i Allahut, a mos shejtani që ndodhet bashkë me mua?" "Po!" - Më tha ai. Unë vazhdova: "A mos ka nga një shejtan për çdo njeri?" "Po!" - Më tha ai. Unë vazhdova: "A edhe për ty, o i Dërguari i Allahut?" "Po, por gjersa ai m'u dorëzua mua (gjersa u bë musliman), Zoti im më ndihmoi kundër tij!"⁸⁵

Njeriu konsiderohet i pranueshëm pranë Allahut dhe i suksesshëm me aq sa t'i bëjë opozitë shejtanit. Ndërkaq, realizimi i këtij suksesi varet nga sa e përdor njeriu vullnetin për këtë dhe sa mbështetet te Allahu që e sheh dhe vëzhgon çdo gjë. Profeti ynë (sal'lallahu alejhi vesel'lem), duke aluduar posaçërisht aspektin e dytë të çështjes, për t'a mësuar se ç'duhet të bëjë dhe për ta ndihmuar dikë që e kish turbulluar zemërimi dhe s'dinte ç'të bënte, i thotë: "Unë di një fjalë që, po ta thuash atë, lehtësohesh. Ajo fjalë është "Eudhu bil'lahi" (Mbështetem te Allahu).⁸⁶ Me këtë, i Dërguari i Allahut synonte ta largonte personin nga atmosfera e rëndë ku ndodhej dhe t'i thoshte se me thënien "Eudhu bil'lahi", njeriu ia linte Allahut çështjen së bashku me shejtanin!

Le t'ia vëmë pikën kësaj çështjeje duke i dhënë vend sures "Nas" (Njerëzit) që na tregon se si duhet të ruhem nga sherri (e keqja) si e shejtanëve-njerëz, ashtu dhe e shejtanëve-xhindër:

"Thuaj: "Mbështetem te Zoti i njerëzve, sunduesi i njerëzve, i adhuruari i njerëzve prej së keqes së shejtanit tinëzar që fut dyshim e lëkundje në gjokset e njerëzve, qoftë ai prej xhindve ose prej njerëzve!" (Nas, 114/1-6)

⁸⁴ Gülen, po aty, 2/414.

⁸⁵ Muslim, Munafikun, 70.

⁸⁶ Buhari, Bed'ul-Halk, 11; Muslim, Birr, 109.

LIBRAT HYJNORE TE FAVORIZUAR NJERIUT

Koncepti *kitab* ose *libër* hyjnor

Kuptimi leksikor i fjalës arabishte *kitab* (shum. *kutub*) është *shkruaj* dhe *dokument i shkruar*. Kurse në terminologjinë fetare, "kitab quhet tërësia e fjalëve që Allahu ua ka komunikuar profetëve për të bërë të ditur se ç'kërkon prej robve të vet dhe për t'u treguar atyre rrugë në këtë drejtim, si dhe forma e shkruar e fjalëve të Tij".

Librat e zbritur për profetët quhen libra hyjnorë sepse janë dërguar nga ana e Allahut, pra, kanë prejardhje hyjnore, sepse në fjalët dhe përmbajtjen e tyre nuk ka asnjë kontribut njerëzor. Ngaqë librat hyjnorë janë të zbritur nga lartësia e Allahut, quhen *kutubu munzele* ose *libra qiellorë*.

Domosdoshmëria e besimit te librat hyjnorë

Një ndër bazat e besimit është edhe besimi te librat hyjnorë. Besimi te librat hyjnorë është një ndër kushtet për t'u quajtur musliman. Kuptimi i besimit te librat hyjnorë është besimi se disa profetëve u janë zbritur libra nga ana e Allahut dhe pranimi pa bërë dallim se përmbajtja e plotë e këtyre librave -

me formën origjinale me të cilën janë zbritur - është e drejtë dhe e vërtetë.⁸⁷ Ajeti në vijim i Kur'anit bën të ditur se besimi te librat e zbritur nga Allahu është një nga bazat e besimit dhe se ata që i mohojnë këta, janë persona që janë shmangur dhe larguar në kuptimin e vërtetë të fjalës nga e vërteta: "O ju që keni besuar, besojuni Allahut, profetit, librit që i ka zbritur profetit dhe librit që ka zbritur më parë. Kush i mohon Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij, profetët e Tij dhe ditën e kiametit, me të vërtetë ka dalë nga rruga!" (Nisa, 4/136)

Edhe profeti ynë, besimin te librat hyjnorë e ka përmendur mes bazave që duhen besuar nga çdo musliman. Në hadithin e njohur Xhibril ku radhiten bazat e besimit dhe në hadithet e tjerë, Profeti u ka bërë të ditur njerëzve hapur se u duhet besuar edhe librit të zbritur atij vetë, domethënë, Kur'anit, edhe librave qiellorë të dërguar para tij.⁸⁸

Nevoja për librat hyjnorë

Meqë ne jemi qenie të paafta për ta njohur Personin e Tij, Krijuesi i Lartë kërkon të na e bëjë të njohur veten me anë të attributeve të veta si dhe me anë të veprave të veta që janë shfaqje të këtyre attributeve. Këto vepra mund t'i trajtojmë në dy grupe: veprat e atributit Fuqi (Kudret) dhe veprat e atributit Fjalë (Kelam).

Në është me vend të shprehemi kështu, gjithësia është si një libër i dalë nga kalem i fuqisë së Zotit, pasi çdo gjë ekzistente që zë vend në këtë sistem ekzistence, është si një gjuhë që na tregon për Të, që na jep informacion për Të! Secila prej këtyre veprave është një letër e shkruar, një fjalë e thënë pa zë, një libër, të cilat na tregojnë ca gjëra, na njoftojnë për cilësitë e autorit dhe qëllimin e tij.

Allahu i Lartë që ua bën të njohur veten robve të vet me anë të veprave të veta që ua mbushin mendjet robve me mahnitje dhe admirim, gjithsesi, me fjalët e veta do të njoftojë edhe për ekzistencën dhe qëllimin e vet. E shprehur ndryshe, duke mos ia lënë ekzistencën dhe qëllimin vetëm dëshmisë së veprave, do të flasë personalisht për to. Ja, pra, me librat e dërguara me ndërmjetësinë e profetëve, Allahu (xh.xh.) u ka folur njerëzve.

Allahu nuk e ka për detyrë ose të detyruar të dërgojë libra ose të flasë. Kjo është krejtësisht një favor hyjnor i Tij për robtë e vet dhe një ndihmë, sepse njerëzit janë nevojtarë për një favor dhe ndihmë të tillë.

Si përfundim, mund të themi se vetëm me anë të parimeve që ia mësojnë librat hyjnorë, njeriu mundet ta njohë drejt dhe saktë Krijuesin e vet dhe të arrijë lumturinë e kësaj bote e të jetës së pasme (ahiret) me rrugën më të shkurtër e më të sigurtë.

Cilësia dhe forma e komunikimit të librave hyjnorë profetëve

Në literaturën islame, për komunikimin hyjnor përdoret termi i përgjithshëm *vahj*. Kuptimi leksikor i fjalës arabishte *vahj* është *hedhje fjale, pëshpëritje, bërje shenjë, frymëzim, sugjerim, njoftim radhazi*

⁸⁷ Këtu na duhet të prekim edhe një pikë tjetër që e shohim të rëndësishme. Kur një musliman njoftohet mbi një specifikë që ndodhet në librat e shenjtë të mëparshëm, po qe se kjo specifikë është në përshtatje me të dhënat e Kur'anit dhe haditheve, pranohet, në të kundërt, hidhet poshtë. Po qe se për të nuk bëhet fjalë fare në ajete dhe hadithe, por ajo nuk bie në kundërshtim me parimet themelore të Islamit, veprohet sipas kësaj porositë të Profetit: "Njerëzit e Librit as mos i vërtetoni, as mos i përgënjeshtrojnë, por u thonë: "Ne u kemi besuar Allahut, asaj që na është zbritur neve, asaj që i është zbritur Ibrahimit...!" (Buhari, l'tisam, 25)

⁸⁸ Shih. Muslim, Iman, 1; Ebu Davud, Sunet, 15.

dhe fshehtëzi. Kurse si term, vahji është "njoftimi nga Allahu i orientimeve dhe urdhrave robve të vet të zgjedhur si të dërguar, drejtpërdrejt ose me ndërmjetësimin e një engjëlli dhe me anë të një rruge të pazakonshme e të fshehtë".

Njohja dhe kuptimi i cilësisë së vahjit është i pamundur për ne, njerëzit, që nuk e kemi përjetuar atë gjendje. Prandaj, si njerëz dhe nga këndvështrimi njerëzor, ne e pranojmë se vahji është i arsyeshëm dhe e detyrueshëm, ndërsa nuk merremi me thelbin dhe cilësinë e tij.

Edhe për sa u përket formave të ardhjes së vahjit, meqë askush përveç profetëve nuk do të mund t'i perceptojë dhe njohë, mund t'i mësojmë jo me arsyetim, por vetëm si të na i thonë ata vetë. Në Kur'an bëhet fjalë për tre lloje vahji:

"Allahu komunikon me njeriun vetëm me rrugën e vahjit ose duke i folur si pas perdes, ose, duke dërguar një engjell ndërmjetës, ia komunikon dëshirat përfaqësuesit të vet me anë të tij!" (Shura, 42/51)

Në fenë islame, vahji, siç tregohet në ajet, është realizuar me njërën prej këtyre formave:

1) Zoti e ka lënë mesazhin drejtpërdrejt në zemrën e profetit (ilká).

2) Zoti ua ka drejtuar urdhrat dhe kërkesat shqisave të jashtme e të brendshme të profetëve, si veshët dhe ndjenjat.

3) Zoti ka dërguar si përfaqësues një engjell të ngarkuar me detyrën e sjelljes së vahjit, i cili ka marrë një formë dhe trajtë të caktuar.

Zoti ua ka njoftuar urdhrat dhe mesazhet profetëve të mëdhenj që kanë qenë njerëz me pajisje të jashtëzakonshme, me njërën prej këtyre tre rrugëve dhe, në shumicën e rasteve, ua ka mësuar sistemin e vet njerëzve duke ngarkuar me punë, për këtë, një engjell. Kur'ani dhe suneti autentik kanë bërë të ditur se engjëlli i vahjit është Xebraili (Xhibrili).

Profetët e kanë marrë vahjin në gjendje të vetëdijshme. Gjatë vahjit nuk ka ndodhur që ata ta humbin veten dhe vetëdijen, përkundrazi, të bëhen të vetëdijshëm në shkallën më të lartë, ta përqëndrojnë krejtësisht vetëdijen. Mbi këtë gjendje të profetëve, Allahu tërheq vëmendjen - në personin e profetit Muhamed (sal'lallahu alejhi vesel'lem) - në këtë mënyrë:

"... Mos e lëviz gjuhën për ta mësuar vahjin shpejt e shpejt; na takon Neve ta mbledhim atë dhe të ta fiksojmë leximin. Kur ne të ta këndojmë Kur'anin, edhe ti ndiqe këndimin e tij!" (Kijame, 75/16-18) Ky ajet tregon se, gjatë vahjit, profeti e ruan tërë vëmendjen dhe vetëdijen.

Librat hyjnorë dhe llojet e tyre

Librat hyjnorë, në përgjithësi, sipas vëllimit dhe madhësisë së popullatës që i janë drejtuar, vlerësohen në dy grupe: fletë (suhuf) dhe libra (kitab).

a) Fletët

Janë libra të vegjël dhe broshura të përbëra prej disa fletësh të zbritura popullatave të vogla në kuadër të ngushtë, të mjaftueshme për t'u dhënë përgjigje nevojave të tyre. Në Kur'an bëhet fjalë për fletët e para të zbritura profetëve.⁸⁹ Veçanërisht, në Kur'an bëhet fjalë për fletët e dhëna Hz. Ibrahimit⁹⁰

⁸⁹ Shih. Taha, 20/133; A'la, 87/18.

⁹⁰ Shih. Nexhm, 53/37; A'la, 87/18.

dhe për librat e dhënë profetëve të ardhur nga soji i tij, si Is'haku, Jakubi, Sulejmani, Jusufi dhe Zekerija (alejhimusselam), gjë që mbështet ekzistencën e librave të vegjël në formë fletësh.⁹¹ Në Kur'an nuk është thënë se cilëve profetë veç këtyre u janë dhënë fletë.

Nga Profeti ynë (sal'lallahu alejhi vesel'lem) është përcjellë se Hz. Adem i janë dhënë 10 fletë, Hz. Shitit 50 fletë, Hz. Idrisit 30 fletë dhe Hz. Ibrahimit 10 fletë.⁹²

Në fletët e dhënë profetëve ka pasur tema që janë baza e të gjitha feve, si besimi në Allahun si Zoti i vetëm i gjithësisë, ahireti ose jeta e pasme është e përhershme dhe më e dobishme se kjo jetë, arritja e shpëtimit me anë të namazit, respekti, këshillat dhe predikimi, etj.

b) Librat

Librat, që janë më të vëllimshëm se fletët dhe të lidhur, që përmbajnë mesazhe universale dhe përmenden me një emër të përveçëm, janë katër: Teurati, Zeburi, Ungjilli dhe Kur'ani.

Teurati: Teurati që është një fjalë hebraishte, do të thotë "ligj, legjislacion dhe doktrinë". I është zbritur Hz. Musait. Besimi se origjinali i këtij libri është fjalë e Allahut, është detyrim (farz) për çdo musliman; mohimi i kësaj e çon personin në mohim (kufr). Në Kur'an bëhet e ditur hapur se Teurati është një ndër librat e shenjtë të Allahut:

"Ne e zbritëm Teuratin, në të cilin ka udhëzim dhe dritë!" (Maide, 5/44)

Sot njihen tre ekzemplarë të Teuratit, të emërtuar Testamenti i Vjetër⁹³: ekzemplari hebraisht i pranuar nga hebrenjtë dhe protestanët, ekzemplari greqisht i pranuar nga kishat krishtere të Romës dhe të Lindjes dhe ekzemplari samaritan i pranuar nga samaritanët.

Zeburi: Zebur⁹⁴ që në hebraishte do të thotë "letër e shkruar"⁹⁵ dhe, në arabishte, "libër", është emri i librit hyjnor të zbritur Hz. Daudit (alejhisalatu vesselam). Në lidhje me këtë specifikë, në Kur'an thuhet: "Dhe Daudit i dhamë Zebur." (Isra, 17/55)

Besimi se Zeburi në formën me të cilën është zbritur, është fjala e Allahut, është nga bazat e besimit.

Ungjilli: Ungjilli që, si fjalë, do të thotë "përgëzim, doktrinë", është emri i librit të shenjtë të zbritur Hz. Isait (alejhisalatu vesselam). Besimi edhe i këtij libri me formën e zbritur Hz. Isait nga Allahu është nga domosdoshmëritë e besimit. Lidhur me këtë libër hyjnor, në Kur'an thuhet kështu:

"Në rrugën e profetëve të mëparshëm, e dërguam Isanë, të birin e Merjemes, si vërtetues i Teuratit para tij. Dhe i dhamë atij Ungjillin ku ka udhëzim dhe dritë, si vërtetues të Teuratit para tij, si dhe udhëzim dhe këshillë për të bindurit!" (Maide, 5/46)

Fjala e fundit dhe më e gjerë e Allahut për njerëzimin: KUR'ANI

Kuptimi i fjalës Kur'an

⁹¹ Shih. Nisa, 4/54; En'am, 6/89; Hadid, 57/26.

⁹² Ibn-i Hibban, Sahih, 2/77; Taberi, Tarih, 1/187; Hejsemi, Mevaridu'z-Zem'an, 1/53.

⁹³ Në origjinal: Ahd-i Atik. Përkthyesi.

⁹⁴ Zeburi njihet edhe si "Psalmet e Davidit".

⁹⁵ Epistulë. Përkthyesi.

Sipas pikëpamjes më të parapëlqyeshme, fjala *kur'an* si infinitiv (mastar) i foljes *karae* në diatezën (vezn) *fu'lân*, do të thotë *lexim*. Ky kuptim përdoret në ajetet e shtatëmbëdhjetë dhe të tetëmbëdhjetë të sures Kijame. Ka edhe kuptimin mbiemëror “i lexuar”, “që lexohet” si emër foljor pësor (ismi mef’ul). Me daljen e Islamit, kjo fjalë është bërë emërtimi i përveçëm i librit të Allahut.

“Allahu (xh.xh.) e ka emërtuar edhe me emra të tjerë këtë libër që ia ka dërguar njerëzimit. Emërtimi më i njohur pas fjalës “Kur’an” është “el-Kitab”. Mes emërtimeve të tjerë më të njohur, mund të përmendim fjalën “Furkan” (ndarësi dhe diferencuesi i të drejtës dhe të vërtetës nga e shtrembra dhe gënjeshtria) dhe “et-Tenzil” (vahj i zbritur pjesë-pjesë). Veç këtyre, janë edhe emërtimet, si “edh-Dhikr”, “en-Nur”, “esh-Shifa”, të marra nga Kur’ani, numri i të cilëve, sipas disa dijetarëve, është nxjerrë në pesëdhjetë, madje, në nëntëdhjetë, shumica e të cilëve nuk janë emra të Kur’anit, por fjalë që shprehin cilësitë e posaçme të tij.

Përkufizimi i Kur’anit nga këndvështrime të ndryshme

Kur’anit i janë bërë përkufizime nga këndvështrime të ndryshme. Këtu mund të përmendim disa prej tyre.

Përkufizimet e Kur’anit të parashtruara në veprat klasike janë kështu: “Kur’ani është fjalë hyjnore e zbritur Hz. Muhamedit me rrugën e vahjit, e shkruar në libra, e përcjellë me tevatur, me tilavetin e të cilës bëhet adhurim.” “Kur’ani është përmbledhje vahjesh që i janë dërguar nga ana e Allahut Hz. Muhamedit me pretekste të ndryshme gjatë periudhës 23-vjeçare 610-632 të profetësisë së tij dhe që bëhet tilavet.”⁹⁶

Kurse përkufizimet e tjera të Kur’anit të bëra duke mbajtur parasysh nga kush është dërguar, nga ç’pozitë është dërguar, kujt dhe përse i është dërguar, na paraqiten me këto shprehje:

“Duke mbajtur parasysh së bashku anën shpirtërore dhe materiale të njeriut, Kur’ani është përmbledhje e mesazheve më të rëndësishme dhe e ligjeve hyjnore e lindur në horizontin e njerëzimit me anë të zbritjes nga pozita më e lartë.”

“Kur’ani është fjala dhe dekreti eternal i Allahut, zotëruesit të të gjithë ekzistencës.”

“Kur’ani është një konsideratë dhe mirësi e Allahut si Zoti i gjithë botërave, për robtë e Tij.”

“Me parimet e tij të përhershme e të pandryshueshme, Kur’ani është një komunikim hyjnor i pashoq e i pangjashëm si tregues i rrugës më të shkurtër e më të ndriçuar të lumturisë së tërë njerëzimit dhe që të çon në atë lumturi.”

“Kur’ani është interpretimi i ekzistencës, interpretuesi i dukurive dhe ngjarjeve, komentuesi i makro dhe mikrobotëve, gjuha në këtë botë e botës së fshehtë, dokumenti i konsideratave hyjnore për njeriun, thelbi, drita dhe bukuria e Islamit, harta e botëve sublime dhe preteksti i lumturisë së atyre që i besojnë atij; në të njëjtën kohë, është një përmbledhje lutjesh e hapur dhe e mbyllur, e drejtpërdrejtë dhe e anasjelltë.”

Allahu është ai që e ka ngritur gjithësinë mbi akordin dhe harmoninë, gjithashtu, ai që e ka bërë atë të flasë me anë të Kur’anit. Sipas kësaj, ashtu siç është i gabuar konkluzioni i të tjerëve mbi gjithësinë,

⁹⁶ Në këto dy përkufizime janë përdorur termat *tevatur* që do të thotë “përcjellje masive me miratim të përgjithshëm nga brezi në brez” dhe *tilavet* që do të thotë “lexim, mënyrë leximi”. Përkthyesi.

është i gabuar edhe mbi njeriun, sepse vetëm ai të cilit i përket ekzistenca dhe prona, mund të japë konkluzion të drejtë mbi ekzistencën dhe pronën!

Argumentet mbi Kur'anin si fjala e Allahut

Si njeriu dhe gjithësia, edhe Kur'ani është vepër e Allahut. Kur'ani edhe ia bën të njohur njeriut njeriun, edhe komenton librin e ekzistencës. Kur'ani e lexon nga njëra anë njeriun bashkë me të gjitha dobësitë dhe virtytet, nga ana tjetër, gjithësinë me të gjitha të fshehtat dhe imtësitë; kështu, është e pamundur që Kur'ani të jetë fjalë e dikujt i cili nuk administron dhe vepron mbi tërë gjithësinë!

Pas kësaj hyrjeje, dëshmitë dhe argumentet mbi faktin se Kur'ani është fjala e Allahut, mund t'i paraqesim në mënyrë të përmbledhur e me pika, kështu:

1) Para së gjithash, në atë periudhën e parë kur Kur'ani e nderoi faqen e tokës me ardhjen e tij, ushtroi një ndikim aq të thellë e të papërfytyrueshëm edhe në shpirtrat, edhe në mendjet, edhe në zemrat, sa që përsosmëria e brezave të zgjuar përsëpari në jetë në atmosferën e tij prej drite, është një mrekulli në ato përmasa që të mos lërë nevojë për ndonjë provë apo mrekulli tjetër për të dhe është e pamundur të tregosh të ngjashmit e atyre njerëzve përsa i përket horizontit të mendimit, njohjes së të fshehtës së detyrës së robit ndaj Zotit dhe përjetimit intuitiv të kësaj detyre. Është një e vërtetë se në atë periudhë Kur'ani përgatiti një brez të quajtur "sahabe" që nuk teprohet po të thuhet se ishte i njëvlershëm me engjëjt!

2) A është shkruar, vallë, gjer tani, ndonjë libër të cilin ta ketë kuptuar dhe nga i cili të ketë përfituar çdo njeri i çdo shtrese dhe niveli sipas kapacitetit të vet, i kënduari e i pakënduari, njeriu me fillore dhe ai me universitet, njeriu i popullit dhe mendimtari, çobani dhe shkencëtari? Përgjigje: Jo! Kur'ani është i vetmi libër që mundet ta lexojë dhe të përfitojë prej tij, ku mundet të gjejë parime për rrugën dhe specialitetin, zgjidhje për çështjen, shërim për shqetësimin e tij poeti dhe muzikanti, ekonomisti dhe juristi, administratori dhe sociologu, edukatori dhe nxënësi, njeriu i mendimit dhe besimit!

3) Ndoshta nuk ka asnjë libër tjetër veç Kur'anit që mund të lexohet shumë e shumë herë me radhë pa u mërzitur prej tij. Është vetëm ky Libër që lexohet vazhdimisht me pretekste të ndryshme, që i bëhet lexim i plotë pa dhënë asnjë herë ngopje dhe mërzitje! Sa e sa vepra të zgjedhura, shkrime ideore dhe poezi e humbin origjinalitetin dhe vlerën, sa e sa vepra aktuale u qëndrojnë dot disa viteve, madje, disa muajve, e humbin vlerën edhe për nga aspekti i drejtësisë, edhe për nga aspekti i aktualitetit dhe, më në fund, lihen mënjane. Sa për Kur'anin, jo që nuk zbehet e vjetërohet, por, përkundrazi, çdo ditë që shkon, u fryn mendjeve dhe zemrave fllade të ideve dhe ndjenjave të reja dhe e shton dhe ruan freskinë.

4) Është e qartë se Kur'ani i cili e përfshin jetën e njeriut me të gjitha aspektet materiale-shpirtërore të saj, nuk mund të jetë fjalë njeriu. Kurrë nuk mund të jetë në kapacitetin e një njeriu, pa le të një njeriu të pamësuar⁹⁷, që të parashtrijë parime të përgjithshme që të zgjidhnin në çdo shekull vështirësitë e njeriut të çdo niveli e nën të gjitha kushtet. E thënë ndryshe, parimet e dala nga mendja e një njeriu nuk mund t'u japin qetësi dhe lumturi kontinenteve për shekuj me radhë. Sistemet dhe zgjidhjet njerëzore të pambështetura në zbulesën hyjnore e në librin hyjnor, nuk mund të mbeten as pesëdhjetë vjet në këmbë pa ndryshuar, pa pësuar revizionim. Rregullat, sistemet, idetë, mendimet dhe ideologjitë si produkte njerëzore vjen një ditë që të vjetërohen dhe të mbeten të pamjaftueshme, të shfaqin efekte

⁹⁷ E ka fjalën për profetin Muhamed i cili nuk dinte shkrim e këndim.

anësore dhe të bëjnë të ndjehet se kanë nevojë për ndryshim dhe rinovim. Kurse është e pamundur që Kur'anit t'i gjenden të meta e defekte të tilla në asnjë temë, në asnjë parim dhe rregull dhe në asnjë çështje.

Është ky Libër që ka vënë si rregull themelor e të pavdekshëm që shteti të mos jetë shtet ku kapitali të qarkullojë vetëm në duart e të pasurve⁹⁸, që njeriut të mos i përkasë tjetër gjë veç zellit, përpjekjes dhe punës së vet⁹⁹, që dhënia e amanetit dhe detyrës atyre që kanë meritën dhe kompetencën përkatëse si dhe gjykimi me drejtësi të jenë domosdoshmëri¹⁰⁰, që vrasja e një njeriu të konsiderohet si vrasje e gjithë njerëzimit!¹⁰¹

Është ky Libër që ndalon çdo formë kamate, bixhozi, pijeje dhe prostitucioni dhe çdo lloj gënjeshtre, shpifjeje, luksi dhe mbishpenzimi (shpërdorimi), të cilat janë që të gjitha nga një helm vrasës më vete për familjen dhe shoqërinë!

Prapë, është ky Libër që e urdhëron njeriun për namaz, agjërim, haxh, zekat dhe adhurime të tjera me qëllim që të fitojë cilësi njerëzore, që, në jetën e individit dhe shoqërisë të përjetojë një jetë parajsore duke qenë ende në botë!

Po kështu, është ky Libër i cili, duke i orientuar mendjet dhe shpirtrat kah çdo bukuri dhe virtyt që e bën njeriun njeri, e bën frikën ndaj Allahut vëzhgues për çdo zemër, kurse dashurinë për Allahun, nxitës dhe inkurajues të çdo zemre!

Me se mund të shpjegohet ekzistenca e një libri të tillë përveç se me faktin që është fjalë e një Krijuesi me urtësi dhe mëshirë të pafundme dhe si mund të pranohet një libër i tillë përveç se si fjalë e atij Krijuesi?

5) Një argument tjetër se Kur'ani është fjala e Allahut, është ky: Një autor cilido, i cili në veprat e tij bën përshkrime natyre e peizazhi, kryesisht me elementë klime, bimësie e formash të relievit dhe natyrës, mbështetet në mjedisin natyror ku ka jetuar ose jeton ose ku ka shëtitur e parë. Kurse në Kur'an shohim se, më tepër se përshkrime të shkretëtirës dhe jetës së shkretëtirës, hapen diskutime dhe bëhen përshkrime mbi lumenj që rrjedhin me vrull, mbi pamje të gjelbëruara, mbi re të ngarkuara me shi që i japin jetë tokës, mbi kopshte dhe vreshta, mbi male dhe detra! Bie fjala, fakti që në suren Nur bëhet fjalë për errësirat e detrave të gjerë, për dallgë që vijnë njëra pas tjetrës, për retë që i mbulojnë dhe për atë që njeriu nuk dallon dot as dorën e vet në errësirën e formuar si pasojë e kësaj situate,¹⁰² fakti që të gjitha këto bëhen me përshkrime metaforike dhe interesante, nuk kanë të bëjnë aspak as me gjeografinë arabike të asaj kohe, as me literaturën detare të asaj periudhe. Pastaj, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi vesel'lem) i cili lindi dhe u rrit në shkretëtirë dhe që vetëm dy herë udhëtoi për në Siri duke kaluar po nëpër shkretëtirë, as i pati parë peizazhet dhe mbulesat bimore që i përshkruan Kur'ani, as pati bërë udhëtime detare!

Po në këtë kuadër, në suren En'am, gjendja e një mohuesi (qafiri) përngjasohet me gjendjen e dikujt që, duke u ngjitur drejt qiellit, pëson shtrëngime të zemrës.¹⁰³ Sot, zhvillimet shkencore kanë nxjerrë në shesh se gjatë ngjitjeve në majat e maleve të lartë pa pajisjet përkatëse, njeriut i vështirësohet frymëmarrja dhe ndjen shtrëngime të gjoksit për shkak të pakësimit të oksigjenit. Kjo e vërtetë është

⁹⁸ Shih. Hashr, 59/7.

⁹⁹ Shih. Nexhm, 53/39.

¹⁰⁰ Shih. Nisa, 4/58.

¹⁰¹ Shih. Maide, 5/32.

¹⁰² Shih. Nur, 24/40.

¹⁰³ Shih. En'am, 6/125.

kuptuar dhe kuptohet vetëm gjatë ngjitjeve malore ose ngjitjeve në lartësi të mëdha qiellore me anë të balonave. Në periudhën e të Dërguarit të Allahut, udhëtimi me balon as që përfytyrohej, kurse relievi i Gadishullit Arabik s'kishte pika të larta. Kështu, pra, ky përngjasim dhe kjo shprehje mund t'i përkiste vetëm Allahut (xh.xh.) që di çdo gjë!

6) Në periudhën kur zbriti Kur'ani, poezia ishte zhvilluar jashtëzakonisht. Në bisedat dhe grindjet, njerëzit pothuajse i flisnin dhe i përgjigjeshin njëri-tjetrit me poezi, çdo vit organizoheshin konkurse letrare dhe poezitë që fitonin, shkruheshin mbi me shkronja të arta mbi një copë që pastaj varej në muret e Qabes. Me fjalët e poetëve, të cilit quheshin secili një hero fisnor më vete, fiset hynin në luftë ose bënë paqe. Dhe, megjithëse Hz. Muhamedi (sal'lallahu alejhi vesel'lem) ishte rritur mes tyre, dihej nga të gjithë se nuk ishte marrë kurrë as me poezi, as me prozë poetike dhe as me prozë. Ndërkaq, shprehjet enigmatike dhe koncize të Kur'anit nuk u ngjanin as shprehjeve të tij, as të të tjerëve. Shprehja e Kur'anit s'ishte as poezi, as prozë poetike e as prozë, por, me origjinalitetin e vet, i magjepste të gjithë! Prandaj, parësia e mushrikëve, politeistëve mekas, të cilët deshën dhe përpiqeshin t'i largonin njerëzit nga Kur'ani, përpiqeshin sipas tyre t'i kundërviheshin Kur'anit: "T'i themi poezi, poezi s'është; t'i themi prozë poetike, prozë poetike s'është; t'i themi fjalë orakulli, as fjalë orakulli s'është; veprës së një të çmenduri s'i ngjan që s'i ngjan; më e mira, të themi është magji, prandaj mbyllini veshët se, pastaj, ju godet!"¹⁰⁴

Përballë mesazheve të Kur'anit që u kanë bërë dritë epokave, edhe mohuesit e sotëm, me gjithë demagogjitë, dialektikën dhe taktikat e tyre të kundërshtimit, krahas frymës së polemizimit të trashëguar nga të vjetrit, nuk kanë arritur të bëjnë dot gjë tjetër veçse të gëlltiten dhe struken mes dobësisë dhe zemërimit të vet! Koha ka ndryshuar paprerë, shekujt janë tjetërsuar, konsideratat janë shndërruar, ndjenja e kundërshtimit dhe e luftës është bërë më e nxehtë, kurse Kur'ani, përballë shumë e shumë polemistëve dhe rrugëve të polemikës, vazhdon të të marrë mendjen me atë ndikueshmëri të lartë!

7) Faktin që Kur'ani nuk mund të jetë vepër e Profetit tonë (sal'lallahu alejhi vesel'lem), le ta shohim edhe nga ky kënd: Një shkrimtar, në rastin më të përgjithshëm, e shkruan veprën në çastet e përqendrimit më të lartë të mendjes dhe ndjenjave dhe nuk rri pa i përmendur ose përshkruar edhe ngjarjet që i kanë shkaktuar më shumë dëshpërim ose gëzim. E thënë ndryshe, nuk është aq e lehtë që shkrimtari të shkruajë ca gjëra duke e izoluar veten nga ngjarjet që i kanë lënë ose i lënë mbresa të thella ndjesore e shpirtërore!

Mes një jete plot luftë, vuajtje e mundime, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi vesel'lem), ndërsa nga njëra anë përgatiste bashkësinë e tij të zgjedhur, nga ana tjetër bënte një luftë të ashpër kundër mjedisit të jashtëm. Ndërsa punët qëndronin kështu, në Kur'an nuk shohim ndonjë ajet as lidhur me hidhërimet që hoqi ai, as lidhur me jetën dhe vdekjen e gruas dhe fëmijëve të tij. Prandaj ky libër s'është i tij. Profeti Muhamed ishte vetëm një ndërmjetës që e ka kumtuar Kur'anin me formën që i ka ardhur!

8) Cili shkrimtar ose, në përgjithësi, autor, vallë, u jep vend në veprën e vet fjalëve që nuk duken të favorshme për të? Për shembull, në Kur'an, për shkak të atyre qëندنjen pa marrë pjesë në luftën e

¹⁰⁴ Për ajetet që flasin mbi akuzat e mushrikëve, shih Enbija, 21/5; Saffat, 37/36; Sad, 38/4; Dharijat, 51/52. Këtu e shohim me vend që ta kujtojmë këtë specifikë: Në atë periudhë, gjuha që zhvilluar shumë dhe pati arritur në një nivel të caktuar, por si gjuhë, arabishtja ishte e varfër në kuptimet metafizike, në konceptet dhe format e shprehjeve shkencore, fetare dhe filozofike. Kjo gjuhë që vlente vetëm për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e njeriut të shkretëtirës, arriti me Kur'anin në mënyrë të menjëhershme një vlerë dhe pasuri të tillë, sa që të ishte e aftë të shprehte të gjitha temat dhe çështjet shkencore, ekonomike, juridike, sociale, administrative dhe metafizike! Është e pamundur që në historinë e gjuhësisë të haset një dukuri e tillë. Një revolucion filologjik që të përfshinte edhe kohët dhe hapësirat e tjera, nuk mund të pritet jo nga një person pa shkrim e këndim, por as nga qindra specialistë, madje!

Tebukut, Profetit i tërhiqet vëmendja me këto fjalë: “O ti, profet që të faltë Allahu, pse u dhe leje gënjeshtarëve para se të të tregoheshin të vërtetat dhe se kush ishte gënjeshtar?”¹⁰⁵ Dhe një shembull tjetër lidhur me këtë specifikë: Përballë ngjarjes së shpifjes¹⁰⁶ e cila ia theu mesin dhe e zvarriti nga vuajtja në vuajtje, i Dërguari i Allahut priti plot një muaj. Po që se, ta supozojmë, ai e ka shkruar Kur’anin, a do të priste një muaj përballë shpifjes së hipokritëve për të shoqen, për ta nxjerrë në shesh të vërtetën dhe për të shpallur se mbi nderin e tij nuk ka asnjë njollë? Pra, në Kur’an u jepet vend deklaratave dhe shprehjeve që është e pamundur që njeriu t’i fusë në librin që e shkruan vetë. Kjo do të thotë se Kur’ani s’është kurrësi fjalë e Hz. Muhamedit, por, absolutisht, fjala e Allahut!

Shkurt, Personi që s’dinte shkrim e këndim, të cilin Kur’ani e prezanton me fjalët “Ti as që e lexoje dot një libër (shkrim) si ky, as e shkruaje” (Ankebut, 29/48), i sfidon të gjithë, nga ata të kohës së vet që dinin të shkruanin e këndonin, gjer në dijetarët dhe letrarët e ditëve të sotme, duke u thënë: “Ejani, bëhuni bashkë e sillni jo të ngjashmen e Kur’anit, por vetëm të një sureje të vetme!” A nuk është vetëm fakti që ai bën një sfidë të tillë krejt i sigurtë në vetvete, dëshmi dhe argument i mjaftueshëm i faktit se Kur’ani nuk është fjalë e atij Personi pa shkrim e këndim, por fjalë e Allahut?

Kur’ani dhe të vërtetat shkencore

Qëllimi esencial i Kur’anit është t’ia mësojë njeriut detyrat dhe përgjegjësitë në kuadrin e pozitës së tij si adhurues i Zotit, të rregullojë jetën individuale e shoqërore dhe të bëhet pretekst për fitimin e lumturisë së përjetshme. Me një shprehje më të përmbledhur, detyra më e parë e Kur’anit është trajtësimi i jetës së njeriut sipas vullnetit dhe pëlqimit të Krijuesit.

Specifikave jashtë kësaj, Kur’ani u jep vend sipas përbërjes, rëndësisë dhe vlerës. Po që se s’do të ndodhte kështu, por, bie fjala, Kur’ani do të bënte fjalë hapur dhe me detaje mbi një sërë mrekullish të qytetërimeve dhe mbi zhvillimet shkencore, atëherë do ta humbte të drejtën për të bërë fjalë mbi synimet tejet të rëndësishme dhe do të ishte lënë mënjanë njeriu, qenia më e përsosur e botës.

Prandaj, Kur’ani, shumë temave shkencore dhe teknike u ka dhënë vend në mënyrë të përmbledhur dhe koncize në kuadrin e synimeve të veta kryesore. Nisur nga kjo, në emër të njohjes së fuqisë, madhësisë dhe urtësive të Krijuesit të Lartë,¹⁰⁷ Kur’ani prek, disa herë hapur e, disa herë, në mënyrë sinjifikative, shumë dukuri që ndodhin në ekzistencë, nga të cilat mund të përmendim disa si më poshtë.

1) “I dërguam erërat si mbarështuese dhe zbritëm ujë nga qielli dhe, kështu, ju dhamë ujë, ndryshe, ju s’mund ta mblidhni ujin!” (Hixhr, 15/22)

Edhe ky ajet është tregues i faktit se një e vërtetë e kuptuar vetëm në shekullin e njëzetë, është pohuar nga Kur’ani shekuj më parë. Erërat përplasnin me njëra-tjetrën retë e formuara nga avujt e ujit. Nga kjo përplasje, mes reeve ndodh një rrjedhje e fuqishme elektronesh në gjendje inkandeshente që e quajmë rrufe ose shkrepimë. Kështu retë mbarështojnë shiun. Pastaj, duke i ngjeshur retë, erërat bëjnë të bjerë shi. Në të njëjtën kohë, duke fryrë mbi lulet, erërat bartin polenin që e shpërndajnë mbi organet

¹⁰⁵ Tevbe, 9/43.

¹⁰⁶ E shpifjes kundër nderit të të shoqes Aishe. Përkthyesi.

¹⁰⁷ Kështu, në një ajet me cilësi ndriçuese të kësaj specifice, thuhet: “Me të vërtetë, në krijimin e qiejve e të tokës, në ndjekjen e ditës nga nata e të natës nga dita, ka prova (që tregojnë ekzistencën, fuqinë dhe urtësinë e Tij) për ata që kuptojnë!” (Al-i Imran, 3/190)

femërore të luleve në hapësira të mëdha. Kështu, retë mbarështojnë edhe bimët. Gjithashtu, ky ajet tregon se ujrat e shiut depozitohen në tokë dhe shërbejnë, pastaj për pirje dhe ujitje.

2) “Çdo gjë Ne e krijuam çift!” (Dharijat, 51/49) “Allahu është i pastër nga çdo e metë dhe mangësi! Ai i krijoi çift çdo gjë që mbin nga toka, ata vetë si dhe shumë gjëra që ata nuk i dinë!” (Jasin, 36/36)

Një specifikë të zbuluar nga shkencëtarët pak kohë më parë Kur’ani e pati lajmëruar shekuj më parë. Sot dihet mirë se ashtu siç janë njerëzit çift, edhe gjallesat e tjera janë çift. Madje edhe atomet, lënda bazë e çdo gjëje, janë çift. Një pjesë e tyre janë të ngarkuar pozitivisht, kurse një pjesë tjetër, negativisht. Veç kësaj, ky dualitet e tregon veten në një formë të ndryshme të çdo gjë në tërheqjen dhe shtytjen brenda vetë gjërave. Kurse në ajetin e dytë tërhiqet vëmendja për ekzistencën edhe të gjërave të tjera të panjohura për njeriun e asaj dite.

3) “Ne e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë pa ndalim!” (Dharijat, 51/47)

Në këtë ajet të Kur’anit, një mijë e katërqind e ca vjet më parë, diskutohet për çështjen e “zgjerimit të hapësirës”, e cila vazhdon ta ruajë peshën në katedrat shkencore.

4) “Edhe dielli do të vazhdojë gjer për një kohë të rrotullohet rreth boshtit të vet!” (Jasin, 36/38)

Shekuj më parë, pavarësisht se ç’thoshte kozmologjia e vjetër, Kur’ani bënte të ditur se dielli s’ishte i palëvizshëm, përkundrazi, rrotullohej rreth boshtit të vet.

5) “Ti i sheh malet dhe pandeh se janë të palëvizshëm, kurse ata lëvizin e notojnë si retë!” (Neml, 27/88)

Gjithashtu, duke tërhequr vëmendjen mbi malet si pjesë të rruzullit tokësor, Kur’ani ka treguar se rruzulli tokësor lëviz.

Siç u pa, në Kur’an, i cili është një interpretim i librit të gjithësisë, nuk janë nënvleftësuar dhe lënë mënjanë as çështjet dhe të vërtetat shkencore lidhur me njeriun i cili, si qenia më e përsosur, i përfton gjithësisë vlerën e vërtetë, por kanë zënë vendin e vet sipas përbërjes dhe rëndësisë.

Mbrojtja mrekullore e Kur’anit

Nuk ka asnjë dyshim se garancia më e madhe në mbrojtjen e Kur’anit është garancia e dhënë nga Allahu i Lartë që e ka dërguar atë: “Pa dyshim, Ne e kemi zbritur Fjalën (Kur’anin) dhe, pa dyshim, Ne jemi garant për të!” (Hixhr, 15/9)

Krijuesi i Lartë e ka mbrojtur Kur’anin duke bërë pretekst për këtë në fillim Profetin, pastaj sahabet, shokët e tij, dhe, më tutje, me pasuesit dhe vazhduesit e veprës së tyre. Me këtë, Krijuesi i Lartë ka vendosur që t’i nderojë me një detyrë kaq të lartë ata që e kanë besuar dhe vërtetuar Kur’anin!

Kur’ani është i vetmi libër që është fiksuar siç është zbritur nga qielli, është marrë nën mbrojtje dhe ka arritur gjer në ditët tona pa i ndryshuar as një shkronjë. Ai do të vazhdojë të ekzistojë gjer në kiamet me formën dhe përmbajtjen e tij origjinale!

Kur’ani ka ruajtur jo vetëm tekstin origjinal, por edhe freskinë dhe transcendentalitetin e mesazheve dhe të vërtetave që i ka paraqitur njerëzimit. Koha që ka rrjedhur me shpejtësi, nuk e ka vjetëruar dot atë. Tezat e njëpasnjëshme të zhvilluara kundër tij, nuk e kanë zbehur dhe vjetëruar vlerën e tij. Po, nga dita kur ka zbritur e gjer më sot, ndaj Kur’anit janë bërë shumë kundërshtime dhe kritika, por të gjitha “gjyqet” e ngritura mbi këtë çështje kanë përfunduar me “pafajësinë” dhe fitoren e tij!

Horizonti magjik i Kur’anit

Kur'ani është drita e amshueshmërisë, e cila shkëlqen në botën e shkronjave dhe fjalëve. Kur'ani është fryma dhe zëri i botës shpirtërore në atllasin e ndjenjave dhe mendimeve të njerëzve dhe xhindve. Kur erdhi dita dhe Kur'ani u shndërrua në margaritar brenda një guaske¹⁰⁸ krejt të veçantë, pikërisht atëherë edhe sytë e sarrafëve të fjalëve morën një bukuri që nuk vyshkej e që nuk çngjyrosej. Gjer ditën kur Kur'ani do të bëhej dritë e do të reshonte mbi fytyrën e ekzistencës, kjo gjithësi e madhe që është në çdo anë të saj një ekspozitë më vete ngjyrash, dizenjosh dhe akordesh, ishte një vendbanim demonësh; edhe ky libër ekzistence, çdo rresht i të cilit konsiderohet guaskë për një enigmë të veçantë të Botës Engjëlllore¹⁰⁹ përbëhej prej ca fletësh të mjera. Sapo Kur'ani lindi si një diell, të paktën në vështtrimin e atyre që s'kishin paragjykime, retë lëmshe-lëmshe që kishin nxirë horizontet gjer atë ditë, u shpërndanë e shkuan dhe doli në shesh ajo pamja e bukur mbi të bukurat e ekzistencës dhe e gjithë materia u shndërrua në paragrafe, fjali dhe fjalë të një libri që të jep kënaqësi kur e lexon... Sapo u dëgjua zëri i Kur'anit, syve të zemrës u zbritën dritëra dhe edhe ndjenjat e shkumëzuara në shpirtra, edhe gjuhët interprete të atyre ndjenjave filluan t'ua thonë këngëve të dritës.

Po, qysh nga dita kur sytë dhe zemrat u ndriçuan me Kur'anin, të panjohurat mbi gjithësinë që prisnin zgjidhje prej mijra vjetësh, problemet e ndërthurura u bënë të zgjidhshme një nga një dhe marrëdhënia njeri-ekzistencë-Krijues doli në shesh si hëna pesëmbëdhjetë, ndërkaq që të gjitha gjërat e pakuptueshme, duke u veshur me kuptim, zunë vend në orbitat e urtësisë.

Kur'ani është kreu i dijes së shëndoshë dhe i mendimit të shëndoshë; prapë Kur'ani është baza e shprehjes së drejtë dhe e deklaratës logjike. Bashkëbiseduesi i tij i parë i shquar¹¹⁰ është zotëria i tërë profetëve, kurse ai vetë, diferencuesi i shquar i të vërtetës nga gënjeshtria,¹¹¹ është mbreti i të gjithë librave qiellorë e joqiellorë. Profetët e parë patën ardhur për të vënë shenja ose për të ngulur flamurka në rrugët nga do të vinte dhe kalonte Kur'ani, kurse të mëpasmit, pak dhe sipas dizenjosh së shpirttrave të veta, për të bërë shënime e vërejtje në të. Të vjetrit në fotografitë shembëlluese të Kur'anit dhe të rinjtë në portretet e tij trupore e panë dhe e njohën Kur'anin në ndikimet dhe transformimet e mëdha të shkaktuara prej tij; duke e quajtur atë "Mbreti i Fjalëve", e patën mbajtur gjuhën me respekt dhe patën qëndruar para tij duarlidhur me nderim të thellë. Ndërsa Kur'ani lëshonte e shpërndante mbi tokë dritërat dhe ngjyrat e tij në gjatësi valësh elektromagnetike të ndryshme, shpirtrat vlerësues e mirënjohës kurrë nuk i ndanë sytë prej tij dhe iu drejtuan kah ai me tërë zemrën. Po, ndërsa Kur'ani zbrazej nga qiejt mbi zemra si ujvarë, dhe zemrat e urta e të zgjuara, duke ia hapur prehrin atij, u përpoqën të mos u shkonte kot asnjë pikë, madje!

Kur'ani bëri t'i dëgjohet emri në një hop në vendet më të fshehta e më të errëta dhe heshti të gjitha britmat ngatërrestare që lëshonin shkëndija; në çdo mendim pa paragjykim zgjoi ndjenja të buçitjeve të ujrave parajsore dhe, duke shuar zjarret e vetmisë në zemrat që ngadhnjeu, në të gjithë shpirtrat vuri në lëvizje entuziaste dëshirën dhe shpresën për bashkim. Natyrat krejt të ftohta me të morën ngrohtësi dhe zemrat që digjeshin flakë me dëshirën e përjetësisë, me të u freskuan!

Nëse në këtë botë të përkohshme e të vdekshme ku çdo gjë e re vjetërohet e rrënohet dhe ku çdo gjë e freskët fishket e zverdhet, ka një gjë që mundet të mbetet në çdo kohë plot ngjyra dhe krejt e freskët,

¹⁰⁸ Guaskë midhjesh margaritare; këtu me kuptim të figurshëm. Përkthyesi.

¹⁰⁹ Në origjinal: Mele-i A'la. Përkthyesi.

¹¹⁰ Profeti Muhamed.

¹¹¹ Në origjinal: Furkan→ Ziflan; Furkan që është një nga atributet dhe emërtimet e Kur'anit, do të thotë dallues, diferencues i të vërtetës nga gënjeshtria.

është Kur'ani! Po, qysh nga dita e parë kur zbriti, Kur'ani është i vetmi libër i cili, pavarësisht nga gjithë ato erëra të kundërta, pavarësisht nga ato të ftohta të papritura, pavarësisht nga bora e rënë pa kohë e nga akulli, pavarësisht nga atmosfera e ashpërsuar vende-vende dhe pavarësisht nga kushtet në ndryshim, ka mundur ta ruajë gjithmonë origjinalin e të mbetet i vetmi libër qiellor. Prandaj ndodh që, sa herë që Kur'ani të lartësohet nga gjokset që shkumëzojnë entuziazëm me gjuhën e tij, të na zgjojë në shpirtra ndjenjën sikur nga qielli sapo na ka zbritur një sofër hyjnore dhe nga xheneti na ka ardhur një tufë hurmash të freskëta. Prandaj ndodh që, sa herë që Kur'ani shpërndan përreth margaritarët e thelbit të tij, i lartëson zemrat besimtare në horizontin e indiferencës ndaj të gjitha pasurive materiale të kësaj bote. Kur'ani është një gjerdan shprehjesh i thurur prej fjalësh hyjnore, stacioni i fundit i njohjes njerëzore me burim dituror dhe një dantelë nga më të hollat e thurur prej ibërshimesh hyjnore, në të cilën është e vizatuar harta e tërë ekzistencës. Të gjitha shprehjet në formë fjalësh në vatrat ku dëgjohej zëri i Kur'anit, shndërrohen në gjëmime; nga bedenat e kalave ku valëvitet flamuri i tij, reshojnë drita mbi shpirtrat e besimtarëve dhe gurë mbi kokat e shejtanëve dhe atje qeniet shpirtërore bëjnë festa njëra pas tjetrës.

Fuqiploti e ka lidhur lumturinë e të dy botëve pas udhëzimit të Kur'anit. Kurrë nuk mund të arrihet synimi pa kërkuar prijësinë e tij. Udhëtarët e pastrehuar nën tutelën e tij, derdhen e mbeten nëpër rrugë. Kur'ani është fjala më e përkryer, më e fundit që i shkojnë pas, e cila të çon në synim pa të çorientuar, pa të gënjyer. Ndërsa lexohet me mjaft lehtësi në çdo kohë e nga çdo njeri, Kur'ani është pamundësisht i përsëritshëm. Ata që e dëgjojnë dhe e ndjejnë atë me thellësitë e tij në zemrat e veta, arrijnë të dëgjojnë e ndjejnë çdo gjë që duhet dëgjuar e ndjerë. Edhe ata që e shijojnë plotësisht atë, konsiderohen nga një "kulm mëshire"¹¹² më vete. Dhe zëri i tyre është gjithmonë i ndërthurur me frymëmarrjet e engjëjve!

Gjer ditën kur Kur'ani do ta nderonte faqen e tokës me zbritjen e tij, çdo profet e pati ndezur pishtarin e vet në burimin e tij të dritës dhe shkretëtirat e pakalueshme përreth vetes, me disa pika prej tij i pati kthyer në xhenet.

Madje, edhe periudhat më të errta kur shëtitej nën hijen e Kur'anit, janë kthyer në epoka të arta. Kurse periudha e atyre që e kanë dëgjuar dhe e kanë përjetuar vetë Kur'anin, nuk kanë ndryshim nga mëngjeset e xhenetit. Ata që e kanë vënë kokën në pragun e tij, janë të barabartë me engjëjt, kurse çdo qeniet e gjalla e jo e gjalla në klimën e ndritshme të tij janë vëllezër.

Përballë frymëzimeve të një zemre që ka mundur ta dëgjojë Kur'anin plotësisht, detrat e mëdhenj mbeten si pika uji, dhe pranë një mendjeje të ndriçuar me dritën e tij, drita e diellit kthehet në dritë qiriri. Me jetën që u dha jetëve tona dhe me dritën që lëshoi në fytyrë të materies fryma e Kur'anit e ndjerë në zemrat tona, e gjithë ekzistenca është provë e ekzistencës së Zotit. Edhe vendet më të errta e më të heshtura ku ndjehen frymëmarrjet e Kur'anit, ringjallen aty për aty si të kishin dëgjuar zërin e bririt të Israfil. Zemrat që e dëgjojnë Kur'anin me të folurit e vet, tendosen sikur të kishin dëgjuar melodi nga Xhebraili; ringjallen dhe tendosen, sepse "ky Libër është nga ana e Zotit të tyre për besimtarët udhëzim dhe provë që u hap atyre aftësinë e parashikimit..." Po, për njerëzit të cilëve nuk u kanë vdekur dhuntitë njerëzore, Kur'ani është një burim i vërtetë mëshire dhe urtësie!

Kur'ani kurrësi nuk është si deklaratat e tjera të cilat, duke mbetur në kornizën e profetësive lokale të periudhave feminare të njerëzimit, nuk kanë mundur t'i kapërcejnë kufijtë e vendit dhe kohës. Kur'ani është një mrekulli e gjerë dhe e pasur që i kapërcen të gjitha hapësirat dhe kohët dhe u jep përgjigje nevojave të të gjithë njerëzimit, nga besimi gjer te rregulli më i thjeshtë i edukatës, dhe me këtë thellësi të tij, Kur'ani ka forcë që edhe sot të sfidojë këdo dhe çdo gjë!

¹¹² Në origjinal: arfl-i Rahman.

Kur'ani ia përplasi fytyrës të gjitha kundërshtimet shtresës opozitare që qe bashkëbiseduesi i parë i tij në periudhën kur zbriti, dhe kërkoi prej tyre të sillnin një libër me përmbajtje të ngjashme, në mos, një sure, të paktën një ajet! Këta polemizuesit e parë u magjepsën nga forca shprehëse e Kur'anit, i thanë magji, u goditën pas stilit të tij letrar dhe i thanë poezi, duke e humbur mendjen përballë njoftimeve të dhëna prej tij nga prapaskena e materies, deshën ta quajnë orakull, por kurrësi nuk mundën të sjellin diçka të ngjashme me të! Polemistët e asaj dite, mjeshtër fjale, të cilët flisnin edhe në prozë, edhe në poezi, të cilët fjalën e kishin pasion, e gëlltitën gjuhën, e vunë bishtin ndër shalë dhe u zhytën në heshtje dhe turp në një qoshe të strofullës së vet; po kështu, edhe mohuesit inatçinj të asaj periudhe demoniake me gjithë demagogjitë, dialektikën dhe taktikat e tyre të kundërshtimit, krahas frymës së polemizimit të trashëguar nga të vjetrit, nuk kanë arritur të bëjnë dot gjë tjetër veçse të gëlltiten dhe struken mes dobësisë dhe zemërimit të vet! Koha ka ndryshuar paprerë, shekujt janë tjetërsuar, konsideratat janë shndërruar, ndjenja e kundërshtimit dhe e luftës është bërë më e nxehtë, kurse Kur'ani, përballë shumë e shumë polemistëve dhe rrugëve të polemikës, ende i fortë si malet, i pasur si detrat dhe i thellë si qiejt, me atë seriozitetin dhe ndikueshmërinë e tij të lartë, vazhdon t'i drithërojë zemrat dhe t'i turbullojë mendjet! Brenda një mijë e katërqind e ca vjetësh që kanë kaluar nga dita kur Kur'ani ngriti fron në zemrat tona, janë përgatitur shumë mbretër të fjalës sipas periudhave përkatëse dhe janë ngritur mbretëri shprehjeje; sisteme të ndryshme, ekole të ndryshme, rryma ideore të ndryshme me më të magjishmit e fjalëve, me më magjistarët e shprehjeve, kanë përdorur të gjitha municionet për ta shprehur veten dhe për ta shembur Kur'anin, i janë drejtuar çdo baterie dhe kanë luftuar vazhdimisht me këtë Libër, por, përballë përputhshmërisë së parimeve të parashtruara prej tij lidhur me gjithësinë, materien dhe njeriun, përballë thellësisë dhe bindshmërisë së shpjegimeve, përballë karakterit shkencor të përgjigjeve ndaj pyetjeve eventuale, gjithmonë kanë rënë të mundur!

Po, Kur'ani ka parashtruar një këndvështrim të veçantë me një stil jashtëzakonisht të qëlluar për të vërtetën e gjithësisë, materies dhe njeriut, një këndvështrim me të cilin ai i trajton si një të tërë ekzistencën dhe njeriun brenda ekzistencës dhe e vendos çdo gjë në vendin e vet pa nënvleftësuar dhe lënë mënjanë asnjë pikë madje. Marrëdhëniet e pjesëve me të tërën, vendin e të tërës përballë pjesëve të veta i parashtron me veçoritë më të imta dhe u jep përgjigje të ndryshme edhe pyetjeve më të vogla që mund t'i kalojnë njeriut nëpërmend lidhur me gjithësinë, këtë libër të madh e këtë ekspozitë të madhe. Duke e analizuar gjer në hollësinë më të imtë enigmën e paraskenës dhe prapaskenës së gjithësisë, në asnjë mënyrë nuk i lë vend nëpër mendjet ndonjë dyshimi çfarëdo. Po, në ato detajizimet e veta tejet të imta, Kur'ani nuk i lë shesh ndonjë boshllëku çfarëdo as në mendje, as në logjikë, as në ndjenjë; ai i përfshin në atë mënyrë mendjen, vetëdijen, ndjenjën dhe njohjen e njeriut dhe imponon në atë mënyrë pranimin e thënieve të veta, saqë përballë kësaj ndikueshmërie transcendentale të tij, njeriu, pothuaj si udhëtarët e së vërtetës që e kanë kapërcyer kornizën e atributit dhe hapur ndaj Individualitetit të Lartë, ecën nga mahnitja në tmerrim, nga tmerrimi në ngrirje, paloset më dysh me frikë dhe pëshpërit me vete: "Po qe se detet do të bëheshin bojë për të shkruar fjalët e Zotit tënd, madje kësaj sasive t'i shtohet po aq, detet do të mbaroheshin, kurse fjalët e tij (lidhur me urdhrat e legjislacionit dhe krijimit) nuk do të mbaroheshin!" Ja, pra, Kur'ani është çelësi i artë i këtij thesari fjalësh të pashtershëm, kurse besimi, dhëmbët ose shifrat e këtij çelësi enigmatik. Unë them se nuk është e mundur që dikush i cili ka në dorë këtë çelës dhe këta shifra, të ndjejë nevojë për tjetër gjë në çështjet themelore lidhur me gjithësinë, materien dhe njeriun!

Askush të mos pandehë se me këto fjalët e mia të mjera, unë po i thur një panegjirik¹¹³ Kur'anit!
Më së pari, kush jam unë që t'i thur lavde atij?

Në e cilëssoftë dikush atë, e cilëson Hazreti Vassaf¹¹⁴,

Dje dhe sot, në botën qiellore, shpirtrat radhë-radhë

E madhërojnë atë ashtu që ti e pandeh tavaf!¹¹⁵

Mund të dalin njerëz që të mos i shohin dot këto merita mrekullore të Kur'anit përse u përket elementëve fjalësorë abstraktë, vetëm se është krejt e qartë se ata që kanë përdorur ndërgjegjet, kurrë nuk janë gënhyer. Sidomos nëse e kanë parë atë ndikimin e tij të jashtëzakonshëm gjer tani në përmasa botërore!

Në atë periudhën e parë kur Kur'ani e nderoi faqen e tokës me ardhjen e tij, ushtroi një ndikim aq të papërfytyrueshëm si në shpirta, ashtu dhe në mendje e zemra, saqë përsosmëria e brezave të rizgjuar në jetë nën atmosferën e tij prej drite është një mrekulli në përmasa që s'lenë nevojë për mrekulli të tjera mbi të dhe, gjithashtu, është e pamundur të gjenden të ngjashmit e atyre njerëzve për sa u përket besimit, fesë, horizontit të mendimit, moralit të tyre, si dhe njohjes dhe ndjerjes prej tyre të enigmës së pozitës së robit ndaj Allahut dhe adhurimit ndaj Tij! Ç'është e vërteta, në atë periudhë, Kur'ani përgatiti një brez të tillë me emrin "sahabe", që nuk teprohet po të thuhet se ai brez ka qenë i njëvlershëm me engjëjt. Në të vërtetë, edhe sot, madje, Kur'ani vazhdon t'ua ndriçojë zemrat atyre që i drejtohen atij me gjithë zemër dhe t'ua pëshpërisë enigmat më intime të ekzistencës atyre që munden t'ia hapin shpirtin atij, ashtu që ata që hyjnë në atmosferën e tij me zemrën, vetëdijen, ndjenjat dhe njohjen e tyre, u ndryshojnë aty për aty ndjenjat dhe mendimet dhe çdo njeri, qoftë edhe në masë të caktuar, e ndjen veten në një botë tjetër, të ndryshme. Po, edhe sikur një herë t'i drejtohet njeriu atij me gjithë zemër, nuk shpëton dot më nga ndikimi i tij. Nxënësin që ka mundur ta tërheqë në atmosferën e vet, Kur'ani ashtu e zbut, ashtu e brishtëson, ashtu e gatuan dhe e formëson që, nëse njeriu do të bëhej në vetvete diçka, bëhet vetëm në sajë të kësaj; madje, shpesh herë, edhe të pandreqshmit hyjnë, nën hijen e tij, në një proces formimi që i lë me gojë hapur të gjithë! Në Kur'an thuhet: "Po qe se malet do të viheshin në lëvizje, kjo do të bëhej e mundur vetëm me anë të Kur'anit; po qe se toka do të bëhej copë-copë dhe të vdekurit do të mund të bëheshin që të flisnin, prapë kjo do të bëhej e mundur vetëm me anë të Kur'anit!" Kështu thotë Kur'ani, sepse ai ka ushtruar një ndikim të tillë në zemrat, në vetëdijet, në ndjenjat e në mendjet, që kjo ndikueshmëri e tij nuk mbetet pas nga lëvizja e maleve, nga copëtimi copë-copë i tokës, nga bërja e të vdekurve që të flasin dhe nga dhënia jetë kufomave të kalbura prej mijëra vjetësh!

Sahabet, çdonjëri prej të cilëve është një hero zemre dhe shpirti, janë një bashkësi e jashtëzakonshme e dalë në klimën e begatë dhe frymëzuese të Kur'anit. Ata kanë ushtruar një ndikim aq të thellë mbi një pjesë të madhe të tokës dhe mbi një të pestën e njerëzimit, saqë në këtë punë të mrekullueshme të përmasave të shkëlqes së maleve, të dhënies jetë kufomave pa jetë dhe të lidhjes së tokës me qiellin, është e pamundur të tregohet një bashkësi tjetër që të mund të matet me ta! Ata njerëz që ia patën dhënë zemrën Kur'anit, që qenë gatuar dhe formësuar me disiplinat qiellore të tij, më drejt, që qenë bërë Kur'an në shpirt e në kuptim, me Furkanin e patën bërë të pamundurën të mundur, shpirtave të vdekur u patën hapur rrugët e ekzistencës së përvetshme, ia patën ndryshuar trajtën faqes së tokës, i patën bërë popujt me të cilët patën rënë në kontakt, të ndjenin kënaqësinë e botës së përtejme,

¹¹³ Në original: me'hiye, panegjirik, lirikë lavdëruese dhe himnizuese. Përkthyesi.

¹¹⁴ Vassaf: cilësues, karakterizues, lavdërues; këtu aludohet për Allahun, i cili, siç shprehet në varg, është i vetmi që mund ta cilësojë, karakterizojë dhe lavdërojë Kur'anin. Përkthyesi.

¹¹⁵ Tavafi është lloji i adhurimit që bëhet duke u rrotulluar rreth Qabes.

patën thyer zinxhirët e hedhur mbi mendjet dhe patën zgjidhur zinxhirët me të cilët patën qenë lidhur gojët, e patën ulur përsëpari njeriun për sa i përket vendit të tij të veçantë në krijim, në vendin ku e pati ulur Allahu, ia patën kthyer njeriut konsideratën e humbur, i patën interpretuar përsëpari gjithësinë, materien dhe njeriun, e patën theksuar edhe një herë tjetër atë marrëdhënie të thellë dhe enigmatike mes urdhrave të krijimit dhe rregullave legjislative, duke përcaktuar dhe parashtruar qëllimet finale të zemrës, vullnetit, ndjenjës dhe vetëdijes, për rrjedhojë, duke i vënë në lëvizje parimet dhe metodat e vënies në zhvillim të vlerave relative, proporcionale dhe potenciale të shpirtit të njeriut, e patën orientuar njeriun e thjeshtë për t'u bërë njeri i përkryer dhe, kështu, e patën bërë atë ta ndjejë praninë e Zotit me fuqi dhe vullnet të pafundmë në çdo gjë ku shkon syri, ku arrijnë ndjenjat dhe që e ndjen zemra, dhe çdo gjë e patën shpënë në vendin e vet duke e lidhur me të zotin e vet!

Po qe se besimtari i ka syrin dhe zemrën të hapur, i ka ndjenjat dhe shpirtin të zgjuar dhe mendjen dhe mendimin të lidhur pas Allahut në këtë përmasë, quhet se ai njeri është distancuar nga të gjitha vulgaritetet e anës materiale të jetës, se ka nisur ta ndjejë jetën në një trajtë tjetër dhe se është zgjuar ndaj tejkuqirit të botës së ndjesive; një burrë i tillë i së vërtetës, në çdo element, në çdo copë të ekzistencës ndjen të dallgëzohet dituria e Allahut dhe të funksionojë dora e fuqisë hyjnore, jeton njëherit në shpresë e frikë me një ndjenjë tronditjeje dhe një vetëdije afërsie dhe, brenda kufizimit kohor dhe material të botës së vet, përsillet gjer në pikat më fundore të botës tjetër. Duke marrë frymë, merr me shpresë dhe pritje, kurse duke dhënë, jep me frikë dhe impresionim. Gjithmonë po kështu shëtit mes vijave dhe kornizës së përvijuar nga Kur'ani dhe e jeton jetën vazhdimisht në një përbashkësi ngjyrash!

PROFETESIA (INSTITUCIONI PROFETIK)

Koncepti profet

Fjala persishte *pejgamber* do të thotë *udhëzues, prijës dhe përfaqësues i dërguar*. Kurse në terminologjinë fetare, *pejgamber* quhet përfaqësuesi i Allahut i zgjedhur prej Tij ndër njerëzit, robtë e Tij, i nderuar me vahjin ose komunikimin hyjnor dhe i ngarkuar me detyrën për t'u përcjellë njerëzve urdhrat dhe ndalimet e Tij.

Barazvlerës të fjalës *pejgamber* në arabishte janë fjalët *resul* dhe *mursel*. *Resul* ose *mursel* quhet *pejgamberi* (profeti) i dërguar te njerëzit me një libër të ri dhe me një legjislacion të ri. Shumësi i këtyre fjalëve është *rusul* dhe *murselun*. Një tjetër fjalë që në Kur'an shpreh kuptimin *pejgamber*, është fjala *nebi*. Edhe *nebiu* është përfaqësuesi i Allahut i dërguar te njerëzit për t'u njoftuar atyre urdhrat dhe ndalimet e Allahut, ndërkaq, i papajisur me libër dhe legjislacion të ri, por i ngarkuar me detyrën për të vazhduar kumtimin e librit dhe legjislacionit të dërguar me anë të *pejgamberit* (profetit) paraardhës. Shumësi i kësaj fjale është *enbiya*. Fjalët *risalet* dhe *nubuuvet* që janë paskajore, kanë kuptimin *pejgamberi* (profetësi) ose *institucioni pejgamberik* (profetik).

Domosdoshmëria e besimit te profetët

Besimi te profetët është një ndër gjashtë bazat e besimit. T'u besosh profetëve do të thotë të besosh se ata janë zgjedhur dhe dërguar nga Allahu dhe se të gjitha njohuritë e marra prej tyre nga Allahu janë të vërteta e të drejta.

Allahu ua ka bërë muslimanëve farz (detyrim fetar) që t'u besojnë të gjithë profetëve pa dallim:

“Edhe i Dërguari i besoi asaj që iu zbrit nga Zoti i tij, edhe besimtarët. Të gjithë u besuan Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij dhe thanë: “Ne nuk bëjmë dallim mes të dërguarve!..” (Bekare, 2/285)¹¹⁶

Kurse në një ajet tjetër, Kur'ani ka bërë të ditur në mënyrë të hapur se besimi te disa profetë dhe mosvërtetimi i të tjerëve është mohim (kufr):

“Ata persona që as Allahun e njohin, as resulët (të dërguarit) e Tij dhe ata persona që, duke pretenduar se e njohin Allahun, nuk i njohin resulët, kërkojnë t'i ndajnë Allahun dhe të dërguarit nga njëri-tjetri.

Dhe ata persona që thonë, “disa resulë i besojmë, kurse disa i kundërshtojmë”, kështu, kërkojnë të zënë një rrugë mes besimit (iman) dhe mohimit (kufr).

¹¹⁶ Originali në Kur'an i kësaj pjese të ajetit është kështu: “ámene'r-resulu bima unzile ilejhi mi(n)'r-rabbihi ve'l-mu'minun(e). kul'lun ámene bil'lahi ve melaiketih(i) ve kutubih(i). lá nuferriku bejne ehadin mi(n)'r-rusulih(i)”. Siç shihet, për profetët (këtu si për profetin Muhamed, ashtu dhe si emër i përgjithshëm për të gjithë profetët) përdoret fjala *resul*, kurse në përkthimin turqisht të këtij libri përdoret fjala *pejgamber*. Duhet të dihet se në Kur'an nuk përdoret kurrë fjala *pejgamber*. Ndërkaq, në literaturën shqiptare ka qenë përdorur dhe përdoret edhe fjala *pejgamber*, por, më shumë fjala profet, kurse fjala *Resulullah* si emër i përveçëm i përdorur vetëm për profetin Muhamed, përkthehet e perifrazuar në formën *i Dërguari i Allahut*. Përkthyesi.

Ja, këta janë vetë mohuesit (kafirët/qafirët). Dhe Ne kemi përgatitur për qafirët një ndëshkim poshtërues e shkatërrues!” (Nisa, 4/150-151)

Nevoja e ndjerë për institucionin e profetësisë

Për sa u përket vlerave potenciale dhe pajisjes, njeriu qëndron në nivelin më të lartë të hierarkisë së qenieve. Ndërkaq, krahas këtij potenciali, me veçori të tilla, si urrejtja, neveria, zilia dhe kundërshtimi, njeriu është një qenie e përshtatshme edhe për të rënë në fund të kësaj hierarkie. Ja, pra, Allahu i Lartë që e di më mirë se kushdo këtë aspekt të njeriut që e ka krijuar vetë, u ka dërguar njerëzve profetë si rrjedhojë e urtësisë, favorit dhe mëshirës së Tij.

Asnjë qenie në gjithësi nuk është krijuar pa qëllim e pa detyrë dhe asnjë gjallesë nuk është lënë pa prijes ose udhëzues. Allahu (xh.xh.) që nuk i ka lënë milingonat pa sundimtar, bletët pa matkë (mbretëreshë), zogjtë pa prijes, edhe njerëzit s’i ka lënë pa profetë-udhërrëfyes!

Gjatë gjithë historisë, çdo profet ka treguar zell të madh dhe ka bërë përpjekje të mëdha si një i ngarkuar me detyrë për t’i zhvilluar aftësitë e vendosura në natyrën e njeriut dhe për t’i orientuar ata sipas qëllimit të krijimit të tyre. Po të mos ishin profetët, njeriu si fryti më i përsosur i pemës së krijimit do të bëhej një qenie pa kuptim e dënuar me dekompozim.

Po kështu, profetët i kanë shërbyer njerëzimit si njerëz kompetentë që rregullojnë lidhjet dhe marrëdhëniet mes njerëzve të detyruar të jetojnë në formë shoqërie dhe që i vënë ata mbi themele drejtësie. Prapë, mësuesit e parë të cilët, duke ua mësuar njerëzve të fshehtat e materies dhe dukurive, ua kanë shpjeguar atyre marrëdhëniet njeri-gjithësi-Allah, janë profetët.

Nga ana tjetër, profetët, jo vetëm kanë qenë udhëzues të pagabuar në fushën moralo-shpirtërore dhe në arritjen e lumturisë së kësaj bote e të përjetësisë, por edhe kanë kryer funksione të rëndësishme si prijes që kanë bërë punën e mjeshtrit në fushat metariale, që kanë hapur brazda të reja që i kanë kapërcyer epokat dhe që, me mrekullitë për të cilat janë bërë pretekst, kanë përgatitur truallin për ngritjen e qytetërimeve dhe për zhvillimin e diturive dhe shkencave.

Shkaqet që njerëzit kanë ndjerë nevojë për profetë, mund t’i shprehim përmbledhtazi, kështu:

Edhe sikur njerëzit, me mendjen e vet, ta gjejnë Allahun duke parë dukuritë që ndodhin në ekzistencë, nuk mund t’i dinë pa ndihmën e profetëve qëllimin final dhe urtësinë e krijimit të tyre, nga kanë ardhur e ku do të shkojnë dhe si duhet t’i drejtohet krijuesit të tyre (si duhet t’i bëjnë adhurimet). Ja, pra, Allahu i Lartë ka dërguar profetë për të plotësuar këtë nevojë të njerëzve.

Po të mos ishin profetët, njerëzit, nën presionin e dëshirave dhe kërkesave të tyre kalimtare, do t’i ngatërronin me njëra-tjetrën gjërat e drejta me gjërat e dëmshme që i vijnë të këndshme vetes dhe nuk do të merrnin dot vendime të qëlluara.

Ka nevojë për profetë edhe për t’i ngarkuar njerëzit me përgjegjësi të caktuara dhe, për rrjedhojë, për t’u dhënë atyre shpërblim dhe ndëshkim. Vetëm në këtë mënyrë është parandaluar që, në jetën pas vdekjes, njerëzit të mos dalin para Allahut me pretendimin se “s’dinin gjë”! Këtë specifikë, Kur’ani e prek kështu në një ajet të tij:

“Ne dërguam profetë përgëzues e paralajmërues që, pas kësaj, njerëzit të mos nxjerrin pretekste ndaj Allahut!..” (Nisa, 4/165)

Si përfundim, mund të themi se profetët janë njerëz të pajisur jashtëzakonisht, të cilët, në kallëpet materiale të kësaj bote të kufizuar, hapin dritare për në botët e padukshme, të cilët tregojnë për ekzistencën e botëve përtej kufijve dhe të cilët na e bëjnë të ditur kuptimin e botës ku jetojmë sipas urdhrave të vetë Krijuesit të saj. Gjersa drita e vahjit ose zbulesës hyjnore, për arritjen e së cilës tek ne

ata janë ndërmjetës, të mos na depërtojë në shpirt, e thënë ndryshe, gjersa shpirti të mos na ndriçohet me atë dritë, i gjithë zelli dhe të gjitha përpjekjet e mendjes sonë që mendon dhe i kërkon të vërtetat, nuk do të kishin ndonjë ndryshim nga loja kukamçefthi!

Veçoritë e përbashkëta e të pandara të profetëve

a) Profetët janë njerëz

E para specifike që duhet të dihet mbi profetët, është se ata janë njerëz. Fundja, këtë e bën të domosdoshëm edhe fakti që ata janë përfaqësues të dërguar te njerëzit. Sepse njeriut mund t'i shërbejë si udhëzues e prijës në çdo specifike vetëm një njeri si ta. Kështu, në Kur'an është bërë e ditur se ata janë njerëz me cilësi njerëzore si ne.¹¹⁷

b) Profetët janë zgjedhur nga Allahu

Profetët janë persona të veçantë të zgjedhur nga Allahu. Asnjë profet nuk ka arritur në gradën e profetësisë me përpjekjet e veta. Allahu e ka krijuar personin që do të bëhej profet, në mënyrë të përshtatshme për këtë detyrë për nga struktura shpirtërore e fizike dhe ka vendosur vetë se kë do ta bëjë profet. Ky parapëlqim e kjo zgjedhje i përkasin plotësisht Krijuesit të Lartë!¹¹⁸

c) Profetët janë të drejtë, të ndershëm e të besueshëm

Si në të gjitha punët e tyre të kësaj bote, si në ato të botës tjetër, janë njerëz të drejtë, të ndershëm e të besueshëm, të cilët nuk të gënjejnë. E thënë ndryshe, janë njerëz që në asnjë mënyrë s'priren nga gënjeshtria, por që gjithmonë u sugjerojnë njerëzve besueshmëri. Edhe Allahu,¹¹⁹ edhe historia janë dëshmitarë se profetët kanë qenë të tillë.

d) Zgjuarsia profetike (fetanet)

Kjo veçori që do ta quanim logjike profetike, është cilësi dhe karakteristikë e pandashme e çdo profeti. Nuk është e drejtë që kjo veçori e profetëve të shprehet (identifikohet) me gjenialitetin, i cili pranohet si kulm i njerëzve normalë (të zakonshëm). Sepse profetët janë të pajisur në mënyrë të jashtëzakonshme, ata zotërojnë një zgjuarsia dhe një logjikë që i kapërcen normat njerëzore. Ata i kanë zgjidhur problemet më të vështira me lehtësinë e pirjes së çajit.

e) Profetët janë të mbrojtur nga mëkati

¹¹⁷ Shih. Maide, 5/75; Rad, 13/38; Kehf, 18/110; Enbija, 21/7-8; Furkan, 25/7; Zumer, 39/30.

¹¹⁸ Shih. En'am, 6/121.

¹¹⁹ Shih. Al-i Imran, 3/161.

Të ngarkuar me detyrën për t'u treguar rrugë njerëzve, profetët janë mbajtur larg gabimeve dhe mëkateve që do ta trondisnin besimin dhe sigurinë në ta. Këta njerëz me pajisje të veçantë që i mbron Allahu, në asnjë periudhë të jetës nuk kanë bërë mëkat.

f) Kuntimi identik i zbulesës hyjnore

Urdhrat dhe ndalimet që kanë marrë nga Allahu, profetët ia kanë përcjellë pa mangësi shoqërisë (bashkësisë) pranë së cilës janë ngarkuar me detyrë. Për ta nuk mund të mendohet e kundërta,¹²⁰ sepse këtë s'e lejon as Zoti i tyre, as natyra e tyre e pastër!

Numri i profetëve dhe profetët e përmendur në Kur'an

Në Kur'an nuk është dhënë ndonjë njohuri e prerë mbi numrin e profetëve të dërguar. Specifika e theksuar në këtë kuadër me përparësi në ajete është se çdo popullate dhe çdo zone i është dërguar një tërheqës vërejtjeje dhe paralajmërues:

"... Nuk ka asnjë ummet (bashkësi, popullatë) që për ta të mos ketë ende një nedhir (një të dërguar që t'u tregojë rrugën e drejtë dhe t'i ruajë nga fundi i rrugës së keqe)." (Fatir, 35/24)

"Me të vërtetë, edhe para teje dërguam resulë (profetë). Nga ta ka që të kemi treguar historitë e tyre, por ka edhe për të cilët s'të kemi treguar gjë..." (Mu'min, 40/78)

Lidhur me numrin e profetëve, në një hadith është thënë se janë dërguar 124 mijë nebi dhe 313 resulë.¹²¹

Profetët, emrave të të cilëve u jepet vend në Kur'an, janë këta: Adem, Idris, Nuh, Hud, Salih, Lut, Ibrahim, Ismail, Is'hak, Jakub, Jusuf, Shuajb, Harun, Musa, Davud, Sulejman, Ejub, Dhulkifl, Junus, Iljas, Eljesa, Zekerija, Jahja, Isa (alejhimusselam)¹²² dhe Hz. Muhamedi (alejhissalatu vesselam).

Ç'lexojmë në figurën e profetësisë

Allahu (xh.xh.), ashtu siç ka dashur që, me anë të ekzistencës dhe materies ta prezantojë e ta bëjë të njohur veten, edhe me anë të gjuhës së vahjit, komunikimit dhe zbulesës hyjnore, ka dashur që urdhrat e krijimit dhe urdhrat e zbritur të kuptohen dhe trajtohen së bashku dhe të ndërthurura me njëra-tjetrën, që kuptimet të cilat rrjedhin nga sytë në zemër të mbështeten me anë të frymëzimeve të cilat vijnë me rrugën e veshëve dhe mbështjellin shpirtrat, që të vihet në shesh një mendësi hyjnore sipas së cilës Ai të njihet me ndjenja¹²³ dhe, natyrisht, për këtë, ka kërkuar që njerëzit, robtë e Tij të mësojnë përgjegjësitë e tyre, mënyrën se si duhet t'i plotësojnë ato, rregullat dhe etikën e rrugës ku ecin e ku do të ecin, si dhe premtimin e synimit ku kanë për të arritur. Sigurisht, ashtu siç njohja e drejtë dhe e saktë

¹²⁰ Shih. Maide, 5/67.

¹²¹ Ibni Hibban, Sahih, 2/77; Hejsemi, Mevaridu'z-Zem'an, 1/53.

¹²² Në Kur'an, përveç këtyre njëzet e pesë profetëve, janë edhe tre emra për të cilët ka mendime kontradiktore nëse janë nebi ose veli (shenjtor): Udhejr, Lukman, Dhulkarnejn (alejhimusselam).

¹²³ Në original: min haysü hüve hüve (osm.). Përkthyesi.

e çështjeve lidhur me të fshehtë të absolute e bën të domosdoshëm vahjin, komunikimin dhe zbulesën hyjnore, edhe vahji e kërkon në mënyrë të domosdoshme institucionin e profetësisë. Pikërisht duke u mbështetur mbi këtë domosdoshmëri, Allahu e ka nderuar me praninë e një profeti të veçantë pothuajse çdo periudhë kurse, në disa periudha, çdo kontinent dhe, siç shprehet Bediuzzamani, Fuqia Eternale që nuk i ka lënë milingonat pa sundimtar dhe bletët pa mbretëreshë, edhe njerëzimin në asnjë kohë s'e ka lënë pa profet!

Allahu (xh.xh.) e ka krijuar këtë gjithësi me dëshirë dhe qëllim dhe duke i veshur trup të jashtëm çdo qenieje dhe çdo sendi të gjallë e jo të gjallë, të patejdukshëm (masiv) e të tejdukshëm (jomasiv), tokësor e qiellor, e ka pajisur me urtësi dhe interesa të ndryshme, e ka kushtëzuar me qëllime të caktuara dhe e ka orientuar drejt synimeve të caktuara. Veçanërisht, në një gjatësi vale të ndryshme të shfaqjes së Tij, në rrugën për ta bërë të ditur Vetën siç është vetë, në këtë kuptim, për ta njoftuar këdo për ekzistencën e vet, posaçërisht për t'i njoftuar qeniet me vetëdije se pse janë krijuar, se për çfarë dhe për ku janë caktuar dhe se prej se përbëhen përgjegjësitë e tyre, na ka dërguar si përfaqësues të Tij të ngarkuar me detyrë disa persona me pajisje të posaçme që t'i bëhen interpretë enigmës hyjnore¹²⁴ dhe regjimit adhurimor¹²⁵, jo vetëm na ka treguar neve ekzistencën e Tij me anë të ngjyrave, dizenjove, varianteve, harmonisë, kuptimit dhe përmbajtjes së krijesave të Tij, por edhe ka dashur, me anë të këtyre personave të zgjedhur, me anë të deklaratës së Tij të zbritur nga perdeja e thjeshtësisë, sipas nivelit të njohjes, ndjeshmërisë dhe vetëdijes njerëzore dhe, në të njëjtën kohë, duke u kujdesur për përputhshmërinë e saktë mes individualitetit, atributëve dhe emrave të Tij, t'ua bëjë të njohur shpirtit tanë enigmën e hyjnitetit, qëllimin final të krijimit, rezultatin e natyrës së krijimit, pozitën e njeriut mbi tokë dhe pikën e fundit ku ka për të arritur ai.

Ndërkaq, Zoti, në çdo punë të të cilit ka shumë urtësi dhe kuadri hyjnor i të cilit, në të njëjtën kohë, përmban shumë urtësi dhe interesa, në këto urdhra revelativë dhe legjislativë¹²⁶ nuk ka marrë për bashkëbisedues gjithkënd, nuk ka biseduar hapur e qartë me gjithkënd; në një çështje të tillë shumë të rëndësishme dhe që kërkon trajtim në veçanti, ka zgjedhur disa karaktere të veçantë të pajisur posaçërisht dhe të aftë për ta jetuar jetën në nivelin e zemrës dhe shpirtit dhe ka biseduar vetëm me ta; duke ua njoftuar ndërgjegjeve me anë të këtyre kapaciteteve të mëdhenj, natyrave të mrekullueshme dhe karaktereve të lartë, qëllimin e krijimit, urtësitë e ekzistencës, kuptimet dhe përmbajtjen e botës dhe çka ndodhet brenda saj, përbërjen dhe cilësinë e botëve përtej, rrugët parajsore që do t'i çojnë njerëzit, në botët përtej, në pavdekësi, si dhe, duke i ngritur aty-këtu zemrat peshë, duke i nxitur herë-herë dëshirat për botën tjetër, u ka njoftuar ndërgjegjeve faktin se, fund e krye, e gjithë faqja e tokës është ekspozitë e bukurive të Tij dhe trull për të mbjellë dhe korrë pavdekësinë, duke i shpëtuar, kështu, njerëzit, nga vetmia, nga mungesa e qëllimit, nga mungesa e detyrës, nga mungesa e synimit, u ka treguar njerëzve se kjo botë është një sallon pritjeje për përtej, ndërkaq që shpirtrat me kapacitet përtej ekzistencës dhe ndërjes së ekzistencës, i ka gëzuar me premtime pavdekësie dhe lajmin e lumtur për t'ua treguar bukurinë e Vet!

Të gjitha këto synime të larta Allahu i ka realizuar me anë të atyre personave të veçantë e të zgjedhur dhe i ka bërë ata gjuhën, interpretin dhe komentuesin e ekzistencës dhe materies, udhëzuesit e pagabuar të arritjes në adhurim, orientim, principialitet, sinqeritet dhe në vendin e jetës së pasme, ahiretit. Ja, pra, këta natyra eprore, në periudhat e tyre, janë përsjellë vazhdimisht brenda fushës së

¹²⁴ Në origjinal: esrar-> ulûhiyet (osm.). Përkthyesi.

¹²⁵ Në origjinal: nizam-> ububiyet (osm.) Përkthyesi.

¹²⁶ Në origjinal: tenzilî ve tefrîî (osm.). Përkthyesi.

përgjegjësisë së tyre, kanë shpallur të vërtetën dhe, duke ua njoftuar të gjithëve kërkesat e Tij, u kanë shërbyer si udhërrëfyes njerëzve që i kanë pasur brenda fushës së përgjegjësisë së tyre.

Që të gjithë profetët - vetëm me dallim grade mes tyre - janë modele të natyrës së pastër, shembuj të moralit të lartë, monumente nderi dhe virtyti, heronj besueshmërie dhe modele tipike besnikërie.

Me karakterin e tyre të lartë, me qëndrimet serioze, me gjendjet e tyre gjithmonë premtuese për besueshmëri e siguri, me orientimin e tyre aspak të pagabueshëm, me drejtësinë dhe ndershmërinë e tyre të pandryshueshme, me besnikërinë e tyre të njëjtë me të engjëjve, me qëndrueshmërinë e tyre si të maleve dhe me atë vetëdijen e tyre tejet të thellë të robit dhe adhurimit ndaj Allahut, profetët janë njerëz shembullorë të treguar gjithmonë me gisht! Në të njëjtën kohë, këta njerëz, me pamjen dhe trajtën të patëmetë, me figurën morale që ia kujton Zotin çdokujt që i sheh, me ecurinë e jetës së tyre gjithmonë të hapur ndaj jashtëzakonshmërive, me aftësitë dhe kapacitetet e tyre aq të larta sa për të zgjidhur me një lëvizje problemet individuale, shoqërore, ekonomike, politike e kulturore që u dalin para, me ndikimin e jashtëzakonshëm të tyre mbi mjedisin e tyre, me mundësitë e tyre mrekullishprehëse, me kriteret e tyre proporcionale e të ekuilibruara të parashtruara në emër të të vërtetave njeri-gjithësi-hyjnitet, me pajisjen e tyre të jashtëzakonshme mbi përmbajtjen njerëzore, të një niveli që do t'i kënaqte të gjitha cilësitë e shquara ndjesore, shpirtërore, mendore, ideore të njerëzve dhe me qëndrimet dhe sjelljet e tyre parashikuese e të ekuilibruara në respektimin ndaj ekuilibrit të përgjithshëm me anë të zotërimit me kompetencë të harmonisë së brendshme e të jashtme të gjithësisë dhe materies në përgjithësi, janë në pozitën e zëdhënësve të botës hyjnore dhe pasqyrave reflektuese të urdhrave dhe enigmave hyjnore në shkallën e revelacionit hyjnor.

Po, pothuaj çdo profet është një prijës i besueshëm e i sigurt në rrugët që i çojnë njerëzit në lumturinë e kësaj bote e të përjetësisë, një këshilltar fjalëkulluar që i paralajmëron zemrat për bukuritë hyjnore, një prijës i patëmetë që hyn në shpirtin e bashkëbiseduesve, një njohës i thellë i njeriut në gdhendjen dhe sendërtimin e mendimeve dhe ndjenjave të njerëzve që i trajtojnë, në sendërtimin sipas qëllimit final të krijimit, një edukator i përsosur në shkuljen dhe hedhjen tutje të veseve dhe zakoneve të këqija dhe të natyrave të fëlliqura dhe në shtresimin, në vend të tyre, të vlerave të larta njerëzore. Profetët janë shpëtimtarë me besimin të fuqishëm, të sigurtë fort te Zoti, të sigurtë në drejtësinë e mesazheve që parashtrojnë, të cilët munden të flasin në çdo kohë pa lëkundje e të bindur, të cilët munden të veprojnë pa u tutur, por absolutisht me arsye dhe zgjuars, edhe përballë ngjarjeve më të ashpra, jashtëzakonisht seriozë dhe, me të gjitha mundësitë, të vendosur; shpëtimtarë të tillë që kurrë s'i kanë zhgënjyer ata që u kanë shkuar pas, ndërkaq që edhe ata që u kanë shkuar pas, në asnjë mënyrë s'kanë ndjerë pendim pse u kanë shkuar pas! Kjo është kështu sepse ata janë shumë shumë mbi përmbajtjen e gjërave që na kanë përfutur e do të na përftojnë neve logjika dhe gjykimi i mendimeve dhe ndjenjave tona, sepse ata janë ruajtësit e thesareve më të pasura të dijeve më të shëndosha e më të kulluara hyjnore e natyrore, prijësit më të besueshëm e më të sigurtë të rrugës së besimit dhe konfidencës, dashurisë dhe kënaqësisë hyjnore, si dhe udhëzuesit më të besueshëm të afrimit të njerëzve te Zoti. Ata që janë zgjuar te e Vërteta, Zoti, me thirrjen e tyre janë zgjuar; gjuhët e atyre që kanë belbëzuar fjalë konfidence ndaj Zotit, me eliksirin e ofruar prej tyre janë zgjidhur; ata që kanë kërkuar pëlqimin e Zotit, në atmosferën e tyre e kanë gjetur atë që kanë kërkuar; ata që kanë qenë kureshtarë për enigmën e librit të gjithësisë, me të dhënat e parashtruara prej tyre kanë mundur ta lexojnë drejt këtë libër enigmatik!

Profetët janë prijësit e përparimit materialo-shpirtëror, pararendësit e rrugës së përkryerjes mendore dhe shpirtërore, arkitektët dhe mjeshtrit e të gjitha rregullave dhe regjimeve temporale¹²⁷ siç është jeta besimore-fetare. Në sajë të tyre njeriu arriti, nga niveli i një qenieje biologjike, në gradën e "krijesës së përsosur"¹²⁸ që konsiderohet titull i veçantë i qenies njeri i vërtetë; duke e zbuluar veten me ndërmjetësinë e tyre, njeriu ka mundur ta kuptojë pozitën e vet mes qenieve; nën prijësinë e tyre ka mundur ta ndjejë dhe shijojë thellësinë e nivelit të jetës së njerëzve të jashtëzakonshëm të ngjitur në lartësitë shpirtërore¹²⁹; prapë, me mësimet, orientimet dhe shenjimët e tyre kanë mundur ta shohin dhe vlerësojnë botën me fytyrën e saj të vërtetë, ta vlerësojnë si një laborator, si një punishte kimike, si një farmaci, si një pallat të mrekullueshëm, si një ekspozitë të shkëlqyer. Po, siç e ka shprehur Bediuzzamani, duke i urdhëruar njerëzit t'i ndjekin profetët, Allahu, krahas nderimit të njerëzve me mundësinë për të përfutur nga ky burim i begatë përmes njohjes me thellësitë moralo-shpirtërore të profetëve dhe, me anë të shfaqjeve nga shkallë të ndryshme të mrekullive të tyre që konsiderohen shenja dhe tregues të profetësisë, u ka treguar njerëzve rrugët e përparimit material; të paktën, ka dhënë disa shenja në lidhje me çështjen dhe, duke i vënë në lëvizje sistemet e asociacionit¹³⁰ të shpirtit të ndjeshëm, kureshtarë e kërkues, në imagjinatën e tyre ka hapur dyert për zhvillime teknologjike dhe mes tyre ka përgatitur truall për formimin e furtunave të truve.

Gjemia mrekullore e profetit Nuh që ai e ndërtoi në kantierin e tij detar të profetësisë... Këmisha zjarrruduese e profetit Ibrahim e dalë nga banaku i tij "miku i Allahut"¹³¹, e cila të kujton qëndrueshmërinë ndaj temperaturave më të larta të amiantit apo lëndëve përtej tij... Ora me përbërje të panjohur e profetit Jusuf e favorizuar atij në mënyrë mrekullore për kërkimin e përcaktimit të kohës, kërkim i arritur gjer në nivel domosdoshmërie... Shkopi magjik i profetit Musa që të kujton mjetet moderne të sondazhit dhe centrifugimit... Mrekullia e profetit Daut në shkrirjen e hekurit dhe derdhjen e tij nëpër kallëpë për t'u dhënë forma të ndryshme, gjë që të kujton industrinë metalurgjike... Veprimi i jashtëzakonshëm i profetit Sulejman i cili ia solli Belkizes fronin e vet me të gjitha pajisjet përreth, gjë që të kujton televizionin, internetin dhe mrekullitë e tjera përtej këtyre të kohëve moderne... Dhe prapë udhëtimi i jashtëzakonshëm i këtij profeti të lartë i cili, me kalimin brenda një dite të një largësie dymujëshe, të kujton teknologjinë e sotme të avionëve... Po kështu, akti i tij tej material e tejfizik që u hap portë kufijve fundorë të studimeve dhe përpjekjeve të ditëve të sotme lidhur me shpirtin, në ngjarjen e ekspozimit të xhindve dhe dajve, gjë që shënon ndërhyrjen në botët metafizike... Veç këtyre, ngjarja e "logjikës së kafshëve"¹³² që tregon teknikat e mësimin të gjuhëve ose kodeve të marrëveshjes mes zogjve, milingonave dhe kafshëve të tjera, madje që e inkurajon këtë... Mrekullitë e profetit Isa, si fryrja jetë gjërave të pajetë, hapja e syve të verbërve të lindur, shërimi i albinizmit dhe ringjallja e të vdekurve, si dhe barërat (ilaçet) e mrekullueshme të tij përtej nivelit aktual të mjekësisë moderne dhe gjenetikës moderne, të cilat e vënë njeriun në mendime... Më në fund, qindra mrekulli të njëvlershme me të gjitha këto të profetit Muhamed, krenarisë së gjithësisë... Të gjitha këto, përse u përket urdhrave të krijimit, janë shenja dhe tregues, janë asociacione dhe pothuaj të gjitha këto janë si thirrje për trajtimin dhe vlerësimin e veçantive të profetëve, të këtyre njerëzve të zgjedhur në fusha të ndryshme.

¹²⁷ Në origjinal: dūnyevî (nga arab.), të kësaj bote, të kufizuara në kohë dhe hapësirë. Përkthyesi.

¹²⁸ Në origjinal: ahseni takvim. Përkthyesi.

¹²⁹ Kështu i kemi shprehur në mënyrë të përbashkët e të perifrashuar emërtimet e papërkthyeshme në shqip të origjinalit: evlija, asfija, ebrar, mukarrebîn. Përkthyesi.

¹³⁰ Në origjinal: çâḡr-ḡl-m (turq), bashkëshoqërim idesh, asociacion. Përkthyesi.

¹³¹ Në origjinal: hasbijallah. Përkthyesi.

¹³² Në origjinal: mantiku'l-hajvanat. Përkthyesi.

Profeti është një kapacitet dhe talent transcendental dhe hyjnor, i cili e merr dhe e kupton siç është informacionin e konsideruar nga tërësia e dijeve të detyrueshme për sa i përket prejardhjes së tyre nga Allahu, dhe, pastaj, që mundet t'ua përcjellë të tjerëve pa i ngjitur asgjë që do të binte në kundërshtim me thelbin e tij. Ashtu si domosdoshmëria e veprimtarive jetësore dhe riprodhuese me anë të shtytjes hyjnore të njerëzit e thjeshtë dhe qeniet e tjera të gjalla - një përngjasim, ky, nga poshtë - ashtu dhe detyrat dhe përgjegjësitë e shpirtave të lartësuar me profetësinë veprojnë pothuajse brenda një natyrshmërie të tillë, ndërkaq, duke ruajtur vëzhgimin dhe kujdesin, bëjnë e përcaktimeve dhe diagnostikimeve dhe, sipas nevojës, ideatimin, të gjitha këto me anë të mekanizmit të tyre ndërgjegjësor i cili është identiteti i aliazhit të përbërë nga delikatesat hyjnore, ndjenjat, vetëdija dhe vullneti. Po, mesazhet e marra nga Zoti, sipas pajisjeve të tyre të brendshme, i ndjejnë si një aspekt të natyrës së tyre dhe, si domosdoshmëri e krijimit të tyre, ua përcjellin personave që duhet t'ua përcjellin, ndërkaq, pa bërë ndalim e pushim, në çdo kohë lëvizin e veprojnë siç janë urdhëruar. Dhe, duke vepruar, sikur të çonin në vend nevojat e natyrës krijimore të tyre, nuk hyjnë në pritje të ndonjë diçkaje.

Interpretimi i shërbimeve dhe veprimtarive të profetëve të dërguar, të kryera në vartësi të zgjedhjes hyjnore, të detyrës së ngarkuar nga ana hyjnore dhe paisjeve të botës së tyre të brendshme, si lëvizje dhe veprime të tipit të akteve të detyrueshme që u përkasin ndërgjegjeve të pastra, është pikëpamje e shumicës dërrmuese. Sipas kësaj pikëpamjeje, profetësia është, për sa i përket pajisjes së botës së brendshme, një ndërgjegje e cila e ka orientuar çdo element përbërës të saj kah qëllimi i krijimit të vet ose, mund të themi, e cila është hapur plotësisht kah qëllimi i krijimit të vet, kurse për sa i përket krijimit të pastër, natyrës së drejtë dhe përbërjes, është një dhuratë e një peshqesh hyjnor për shpirtat si lagështirë e përshtatshme për ta bërë atë të reflektohet pa të meta dhe profeti, përfaqësuesi i posaçëm i kësaj dhurate dhe peshqeshi. Nisur nga kjo, profetësia është vlerësuar edhe si kuptim dhe konceptim i gjërave të pakuptueshme me njohjen njerëzore dhe përcjellje e këtij kuptimi dhe konceptimi të bashkëbiseduesit e gradës së dytë pa e thyer dhe shformuar. Pikërisht nga ky këndvështrim, profetësia është konsideruar pika ku bashkohen fillimi dhe fundi. Pra, sipas dekretit që thotë se "Ai i jep urtësi kujt të dojë dhe kujtdo që t'i ketë dhënë urtësi, do të thotë se i ka dhënë shumë të mira e dobi" (Bekare, 2/269), Allahu i ka nderuar shumë vetë me pjesë dhe pozita të larta dhe, pastaj, me anë të këtyre personaliteteve të zgjedhur, ua ka njoftuar "enigmën hyjnore" dhe "enigmën adhurimore" ndërgjegjeve të tjera, i ka ndriçuar edhe ato.

Dërgimi nga Allahu për njerëzit i karaktereve të lartë të pafajshëm e të mbrojtur, me një pajisje të tillë të botës së brendshme, është një e dhënë e veçantë po aq me rëndësi, madje më me rëndësi se dhuntia e krijimit dhe e ekzistencës për ne që ndodhemi në gjendjen për të ngecur e mbetur në rrugë, për të rënë në hutim e për të humbur. Sigurisht, ekzistenca është një dhuratë dhe mirësi, kurse, pas ekzistencës, shpjegimi dhe interpretimi me ndërmjetësinë e një profeti i tërë gjithësisë dhe dukurive e ngjarjeve, interpretimi dhe nxjerrja në shesh e thellësive hyjnore, është një favor dhe dhuratë më vete. Çdo natyrë njerëzore e kulluar që nuk është fëlliqur dhe çdo ndërgjegje që s'është verbuar, pavarësisht nga niveli ku ndodhet, duke i vlerësuar këto shpjegime dhe interpretime mund të arrijë në nivelet më të lartë që do t'ua kishin zili qeniet shpirtërore, dhe kanë arritur. E kundërta e kësaj, ata që jetojnë në gëthapët e mendjemadhësisë, padrejtësisë, dhunës, perversitetit dhe imitimit të verbër, jo vetëm që nuk e ndjejnë favorin e të qenit dhe ekzistencës, por edhe në dhuratën dhe mirësinë e dytë - në vartësi të vullneteve të veta në planin e kushtit elementar - kanë ngecur në verbërinë, shurdhërinë dhe pandjeshmërinë e vet dhe, duke thënë, "sikur t'i zbritet atij (Profetit) një engjell i cili, bashkë me të, t'i paralajmëronte njerëzit" (Furkan, 25/7), kanë dalë kundër dhe i kanë nxirë krejt horizontet e vet!

Dërgimi i profetit dhe përcaktimi i personit që do të dërgohet profet, është nga çështjet e larta¹³³ që i përkasin Allahut. Nisur nga kjo, çdo punë dhe çdo veprimtari duhet lidhur pas logjikës "Në çdo punë ka urtësi, Allahu nuk bën punë të kotë" (Ibrahim Haki) dhe pastaj duhen kërkuar urtësitë e Tij në atë masë që ta lejojë horizonti njohës i mendjes. Në të vërtetë, ndërkaq, ne mund të bëjmë fjalë për urtësi dhe interesa me rëndësi, si duhet që personi që do të dërgohet si i ngarkuar me detyrën profetike, të jetë njëri ndër ne, ta ndjejë jetën siç e ndjejmë edhe ne, të kënaqet me ato gjëra nga të cilat kënaqemi edhe ne, të ndajë me ne të gjitha dhimbjet dhe kënaqësitë tona, t'i ndjejë në shpirt ato gjëra që ne i konsiderojmë domosdoshmëritë dhe nevojat tona, të marrë edhe ai përsipër përgjegjësitë që duhet të marrin masat njerëzore dhe personat që ai u drejtohet, të jetë shembull imitimi, më drejt, prijës për ata që e ndjekin, shkurt, në çdo kohë, brenda qiellores së mesazheve të Zotit, të përfaqësojë edhe tokësoren. Prapë dhe, megjithëkëtë, ne themi se "fytyrën e brendshme të kësaj pune Allahu e di", e rinojmë nënshtrimin tonë ndaj të vërtetës "Allahu e dëshmon se ç'është më e mira"¹³⁴ dhe, duke e konsideruar si urtësinë më të madhe heshtjen përballë atij "të Diturit dhe të Urtit"¹³⁵, e lidhim gjuhën pas zemrës dhe priremi të zhytemi në vetëkontroll.

Ndërkaq, pavarësisht nga të gjitha këto, është edhe një gjë që nuk duhet harruar: edhe profetët, ata të dërguar bujarë, janë njerëz krejt si ne! Po, edhe ata kanë qenë njerëz si ne! Detyra e tyre më e rëndësishme është besimi (iman) dhe adhurimi (ubudijet), kurse detyra që përbën bazë për zgjedhjen e tyre, është që botëkuptimin e tyre besimor dhe adhurimor t'ua përcjellin dhe bëjnë të ditur edhe të tjerëve dhe të heqin dhe zhdukin pengesat mes atyre të tjerëve dhe Zotit. Kthimi maleve dhe gurëve në ar, ndërrimi i rrjedhës së lumenjve, shndërrimi i shkretëtirave të thata në kopshte të blerta parajsore, çarja e lumenjve dhe kalimi përmes tyre si dhe zbritja e gjellëve dhe ushqimeve nga qielli nuk janë detyra të profetëve. Ç'është e vërteta, është prapë Kur'ani që flet për ekzistencën e shumë mrekullive kozmike si këto që janë kryer me dorën e profetëve në vartësi të kauzës së tyre profetike. Por të gjitha këto mrekulli që janë, nga njëra anë, "pagesa urgjente" dhe "favore private"¹³⁶ për devocionin e kthjelltë të këtyre personave të zgjedhur, për vetëdijen e tyre të detyrës dhe qëndrimin e tyre para Zotit, kurse, nga ana tjetër, shfaqje të tyre të posaçme me synimin për të krijuar bindje në bashkësitë e tyre, pra, të gjitha këto mrekulli janë, në fakt, konsiderata hyjnore të parashtruara krejtësisht me dëshirën dhe vullnetin hyjnor!

Në kuadrin e realizimit të kauzës së profetësisë, duke e kthyer me dorën e tyre gurin në ar dhe qymyrin në margaritar si dhe, prapë, duke i ngjallur të vdekurit me frymën e tyre - që asnjëri nga këto nuk është më mrekulli se njoftimi i të vërtetës së besimit shpirttrave mohues, se, duke i zbutur natyrat e mbërthyer pas mohimit, bërja e tyre ta ndjejnë Zotin dhe fryrja jetë zemrave të vdekura, të gjitha këto, me mirësinë e posaçme të Zotit - Allahu bën një shfaqje favori për pranimin e profetësisë së tyre dhe një mirësi për t'ua konkretizuar shpresat. E shprehur ndryshe, këto dukuri ose ngjarje mrekullore të ndodhura me anë të aktit krijues të Allahut, janë krejtësisht ngjarje dytësore që synojnë ta mbështesin dhe qetësojnë profetin dhe që t'i bëjnë bashkëbiseduesit e tyre të kuptojnë e të nënshtrohen, pra, nuk konsiderohen orbita themelore e profetësisë.

E shohim të dobishme të kujtojmë edhe një herë se detyra e vërtetë e profetëve është që të sigurojnë pastrimin e njerëzve nga veset e këqija dhe nga shprehitë e këqija, si mendjemadhësia, padrejtësia dhe dhuna, thyerja, imitimi i etërve, mbetja nën ndikimin e egos dhe sensualitetit, etj., të cilat konsiderohen

¹³³ Në original: umûr-u âliye (osm.). Përkthyesi.

¹³⁴ Në original: "fe lil'lahi'l-huxhxhetu'l-baliga" (arab.). Përkthyesi.

¹³⁵ Në original: "Alim-u Hakim" (osm.) Përkthyesi.

¹³⁶ Në original, përkatësisht: ücret-i âcile; özel lütuf (osm. turq.). Përkthyesi.

pengesa në afrimin tek Allahu dhe pretekste për t'u larguar prej Tij; t'i bëjnë njerëzit të interesohen dhe priren nga cilësitë dhe shprehitë e bukura, si modestia, edukata, orientimi i mendimit, përkrahja e të drejtës, prirja ndaj jetës ndjesore dhe shpirtërore, etj.; t'ua tërheqin vëmendjen njerëzve dhe t'ua kujtojnë pozitën ku ndodhen dhe përgjegjësitë që kanë dhe t'i mësojnë ata të jenë respektues në marrëdhëniet me Krijuesin, kurse të dhembshur ndaj krijesave; t'i kthejnë nga bukuritë e përjetësisë sytë e zemrave të njerëzve, të cilat janë krijuar për përjetësinë dhe që s'kënaqen me asgjë tjetër veçse me përjetësinë; duke ua treguar njerëzve specifikat që u interesojnë të gjithë njerëzve, si e drejtë-e gabuar, e dobishme-e dëmshme, e bukur-e shëmtuar, e vërtetë, e shtrembër, e përjetshme-e përkohshme (e vdekshme), etj., duke ua treguar, pra, këto specifika pa paragjykime, në mënyrë që të mund t'i kuptojnë pothuaj të gjitha mendjet dhe të mund t'i pranojnë ndërgjegjet e paprishura, të parandalojnë rënien e tyre në gabim dhe zhgënjim; duke diskutuar dhe përcaktuar me mjediset e afërta me Zotin, rrugën e drejtë dhe të shtrembër, t'ua bëjnë të qarta shpirttrave bukuritë e pafundme të arritjes të e Vërteta (te Zoti) dhe shëmtitë e tmerrshme të shmangies nga rruga dhe humbjes; t'u mësojnë dhe praktikojnë njerëzve një bindje hyjnore dhe njerëzore jo ashtu siç e përcaktojnë dëshirat dhe pasionet, por siç e do Zoti; t'i bëjnë njerëzit ta lidhin çdo punë me pëlqimin e Zotit dhe t'ua tregojnë rrugët që çojnë në atë horizont; t'u njoftojnë njerëzve se, në jetën përtej, mohuesit do të ndëshkohen, kurse besimtarët do të shpërblehen me xhenete të bukura.

Të presësh nga profetët diçka jashtë fushës së detyrës së tyre është të mos e njohësh se ç'është profetësia si dhe të tregosh mungesë të hapur respekti ndaj tyre. Përgjigjja e Kur'anit ndaj atyre që kërkojnë apo presin nga profetët diçka jashtë fushës së detyrës së tyre, është mjaft i qartë: "Thuaju: "Unë nuk po ju them juve se thesaret e Allahut janë pranë meje (kurse unë jam pronari i tyre). Në të vërtetë, unë as të fshehtëm nuk e njoh; veç kësaj, unë nuk ju them as se jam engjëll. Unë i përshtatem asaj që më komunikohet mua dhe veproj sipas saj!" (En'am, 6/50) Po, profetët janë të lidhur vetëm pas vahjit (komunikimit) hyjnor dhe, me të gjithë zellin e tyre përpiqen ta njoftojnë, interpretojnë dhe përfaqësojnë atë. Pothuaj çdo gjë që dinë, që thonë, që bëjnë dhe që duan të bëjnë, është kumtimi dhe përfaqësimi i mesazheve të njoftuara atyre me një stil të posaçëm nga ana e Zotit të Ditur e të Urtë. Me një shprehje të veçantë, përballë mesazheve hyjnore dhe në krye të burimit të vahjit ose zbulesës hyjnore që është "vendndalesa e moralit të ardhur"¹³⁷, ata janë pothuaj si nëpunës ndarjeje, shpërndarjeje dhe lajmërimi. Edhe nëse vende-vende bëjnë disa komente dhe ideatime në përputhje me kuptimin e drejtpërdrejtë të vahjit, prapë përpiqen ta shprehin çdo gjë sipas planit dhe kuadrit të mezologjisë¹³⁸ dhe në çdo lëvizje të tyre mbajnë parasysh dëshirën dhe pëlqimin hyjnor.

Ata e vazhdojnë jetën gjithmonë nën hijen e vahjit, në të gjitha veprimtaritë kërkojnë vetëm e vetëm pëlqimin hyjnor, në çdo situatë ecin në rrugën e përcaktuar nga Mësuesi Hyjnor¹³⁹, përfundimin e lëvizjeve dhe veprimtarive ia lënë Allahut dhe frytet e përpjekjeve të tyre i lënë gjer për në skajin më të largët të botës përtej. Profetët dhe ata që u shkojnë me gjithë zemër pas, kurrë nuk kapen pas dashurisë ndaj kësaj bote dhe pas dëshirës për post e pozitë, çdo lëvizje dhe çdo veprimtari e lidhin me ndjenjën e devocionit, tej pamësinë e përputhjes ndaj vahjit e konsiderojnë si vetë orientimin në rrugën e drejtë, ata drejtohen në këtë rrugë të gjerë e të ndritshme me të gjitha aftësitë e tyre mendore, shpirtërore dhe ndjesore, ecjen në atë rrugë e shohin si garanci edhe të shpëtimit të vet, edhe të shpëtimit të të tjerëve dhe e lidhin jetën pas këtij shikimi e pas kësaj njohjeje.

¹³⁷ Në original: menhelu'l-azbi'l-mevrud (arab.). Përkthyesi.

¹³⁸ Në original: ilm-i muhit (osm.), mezologjia (frëngj. mésologie; angl. mesology). Përkthyesi.

¹³⁹ Në original: Cenâb-ı Mürlid (osm.). Përkthyesi.

Për sa kohë që mendja e njeriut, logjika dhe gjykimi njerëzor - mundet edhe që të gjitha këto të pranohen si diçka e vetme - ta pranojnë profetësinë dhe premtimet e saj dhe të përfitojnë plotësisht prej një burimi të tillë të begatë, ndërsa nga njëra anë do të hyjnë në rrugën e arritjes së kufirit të fushës së vet, nga ana tjetër do të shpëtojnë nga rënia në gjendjen e mjeteve për të gënjyer të tjerët. Para së gjithash, në këtë lloj sjelljeje bëhet fjalë për nënshtrimin ndaj fuqisë së pafundme që sundon mbi gjithë ekzistencën dhe materien, dhe ndaj mezologjisë. Po deshët, ju mund t'i thoni kësaj qiellorizim të produkteve të mendjes dhe logjikës, të projekteve të ndryshme të arritura me anë të mendjes dhe logjikës si dhe kërkimet dhe përvojat e fushave të ndryshme, domethënë qiellorizim të të gjitha gjërave tokësore si dhe testimin e çdo gjëje me anë të vahjit me qëllim për ta reflektuar frymën e elementit esencial në ato truallësore. Në të vërtetë, Allahu është po ai që e ka krijuar mendjen dhe po ai që i tregon mendjes rrugën e thellimit me anë të vahjit. Me anë të mendjes, Allahu ua ka hapur sytë njerëzve kurse me anë të vahjit, duke siguruar shikimin dhe mendimin e saktë të mendjes, i ka përgatitur asaj një fushë më të gjerë gjykimi dhe, me atë deklaratën e tij gjithëpërfshirëse, ka shtresuar mbi njerëzit argumentin e tij kushtëzues. Me një shprehje tjetër, institucionin e vahjit që përfshin të tërën menjëherë, Allahu e ka sjellë në gjendjen e një laboratorit që t'i sintetizojë rrugët e ndryshme të mendjes dhe gjykitimit që në çdo kohë paraqesin një gjendje të shpërndarë dhe të këputur nga njëra-tjetra, dhe t'i testojë produktet krahasuese të këtyre.

Ja, pra, është si rrjedhojë e këtyre konsideratave që ne kemi opinionin se, pa ndjekur profetët, kushdo nga të cilët ka qenë i sigurt dhe me përvojë në kohën e vet dhe i ka njohur me të gjitha specifikat e ndryshme rrugët ku ka ecur, nuk do të mund të merret rrugë në mënyrë të sigurtë dhe kjo jetë që duket tejet komplekse, nuk do të mund të jetohet pa rrëshqitje. Po kështu, kemi besimin se vahji është një eliksir që e mbron mendjen e njeriut nga përçarjet e ndryshme, kurse profetët, mjekë specialistë që e përdorin me vend këtë eliksir. Po, këta njerëz të zgjedhur janë prijës dritësorë që e mbrojnë mendjen e njeriut përballë pikave të ndryshme rrëshqitjeje, që i hapin asaj horizonte tejfizike mbi synimet e larta, hyjnore e fizike. Mendja, logjika dhe gjykimi që ua japin dorën këtyre prijësve, në të njëjtën kohë quhet se e kanë garantuar edhe arritjen në kufijtë e tyre. Ne që u besojmë profetësisë dhe vahjit, krahas vlerësimit të mendjes, logjikës dhe produkteve të këtyre aftësive, besojmë plotësisht se këto kurrë nuk do të mund ta mbushnin boshllëkun e vahjit dhe nuk do të mund ta zinin vendin e kumtuesve besnikë e të patëmetë të tij!¹⁴⁰

Pas një vështrimi të përgjithshëm mbi institucionin e profetësisë, do të përpiqemi, qoftë edhe pak, ta njohim profetin tonë, mbretin e profetëve (sal'lallahu alejhi vesel'lem).

Profeti ynë, Muhamedi (alejhissalatu vesselam), profeti i fundit, krenaria e gjithësisë

Meqë këtu nuk ekziston mundësia për ta treguar në mënyrë të gjithanshme profetësinë e çdo profeti, besojmë se duke treguar për profetin tonë (alejhissalatu vesselam), i cili na tregon për të gjithë profetët dhe librat e tyre dhe na kërkon t'u besojmë atyre, do të kemi treguar për të gjithë ata dhe do t'i kemi kuptuar të gjithë ata!

Një vështrim i shkurtër mbi jetën e tij të çmuar

¹⁴⁰ Revista "Yeni Ümit" prill-maj-qershor 2001, vëll. 7, nr. 52.

Profeti ynë (alejhissalatu vesselam), jeta e të cilit, mbështetur në dokumente historike, njihet me hollësi nga lindja gjer në vdekje, e ka nderuar botën tonë në qytetin Mekë të Gadishullit Arabik në vitin 571 e.r. Ai i përket familjes hashimite, një familjeje me rrënjë nga fisi i shquar Kurejsh i zonës. I ati është Abdullahu, i biri i Abdylmuttalibit nga parësia kurejshe, kurse e ëma, Amineja, bija e Vehbit nga fisi Dhuhre. Muhamedi (alejhissalatu vesselam), i cili e humbi të atin para se të lindte, qëndroi dy vjet nën mbrojtjen dhe kujdesin e të gjyshit. Pasi e humbi edhe atë, shkoi pranë të ungjit Ebu Talib. Muhamedi i kaloi vitet e vegjëlisë në Mekë dhe në rrethinat e saj. Në moshën dymbëdhjetë vjeçe udhëtoi për në Siri me karvanin tregtar të të ungjit Ebu Talib. Pas moshës njëzetvjeçare, shkoi për të dytën herë në Siri në krye të karvanit tregtar të Hatixhesë, bijës së Huvejlidit, një nga tregtarët e pasur të Mekës. Në moshën njëzet e pesë vjeçe u martua me Hatixhenë. Në moshën dyzet vjeçe filloi të përjetojë disa përvoja shpirtërore që s'i kishte ndjerë më parë dhe u tërhoq në vetmi në shpellën Hira në majë të malit Nur të Mekës. Pastaj, këtë tërheqje në vetmi e ktheu në zakon. Një ditë ndërsa ndodhej i vetëm në shpellën Hira, i erdhi një engjëll me trajtë njeriu dhe i tha: "Lexo!" Muhamedi (sal'lallahu alejhi vesel'lem) ia ktheu: "Unë nuk di të lexoj!" Atëherë, engjëlli e shtrëngoi fort dhe i tha përsëdyti: "Lexo!" Pasi kjo u përsërit për të tretën herë, engjëlli i transmetoi këtë fjalë hyjnore:

"Lexo me emrin e Zotit tënd krijues që e ka krijuar njeriun prej një qelize ngjitëse! Lexo (dhe dije) se Zoti yt i cili ia mësoi njeriut ato që s'i dinte, i cili e mësoi njeriun të shkruajë me kalem, është bujar i madh!" (Alak, 96/1-5)

I ngarkuar me detyrën profetike, Profeti (alejhissalatu vesselam) filloi t'ua kumtojë pa humbur kohë njerëzve vahjin (zbulesën) që mori nga Allahu dhe i ftoi ata në tevhid, në besimin monoteist islam mbi Allahun, Zotin e gjithësisë. Gjatë veprimtarisë ftuese që e zhvilloi bashkë me shokët, iu nënshtrua vështirësive, shqetësimeve dhe vuajtjeve të padurueshme. Pas kësaj, në vitin e trembëdhjetë të profetësisë, emigroi në Medinë. Aty, me gjithë luftërat e ashpra dhe pengesave, Profeti e plotësoi me sukses detyrën profetike dhe, në vitin 632 e.r., si çdo qenie e vdekshme, edhe ai eci drejt Zotit të vet duke u lënë njerëzve pas si porosi fjalën e Allahut dhe sunetin e vet!

ARGUMENTET E PROFETËSISË SË PROFETIT MUHAMEDIT

Lajmërimi i ardhjes së Profetit Muhamed në librat hyjnorë

Në librat hyjnorë të kaluar ka shprehje që parashikojnë profetësinë e Hz. Muhamedit (alejhissalatu vesselam) dhe lajmërojnë se ai do të dërgohet si profet te njerëzit. Megjithëse Teurati dhe Ungjilli kanë pësuar shumë ndryshime, në ekzemplarët e tyre që kemi në dorë ka shumë shenja mbi këtë çështje.

Nga Teurati do të mjaftohemi me përmendjen e vetëm katër prej këtyre shenjave.

"... Moisiu ka thënë: "Zoti do të nxjerrë për ju nga vëllezërit tuaj një të dërguar si unë dhe ju duhet t'ia dëgjoni fjalën. Dhe të gjithë profetët, Samueli (Ismaili) dhe ata që kanë ardhur me radhë pas tij, që të gjithë shpallën këto ditë për të cilat po flitet!"¹⁴¹

¹⁴¹ Punët e apostujve, kapitulli. 3, sentenca 22.

“... dhe Zoti yt nuk nxori më në Izrael një profet si Moisiu!”¹⁴²

“Ndër të vëllezërit e tyre do të nxjerr për ta një të dërguar si ti dhe do t’i vë në gojë fjalët e mia dhe do ta urdhëroj atë dhe ai do t’ua thotë çdo gjë atyre!”¹⁴³

“Zoti erdhi nga Sinaja dhe u lindi atyre nga ana tjetër; shkëlqeu në malet Paran dhe erdhi nga mesi i qindramijëra të të bekuarve. Në të djathtë të tij kishte për ta një vendim prej zjarri!”¹⁴⁴

Duke u nisur nga citimet e bëra nga vende të ndryshme të Teuratit, mund të bëjmë këto përcaktime:

Me fjalën “vëllezërit tuaj”, me të cilën profeti Musa u drejtohet të bijve të Izraelit me prejardhje nga Is’haku, i biri i Ibrahimit, shënohen të bijtë e Ismailit, vëllait të Is’hakut. Kurse profeti që ka për të ardhur nga të bijtë Ismail, mund të jetë vetëm profeti Muhamed (alejhissalatu vesselam), sepse vetëm ky ka rrjedhur nga soji i Ismailit. Këtu, mund të mendohen Jusha dhe Isai si profetë të ardhur më pas, vetëm se që të dy e kanë prejardhjen jo nga Ismaili, por nga të bijtë e Izraelit. Kështu, në sentencën e dytë, Hz. Musai e shpreh hapur se një profet si ai vetë nuk ka për të dalë më nga të bijtë e Izraelit.

Me fjalën “si unë”, profeti Musai e ka fjalën për profetin e ardhshëm Muhamed, sepse në shumë veçori të detyrës profetike e të legjislacionit që solli, ku futen xhihadi ose lufta fetare, ligjet dhe ndëshkimet, autoriteti i fjalës mes bashkësisë, etj., është Hz. Muhamedi që i përngjet Hz. Musait, jo Jusha dhe Isai.

Shprehja “do t’i vë në gojë fjalët e mia” aludon për faktin se, megjithëse profeti i ardhshëm (Muhamedi) s’do të dijë shkrim e këndim, do ta këndoje Kur’anin përmendësh. Allahu i Lartë ia zbriti vahjin të dërguarit të vet dhe ai ua përcolli të tjerëve gojarisht, gjë që do të thotë se në këtë çështje ai është vetëm në pozitën e një ndërmjetësi. Ky ajet i Kur’anit tërheq vëmendjen mbi këtë specifikë: “(O i Dërguar!) Me të vërtetë, ky (Kur’an) është një libër i zbritur nga Zoti i botëve. Atë e zbriti Shpirti i Besueshëm¹⁴⁵ (Xhibrili) me një arabishte të qartë në zemrën tënde që të bëhesh nga paralajmëruesit. Kjo (zbritja e Kur’anit), pa dyshim që është edhe te librat e paraardhësve. A nuk është njohja e kësaj nga dijetarët e të bijve të Izraelit, një argument për ta?” (Shuara, 26/192-197)

Shprehja “ardhja nga Sinai” do të thotë se Musait iu dhanë ligjet e Zotit në malin Sina. Shprehja “lindja nga ana tjetër” do të thotë se profetit Isa iu dha ungjilli. Kurse “shkëlqimi në malet Paran” do të thotë “i dalë në vendin e maleve Paran”, gjë që do të thotë se profeti Muhamed do të dalë në Mekë. Paran që në arabishte është në trajtën Faran, është jo vetëm emri i vjetër i Mekës; në pjesën “Gjeneza” të Librit të Shenjtë¹⁴⁶ thuhet se Ismaili jetonte në shkretëtirën Paran. Me “të bekuarit”, nga mesi i të cilëve do të dilte profeti i ardhshëm, shënohen familja dhe sahabet, shokët e Profetit. Me “vendimin prej zjarri nga e djathta” aludohet për xhihadin në Islam.

Këto shenja mund të shihen edhe në tekstet e Ungjillit që kemi në duar.

“Guri u bë kreu i këndit... dhe ajo që në sytë tanë një punë për t’u çuditur... Sundimi i Zotit do të merret prej jush dhe do t’i jepet një popull që do t’i mbarështojë frytet e Tij dhe kush të bjerë mbi këtë gur, do të copëtohet; dhe mbi kë të bjerë ky gur, do ta thërrmojë atë si pluhur...”¹⁴⁷

¹⁴² Numrat çift (Dualiteti), kap. 34, sent. 12.

¹⁴³ Numrat çift (Dualiteti), kap. 18, sent. 18.

¹⁴⁴ Numrat çift (Dualiteti), kap. 33, sent. 2.

¹⁴⁵ Në origjinal: Ruhul Emin.

¹⁴⁶ Gjeneza, kap. 21, sent. 21.

¹⁴⁷ Mateu, kap. 21, sent. 42.

“Zoti do t’ju japë juve një Faraklit tjetër që të jetë bashkë me ju!”¹⁴⁸

“... Ai do t’jua mësojë juve çdo gjë dhe do t’jua kujtojë çdo gjë që ju kam thënë...”¹⁴⁹

“... po të mos shkoj unë, Farakliti s’vjen... dhe, kur të vijë ai, do ta bindë botën për falje dhe veprim!”¹⁵⁰

“Guri i këndit” që përmendet në ajetin e parë, nuk mund të jetë profeti Isa, sepse s’ka ndodhur ndonjë copëtim nën Isain dhe gjërat që solli ai, apo thërrmim si pluhur, por nën profetin Muhamed, si dhe, sepse Isai nuk solli ligj, nuk sundoi, por solli ligj dhe sundoi profeti Muhamed; vetë Isai thotë se nuk ka ardhur për të vënë ligje e për të sunduar.¹⁵¹ Nga ana tjetër, në hadithet profetike, profeti Muhamed pohon vetë se është guri i këndit i ndërtesës profetike, për rrjedhojë, me profetin tonë plotësohet misioni profetik.¹⁵²

Origjinali i fjalës “Faraklit” që përmendet më sipër, është greqisht në trajtën “Piriklitos” që ka për përgjegjëse fjalën arabishte “Ahmed”. Ahmed është emri i profetit Muhamed dhe në Kur’an pohohet hapur se emri i tij në ungjill është Ahmed. Ndërkaq, ne sot nuk kemi ndër duar shumë nga ungjijtë që flasin hapur për të ardhmen dhe vetitë e profetit Muhamed.

Morali i tij i lartë e i pashoq

Është një e vërtetë e fiksuar nga të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me historinë, se në të gjitha periudhat e jetës si para profetësisë, ashtu dhe pas profetësisë, profeti Muhamed (sal'lallahu alejhi vesel'lem) ka qenë një njeri i përsosur “me moral të lartë” që i bënte të mira çdo njeriu, që ua plotësonte nevojat nevojtarëve, që bënte një jetë të thjeshtë, që kurrë s’gënjente, që mundej t’i falte ata që i bënin keq dhe të cilit mund t’i besohej për çdo gjë. Moralin e tij të pashoq, Kur’ani e shpreh kështu:

“Me të vërtetë, ti qëndron mbi moralin më të lartë i cili, meqë është me dimensione kur’anore dhe bosht hyjnor, është e pamundur të përfshihet dhe të njihet!” (Kalem, 68/4)

Përballë çdo lloj gjendjeje, situatë dhe pengesash, të mund t’i jetosh të gjitha vlerat morale dhe të japësh një shembull të gjallë të këtyre vlerave në çdo etapë të jetës, mund të jetë e mundur vetëm për një profet të edukuar drejtpërdrejt me edukatën hyjnore.

Profeti Muhamed i mblidhte në vetvete të gjitha tiparet e bukura në atë mënyrë që të formonin personalitetin më të lartë. Ai ishte tejet i guximshëm dhe i ashpër por, në të njëjtën kohë, tejet modest, i butë dhe paqësor. Më e rëndësishmja është se, jo vetëm guximi dhe ashpërsia e tij nuk patën arritur gjer atje sa të thyenin dhe rrënonin zemrat, por as modestia dhe prirja e tij për t’i falur të tjerët nuk patën rënë kurrë gjer në nivelin e mjerimit dhe frikakërisë. Profeti ynë ishte sa serioz dhe i ashpër, aq dhe njeri i qeshur dhe që të jepte qetësi. Ai ishte sa i fortë dhe i vështirë, aq dhe njeri që i donte shumë njerëzit dhe tregonte mëshirë për ta. Megjithëse ndodhej në një pozitë moralo-shpirtërore që ata që e donin i drejtoheshin me ndjenjat më të thella, ai ishte aq i thjeshtë dhe modest sa të shtrohej dhe bisedonte edhe me një fëmijë! Gjithashtu, ai ishte tejet bujar por edhe aq ekonomiqar sa të mos e kthente bujarinë gjer në shpenzim të tepërt dhe shpërdorim. Gjendja e një njeriu që mbledh dhe i jeton edhe shumë cilësi të tjera morale të bukura si këto si dhe që është model në këtë drejtim, mund të

¹⁴⁸ Joani, kap. 14, sent. 15.

¹⁴⁹ Joani, kap. 14, sent. 26.

¹⁵⁰ Joani, kap. 14, sent. 7-8.

¹⁵¹ Shih. Joani, kap. 12, sent. 47. Për njohuri më të gjera mbi këtë çështje, shih Davud, Abdulahad, Tevrat ve ‘ncillere Göre, përkth. Nusret Çam, Nil Yay. ‘zmir 1992.

¹⁵² Shih. Buhari, Menakib, 18; Muslim, Fedail, 20.

shpjegohet vetëm me faktin që ai njeri është i posaçëm dhe i ngarkuar me një detyrë të lartë, pra, që është profet!

Profeti ynë (alejhisssalatu vesselam), i cili gjatë gjithë jetës pati parapëlqyer të bënte një jetë të thjeshtë, i pati refuzuar çdo radhë premtimet materiale si pozita dhe pasuria që i qenë bërë për shumë herë me radhë. Ai pati siguruar që edhe familja dhe fëmijët t'u qëndronin larg këtyre gjërave. Kjo ndjeshmëri e tij kuptohet më mirë si po të shihen pjesëtarët e familjes për të cilët marrja e zekatit dhe sadakasë qenë të ndaluara, ashtu dhe e bija Fatime së cilës nuk i qe dhënë leje as për të vënë një varëse qafe.¹⁵³ Fakti që Profeti nuk ndërroi fare as në periudhën e Medines pasi arriti suksese të ndryshme, fitore dhe mundësi ekonomike, tregon për gradën e drejtësisë dhe ndershmërisë të moralit të tij të lartë. Fakti që edhe pas fitoreve dhe ngadhnjimeve të mëdha, madje, atij nuk iu turbullua vështrimi, nuk iu muarën mendtë dhe që e përfundoi detyrën siç e nisi, është një nga argumentet dhe provat më të shkëlqyera të profetësisë së tij!

Shkurt, po të supozojmë se në fjalët dhe sjelljet e tij do të kishte gënjeshtër dhe mungesë sinqeriteti, patjetër që do të tregonte ndonjë të çarë qoftë para profetësisë, qoftë në periudhën e profetësisë dhe, atëherë, armiqtë që prisnin rastin, do të përfitonin nga kjo dhe, pa i prekur armët, do t'ia arrinin qëllimit.

Prandaj, mund të themi me lehtësi se, edhe sikur Profeti të mos kishte asnjë mrekulli, vetë personi i tij është një argument, provë dhe dëshmi e drejtësisë, ndershmërisë dhe profetësisë së tij!

Transformimet që bëri në historinë e njerëzimit

Është e pamundur që në historinë e njerëzimit të gjendet një njeri i dytë që ta ketë njohur, gatuar dhe përgatitur më mirë se profeti ynë elementin njeri që është një qenie komplekse, që ta ketë bërë atë model për t'ia lënë historisë, dhe që njerëzit që përgatiti, t'i ketë shndërruar në mësues dhe udhërrëfyes për popujt e qytetëruar.

Profeti Muhamed (sal'lallahu alejhi vesel'lem) është një profet i vërtetë i ardhur nga i Vërteti (Zoti) me mesazhe të vërteta. Jeta e pastër që vuri në shesh dhe transformimi i pashoq që realizoi, janë prova dhe argumente të pakundërshtueshme të faktit se ai ka folur në emër të Allahut.

Nisur nga kjo, e shohim me vend të kujtojmë disa specifika.

Si mund të dyshohet për profetësinë e Personit i cili vendosi një rregull universal që e përfshinte jetën me të gjitha aspektet e saj dhe s'kishte të bënte me të meta të tilla si vjetërimi nga koha, pamjaftueshmëria dhe nevoja për rishikim dhe korrigjim, duke e filluar punën me një burrë, me një fëmijë, me një skllav dhe me një grua si dhe brenda një kohe 23-vjeçare që mund të quhet shumë e shkurtër? Si mund të shpjegohet ndryshe fakti që ai Person i cili nuk kishte marrë asnjë arsimim pedagogjik, nuk kishte mbaruar asnjë shkollë ushtarake, nuk kishte marrë dëftesë nga asnjë shkollë ekonomike, pa le që nuk dinte shkrim e këndim, thoshte në çdo fushë fjalë që e kapërcenin kompetencën e specialistëve përkatës, fjalë që nuk gabonin e nuk vjetëroheshin?

Nga një mjedis ku të varfërit dhe të pafuqishmit shtypeshin me të gjitha mënyrat dhe mundësitë, ku njerëzit vlerësoheshin sipas fisit dhe sojit, ku tregun e kishte marrë në dorë kamata dhe spekulimi dhe ku forca ishte bërë ligj, e shprehur ndryshe, nga njerëzit inatçinj, përdhunues dhe që u pëlqente vetja, të shkretëtirës, nxori udhërrëfyesit më me rëndësi të njerëzimit. Me ç'mund të shpjegohet kjo përveç se me profetësinë e tij?

¹⁵³ Shih. Nesai, Zinet, 39.

Është sheshit se gjer në ç'gradë është e vështirë të ndryshohen dhe ndërrohen besimet dhe bindjet e shtresuara në kokë dhe zemër, sidomos shprehitë e gradës së ideve fikse dhe manive, veçanërisht, është më e vështirë t'i bësh njerëzit që kanë kaluar një moshë të caktuar, t'i braktisin bindjet e gabuara dhe bestypte. Sot konsiderohet sukses shumë i madh jo më t'i bësh njerëzit të braktisin vese të tilla, si pijen, bixhozin, prostitucionin, mitën (ryshfetin), mashtrimin, por, madje, duhanin. Megjithëse shkencëtarët nuk pushojnë së shpjeguari dëmet e tyre, nuk po braktisen as duhani, as pija, as bixhozi.

Tani le të zgjatemi në shekullin të cilit profeti ynë (sal'lallahu alejhi vesel'lem) ia ndërroi fytyrën dhe le të bëhemi dëshmitarë të faktit se, megjithëse vetë nuk ishte sundimtar, pra, nuk e bëri punën me asnjë lloj urdhri dhe shtrëngimi - fundja, as që kishte mundësi të përdorte urdhrin dhe shtrëngimin - ai Person hoqi me pak mundësi dhe brenda një kohe mjaft të shkurtër nga fiset dhe popullatat e ndryshme kryeneçe, fanatike dhe të lidhura gjer në fund pas traditës, që zakonet dhe veset u ishin ngulitur gjer në damarë, jo një, por dhjetra, mbase qindra vese, shprehi dhe zakone. Dhe, për më tepër, shohim se nuk u mjaftua me heqjen e veseve dhe zakoneve, por, në vend të tyre, shtresoi cilësi dhe veti që e bëjnë njeriun njeri! Atëherë, a nuk i duhet thënë njeriut që i ka ditur dhe bërë këto, "ti je i dërguari (resuli) i Allahut"?

Duke i bërë të gjitha këto punë, Ai (alejhissalatu vesselam) hyri në zemra jo duke përdorur frikësimin dhe shtrëngimin, por me rrugën e bindjes mbështetur në parimin për ta bërë të dashur qëllimin dhe synimin. Fundja, po qe se do të kishte përdorur kërcënimin, detyrimin dhe shtrëngimin, do të ishte e pamundur që feja që solli të kapërcente shekujt e të vinte gjer në ditët tona! Me afërsinë, lejueshmërinë, mirëkuptimin, mëshirën, dhembshurinë dhe ndjenjën e faljes, Ai pati ngadhnyjer jo vetëm zemrat e miqve, por një e nga një edhe zemrat e armiqve, madje, që patën zhveshur shpatën kundër tij, si Halid, Vahshi, Ebu Sufjan, Hind, Ikrimë dhe Safvan.

Po qe se s'është e mundur të tregohet një njeri i dytë i cili, me Kur'anin që e kumtoi dhe Sunetin, traditën e tij, që është komenti i gjallë i Kur'anit, përbën model për jetën individuale e shoqërore të një të katërtës së popullsisë së botës dhe emri i të cilit përmendet me zë të lartë në të katër anët e botës të paktën pesë herë në ditë - dhe që s'është e mundur - atëherë, a nuk duhet menduar se "një njeri i tillë mund të jetë vetëm një profet që e ka marrë forcën nga Allahu"?

Njoftimet mbi të kaluarën dhe të ardhmen

Njohja e të fshehtës i përket plotësisht Allahut. Kur'ani tërheq vëmendjen mbi këtë të vërtetë në shumë ajete të tij.¹⁵⁴ Prandaj, si njeri që ishte, Profeti nuk e njihte të fshehtën, por njihte vetëm aq sa ia bënte të ditur Allahu. Me të vërtetë, kjo specifikë shprehet kështu në një ajet:

"Është Ai që e njeh të fshehtën. Ai nuk e bën askënd të informuar mbi të fshehtën me përjashtim të të dërguarit (resulit) për të cilin dëshiron..." (Xhin, 72/26-27.

Profeti Muhamed nuk thoshte gjë nga vetja; ato që thoshte ishin vetëm ato për të cilat e informonte Allahu. Nisur nga kjo, njoftimet e Profetit mbi të panjohurën do t'i trajtojmë në dy grupe: a) mbi të kaluarën dhe b) mbi të ardhmen.

a) Asnjëri prej njoftimeve dhe informacioneve të dhëna prej tij me ndërmjetësimin e Kur'anit si mbi individët, ashtu dhe mbi popujt e kaluar, si fiset Ad, Themud dhe Irem, nuk janë përgënjeshtuar me

¹⁵⁴ Shih. En'am, 6/50, 59; A'raf, 7/188.

kërkimet shkencore dhe gërmimet arkeologjike që vazhdojnë të bëhet qysh prej shumë shekujsh, përkundrazi, janë vërtetuar çdo ditë që ka kaluar me anë të gjetjeve dhe zhvillimeve të reja. Veçanërisht, ai i ka parashtruar thëniet dhe tregimet e tij jo vetëm si ngjarje të mbetura në histori, por si skena shembullore nga të cilat duhet nxjerrë mësim. Me se mund të shpjegohet, vallë, veçse me anë të profetësisë së tij, fakti që profeti ynë (alejhissalatu vesselam) që s'dinte shkrim e këndim, përballë dijetarëve edhe të kohës së tij, edhe të kohëve të ardhme, i kritikoi i sigurtë në vetvete librat e shenjtë me burim hyjnor, si Teuratin dhe Ungjillin, duke ua vërtetuar gjërat e drejta dhe duke ua rregulluar aspektet e gabuara e të korrigjuara?

b) Me përjashtim të njoftimeve të Kur'anit, këtu mund të përmendim disa prej njoftimeve të tij mbi të fshehtën që, sipas tij, do të ndodhnin në të ardhmen. Para se të ndodhte lufta e Bedrit, Profeti njoftoi edhe vdekjen e mohuesve të tillë, si Ebu Xhehli, Utbe, Shejbe dhe Velid, edhe vendin se ku do të binin të vrarë, gjë që u vërtetua.¹⁵⁵ Profeti njoftoi se, nga familja e tij, e bija Fatime do të ishte ajo që do të takohej e para me të pas vdekjes së tij dhe Fatimja vdiq gjashtë muaj pas të atit.¹⁵⁶ I nipi Hasan ishte ende i vogël kur Profeti tha kështu për të: "Ky është biri im Hasan, ky është sejjid (zotëri), me të Allahu ka për të bërë pajtim mes dy grupeve të forta";¹⁵⁷ pastaj, kur i erdhi koha, kjo ngjarje u vërtetua plotësisht. Profeti pati njoftuar se Ammar b. Jethiri do të vritej gjatë një konflikti,¹⁵⁸ se fisi i tij nga e ëma, Ummu Haram, do të merrte pjesë në një fushatë ushtarake,¹⁵⁹ gjë që ngjau në fushatën e Qipros...¹⁶⁰

Profeti ka dhënë njoftime edhe për të ardhmen e largët, të cilat, meqë janë të tilla që kërkojnë interpretim, e kapërcejnë vëllimin e këtij punimi.

Shkurt, duke u përkulur edhe një herë tjetër para këtij Personi pa shkrim e këndim, i cili i ka përcjellë me një saktësi të plotë dhe me një stil të përsosur ngjarjet që patën ndodhur dhe do të ndodhnin shekuj para e pas tij, s'na mbetet gjë tjetër veçse të themi: "Ti je Resuli i Allahut!"

Mrekullitë

Mrekullitë janë gjendje dhe situata të jashtëzakonshme të treguara me anë të profetëve nga Allahu qoftë për të mbështetur drejtësinë dhe saktësinë e vahjit, qoftë për të fuqizuar besimin e muslimanëve dhe për të thyer kryeneçësinë e mohuesve. Mrekullitë e profetit Muhamed mund t'i shqyrtojmë në dy grupe: a) Kur'ani; b) mrekullitë e tjera kozmike.

Mrekullia e përjetshme: Kur'ani

Pa asnjë dyshim, mrekullia më e madhe e profetit Muhamed është Kur'ani. Me veçorinë e tij të zotërimit të një realizmi mbiepokal, para së gjithash qëndron para nesh si një provë dhe argument që mbështet profetësinë e profetit tonë.

¹⁵⁵ Shih. Muslim, Xhenet, 76-77.

¹⁵⁶ Shih. Buhari, Menakib, 25; Muslim, Fedailu's-Sahabe, 98, 99; Ibni Hanbel, Musned, I, 6.

¹⁵⁷ Buhari, Sulh, 9; Ibni Hanbel, Musned, V, 49.

¹⁵⁸ Tirmidhi, Menakib, 35.

¹⁵⁹ Shih. Buhari, Ta'bir, 12; Muslim, Imare, 160.

¹⁶⁰ Shih. Ibni Haxher, Isabe, IV, 441.

Me aspektet e tij mrekullore, si dalja në shesh në dorën e një njeriu pa shkrim e pa këndim, moskundërshtia midis të vërtetave që përmban, njoftimi për çështje të së kaluarës dhe të së ardhmes dhe prekja e njohurive kozmike shekuj më parë, Kur'ani është provë dhe argument krejt i hapur edhe i faktit që është fjalë e Allahut, edhe i profetësisë së Muhamedit (alejhissalatu vesselam).

Çdo profet ka treguar mrekulli lidhur me çështjet e rendit të ditës në periudhën e tij. Për shembull, meqë në periudhën e Hz. Musait (alejhissalatu vesselam), në Egjipt ishte në rend të ditës magjia, ai ka ardhur si profet me mrekullinë e shkopit që i gëlltiti dhe i asgjësoi të gjitha magjitë dhe që i përgjunji të gjithë magjistarët. Meqë në kohën e Hz. Isait (alejhissalatu vesselam) ishte në rend të ditës mjekësia, ai erdhi me mrekullinë e përmirësimit të sëmundjeve të pashërueshme dhe të ringjalljes së të vdekurve. Kurse meqë në kohën e profetit Muhamed (alejhissalatu vesselam) i jepej përparësi poezisë dhe artit të ligjërimit dhe oratorisë dhe ndoshta pse "arti i të folurit" do të bëhej në të ardhmen arma më e efektshme dhe e fuqishme, profeti Muhamed erdhi me mrekullinë Kur'an si mrekullia më e madhe që do t'i bënte të heshtnin të gjithë poetët, ligjëruesit dhe letrarët.¹⁶¹

Mrekullitë e tjera dhe specifikat që duhen theksuar lidhur me këto mrekulli

Natyrisht mrekullitë e profetit tonë nuk përbëhen vetëm prej Kur'anit. Meqë ai u dërgua si "mëshirë për të gjitha botët"¹⁶², ka treguar mrekulli lidhur me çdo krijesë.¹⁶³ Ashtu siç ndodh që, kur një mbret i madh e dërgon adjutantit ose përfaqësuesin e vet në një zonë të mbretërisë ku jetojnë fise dhe popuj të ndryshëm, përfaqësuesit e atjeshëm të fiseve, popujve, klasave dhe shtresave shoqërore, në emër të atyre që përfaqësojnë, e presin të dërguarin me duartrokite, me "mirë se erdhe" dhe duke ia parashtruar përgëzimet dhe falenderimet e tyre, ashtu dhe kur Allahu, Zoti i gjithësisë, e dërgoi Hz. Muhamedin, më të madhin përfaqësues të Tij në botë, jo vetëm si të ngarkuar me detyrë, por edhe si mëshirë për të gjitha qeniet e tjera, kështu, me mesazhin e tevhidit, besimit monoteist islam mbi Allahun, Zotin e vetëm të gjithësisë, qeniet e tjera, duke shpëtuar nga dukja si gjë boshe e pa kuptim, morën kuptim dhe fituan vlerë. Dhe, me këtë rast, engjëjt, njerëzit dhe xhindet, dielli, hëna dhe yjet, uji dhe gjërat ushqimore, pemët, malet dhe gurët si dhe të gjitha llojet e kafshëve ia paraqitën atij falenderimet e llojit të vet dhe u bënë në dorën e tij mjete nga mund të nxirreshin mrekullira. Kështu, të gjitha qeniet, duke dëshmuar për drejtësinë e Përfaqësuesit të dërguar si mëshirë për to, e shpallën profetësinë e tij në tërë gjithësinë.

Kjo specifikë që u përpoqëm ta theksojmë, mund të merret si shprehje të hiperbolizuara. Në këtë pikë do të mjaftohemi duke kujtuar këtë: Nuk duhet harruar se mesazhi i sjellë nga profeti Muhamed (alejhissalatu vesselam), mëshira për të cilën ai u bë pretekst, ka të bëjë me të gjitha botët.¹⁶⁴ Sipas kësaj, është mjaft e arsyeshme që çdo botë e gjithësisë të jetë skenë e mrekullive që e vërtetojnë dërgesën dhe profetësinë e tij!

Mohimi i mrekullisë për sa i përket mundësisë, është i pamundur. Sepse edhe pse mrekullitë janë parë në duar e profetëve, ai që i ka nxjerrë ato në fushën e ekzistencës, ai për të cilin nuk ka gjëra të lehta

¹⁶¹ Njohuritë e domosdoshme lidhur me Kur'anin do t'i trajtojmë në pjesën "Besimi te librat hyjnorë".

¹⁶² Shih. Enbija, 21/107.

¹⁶³ Mrekullitë e këtij lloji janë shndërrime të llojit mrekullor me anë të vullnetit dhe fuqisë së Allahut të gjërave të zakonshme me të cilat është mësuar njeriu, në gjëra mbi shkaqet dhe ligjet të cilat janë, gjithashtu, gjëra të zakonshme për njeriun.

¹⁶⁴ Kështu, në një ajet thuhet: "(O i Dërguar!) Ne të dërguam ty mëshirë për botët!" Enbija, 21/107.

e të vështira, me shprehjen e Kur'anit, i cili bën atë që dëshiron,¹⁶⁵ është Allahu i Lartë. Si domosdoshmëri e zakonit hyjnor, Allahu (xh.xh.) vepron në kuadrin e shkaqeve dhe ligjive.¹⁶⁶ Ndërkaq, ai s'është i detyruar të veprojë brenda shkaqeve. Nuk mund të flitet për ndonjë detyrim për Allahun. Prandaj, qoftë për të treguar se nuk është i detyruar për asgjë, qoftë për të parandaluar që mendjet të mos bien dhe ngecin në rrjetën e shkaqeve dhe ligjeve, kohë pas kohe vepron ndryshe, kështu, na kujton neve se vullneti dhe fuqia e tij janë të pakufizuara e të pafundme në mënyrë që i kapërcejnë shkaqet dhe ligjet.

Të gjitha mrekullitë nuk janë zhvilluar në çdo vend dhe në atë mënyrë që të gjithë t'i shohin hapur dhe qartë. Po të kishte ndodhur kështu, atëherë ekzistencës së mendjes dhe arsyes nuk do t'i mbetej kuptim. Sepse, në këto kushte, meqë njerëzve do t'u merrej vullneti duarsh, do të shtrëngoheshin të besonin në mënyrë të determinuar, gjë që nuk përputhet me të fshehtën e provës në të cilën ndodhen.

Shumicën e mrekullive e ka përcjellë një bashkësi dhe, pastaj, një masë njerëzish që e kanë pasur të pamundur të merren vesh për të gënjer. Kurse disa mrekulli, edhe pse s'janë përcjellë nga ndonjë grup në këtë nivel, meqë nuk janë kundërshtuar nga dëshmitarët (sahabe) e tjerë, kanë fituar një fuqi përcjelljeje si të parat.

Mrekullitë e profetit tonë

a) Mrekullitë e përmendura në Kur'an

Ngjarja e miraxhit

Në Kur'an, mrekullia e miraxhit preket në dy vende lidhur me fillimin e ngjarjes dhe të pastajmen e saj.

"Allahu që e çoi një natë robin e vet (Muhamedin), për t'i treguar disa prej provave tona, nga Mesxhidi Haram në Mesxhidi Aksa, mjedisin e të cilës e kemi begatuar, është i pastër prej attributeve të mangëta." (Isra, 17/1)

"Pastaj u afrua dhe u var sa largësia prej dy harqesh ndoshta më afër. Dhe (Allahu) ia zbuloi robit të vet ç'kishte për t'i zbuluar. Dhe zemra (e Muhamedit) nuk i përgënjeshtroi ato që ia panë sytë..." (Nexhm, 53/8-11)

Të tërheq mjaft vëmendjen fakti që, duke e treguar ngjarjen Isra e cila është fillimi i mrekullisë së miraxhit, Kur'ani fillon me shprehje të tilla, si "subhanel'ledhi..." që do të thotë "Allahu që është i pastër nga atributet e mangëta..." Me këtë, në të vërtetë, mesazhi që kërkon të na japë Allahu neve, robve të Tij besimtarë, është ky: Shihni, tani do t'ju njoftoj për një ngjarje, prandaj, kujdes, të mos mendoni se a mund të jetë e vërtetë një gjë e tillë, sepse jam Unë që e realizoj këtë punë dhe për Mua s'ka asnjë lloj vështirësie si shprehje mangësie!

¹⁶⁵ Buruxh, 86/16.

¹⁶⁶ Këtu do të ishte me vend ta preknim shkurt konceptin "ligj". Ligjet janë pamja e reflektuar tek ne e mënyrës (zakonit) të Krijuesit të Lartë për ta krijuar materien dhe për t'i dhënë vazhdimësi ekzistence asaj në linjën shkak-pasojë (përfundim) brenda një vazhdimësie të rregullt. Allahu nuk është i detyruar ta krijojë qenien në linjën shkak-pasojë, por ne kemi nevojë për këtë lloj krijimi në mënyrë që të mund të kuptojmë se si krijon ai. Dijet dhe shkencat dalin në shesh nga zbulimi i ecurisë uniforme të kësaj veprimtarie hyjnore - në vartësi të dëshirës volitive hyjnore.

Allahu me fuqi dhe favor të pakufizuar, me favorin e tij e ka marrë pranë Resulin (të dërguarin) e Tij i cili, me devocionin e thellë dhe të kulluar, pati bërë t'i zhvillohet cilësia, dhe e ka bërë të merituar të një veçantie që s'i ka rënë në pjesë asnjë qenieje. Në udhëtimin e miraxhit, Profeti, duke i kapërcyer shkaqet që e rrethonin nga të gjitha anët dhe duke i lënë pas dimensionet-pengesë për ta parë Zotin, nga pozicioni ku ka arritur trupërisht dhe shpirtërisht, e ka vëzhguar Zotin. Në këtë udhëtim të mbushur me të fshehta, Profeti është përshëndetur me profetët, ka parë engjëjt, ka soditur xhenetin dhe bukuritë e tij, ka parë xhehenemin dhe pamjen tronditëse të tij.¹⁶⁷

Allahu ia favorizoi të dërguarit të tij këtë miraxh me qëllim për t'ia treguar bashkësisë së tij çështjet që i duheshin treguar duke i parë vetë me sy dhe në mënyrë ngopëse, për të na i përcjellë neve gjërat që i besojmë si të fshehta, si vëzhgime të tij, për më tepër, për ta parë Allahun dhe për të na thënë neve "është".

Në këtë udhëtim, profeti Muhamed (alejhissalatu vesselam), pasi e soditi xhenetin, me një orë soditje të të cilit nuk mund të barazohen një mijë vjet jetë të tokës dhe pasi u nderua me vëzhgimin e Bukurisë hyjnore, me një çast vëzhgimi të së cilës nuk mund të barazohet jeta parajsore, pasi i pa dhe i kuptoi të vërtetat e të gjitha çështjeve të Kur'anit dhe cilësitë e tij metaforike, kuptimet dhe urtësitë e të gjitha adhurimeve, Profeti u kthye sërish në tokë mes nesh për të na i treguar neve.

Ndarja e hënës (shakk-i kamer)

Kjo mrekulli të cilën Kur'ani na e njofton duke thënë "Kiameti u afrua dhe hëna u nda" (Kamer, 54/1), përcillet në librat e hadithit. Nga sahabet, Ibni Mes'ud na e tregon kështu këtë ngjarje: "Një herë, ndërsa ndodhesha me të Dërguarin e Allahut në Mina, papritmas hëna u nda në dy pjesë: njëra pjesë në këtë anë të malit, tjetra, në anën tjetër. Para kësaj ngjarjeje, i Dërguari i Allahut na tha: "Jini dëshmitarë!"¹⁶⁸

Ata që nuk u besojnë mrekullive të këtij lloji, në fakt, nuk kanë mundur ta vërtetojnë dot Allahun dhe fuqinë e Tij. Ata që thonë se "hëna nuk ndahet me anë të mrekullisë", e kuptojnë apo jo, kanë rënë në një rrugë pa krye sikur të thoshin se "Allahu nuk e ndan dot hënën"!

Përsëri, në këtë kuadër, bëhemi dëshmitarë se një sërë persona besimtarë, duke u nisur nga shprehja e ajeteve të formës "... nuk mund të gjesht ndryshim në sunetin/zakonin e Allahut...",¹⁶⁹ dalin me pretendimin se "Allahu nuk e bën këtë punë". Duke iu përgjigjur një qëndrimi të tillë, ne themi po, në gjithësi ka ligje të Allahut që nuk ndryshojnë dhe paraqesin vazhdueshmëri, ndërkaq që, këto veprimtari që zhvillohen në linjën shkak-pasojë, nuk janë pengesë që Allahu të shfaqë një akt tjetër, të ndryshëm. Kjo ka të bëjë vetëm me anën që sheh nga ne, të çështjes. Për shembull, Allahu (xh.xh.) që ka vënë si sunet/zakon që, për sa u përket shkaqeve, fëmija të formohet nga bashkimi i nënës me babanë ose nga bashkimi i elementëve që përbëjnë shkak për formimin e fëmijës, e ka sjellë në botë Hz. Isanë (alejhissalatu vesselam) me anë të një akti tjetër, të ndryshëm nga suneti/zakoni i vënë prej Tij!

Këtu duam të theksojmë një specifikë shumë të rëndësishme: mrekullitë nuk janë zhvilluar në çdo vend në mënyrë që çdo njeri të ketë pasur mundësi çdo çast për t'i parë hapur e qartë për të mbetur i detyruar të besojë. Sepse, me aspektin e tyre që sheh nga njerëzit, mrekullitë janë për të fuqizuar besimin

¹⁶⁷ Shih. Buhari, Salat, 1; Muslim, Iman, 263; Nesai, Salat, 1; Ibni Maxhe, Ikame, 194.

¹⁶⁸ Shih. Buhari, Menakib, 27; Muslim, Sifatul-Munafikin, 44; Ibni Hanbel, Musned, I, 377.

¹⁶⁹ Shih. Ahzab, 33/62; Fatir, 35/43; Fetih, 48/23; Isra, 17/77.

e atyre që besojnë dhe për t'ua thyer kryeneçësinë në mohim të atyre që nuk besojnë për rrjedhojë, për t'i bindur ata, por jo për t'i detyruar dhe shtrënguar ata. Po të ndodhte kështu, atëherë ekzistenca e mendjes dhe arsyes e humbte kuptimin, njerëzve u merrej vullneti nga duart dhe detyroheshin me forcë të besonin, gjë që do të thoshte të eliminoreshin propozimi i adhurimit dhe e fshehta e provës, në përfundim të së cilës, mes Omerit shpirtmargaritar dhe Ebu Lehebit shpirtqymyr nuk do të kishte ndryshim, pra, njerëzit do të ishin të njëvlershëm në besim. Është për këtë arsye që një mrekulli e madhe si ndarja e hënës në dy pjesë është zhvilluar në një kohë të caktuar të natës, brenda një kohe të shkurtër dhe para syve të një numri të kufizuar njerëzish, për rrjedhojë, si për dëshmitarët e kësaj ngjarjeje, ashtu dhe për pasardhësit, as nuk është marrë e drejta e vullnetit të tyre për të zgjedhur, as nuk është mbyllur dera e mendimit dhe arsyetimit e mendjes së tyre.

b) Mrekullitë e përmendura në librat e hadithit

Në librat e hadithit janë rrëfyer dhe bërë të njohura shumë mrekulli të profetit Muhamed (alejhissalatu vesselam). Këto janë aq shumë, saqë, po t'i përmendnim të gjitha këtu, do të rritej vëllimi i këtij punimi, ne do të mjaftohemi të përmendim prej tyre vetëm ato më të njohurat dhe më të përhapurat. Këtu, jashtë mrekullive të përmendura në Kur'an, mund të rreshtojmë këto: rrjedhja e ujit nga gishtat¹⁷⁰, begatimi dhe shtimi i ushqimit të pakët¹⁷¹, shërimi i të sëmurëve e të të plagosurve¹⁷², përshëndetjet dhe dëshmitë e maleve dhe gurëve¹⁷³, pranimin në çast të lutjeve¹⁷⁴.

Një vlerësim mbi mrekullitë emotive/materiale

E shohim me dobi që, nën këtë nëntemë, të kujtojmë një specifikë. Edhe nëse mrekullitë e profetit Muhamed (alejhissalatu vesselam) si dhe mrekullitë e tjera nuk pajtohen me parimin e përputhshmërisë së shkaqeve¹⁷⁵, janë ngritur mbi një sërë shkaqesh. Për shembull, po që se do t'u hidhnim një sy mrekullive të shfaqura nga profeti Muhamed, një radhë, ai, për të plotësuar nevojën e ushtrisë së tij të mbetur pa ujë, bën që nga gishtat e tij të rrjedhë ujë si çurg, vetëm se, duke e shfaqur këtë mrekulli, ai i ka zhytur gishtat në një enë me ujë. Një radhë tjetër, Profeti përdori një dy grushte hurma për të ngopur rreth treqind sahabë, shokë të tij, duke i begatuar atë sasi hurmash në sajë të aktit krijues të Allahut. Nga të gjitha këto kuptojmë se, për sa kohë që çështja të mbetet brenda kuadrit të shkaqeve, Allahu (xh.xh.) nuk i eliminon shkaqet plotësisht. Edhe mrekullitë e dala nga profetët e tij, Allahu (xh.xh.) i favorizon me anë të shkaqeve të pjesshme dhe me këtë tërheq vëmendjen mbi rëndësinë e shkaqeve.

Si përfundim, jemi të detyruar edhe një herë tjetër që, me anë të provave dhe argumenteve racionale dhe logjike, ta përcaktojmë pozitën dhe ta vendosim vendin e profetit tonë (sal'lallahu alejhi vesel'lem) si në mendjen, ashtu dhe në jetën tonë. Sa të thellë që të jenë besimi dhe nënshtrimi ynë ndaj Tij, po aq do të jetë përfitimi ynë prej mesazhit dhe dritës së Tij!

¹⁷⁰ Shih. Buhari, Shurut, 15; Muslim, Fedail, 4-6.

¹⁷¹ Shih. Buhari, Ejman, 22; Muslim, Eshribe, 142.

¹⁷² Shih. Buhari, Fedailu's-Sahabe, 9; Muslim, Fedailu's-Sahabe, 34.

¹⁷³ Muslim, Fedail, 2; Buhari, Menakib, 25.

¹⁷⁴ Buhari, Istiska, 7; Muslim, Istiska, 1.

¹⁷⁵ Në origjinal: tenasüb-i illiyet. Përkthyesi.

... Dhe lajmëtari i fundit i të fshehtës

Fjalën e fundit për Allahun, gjithësinë dhe njeriun e ka thënë Hz. Muhamedi (sal'lallahu alejhi vesel'lem), bërthama e pemës së ekzistencës, qëllimi final i librit të gjithësisë dhe zëri më i kthjelltë i ftesës për tek e Vëreta (Zoti). Ai, lajmëtari i fundit i të fshehtës dhe i të fshehtës së të fshehtës, Ai, intepretuesi i pagabuar i materies dhe dukurive, Ai, parashtruesi, madje, në një mënyrë që të mos i lërë shesh ndonjë ngatërrese, i marrëdhënieve mes njeriut dhe Krijuesit dhe prapë Ai, përcaktuesi në mënyrë krejt të hapur e të qartë i domosdoshmërive të këtyre marrëdhënieve. Me një aspekt, ai është një udhërrëfyes afërsie i pari dhe më i afërti i Zotit, kurse, me një aspekt tjetër, i fundit por më i sigurti.

Engjëjt janë pritësit e tij, profetët, paralajmëruesit e ardhjes së tij dhe velinjtë, frytet e tij që marrin dritë prej tij. Pishtari i profetësisë u ndez në fillim me të, kurse kuptimi dhe përmbajtja në thelbin e profetësisë, me formën e saj më të ndritshme, prapë me atë është vënë në shesh. Drita e parë para çdo gjëje është drita e tij, kurse tufani i fundit i dritës është shfaqja e tij në botën e jashtme. Nga një këndvështrim tjetër, ai është indeksi i objektives dhe subjektives, esenca e ekzistencës, lëngu jetësor i saj, fryti më i ndritshëm i pemës së krijimit në kornizën e qëllimit dhe, në emër të Krijuesit të Lartë, zotëria i tërë njerëzve dhe xhindve.

Për nga esenca dhe pozita e tij, Ai është në çdo kohë i mbikarakterizueshëm; për nga individualiteti, i pashembëllyeshëm; për nga këndvështrimi i thellësive që i përkasin botës tjetër, i vetmi i kohës dhe hapësirës; për nga mesazhi në dorën e tij, një provë krejt e hapur. Ai njihet qysh para profetit Adem; drita e tij e bërë legjendë në gojët para trupit të tij, kurse hapi i tij - këmba na u bëftë kurorë e kokës - është një mirësi për të gjithë njerëzimin. Qenia e tij është margaritari më i kulluar i sedefit të trupit, kurse mesazhi i tij, më i përgjithshmi i të gjithë mesazheve. Dituria e tij është pika e fundit e të gjitha diturive, kultura e tij është një burim krejt i pastër rreth të cilit mblidhen fytyrat më të ndritshme, kurse horizonti i tij është në rolin e observatorit të shpirtrave të pastër që vrapojnë për ta vëzhguar pafundësinë. Në sajë të dritërave të shpërndara në çdo anë prej tij, sytë kanë gjetur rastin për ta vëzhguar materien me fytyrën e saj të vërtetë; me anë të melodikës së fjalëve të tij, veshët kanë dëgjuar kompozime hyjnore të padëgjuara nga elementi fjalë gjer atë ditë; shumë e shumë gjëra të fshehta kanë dalë në dritë në atmosferën e tij dhe mendimet e turbullta janë kthjelluar e kulluar. Atyre që e kanë parë dhe që e kanë dëgjuar, u është pastruar ndryshku në shpirt, u janë fshirë avujt para syve; me lajmet që ka dhënë në fillim fare e në fund fare janë ndriçuar të gjitha të panjohurat mbi njohjen njerëzore, paqartësitë janë shtruar një e nga një në truallin e kuptimit dhe tërë ekzistenca është shndërruar në një poezi të recituar dhe interpretuar nga këndvështrimi i qëllimit të krijimit dhe në një kompozim me pamje pafundësie.

Të gjitha dituritë janë vetëm një centimetërkub nga deti i dijeve të tij dhe urtësitë e përgjithshme, një pikë e vogël nga ujëvara e aftësisë së tij. Në raport me sekondat dhe mikrosekondat e jetës së tij, të gjitha kohët pothuajse një e dhjetë; me enigmën e të qenit vendlindje e tij, globi tokësor sa një thua në krahasim me gjithësinë, është një botë sa e gjithë ekzistenca. Ai, i pari në programin paracaktues dhe shfaqës, thënësi i fjalës së fundit në kauzën e profetësisë, sqaruesi i vërtetë i të jashtmes, njoftuesi i enigmës së të brendshmes. Me krijimin e përshtatshëm për të marrë nga Shpirti i Shenjtë të vërtetat diturore dhe racionale, me vetëdijen e gjerë, me aftësinë e lartë njohëse, me zemrën të hapur ndaj përtej botës engjëjllore dhe me të fshehtën e kapacitetit për të vëzhguar përtej botës së përtejme, ai është mbreti i fronit profetik, kurse, për sa i përket përcjelljes pa gabime në shpirtit dhe mendje të gjërave të marra

si të ishte një receptor drite i hapur ndaj botëve të përtejme, është interpreti më elokuent i botës profetike.

Duke i ruajtur veçoritë përkatëse të individualitetit të vet dhe siç ia kërkon profetësia, ai na e bën të njohur Zotin me individualitetin, atributet dhe emrat e Tij dhe zgjon tek ne ndjenjën e përgjegjësisë ndaj Tij; me këtë aspekt, ai është një përshkrues dhe një mësues i madh i cili na informon për të panjohurat dhe ua njofton shpirttrave tanë gjërat e pamundshme për t'u perceptuar dhe njohur. Kurse me aspektin e kumtuesit të konkluzioneve dhe urdhrave fetare, të zbatuesit të vlerave njerëzore dhe të përfaqësuesit të parimeve morale, ai është një shpjegues i emëruar, një ligjvënës dhe një zbërthyes me fjalë i të vërtetës së të vërtetave.

Profetët, dërgesa profetike si dhe ndjekësit dhe trashëguesit e këtyre, siç janë të hapur ndaj të jashtmes, janë “portëhapur” edhe ndaj të brendshmes. Madje edhe mendjet e tyre kanë kaluar nëpër një ngjyrosje me ngjyrën e kësaj nëpunësie hyjnore, qëndrojnë disa shkallë pas tyre dhe presin urdhrat e tyre. Një mendje që, si mendjet e tyre, e njeh veten dhe hyn nën kujdesin profetik, ndriçohet me “Shpirtin e Lartë” dhe shndërrohet në një dimension me rëndësi të së vërtetës njerëzore dhe, me kohë, fillon që, krahas të jashtmes, ta parandejë edhe të brendshmen, që, krahas të pames, ta ndjejë edhe të pasmen.

Ekzistenca ka edhe anën e vet të jashtme, edhe anën e vet të brendshme; e jashtma shihet me sy, ndihet me anë të organeve të shqisave dhe vlerësohet me anë të arsyes dhe gjykimit. Kurse e brendshmja u hapet nga ana e Allahut vetëm personave të krijuar me pajisjet e perceptimit të saj dhe e bën veten të ndihet si një zë, një frymëmarrje, një ngjyrë dhe një dizeno përtej dukjes dhe të jashtmes. Ja, këtë zë, këtë frymëmarrje e ndiejnë profetët me anë valëve me gjatësi të ndryshme gjatë gjithë jetës dhe gjithmonë sipas tyre e përcaktojnë gjendrimin e vet.

Për nga pajisja e posaçme sipas pozicionit të tij të posaçëm, Profeti Muhamed (alejhissalatu vesselam) është, në këtë çështje, simboli dhe zëri i një epërsie absolute. Me anë të njoftimeve të Allahut, ai i ndjen të pandjeshmet, i sheh të pashikueshmet; vende-vende, duke i marrë shpirti një cilësi mbikohore e mbivendore, kalon para qenieve shpirtërore, i kapërcen engjëjt adhurues më bujarë të Zotit dhe shkon e arrin gjer në horizontin e “largësisë sa dy harqe dhe më pak” ndaj Zotit. Sa ç'ka pjesë në lartësinë e Zotit, ai ka edhe po aq një konsideratë të pandërprerë e të palëkundur mes popullit. Gjatë gjithë jetës ai nuk është larguar as sa qimja nga e vërteta dhe ndershmëria dhe u ka ofruar siguri të gjithëve, me miq dhe armiq; mesazhet e marra nga Zoti ua ka paraqitur bashkëbiseduesve të vet me tërheqjen e hyjnës tek to; në çdo kohë është kujtuar me pafajësinë e tij, është njohur për paprekshmërinë e tij; me zgjuarsinë e tij të mprehtë dhe me shpirtin e tij të ndriçuar të hapur ndaj botëve fizike e metafizike, ai e ka lexuar dhe e ka interpretuar gjithmonë drejt natyrën dhe përtej natyrën, për rrjedhojë, pothuajse të gjithë shpirttrat e pastër e pa paragjykime kanë vrapuar për tek ai pa u lëkundur aspak; egot më kryeneçe para tij kanë rënë në gjunjë, kokat më të rralla kanë lexuar qëllimin e krijimit të mendjes dhe arsyes në mesazhin e tij dhe ia janë dorëzuar atij. Është në sajë të tij që njeriu, duke u çliruar nga shtazëria dhe materialja tek vetja e vet, është drejtuar për tek një horizont në nivelin e gradës jetësore të zemrës dhe shpirtit. Sipas horizontit të ekzistencës, ai është çelësi enigmatik i portës së hapur për tek qenia e jashtme dhe, në emër të realizimit të qëllimit të ekzistencës, prijësi i udhës së drejtë që shkon për tek Zoti, dhe ndërmjetësuesi i lumturisë së përjetshme.

Të gjithë profetët e ardhur gjer tek ai kanë thënë atë që ka thënë ai dhe të gjithë të urtët dhe shenjtoret e ardhur pas tij, me gjendjet e tyre të jashtëzakonshme si provë të kauzës së tyre, e kanë vërtetuar atë dhe kanë pohuar se meritat e tyre i kanë pasur prej tij. Sigurisht, nëse ai ka thënë “Allah” dhe i ka kthyer të gjitha shikimet kah besimi monoteist (tevhid), këtë e kanë mbështetur zëri e

frymëmarrja e të gjithë të dërguarve dhe profetëve, vëzhgimet dhe zbulimet e të gjithë të urtëve dhe shenjtorëve!

Ai ishte një monumenti i sigurtë besimi; ai i jetonte thëniet e veta gjer në imtësi, i rregullonte qëndrimet gjithmonë sipas botëve përtej dhe e jetonte jetën thellësisht sikur ta shihte Zotin dhe të shihej prej Tij; sillej më me ndjeshmëri se çdokush tjetër dhe me çdo gjendje të tij shpaloste një qëndrim serioz përgjegjësie; në çdo kohë vraponte pas përfundimit të pëlqyeshëm dhe, pa e ndarë qoftë edhe për një çast syrin prej synimit, vraponte gjithë po drejt pikës për të cilën ishte kandidat; vraponte dhe çdokujt i ofronte kuptime vijë për vijë nga ajo marrëdhënie e thellë mes tyre dhe Allahut!

Ai ishte që, duke e shpjeguar kuptimin e ekzistencës, e lidhte atë me të zotin e saj të vërtetë, që i nxirrte në shesh urtësitë dhe interesat në thelbin e marteries, ngjarjeve dhe dukurive, që na e kujtonte shpesh neve se nuk jemi të vetëm këtu, që, duke ua njoftuar shpirttrave tanë se shihemi e jemi nën vëzhgim të vazhdueshëm, na lëshonte përbrenda prehje e qetësi, që, duke na e zbutur egërsinë, na i entuziazmonte zemrat me afërsinë që na krijonte dhe na bënte të ndjenim me tërë qenien se ndodheshim në një vend si vatra atërore. Po qe se sot ne shohim e ndjejmë në këtë fole të ngrohtë se çdo gjë është përvijuar në vend të vet, po qe se zemra na rreh me pasionin e të vërtetës, po qe se bëjmë e vëmë diçka në shesh në emër të analizës dhe njohjes së ekzistencës, të gjitha këto janë pishtari që ndezi ai në mendjet tona. Pa dyshim, çdo gjë që dimë ne mbi njeriun, ekzistencën dhe të gjitha botët, të gjitha këto janë zhvillim në gjerësi dhe thellësi i përmbledhjes që ua bëri të njohur ai shpirttrave tanë!

Ai e ka strukturuar, e strukturon dhe do ta strukturojë njerëzimin për sa i përket të djeshmes, të sotmes dhe të ardhmes. Ne kemi besim të plotë se, ashtu siç i ndryshoi në kohën e vet në një hop, në një frymë, mendësitë perverse mijëravjeçare të skalitura në natyrën njerëzore, sjelljet antinjerëzore, refraktimet antimorale dhe të karaktereve, ai do t'i zotërojë herët a vonë masat popullore të ditëve të sotme të dala krejtësisht prej binarësh duke i bërë t'ia dëgjojnë fjalën, dhe do ta tregojë forcën e mesazhit të tij!

Profeti Muhamed (alejhissalatu vesselam) pati ardhur me një mesazh që kishte të bënte me çdokënd e me çdo gjë dhe që i interesonte çdokujt dhe çdo gjëje dhe, për sa i përket detyrës së tij, zotëronte një thellësi dhe tërheqje që do t'i mbushte zemrat dhe sytë. Në natyrën krijuese të tij dukej sheshit një tejet përkryerje, në sjelljet e tij, një cilësi bindëse e jashtëzakonshme, kurse në qëndrimet e tij, një cilësi sublime që e kalonte në çdo kohë aspektin material e fizik të tij. Pas këtyre linjave të jashtme e të dukshme që të merrnin sytë, ai zotëronte një moral aq të lartë, të cilësuar nga Kur'ani "huluku adhim", (moral i lartë), dhe të pamundësuar për askënd gjer atë ditë, që kush hynte qoftë edhe një herë të vetme pa paragjykim në atmosferën e tij, nuk mund të shpëtonte më nga ndikimi i tij. Krahës këtyre bukurive dhe epërsive, ai kishte një shprehje magjepsëse, para së cilës edhe mjeshtrit më të shquar të fjalës e gëlltitnin gjuhën kur fliste ai, zhyteshin në heshtjen e vështirimit nga vetvetja dhe e lëshonin veten në magjinë e shprehjeve të tij!

Po deshët, tani le t'i shtjellojmë edhe pak këto specifika. Allahu i kishte falur atij një gjerësi të ndërtimit të jashtëm e të brendshëm të tillë që, krahas të qenit jashtëzakonisht i thjeshtë e modest, ai ishte tejet impresionues dhe magjepsës; edhe shpirttrat më krenarë dhe kryelartë, madje, që hynin në praninë e tij, dridheshin përballë prezencës madhështore dhe impresionuese të tij dhe merrnin një pamje e qëndrim në kundërshtim me mendimin dhe qëllimin me të cilin kishin hyrë. Kur të dërguarit krenarë të Kistrës qenë përballur me atë monument impresionues, patën ngrirë në vend dhe patën harruar se ç'duhej të thoshin. Në të njëjtën kohë, krahas një madhështie dhe serioziteti të tillë, ai kishte një butësi të tillë që i magjepste të gjithë dhe i tërhiqte pas vetes, saqë çdo njeri që e njihte atë nga afër, ndjente për të afërsi më shumë se për fëmijët, prindërit dhe të afërmit, bëhej, pothuajse, i shtënë pas tij

dhe nuk donte të largohej më nga prania e tij. Me të gjithë qenien e vet, ai i premtojte mjedisit besueshmëri e siguri; me fjalët, qëndrimet dhe mimikën, tregonte në çdo kohë se ndodhej në praninë e Zotit të vet, vazhdimisht frymëzonte siguri dhe çdokujt i shpërndante tufë-tufë besim e siguri. Ai ishte bërë i njohur qysh në fillim si njeri i besueshëm dhe mbeti i tillë gjer në fund; në shikimet e tij, besueshmëria dhe siguria ishin të dukshme, fjalët e tij përsilleshin rreth besueshmërisë dhe pranë tij dëgjoheshin gjithmonë kompozime besueshmërie. Në të gjitha sjelljet e tij prinin arsyeja, shpirti, ndjenja dhe logjika e tij dhe konsideroheshin të barazvlershme me njëra-tjetrën. Zgjuarsia e tij e mprehtë, intuita që s’e gënjente kurrë, vendosmëria e tij e mbyllur ndaj çdo lloj lëkundjeje, qëndrueshmëria dhe vazhdueshmëria, strategjitë e tij marramendëse krahas faktit që s’gënjente njeri, fakti që nuk prapesej as para ngjarjeve më të vështira, që u qeshte në fytyrë fatkeqësive dhe, duke i lexuar drejt ngatërresat e kokëçarjet, nxirrte mësim sa libra të tëra, që sillej tejet gjakftohtë dhe tejet i matur ndaj sjelljeve të padenja që bëhen shkak për dhunë, zemërim dhe furi, janë vetëm disa prej veçorive që reflektojnë karakterin e tij mbinjerëzor, pozicionin e tij dhe qëndrimin e tij sipas atij pozicioni. Në ato raste kur gjithkush do të shqetësohej e kapej nga paniku, ai kishte një qëndrim burrëror të tillë, para të cilit disfatat ktheheshin në fitore, tërheqjet në rrëmujë ia linin vendin sulmit të organizuar dhe brenda pluhurit e tymit të mundjes përvijoheshin strategjitë e suksesit!

Mes pjesëtarëve të familjes, ai ishte një kryetar familjeje i pashoq. Mes shokëve, ai ishte një prijës dhe mësues i mrekullueshëm i cili, me qëndrimet e buta vëllazërore, dinte shumë mirë të futej në zemra. Ai ishte një udhëzues i pashoq që kurrë nuk i zhgënjente dhe nuk i thyente ata që i shkonin pas. Ai ishte një ligjërues mbret i fjalës, një mbinjeri me zemër burri, një gjykatës mjeshtër gjykimi, një kryetar shteti i mrekullueshëm dhe një specialist ushtarak që nxirrte fitore nga humbjet. Të gjitha këto përsosmëri arrinin tek ai kulmin, por, pavarësisht nga të gjitha këto, ai gjithmonë sillej si njeri i rrafshtë, e quante veten njeri si gjithë të tjerët, ndjente shqetësim të jashtëzakonshëm nga dedikimet e larta që, në fakt, i meritonte dhe që ishin rrjedhojë e edukatës së popullsisë dhe vende-vende i qortonte disi ashpër për këtë shokët e tij të zgjedhur që i donte aq shumë!

Ishte në pozitën e “qëllimit final” të ekzistencës, por nuk i jepte rëndësi kësaj as sa një krah mize. Megjithatë u falte frone dhe u vinte kurora mbretërve, vetë jetonte tejet i përkorë dhe e kalonte jetën në një asketizëm të jashtëzakonshëm sikur t’ia kishte kushtuar jetën agjërimit duke ia kundërvënë botës. Nuk hante por u jepte të tjerëve të hanin, nuk vishej por vishte të tjerët; për një thërrime dhunti bërtiste njëqind herë me falenderim dhe ulej e ngrihej gjithmonë me ndjenja mirënjohjeje. Përsa u përket ndjenjave të afërsisë, dashurisë dhe frikës ndaj Allahut, ai qëndronte në çdo kohë përkrah engjëjve; ndodhej në këtë botë, por nuk ishte i kësaj bote, ishte në rrugën e botës tjetër, ndërkaq që nuk kishte qysh në fillim lidhje personale me të sepse zemrën e kishte gjithmonë te Zoti, syrin, te shenjat e Tij, tek emrat e tij që u përfitonin shenjave ngjyrë, formë dhe variacione. Ai e shihte botën me një vështrim të thellë përjetësie, e shihte botën si një arë bujqësore: mbillte, korrte dhe të gjitha fitimet i vinte gjithmonë në fitim të botës përtej. Ashtu siç erërat i shpërndajnë farërat andej-këtej duke ia lënë amanet tokës që t’i ushqejë për të mbirë e për t’u zhvilluar, edhe ai shpërndante andej-këtej çdo gjë që kishte, kujdesej për të varfërit ushqente të uriturit kurse vetë shumë herë binte e ngrihej i uritur. Kur u nis i mbret i të dy botëve dhe arriti te Zoti i vet, nuk la pas pallate e vila, as pasuri e kapital, as dhe ndonjë mall për t’ua lënë grave dhe fëmijëve. Kishte jetuar si vetë ai, e kishte vlerësuar botën si vetë ai dhe kishte emigruar e ikur që këtej në një mënyrë që i kishte hije atij vetë! Sigurisht, ai erdhi në këtë botë si një udhëtar dhe, natyrisht, bota aspak s’e tërhoqi. Ai i jepte vlerë botës sa ç’e kishte vlerën, po kështu, edhe botës tjetër dhe përtej saj, sa ç’e kishin vlerën dhe mbante e shpaloste një qëndrim sipas kësaj.

Me gjithë atë madhështinë e tij impresionuese të prodhuar nga fisnikëria e jashtëzakonshme dhe lidhja me Zotin, e cila ia merrte mendtë kujtdo, Profeti ishte aq i thjeshtë e modest, sikur të kundërtat e

tij të jetonin së bashku në paqe, saqë ata që nuk i shihnin veçoritë e parashtruara ca më parë, e pandehnin ata si njërin prej njerëzve të thjeshtë. Duke bërë sikur s'i shihte nderimet dhe respektet e shumta që i bënin shokët, rrinte mbi një truall me ta, hante në të njëjtën sofër, dallimet dhe veçoritë e veta i mbulonte që të mos dukeshin sikur kjo të ishte një çështje nderi dhe, për të mos i turbulluar me madhështinë dhe impresionimin e natyrës së vet ata që i ndodheshin pranë, herë-herë i lehtësonte dhe qetësonte ata me shaka të holla, të bukura e mësimdhënëse, dinjitetin e stoliste me thjeshtësi dhe modesti, madhështinë dhe karakterin impresionues e zbuste me dhembshuri dhe, duke e nxjerrë ngjyrën e vet njerëzore në plan të parë, i shtonte një ëmbëlsi tjetër asaj pozitës së vet kënaqësiindjellëse!

Ai ishte gjithmonë i butë, paqësor dhe i ekuilibruar. Edhe në situatat kur nxiten dhe ndizen ndjenjat e urrejtjes, armiqësisë dhe zemërimit, madje, sillej jashtëzakonisht butë, ua zbuste furinë dhe ashpërsinë njerëzve që shkumëzonin me tërbim, armiqtë më të betuar i qetësonte me një lëvizje dhe dinte që, edhe atje ku kërkohej të vihej në pozitë kundërshtare, të ulej papritmas në kolltukun e gjykatësit! Pothuaj në çdo vend ku nuk shkelej e drejta e përgjithshme, ku nuk tregohej mungesë respekti ndaj të drejtës së Allahut, ai sillej tolerant dhe falës dhe në biografinë profetike mund të shihen e të tregohen me qindra shembuj të mirëkuptimit, tolerancës dhe faljes së tij!

Edhe në besnikërinë ndaj fjalës së dhënë ai s'kishte shok e s'kishte të ngjarë. Nuk qe parë ndonjëherë të mos e mbante premtimin, nuk pati ndodhur qoftë edhe një herë të vetme ta kthente fjalën. As para profetësisë, as pasi u nderua me detyrën profetike, kurrë nuk e ktheu fjalën ndërsa është i njohur qëndrimi i tij i vendosur kundër atyre që nuk njihnin marrëveshje e betim, kurrë nuk bëri ndonjë deklaratë kontradiktore, madje as aludoi për këtë, dhe jetoi si një përmendore besnikërie dhe sigurie.

Ai ishte mbreti i fjalës dhe shprehjes, tek ai e pati gjetur vlerën e vërtetë margaritari i fjalës. Ai nuk pati marrë në dorë as penë e as bojë, nuk qe njohur me asnjë libër, nuk qe ulur në rrethin mësimor të askujt, nuk pati mbetur i detyruar ta quante mësues e mjeshtër askënd dhe kurrë nuk pati lejuar të hidhej pluhur mbi faktin që vetë ishte kryemësuesi dhe kryemjeshtri i përgjithshëm. Në lidhje me interpretimin e urdhrave hyjnorë, kjo do të thoshte që Allahu i mbronte së pari urdhrat e veta dhe, pastaj, aftësitë natyrore të Profetit nga ndikimet dhe konsideratat e jashtme me qëllim që arritjet mendore dhe informacionet e jashtme të mos e turbullonin çështjen dhe të mos e derdhnin në ngjyra dhe kallëpe të tjera. Ja, në këtë kuptim ishte i pamësuar ai, në këtë kuptim s'dinte të shkruante e të lexonte ai që i qoftë falë jeta jonë, se, sa për punët që kishin të bënin me këtë botë e me botën e përjetësisë, në çdo fushë të tyre, si kryemësuesi i përgjithshëm që ishte, ai pati thënë fjalë të tilla, pati parashtruar konkluzione të tilla dhe, kur pati qenë vendi, pati marrë vendime të tilla që, nga dijetarët e shumëditur te gjenitë më të zgjedhur, nga kokat më filozofike te shpirtrat më të ndritshëm, çdo njeri mbetej pa mend para atyre fjalëve, atyre konkluzioneve dhe atyre vendimeve! Historia është dëshmitare se askush s'pati thënë dot ndonjë gjë kundër forcës shprehëse të tij, s'e pati gjykuar dot asnjë konkluzion të tij dhe s'pati marrë guximin për ta kritikuar asnjë punë të tij!

Ai ishte një basen dhe thesar niformacioni dhe dijeje me tërë përmbajtjen të pastër e të kulluar, i tillë që nuk u përball me asnjë kundërshtim as në njoftimet që dha për ngjarjet e përhirosura të së kaluarës, as në informacionet lidhur me fenë, kulturën, traditat dhe zakonet e popujve të ndryshëm prehistorikë; dhe s'mund të përballej, sepse ai ishte i dërguari i Allahut dhe ai informacion që s'të gënjente, i cili pikonte në basenin e dijes së tij, vinte gjithë po prej Allahut. Në shprehjet e tij ai ishte një mbret shprehjeje që ta pret fjalën; në logjikën e tij ai ishte një përmendore gjykimi dhe, në mendimet e tij, ai ishte një oqean sa gjerësia e misionit të vet. Shprehjet i kishte aq të epshme, deklaratën e kishte aq të qartë, stilin e kishte aq të pasur e me nuanca, saqë, disa herë, me një a dy fjali u parashtronte bashkëbiseduesve menjëherë të vërteta sa bota, disa herë, çështje të gjera që nuk do t'i merrnin dot as

volume të tëra, i shtrëngonte në një frymë fjalësh, kurse disa herë, ç'margaritarë fjalësh u linte amanet mjeshtrave të komentit dhe interpretimit për t'i komentuar dhe interpretuar! Ja, këtë gjerësi të tij shënonin fjalët që thoshte ai për vete: "Mua më është dhënë përmbledhja e fjalës"¹⁷⁶!

Në çdo kohë atij i drejtoheshin njëqind lloj pyetjesh nga njëqind drejtime, kurse ai u jepte përgjigje të gjitha pyetjeve aty për aty, pa rënë në ndonjëfarë lëkundjeje. Në bisedat e tij ai përdorte një stil që mund ta kuptonte shumica dërrmuese dhe e parashtronte synimin e fjalës me një shprehje mjaft lakonike por tejet të pastër e të kulluar larg çdo lloj loje fjalësh dhe stërhollimesh dhe pa u dhënë shkak lojrave të fjalëve dhe stërhollimeve. Ai bisedonte në një nivel që mund të përfitonte çdokush, dijetar apo injorant, i zgjuar apo kokëtrashë, pak i mësuar apo shkencëtar, i ri apo plak, grua apo burrë dhe në zemrën e bashkëbiseduesve lindte patjetër ngopje e kënaqësi!

Ai ka biseduar shumë, ka mbajtur shumë predikime, në shprehjet e tij u ka hyrë çështjeve të ndryshme, ka analizuar tema të ndryshme, por gjithmonë ka menduar dhe folur në përputhje me realitetin. Mbi shprehjet dhe ligjëratat e tij nuk ka rënë as hija e shprehjes kontradiktore, aq sa, edhe armiq të tij të betuar, madje, që e ndiqnin pa pushim dhe ruanin rastin për ta goditur, kurrë nuk e akuzuan për gënjeshtëri dhe nuk mundeshin ta akuzonin!

Në të vërtetë, të mendosh se është e mundur që një njeri i cili nga fëmijëria në rini e, që në atë kohë, gjer në moshën dyzet vjeç, e ka ruajtur me një ndjeshmëri të jashtëzakonshme gjuhën e vet nga deklaratat kontradiktore, siç e pati ruajtur edhe pothuaj çdo sjellje të vet, pra që ky njeri të ngrihet e të pretendojë padrejtësisht për profetësi pasi i kanë kaluar në këtë mënyrë të ndershme dy të tretat e jetës, është, përtej mëkatit, një fanatizëm i hapur mohimi e herezie dhe një mungesë respekti ndaj mendjes dhe logjikës. Kurse fjalët që thoshte ai, konkluzionet që parashtronte ai, ishin jashtëzakonisht me vështirësi të gjerë në atë mënyrë që e përfshinin edhe aktualitetin, edhe të djeshmen dhe të ardhmen e asaj dite, kurse përmbajtja e tyre ishte aq e shumëllojshme sa ta kapërcente një mendje njerëzore. Ai fliste lidhur me bindjen dhe besimin, parashtronte konkluzione mbi adhurimin, thoshte fjalë që kishin të bënin me tema shoqërore, ekonomike, ushtarake dhe administrative, i zbatonte në praktikë ato që thoshte, merrte fryte nga zbatimet në praktikë dhe, duke e shënuar në histori drejtësinë e parimeve që kishte sjellë, ua linte amanet ato ndërgjegjeve të matura dhe pa paragjykime. Pastaj, pas tij, mijra interpretues, mijra mendimtarë, qindra filozofë dhe dhjetramijra shkencëtarë specialistë të shumë fushave, u thoshin "po" dhe u vinin firmën fjalëve që kishte thënë ai, parimeve shoqërore dhe ekonomike, disiplinave ushtarake dhe administrative dhe rregullave edukative të parashtruara prej tij; veç këtyre, miliona të urtë e shenjtore, duke e vërtetuar atë në çdo konkluzion dhe deklaratë, njoftonin me të madhe se kishin arritur nivele të larta nën udhëzimin e tij. Prandaj, ai që i thotë "jo" atij, gjithsesi duhet të jetë ose një i paekuilibruar që s'di se ç'thotë, ose një i pafat që ia kanë larë trurin, sepse as dje e as sot, askush nuk ka thënë dot mbi kaq shumë çështje të ndryshme nga njëra-tjetra, qoftë edhe një fjalë të vetme që mund të mbetet e freskët gjer në këtë masë, dhe nuk ka dhënë dot konkluzione të pandryshueshme, sidomos kurrë mbi tema që kërkojnë specializim! Para së gjithash, siç e ka thënë edhe Bediuzzamani, një njeri, sado kapacitet i lartë që të jetë, mund të thotë fjalë konsekuente vetëm në disa shkenca dhe në disa fusha. Kurse ky person fliste për punë aq të imta lidhur me tërë ekzistencën dhe dukuritë, të vlefshme në të gjitha kohët dhe vendet, i parashtronte thëniet e tij me një stil aq mjeshëtor dhe kompetent dhe fliste aq i sigurtë në vetvete dhe pa lëkundje, sa që e bënte këdo që e shihte, e njihte dhe ia vinte veshin dhe e dëgjonte atë pa paragjykim, të thoshte: "po, ke të drejtë, ashtu është!"¹⁷⁷

¹⁷⁶ Në original: cevâmiu'l-kelim, aftësia për t'u shprehur në mënyrë lakonike e koncize. Përkthyesi.

¹⁷⁷ Në original: amenna. Përkthyesi.

JETA E PAFUNDME PAS VDEKJES

1. Koncepti *ahiret*

a) Kuptimi leksikor i fjalës *ahiret*

Fjala *ahiret* është femërorja e emrit foljor *ahir* () me prejardhje nga rrënja *ehr* (). Kjo fjalë që është mbiemër me kuptimin *i pasëm* si antonim i fjalës *i evvel, i përparëm*, e ka shumësin *evahir* ().

Bëhen dy shpjegime për emërtimin *ahiret*. Sipas shpjegimit të parë, *ahiret* quhet bota e pasme e cila vjen pas jetës së kësaj bote. Sipas shpjegimit të dytë, bota ku ndodhemi bashkë me të gjitha qeniet në të dhe dimensionin jetësor që na rrethon aktualisht, quhet "e tashme" (dunja), kurse bota tjetër pas kësaj, quhet "e pasme, e pastajme" (*ahiret*).

b) Kuptimi terminologjik fetar i fjalës *ahiret*

Fjala *ahiret* është përdorur në Kur'an si emërtim i një dimensionit të ri jetësor të pafund pas jetës së kësaj bote. Këtë e tregon fakti që për jetën e parë është përdorur fjala "úlá" (i pari, e para, e tashmja), kurse për jetën e dytë, fjala "áhir" (i pasmi, e pasmja).¹⁷⁸

Në veprat e kelamit, apologetikës islame, termi *ahiret* është përkufizuar kështu: *Ahireti* është jeta e dytë që do të fillojë pas shpërthimit të kiametit¹⁷⁹ dhe do të vazhdojë pafundësisht, ku përfshihen të gjitha ngjarjet dhe etapat e quajtura ringjallje (*ba'th*), grumbullim (*hashr*), llogaridhënie (*hesap*), peshore (*mizan*), ndërmjetësim për falje (*shefaat*), ura (*sirat*), parajsë (*xhenet*), ferr (*xhehenem*).

Në fakt me vdekjen e një njeriu, fillon për të *ahireti* i tij, i cili vazhdon pafundësisht. Sipas kësaj, ndërsa një pjesë e njerëzve jetojnë dimensionin jetësor të kësaj bote, një pjesë tjetër kanë hyrë dhe ndodhen në dimensionin jetësor të *ahiretit*.

2. Ahireti në Kur'an

për sa i përket mundësisë dhe domosdoshmërisë së tij

¹⁷⁸ Shih Lejl, 92/13: Ve inna lená lel áhirete vel úlá (Dhe, pa dyshim, tonat janë edhe e pasmja, edhe e tashmja!). Duha, 93/4: Ve lel áhiretu hajrul leke minel úlá (Dhe e pasmja është, për ty, më e mirë se e tashmja!). Përkthyesi.

¹⁷⁹ Katastrofës së përgjithshme. Përkthyesi.

Çështja e ringjalljes pas vdekjes dhe e marrjes në llogari të njeriut për ato që ka bërë, ka qenë dhe vazhdon të jetë një nga temat që e kanë preokupuar mendjen e njeriut qysh nga kohët më të vjetra, ndërkaq që mendimet pranuese dhe mohuese të kësaj janë alternuar vazhdimisht me njëra-tjetrën.

Historia njerëzore është bërë skenë e pikëpamjeve dhe qëndrimeve të ndryshme lidhur me çështjen e ringjalljes dhe jetës së pasme (ahiret). Gjëja, në një farë mase, më e çuditshme për njerëzit të cilët nuk e kanë ruajtur dot natyrën origjinale të krijimit, ka qenë njoftimi i një profeti se njeriu do të ringjallet pas vdekjes.

Shpesh herë, mrekullia e jetës ku ndodhet nuk ia ka frymëzuar njeriut të larguar prej vijës së natyrshmërisë së krijimit të vërtetën se jeta e pastajme do të jetë më e lehtë dhe më e thjeshtë. Në fakt, megjithëse çdo gjë dhe çdo dukuri flet vazhdimisht për këtë të vërtetë, ky tip njerëzish nuk e kanë dëgjuar ose nuk kanë dashur ta dëgjojnë ngaqë e kanë lëshuar veten në moskokëçarje dhe indiferentizëm. Prandaj, shumë njerëz u kanë kthyer shpinën atyre që ua kanë tërhequr vëmendjen dhe i kanë paralajmëruar për jetën e pasme, ahiretin, dhe, duke u kapur pas iluzionit se kiameti dhe jeta pas tij nuk kanë për të ndodhur, kanë zënë rrugën e mohimit. Duke e shprehur këtë situatë ku kanë rënë këta njerëz, Kur'ani thotë kështu:

"Dita e kiametit do të vijë patjetër dhe për këtë nuk ka dyshim, por shumë njerëz nuk e besojnë!" (Mumin, 40/59)

a) Faktorët shkaktarë të mohimit të ahiretit

Me synimin që kjo temë të kuptohet më mirë, do të ishte e dobishme që, para se të kalonim te mundësia dhe domosdoshmëria e jetës së ahiretit, të qëndronim shkurt mbi faktorët që i shtyjnë njerëzit në mohimin e ahiretit.

Në të kaluarën dhe në ditët e sotme, shumë njerëz nuk janë druajtur të flasin vazhdimisht mbi ahiretin për të cilin s'kanë ditur gjë, dhe, duke pretenduar se nuk kanë mundur ta rrokin jetën pas vdekjes me anë të mendjes dhe aftësisë njohëse, nuk janë prirur për ta pranuar atë.

Në këtë kuadër, shihet se në Kur'an i ofrohen vështirimit një sërë shkaqesh si përsa u përket faktorëve lidhur me *nënvleftësimin e mendimit dhe arsyes*, si dhe për sa u përket faktorëve *subjektivë* që kanë çuar në mohimin e jetës së pasme, ahiretit.

Sipas Kur'anit, ata që s'i besojnë ahiretit nuk kanë asnjë argument që të kënaq. Ndërkaq, mohuesit, ngaqë nuk e konceptojnë dot ahiretin me vështirimet e tyre sipërfaqësore ose ngaqë nuk tregojnë vendosmërinë e duhur dhe nuk bëjnë përpjekjet e nevojshme për ta konceptuar atë, nuk kanë mundur ta përballojnë shtysën për të hedhur në shesh shumë pretendime. Faktorët që i kanë shtyrë dhe i shtyjnë këta njerëz në mohimin e jetës së pasme, ahiretit, mund të përmbliidhen nën këto tema e nëntema:

a-1 Faktorët lidhur me nënvleftësimin e mendimit të drejtë

Vlerësimi sipërfaqësor dhe me paragjykim

Njeriut i jepen informacione dhe njohuri të njëpasnjëshme si me anë të profetëve, ashtu dhe me anë të gjuhës së dukurive dhe ngjarjeve që ndodhin në gjithësi. Lidhur me këtë specifikë, në një ajet të Kur'anit thuhet kështu:

"... Atyre u vijnë njohuri të njëpasnjëshme mbi ahiretin, por ata janë në dyshim për këtë; ç'është e drejta, ata janë të verbër ndaj kësaj!" (Neml, 27/66)

Ky ajet tregon se, pavarësisht nga bollëku i argumenteve dhe provave mbi ahiretin, në këtë çështje, te një sërë njerëzish nuk është formuar asnjë akt informativ dhe ideor për shkak se veprojnë në injorancë dhe verbëri.

Kur'ani u ka folur njerëzve duke marrë për bashkëbisedues mendjen dhe arsyen e tyre. Fakti që në shumë vende të Kur'anit përdoret shprehja "ulu'l-erbab"¹⁸⁰ që do të thotë posaçërisht "zotërues të mendjes (arsyes) së padëmtuar nga kufizimi dhe subjektivizmi", është shembulli më i hapur i kësaj. Sepse me anë të mendjes (arsyes) dhe vullnetit realizohet njohja e diçkaje dhe, si rezultat i kësaj, dhënia e vendimit përfundimtar. Duke u nisur nga kjo mund të thuhet se meditimi në kuptimin kur'anor është përdorimi i mendjes (arsyes), në ecurinë e kërkimit të së vërtetës, në mënyrën më të mirë dhe në vendin e duhur. Vetëm me anë të një meditimi të tillë mund ta shohë mendja (arsyeja) të vërtetën pas njohurive të arritura.

Arsyetimi mbështetur në pandehmën dhe supozimin

Mohuesit s'kanë në dorë asnjë mbështetje shkencore mbi mosqenien e një jete tjetër në fund të kësaj jete. Mendimet sipas të cilave njeriun e asgjëson vetëm koha dhe se prej tij nuk mbetet pas tjetër gjë veç dheut e pluhurit, në të vërtetë, nuk janë gjë tjetër veç pandehma apo supozime të mohuesve të ahiretit. Ata nuk mund të shkojnë më tutje se të thonë "ne nuk e dimë se ç'do të ndodhë pas kësaj jete; njeriu, krejt si një orë, me kohë ndalon dhe asgjësohet"! Në të vërtetë, pretendimet e tyre nuk kanë ndonjë themel racional dhe logjik, por ata ashtu dëshirojnë të jetë!

Kur'ani e parashtron qartazi me këtë ajet faktin që shumica e mohuesve mbështeten në pandehmën dhe supozimin si shfaqje të parapëlqimit prej tyre të nënvleftësimit dhe injorancës: "Shumica e mohuesve kapen vetëm pas një pandehme (dhe supozimi). Kurse pandehma nuk pohon diçka mbi të vërtetën!" (Junus, 10/36)

Fushat në të cilat njeriu flet duke u mbështetur mbi supozimin, në të vërtetë, nuk janë fushat ku ai ka informacion dhe njohuri. Prandaj kurrë nuk është e mundur që njeriu ta arrijë të vërtetën në një specifikë ku nuk ka njohuri pa u mbështetur në asnjë bazë, duke ndjekur një pandehmë të përbërë prej dëshirash dhe iluzionesh.

Prirja për imitim

Siç ndodh në shumë çështje të tjera, edhe në çështjen e jetës së pasme (ahiretit), një rol të madh ka fakti që njerëzit, pa e vënë veten në mundim për të mësuar nëse janë të drejta apo jo njohuritë që bëhen shkak për rrëshqitjen e tyre në mohim, kapen pas mendimeve të atyre që kanë në krye ose të atyre që

¹⁸⁰ Shih Bakara, 2/179, 197, 269; Al-i Imran, 3/7, 190; Maide, 5/100; Jusuf, 12/111; Rad, 13/19; Ibrahim, 14/52; Sad, 38/29, 43; Zumer, 39/9, 18, 21; Gafir (Mumin), 40/54; Talak, 65/10.

përbëjnë shumicën. Me ajetin në vijim, Kur'ani tërheq vëmendjen për faktin që ata që imitojnë të parët pa u mbështetur në asnjë argument, shkojnë, porsi ata, në mohimin e ahiretit:

"Jo, ata përsërisin thëniet e të parëve të tyre. Të parët e tyre patën thënë: "A mos vallë do të ringjallemi pasi të vdesim, të bëhemi dhé dhe një grumbull kockash? Betohe mi se edhe ne, edhe etërit tanë më parë jemi kërcënuar! Kjo s'është gjë tjetër veç përrallave të të tjerëve më parë!" (Muminun, 23/81-83)

a-2 Faktorët subjektivë

Mes shkaqeve që çojnë në mohimin e jetës së pasme (ahiretit), Kur'ani përqëndrohet edhe mbi një sërë faktorësh subjektivë. Këto pika mbi të cilat Kur'ani është përqëndruar me përparësi, parimisht mund të përmbledhen nën tri tituj: 1) dashuria për këtë botë e kthyer në pasion; 2) dëshira për t'i vazhduar në mënyrë të pandërprerë harbinin (sjelljen e tepruar e të shfrenuar) dhe kërkesat seksuale; 3) mendjemadhësia ose krenaria.

Tani do të përpiqemi t'i shqyrtojmë dhe vlerësojmë këto shkurt.

Dashuria për këtë botë e kthyer në pasion

Dashuria për këtë botë dhe për jetën është e pranishme në krijimin e njeriut.¹⁸¹ Njeriu mundet t'i kënaqë me të tepërt në kornizën e hallallit¹⁸² nevojat, dëshirat dhe kënaqësitë e tij. Korniza e hallallit është e mjaftueshme për kënaqësitë pa pasur nevojë për të shkuar te gjërat dhe veprimet haram. Këtu, për sa i përket kuptimit më të qartë të çështjes, duam të bëjmë fjalë për qëndrimin shumë origjinal dhe të këndshëm të Bediuzzamanit lidhur me këtë botë. Kjo botë ka tri fytyra:

Aspekti i parë: Kjo botë është një galeri artesh ku shfaqen emrat e Allahut. Sendet dhe dukuritë që ndodhin në botë janë si pasqyra ku reflektohen emrat e Allahut. Çdo qenie është një art i mrekullueshëm i Allahut, një libër, një letër e tij. Kjo fytyrë e botës është mjaft e bukur dhe e denjë për t'u dashuruar.

Fytyra e dytë: Sheh në jetën e pasme, ahiret. Është, në këtë botë, ara ku mbillet ahireti. Rruga që shkon për në jetën e pasme, ahiret, kalon nga kjo botë. Ahireti fitohet me vlerësimin e kësaj bote në kornizën e kënaqësisë dhe pëlqimit të Allahut. Edhe kjo fytyrë, si e para, është e bukur. Është e denjë jo për përbuzje, por për dashuri.

Fytyra e tretë: Është fytyra që sheh vetëm nga ndjenjat e njeriut, që është perde idiferentizmi dhe pengesë për njohjen dhe lodër e ndjenjave dhe pasioneve të atyre që janë dhënë pas kësaj bote. Kjo fytyrë është e shëmtuar. Është e përkohshme, kalimtare, dhimbëse, gënjeshtare.¹⁸³

Kur çështjen e shohim nga ky këndvështrim, e kuptojmë se fakti që njerëzit të cilët kapen vetëm pas fytyrës së shëmtuar të kësaj bote dhe shohin në të çdo gjë, kridhen në kënaqësinë e kësaj bote, mendojnë vetëm për këtë botë pavarësisht nëse është e gjatë apo e shkurtër, priren vetëm pas kësaj bote

¹⁸¹ Këtë specifikë Kur'ani e prek me këtë ajet: "Dëshira dhe pasioni për grua, fëmijë, ar dhe argjend me shumicë, kuaj të mësuar, kafshë dhe të mbjella u janë bërë njerëzve të stolisura (tërheqëse)!" (Al-i Imran, 3/14)

¹⁸² Korniza e hallallit: korniza ku futen gjërat legjitime, të lejuara, të miratuara e të bekuara.

¹⁸³ Shih. Said Nursi, Sözlür, f. 862.

dhe lidhin shpresa të pafundme ndaj saj, është njëri nga shkaqet që i çon ata në mohimin e jetës së pasme, ahiretit!

Duke aluduar pikërisht për faktin që pasioni pas kësaj fytyrës së shëmtuar të kësaj bote e bën njeriun ta harrojë përtejvdekjen, Kur'ani thotë kështu në një ajet: "Ata i gënjeu jeta e kësaj bote."¹⁸⁴ Menjëherë pas këtij ajeti të sures Araf theksohet se ata e kanë harruar se do ta shohin ahiretin.¹⁸⁵ Kështu, tërhiqet vëmendja për faktin se si kënaqësitë e kësaj bote të shndërruara në pasion e bëjnë njeriun që të mos jetë në gjendje të mendojë dhe arsyetojë.

Për njerëzit e kënaqur me jetën e kësaj bote dhe të mbërthyer pas saj është mjaft e vështirë të mendojnë dhe arsyetojnë mbi një jetë tjetër të gjithmonshme dhe më të lartë. E shprehur ndryshe, Është e vështirë që mendimi i atyre që e bëjnë këtë botë qëllim të ekzistencës së tyre, të zgjatet përtej saj!

Dëshira për t'i vazhduar në mënyrë të pandërprerë

harbimin (sjelljen e tepruar e të shfrenuar) dhe kërkesat seksuale

Veçoria më e shquar e përdhunuesve që nuk njohin drejtësi dhe kufi, si dhe të atyre që janë të shtënë pas mëkatit, është mohimi i ditës së llogarisë. Këtë specifikë, Kur'ani e shpreh me fjalët "Ditën e llogarisë nuk e mohan tjetërkush veç atij që ka kapërcyer çdo kufi!" (Mutaffifin, 83/12)

Qëndrimet dhe sjelljet mbi këtë çështje të atyre që e mohojnë jetën e pasme, ahiretin, janë, në të vërtetë, përpjekje për të shpëtuar nga ndikimi i detyrës dhe përgjegjësisë. Njerëz të tillë përpiqen të ngushëllojnë veten e të qetësohen duke e përgënjeshtruar ditën e ahiretit. Kur u kujtohen mesazhet hyjnore që u njoftojnë ekzistencën e jetës pas vdekjes, ata përgjigjen duke thënë se "këto janë sajime të popujve të mëparshëm, janë thënie të përcjella prej tyre, janë gjëra pa bazë që nuk e vlen të merresh me to!" Ja si thuhet në Kur'an:

"Dhe, kur u këndohen ajetet tona (që i njoftojnë të vërtetën e ringjalljes), thotë: "Janë përrallat e të vjetërve!" (Mutaffifin, 82/13)

Siç shihet, meqë këta njerëz të mësuar për t'i plotësuar dëshirat epshore sipas qejfit pa e menduar aspak fundin e asaj që bëjnë si dhe për ta shkelur drejtësinë njerëzore, do t'u prishej qejfi po ta besonin ditën e ndëshkimit (ditën kur do t'u jepet përgjegjësja e punëve që kanë bërë), e kanë gjetur rrugëdaljen sipas vetes me fjalët "janë përrallat e të vjetërve" me kuptimin se dita e fesë (dita e llogaridhënies) është pa bazë.

Ajo çka i shtyn mohuesit të thonë kështu, janë punët që kanë bërë. Ata kanë vazhduar në këtë rrugë gjersa u janë ngurtësuar zemrat. Ngaqë i kanë bërë mëkatet shprehi, zemrat e tyre janë nxirë si pasqyra që kanë zënë ndryshk, më në fund, e kanë humbur aftësinë për ta parë dhe treguar të vërtetën.

Gjendja e tipave që e mohojnë jetën e pasme, ahiretin, trajtohet kështu në një ajet tjetër:

"Por njeriu, duke e parë rrugën para vetes të hapur, kërkon të vazhdojë në mëkat dhe pyet: "Kur është ajo dita e kiametit?" (Kijame, 75/5-6)

Ky ajet e shpjegon shkakun bazë, motivin e fshehur në shpirt të mohimit të ahiretit. Njeriu kërkon të zhytet në epshe, të drejtohet në gjëra dhe veprime jolegjitime (haram), por mes tij dhe dëshirave të

¹⁸⁴ En'am, 6/130. Veç kësaj, shih A'raf, 7/51; Lukman, 31/33; Fatir, 35/5; Al-i Imran, 3/185; Hadid, 57/20.

¹⁸⁵ Shih. A'raf, 7/51.

veta futet ideja e ringjalljes pas vdekjes dhe llogaridhënies. Meqë njeriu dëshiron që asgjë të mos e pengojë nga këto kënaqësi, kërkon ta fshijë nga mendja e ta hedhë tutje idenë e ringjalljes pas vdekjes.

Mendjemadhësia dhe krenaria

Shohim se një faktor tjetër që e çon njeriun në marrjen e një qëndrimi negativ në momentin e pranimit të jetës së pasme, ahiretit, është mendjemadhësia. Mendjemadhësia që do të thotë që njeriu të fryhet e ta shohë veten lart, është, në përgjithësi, qëndrimi kryeneç dhe një shkak për t'i mbuluar dritaret e natyrës krijimore të njeriut të hapura për kah Krijuesi. Faktin që mohuesit e ahiretit janë më shumë persona mendjemëdhenj dhe krenarë, Kur'ani e shpreh kështu me gjuhën e Hz. Musait (alejhissalatu vesselam):

"Dhe Musai tha: "Unë mbështetem te Allahu, Zoti juaj dhe imi, nga çdo mendjemadh që nuk i beson ditës së llogarisë!" (Mumin, 40/27)

Mendjemadhësia është një perde që e mbulon, që e verbon tej pamësinë. Prandaj, ndërgjegjja e mbuluar me mendjemadhësi nuk ka mundësi as t'i shohë mrekullitë e shkruara fletë-fletë në gjithësi, as ta pranojë ekzistencën e një jete përtej vdekjes, sepse, kur tej pamësia verbohët, edhe syri (shikimi) nuk vlen për gjë. Kur'ani bën të ditur se zemra e fryrë me krenari dhe nefsi (egoja) i mbajtur më të madh nuk do të bindet për të vërtetën e ahiretit dhe nuk do t'i nënshtrohet asaj:

"Sa për ata që nuk i besojnë ahiretit, zemrat e tyre janë mohuese, kurse vetë, persona që mbahen më të madh!" (Nahl, 16/22)

Duke mos ua pranuar mendjemadhësia adhurimin ndaj Allahut dhe trajtimin si rob të Allahut, këta nuk kanë pranuar t'i dëgjojnë bazat e besimit të kumtuara nga profetët dhe kanë dalë kundër tyre. E shprehur ndryshe, këta mohues që nuk duan ta pranojnë të vërtetën, e kanë lëshuar veten pas një kauze madhështie abstrakte dhe pas një fantazie madhështie të thatë.

b) Metodat vërtetuese të Kur'anit mbi mundësinë e ringjalljes

Argumenti dhe garancia më e madhe mbi realizimin e jetës së ahiretit është premtimi i Zotit për robtë e vet. Duke theksuar në shumë vende se çdo nefsi (frymë, vete, ego) do të vdesë,¹⁸⁶ se nuk do të mundet të iket nga vdekja,¹⁸⁷ se Allahu është ai që e jep vdekjen¹⁸⁸ dhe se, në fund, kthimi do të jetë te Ai,¹⁸⁹ Kur'ani bën të ditur se ringjallja pas vdekjes është domosdoshmëri e premtimit të Allahut:

"Ajo që po ju premtohet juve është, jashtë çdo diskutimi, e vërtetë! Nuk ka asnjë dyshim se edhe llogaridhënia, edhe ndëshkimi do të realizohen patjetër!"¹⁹⁰

Siç dihet, drejtësia e një lajmi është e lidhur (e kushtëzuar, e varur) me drejtësinë e njoftuesit të atij lajmi. Kështu, Krijuesi i Lartë që as mund të diskutohet që të dalë kundër premtimit të vet, në të gjitha librat qiellorë si dhe në Kur'an thotë se do ta mbyllë këtë gjithësi që e ka krijuar si një libër dhe një ditë

¹⁸⁶ Shih Al-i Imran, 3/185; Isra, 17/99; Enbija, 21/34; Muminun, 23/15; Ankebut, 29/57; Rahman, 55/26.

¹⁸⁷ Shih Bakara, 2/243; Al-i Imran, 3/145, 154; Nisa, 4/78; Kaf, 50/19.

¹⁸⁸ Shih Bakara, 2/28; Al-i Imran, 3/27, 156; En'am, 6/2; Araf, 7/158; Tevbe, 9/116; Junus, 10/31, 56; Hixhr, 15/23; Nahl, 16/70; Haxh, 22/66; Rum, 30/19, 27, 40; Mumin, 40/68; Duhan, 44/8; Kaf, 50/43; Nexhm, 53/44; Vakia, 56/60; Hadid, 57/2.

¹⁸⁹ Maide, 57/18, 105; En'am, 6/61, 62; Araf, 7/29; Junus, 10/4; Hud, 11/4; Merjem, 19/40; Nur, 24/42; Kasas, 28/70, 88; Ankebut, 29/17, 21, 57; Jasin, 36/83; Nexhm, 53/42.

¹⁹⁰ Dharijat, 51/5-6. Po kështu, shih Nahl, 16/38; Junus, 10/4.

tjetër do ta hapë përsëpari. Meqë ai që e thotë këtë është Krijuesi i Lartë dhe se për këtë dëshmojnë profetët që kanë të drejtën e fjalës, atëherë, ndodhia e jetës së ahiretit duhet parë si e kryer.

Kur'ani nuk është mjaftuar vetëm me njoftimin se ringjallja pas vdekjes do të ndodhë patjetër. Ai ka sjellë argumente kategorike që e vërtetojnë ringjalljen pas vdekjes dhe grumbullimin (hashr) që janë njëra prej çështjeve me rëndësi që e preokupojnë mendjen e njeriut. Dhe, duke i parashtruar argumentet në fjalë, ka dhënë shembuj të gjallë që përmbajnë kundërshtimet e mohuesve.

b-1 Vërtetimi me metodën e analogjisë krahasuese

Në Kur'an, metodën e analogjisë krahasuese e shohim si njërën prej metodave të përdorura nga bashkëbiseduesit për ta gjetur të vërtetën në çështjen e shpjegimit dhe vërtetimit të mundësisë së botës së jetës së pasme, ahiretit. Kjo metodë është bërë në Kur'an një metodë e posaçme e tij për sa i përket tregimit të pretendimeve të mohuesve si të shtrembra e të gënjeshtërt.

Ai që ka mundësi ta krijojë një gjë nga e paqena, e ka më të lehtë ta krijojë atë për herë të dytë

Disa herë, kur njeriu përballët me një gjë që e kapërcen fuqinë dhe mendimin e tij, kapet nga pandehma se realizimi i asaj gjëje është i pamundur. Është për këtë gjë që Kur'ani, kur e merr për epiqendër fuqinë e Krijuesit të Lartë, e thekson në mënyrë të vazhdueshme se as që mund të bëhet fjalë për pamundësinë e ringjalljes së kufomave dhe për grumbullimin dhe llogaridhënien pas ringjalljes.

Po qe se personi që shkruan në një faqe miliona libra pa i ngatërruar me njëri-tjetrin dhe na e hap para syve, premton se librin që e prish duke ia shpërndarë fletët, e mbledh përsëdyti duke e sjellë në gjendjen e mëparshme, a mund të thuhet se "ai s'ka fuqi për ta bërë këtë"? Nga ky këndvështrim, le ta mendojmë këtë ajet përsëpari:

"Atë ditë do ta mbledhim qiellin rrotull dhe do ta bëjmë atë si ditën e parë kur nisëm ta krijojmë. Japim fjalën se ne do ta bëjmë patjetër këtë!" (Enbija, 21/104)

Përsëri në të njëjtin paralel, le ta trajtojmë çështjen me një shembull tjetër. Po qe se artisti që ka shpikur një maqinë, më pas e zbërthen atë dhe thotë se do ta montojë edhe një herë tjetër, a mund të kundërshtohet ai duke i thënë "jo, s'mund ta bësh, s'mund ta arrish këtë"? Po qe se kjo është e mundur për fuqitë njerëzore, a mund të bëhet fjalë për pengesë për fuqinë hyjnore që s'njeh kusht e kufi? Si mund të ndodhë që Fuqia e Lartë që e ka nxjerrë materien nga mosqenia në botën e ekzistencës, të mos i mjaftojë mundësia për t'i bashkuar sërish pjesët e shpërndara?

Pse të mos jetë e mundur që njeriu i cili ekziston ndërsa nuk ka ekzistuar, të mos rikthehet në ekzistencë pasi të ketë kaluar në mosekzistencë? Kur'ani i jep këtë përgjigje lakonike kundërshtimit të kokës mohuese që thotë: "A nuk e kujton ai se e kemi krijuar ndërsa më parë s'ishte asgjë?" (Merjem, 19/66-67)

Krijimi i njeriut, ardhja e tij në këtë botë dhe etapat e këtij zhvillimi ndodhin vazhdimisht nga jashtë pa asnjë ndërhyrje dhe kontribut prej tij. Nisur nga kjo, ecuria e krijimit që kalon njeriu është argumenti më i afërt dhe më i efektshëm për të për ta vërtetuar Allahun dhe jetën e pasme, ahiretin.

Duke e vërtetuar ringjalljen me argumente subjektive, Kur'ani na e tërheq vëmendjen në botën normale ku jetojmë. Si argument të faktit se ringjallja është një dukuri që ndodh brenda kuadrit të mundësisë, parashtron etapat e jetës së vetë njeriut:

"O njerëz! Po që se dyshoni të ringjallja pas vdekjes, (dijeni se) Ne ju krijuam ju nga dheu, pastaj nga një pikë uji (spermë), pastaj nga embrioni, pastaj nga një fetus me pamjen e një cope mishi të përtypur që e ka plotësuar krijimin, por nuk i janë formuar gjymtyrët, që t'ju tregojmë hapur (fuqinë tonë). Atë që dëshirojmë, e mbajmë për një farë kohe të caktuar në mitrën e nënës, pastaj ju nxjerrim në botë si foshnjë. Pastaj ju bëjmë të rriteni gjersa të bëheni të fuqishëm e të aftë. Pastaj, dikë nga ju e bëjmë të vdesë ende fëmijë, kurse dikë tjetër e mbajmë gjallë gjersa të plakët sa ta lënë fuqitë dhe t'i harrojë krejt ato që ka ditur..." (Haxh, 22/5)

Krijimi i një qenieje të përkryer nga një embrion i thjeshtë është jo vetëm argument për ekzistencën e Allahut, por edhe një argument kategorik për ringjalljen dhe grumbullimin e njerëzve pas ringjalljes dhe llogaridhënien. Kështu, në pjesën e fundit të ajetit tërheq vëmendjen mbi këtë specifikë duke thënë: "... Kjo është kështu, sepse Allahu është e vërteta e vetme. Ai i ringjall të vdekurit dhe Ai ka mundësi për çdo gjë!" (Haxh, 22/6)

Kundërshtimet dhe qëndrimin armiqësor të njeriut që e mohon jetën e pasme, ahiretin, e lidh me mosnjohjen nga njeriu të procesit të krijimit të vet: "A nuk e ka parë njeriu se si e krijuam atë prej një pike uji (spermë), që tani bëhet një armik i hapur?" (Jasin, 36/77)

Kur njeriu e harron veten, e shprehur më qartë, kur e harron atë përkryerje dhe mrekulli të krijimit të vet, kjo gjë bëhet shkak që për të të hapet porta e mohimit. Këtë specifikë e thekson kjo shprehje e Kur'anit në vazhdim të ajetit që e përmendëm lidhur me këtë specifikë: "Dhe ai e harroi krijimin e vet!" (Jasin, 36/78)

Nuk mund të mendohet që njeriu i cili e njeh ecurinë e krijimit të vet, të dyshojë për ringjalljen e vet. Sigurisht, Allahu i cili e krijoi prej dheu njeriun si një qenie të gjallë që mendon, flet, dëgjon, kupton, që ka vetëdije dhe aftësi njohjeje, mundet ta ringjallë njeriun pasi të ketë vdekur e të jetë bërë dhé!

Ringjallja është më e lehtë

Kur'ani përpiqet t'i zgjojë mendjet e njerëzve nga një këndvështrim tjetër përsëri me këtë metodë krahasimi. Duke u kujtuar njerëzve, në lidhje me dyshimet dhe kundërshtimet e atyre që e mohojnë ahiretin duke e përsëritur shpesh se "a do të ringjallen dhe kthehen në jetë pasi të jenë shndërruar në një grumbull eshtrash pa jetë", se Allahu i Lartë ka krijuar në gjithësi gjëra më të mëdha dhe më të vështira se njeriu, Kur'ani bën të ditur se, në krahasim me këto gjëra të mëdha, rikthimi i njerëzve në jetë është një punë jo fort e vështirë.

Në këtë pikë, me synimin për t'i bërë mohuesit të mendojnë më seriozisht, Kur'ani u drejton atyre në fillim këtë pyetje: "Allahu që e ka ngritur qiellin, a e ka më të vështirë ta krijojë qiellin, apo t'ju rikrijojë ju (pasi të keni vdekur)?" (Naziati, 79/27)

Me këtë ajet u thuhet kështu njerëzve: "Ju vazhdimisht pyesni se "si do të marrin jetë këto kocka të kalbura"! A nuk mendoni se për Allahun që e ka krijuar këtë qiell madhështor, nuk mund të ketë asgjë të vështirë?"

Pasi i përqendron mendjet mbi një pikë me rëndësi me pyetje të formës "a është më e vështirë krijimi i njeriut apo i qiellit me të gjithë elementët", si hap i parë, kjo, Kur'ani, si hap të dytë, u përgjigjet vetë këtyre pyetjeve: "Sigurisht, krijimi i qiejve e i tokës është diçka më e madhe se krijimi i njerëzve, mirëpo shumica e njerëzve nuk e dinë (se kjo është kështu)!" (Mumin, 40/57)

Ashtu siç është më e lehtë për një njeri që ndërton një pallat të mrekullueshëm, të ringrejë një kolibe të thjeshtë të shembur, ashtu dhe çështja e krijimit të njeriut si qenie që zë në gjithësi një vend jashtëzakonisht të vogël në krahasim me qiejt dhe tokën, në krahasim me çështjen e krijimit të kësaj gjithësie të madhe, nuk është e ndryshme.

Në një ajet tjetër, faktin që, për sa i përket vështirësisë, rikrijimi i njeriut pas vdekjes përbën një specifikë për të cilën nuk e vlen të flitet në krahasim me krijimin dhe funksionimin harmonik të gjithësisë nga Allahu, Kur'ani e shpreh kështu:

"Dhe tani, Ai që i ka krijuar qiejt dhe tokën, a nuk ka mundësi t'i krijojë edhe njerëzit? Sigurisht që ka mundësi! Allahu është i gjithëditur!" (Jasin, 36/81)

Ai që mundet ta kthejë një gjë në të kundërtën, mund ta kthejë në të kundërtën edhe një gjë tjetër

Një formë tjetër krahasimi e ofruar njerëzve nga Kur'ani për ta provuar mundësinë e ringjalljes, është trajtuar me një shembull të veçantë:

"Është Ai që nxjerr për ju zjarr nga druri i gjelbër (i njomë). Ja, nga ai digjni ju!"¹⁹¹

Këtu, me këtë shembull, duke treguar për zjarrin që ndiznin arabët të cilët ishin atë ditë bashkëbiseduesit e parë të tij, duke fërkuar me njëri-tjetrin dy lloj drurësh të njomë,¹⁹² Kur'ani tërheq vëmendjen mbi faktin që Allahu i Lartë është i aftë për të bërë dhe çuar në vend çdo gjë që dëshiron, që para fuqisë së tij nuk ka asnjë pengesë.

Specifika që kërkon të shprehë ajeti lidhur me çështjen, është kjo: Uji dhe zjarri janë gjëra të kundërta me njëri-tjetrin. Ndërsa dalja e zjarrit nga druri i njomë ku përmbahet ujë me sasi të madhe, është pothuajse e pamundur, Fuqia e Lartë, duke e nxjerrë zjarrin nga druri i njomë, ka treguar se e ka krijuar diçka nga diçka tjetër e kundërt me të.¹⁹³

Me këtë shembull të dhënë për të argumentuar mundësinë e jetës pas vdekjes, Kur'ani, duke ua kujtuar njerëzve se në këtë gjithësi, prodhimi i diçkaje nga diçka tjetër e kundërta e saj është një dukuri e mundshme që vëzhgohet, ka synuar t'i përgatisë mendjet për ta pranuar nga ky këndvështrim mundësinë e ringjalljes.

Shkurt, Kur'ani na e parashton para syve me një shprehje të shquar se Krijuesi i Lartë i cili ka mundësi për të nxjerrë nga një dru i njomë zjarrin që është e kundërta e tij, është i aftë edhe për ta krijuar jetën nga kockat e kalbura që janë në dukje si antagonistë të jetës.

b-2 Vërtetim me paraqitjen e shembujve të krahasueshëm

¹⁹¹ Jasin, 36/80. Kurse një ajet tjetër ku ka shprehje të ngjashme lidhur me këtë çështje, është kështu: "Thoni tani, a ju e keni krijuar drurin me të cilin zini zjarrin, apo jemi Ne krijuesit e tij? Ne e bëmë atë një shembull që të tregojë për fuqinë tonë dhe pretext përfitimi për kalimtarët. Atëherë, madhëroje emrin e Zotit tënd të Lartë!" (Vakia, 56/71-74)

¹⁹² Arabët i quanin këto dy lloje drurësh të njomë, *merh* dhe *afar*.

¹⁹³ Në të vërtetë, edhe njeriu e praktikon këtë në jetën e vet me ndihmën dhe favorin e Allahut. Bie fjala, njeriu, sipas dëshirës, siç mund të përftojë nga energjia elektrike zjarr dhe ngrohtësi, mund të përftojë edhe akull dhe freski.

Disa herë, Kur'ani na kujton neve shembuj të krahasueshëm e të vëzhgueshëm me vetë ringjalljen. Këta shembuj nuk ndodhen larg; ata ndodhen pranë të gjithë njerëzve, besimtarë e jobesimtarë, e thënë ndryshe, dukuri që i vëzhgon kushdo.

Kështu, duke u mbështetur në argumente të marra nga bota e përvojës, Kur'ani edhe tregon themelet racionale të dukurisë së ringjalljes, edhe nxjerr në shesh se mohuesit e ringjalljes nuk kanë asnjë argument dhe kundërshtimet e tyre nuk bartin vlerë shkencore. Në këtë kuadër, përballë atyre që e shohin ringjalljen të pamundur, Kur'ani, gjallërimin me anë të ujit të shiut të tokës zhuritur nga thatësira dhe të vdekur dhe, pastaj, stolisjen e saj me bimë të ndryshme, si dhe shembullin e gjumit që e provon vetë njeriu, i paraqet si prova dhe argumente që vërtetojnë se ringjallja është e mundur.

Këtu, konkluzionet që mund të arrijë mendja (arsyeja) me rrugën e mendimit (arsyetimit) dhe meditimit, jepen përmes një stili mësimdhënës, ashtu që stilin vërtetues dhe bindës të Kur'anit në këtë drejtim mund ta shohim më tepër se si njoftim të një çështjeje njerëzve nga pozita hyjnore, si mësimdhënie të një mësuesi për nxënësin e vet.

Nisur nga këto prova dhe argumente të Kur'anit, edhe nëse çështja trajtohet nga këndvështrimi i një filozofi, edhe nëse trajtohet nga këndvështrimi i një çobani, nuk mund të ketë metodë më të lartë se metoda provuese dhe bindësi e ndjekur nga Kur'ani. Edhe hadithet e Profetit (sal'lallahu alejhi vesel'lem) lidhur me këtë çështje janë trajtim në hollësi dhe koment i atyre që tregon Kur'ani. Dhe tani le t'i trajtojmë shkurt këta shembuj të paraqitur për këtë qëllim nga Kur'ani vështrimit të vëmendshëm të njerëzve.

Gjallërimi i tokës pas vdekjes

Ringjallja në pranverë e faqes së tokës e cila gjatë dimrit duket si e vdekur, është shembulli më domethënës i dhënë në Kur'an me qëllim për të treguar se ringjallja pas vdekjes është një dukuri e mundshme dhe e vëzhgueshme. Me një ligj të vendosur nga Allahu që sundon mbi tokë, çdo gjë është në një proces ripërtëritjeje të pandërprerë. Veçanërisht, duke na i dhënë shembuj ujin dhe bimësinë që hedh shtat dhe zhvillohet me anë të ujit, me anë të kësaj Kur'ani i tërheq vëmendjet në këtë pikë: Po që se çdo gjë asgjësohet dhe, pastaj, rikthehet në gjendjen e mëparshme nga pikënisja, pse të mos jetë e mundur që edhe njeriu të rikthehet në gjendjen e mëparshme pasi të ketë vdekur?

Funksionimi i jetës ku ndodhemi është argument më vete i mundësisë së një jete pas vdekjes. Përsëritja e vazhdueshme e alternuar e pranverës dhe dimrit na japin mundësi neve ta vëzhgojmë për muaj të tërë dukurinë e vdekjes dhe ringjalljes. A mund të ketë ndonjë kuptim fakti që e shohim shumë dukurinë e ringjalljes në një botë ku rastet e ngjashme të tij i shohim dhe i vëzhgojmë në mënyrë të vazhdueshme? A është diçka e ndryshme nga kjo ringjallja dhe grumbullimi pas vdekjes? Apo mos njeriu e pandeh ringjalljen e vet si diçka të pamundur për fuqinë e Zotit?

Njeriu i cili mundet ta shohë një herë me sy mësimnxjerrës tokën e cila është çdo pranverë skenë e ngjarjeve të pafundme të "ringjalljes pas vdekjes"¹⁹⁴, nuk do ta ketë të vështirë ta kuptojë se krejt si në këto ngjarje, edhe ai do të ringjallet në pranverën e një botë tjetër. Në Kur'an ka shumë ajete që aludojnë për këtë specifikë. Le të përmendim disa prej tyre:

¹⁹⁴ Në original: ba'thu ba'de'l-mevt.

"Shih kah veprat e mëshirës së Allahut se si e ringjall tokën pas vdekjes! Ai që e bën këtë, edhe të vdekurit i ringjall. Ai ka mundësi për çdo gjë!" (Rum, 30/50)

"Njëri prej ajeteve (argumenteve, provave) të tij është edhe ky: Ti e sheh tokën me qafë përkulur (të tharë e të zhuritur nga thatësira). Por kur zbresim ujë mbi të, dridhet dhe fryhet. Allahu që e ringjall atë, i ringjall edhe të vdekurit. Ai ka mundësi për çdo gjë!" (Fussilet, 41/39)

Për sa i përket parashtrimin të unitetit të krijimit, sjellja nga Kur'ani e tokës së vdekur si argument të ringjalljes së njeriut, është një specifikë me rëndësi. Sepse Fuqia absolute, Zoti, do ta ndryshojë trajtën e gjithësisë në ditën e kiametit po me atë ligj që e ndryshon sot për çdo çast trajtën e kësaj bote. Me atë ligj që e ringjall në pranverë të gjithë bimësinë e vdekur, do t'i ringjallë edhe njerëzit pas vdekjes.

Në fund të ajeteve lidhur me këtë çështje, duke thënë "ja, kështu do të nxirreni"¹⁹⁵ dhe "ja, kjo është dalja"¹⁹⁶, na jep neve njerëzve këtë mesazh: "Ashtu siç gjallërohet toka e vdekur, si u vjen pemëve një jetë e re dhe bimët mbijnë nga toka, edhe ju do të dilni nga varret duke gjetur një jetë të re!"

Zgjidhja e njeriut çdo mëngjes sikur të ringjallej nga vdekja

Mes argumenteve të marra nga bota e përvojës, Kur'ani na kujton edhe këtë: po qe se njeriu arsyetonte mbi rikthimin e tij në jetë pas rënies në gjumë që mund të konsiderohet një lloj vdekjeje dhe e studion këtë funksion dhe harmoni, nuk do ta ketë të vështirë për ta kuptuar ringjalljen dhe grumbullimin pas vdekjes.

Në lidhje me çështjen e ringjalljes, mohuesit e quajnë të pamundur këtë, duke thënë kështu: "Le ta pranojmë mundësinë e një jete të re vegetative pas vdekjes; si do të mund të fillojë jeta jonë njerëzore pasi të na jenë prerë lidhjet e ndjenjave dhe vetëdijes me trupin?" Përballë këtij kundërshtimi të mohuesve, Kur'ani ka kujtuar gjumin, një përvojë të përditshme. Gjendjet e gjumit dhe zgjimit që ndjekin njëra-tjetrën, përbëjnë për ne një shembull të bukur për çështjen e jetës pas vdekjes. Për vërtetimin e ringjalljes nuk kërkohet një forcë bindëse më tepër se kaq. Në Kur'an thuhet kështu:

"Është Ai që natën ju vë në gjumë sikur t'ju kishte bërë të vdisnit dhe ju ringjall ditën, pastaj ju do të ktheheni tek Ai dhe Ai do t'ju njoftojë për ato që keni bërë në botë!"¹⁹⁷

Edhe dijetari Hamdi Jazër bën një vlerësim me mjaft rëndësi për fragmentin "dhe ju ringjall ditën" të ajetit të mësipërm. Ai thotë, shkurtimisht, kështu:

"Allahu jua kompenson dhe rinovon në gjumë, pa e ditur ju, pjesët e trupit që ju janë dëmtuar ose që ju kanë vdekur dhe, duke jua kthyer përsëri në mëngjes vetëdijen dhe aftësinë njohëse që jua pati marrë, ju ringjall dhe ju zgjon me jetën tuaj materiale e shpirtërore të mëparshme. Vetëm atëherë ju i dalloni ditën dhe natën, i njihni veten dhe arrijtjet tuaja sikur të mos i kishit humbur fare, sikur në mes të mos kishte ndodhur asnjë ndërprerje. Të dyja jetët materiale-shpirtërore që ka njeriu ndodhen çdo ditë e çdo natë, madje, çdo çast në një "ringjallje" të tillë materiale-shpirtërore. Edhe nëse shumë njerëz e pranojnë këtë si një ringjallje me kuptim të figurshëm, po qe se çështja shihet seriozisht me një sy shkencor, del në shesh se kjo është një ringjallje me kuptimin e vërtetë të fjalës!"¹⁹⁸

¹⁹⁵ A'raf, 7/25; Rum, 30/19; Xhathije, 45/35.

¹⁹⁶ Kaf, 50/11.

¹⁹⁷ En'am, 6/60.

¹⁹⁸ Elmalıb Hamdi Vazır, *Hak Dini Kur'an Dili*, 3/1949-1950.

Në suren Zumer është një ajet tjetër që e pohon ringjalljen e njerëzve pas vdekjes si të zgjoheshin nga gjumi:

"Zoti e merr jetën kur njeriut i vjen vdekja, kurse atë që s'i ka ardhur vdekja, e vë në gjumë. Kështu, e mban shpirtin e atij për të cilin është dhënë vendimi i vdekjes, kurse shpirtin e tjetrit e lëshon gjer në një afat të përcaktuar. Pa dyshim, në këtë ka prova me rëndësi për një popull që mund të mendojë!" (Zumer, 39/42)

Këto ajete shpjegojnë ngjasimin mes vdekjes dhe ringjalljes, domethënë, ngjasimin mes zgjimit nga gjumi dhe ringjalljes pas vdekjes. Gjumi është një vdekje e dobët (e lehtë) dhe e vogël, kurse vdekja, një gjumë i madh dhe i rëndë (intensiv). Në të dyja gjendjet ndodh kalimi i shpirtit të njeriut nga një jetë në një jetë tjetër.

Ngjashmëria mes rënies në gjumë-zgjimit dhe vdekjes-ringjalljes është theksuar edhe në hadithet profetike. Për shembull, në një deklaratë profetike është dhënë kjo porosi: "Kur të bini për të fjetur, thoni "Allahu im, me emrin tënd vdes dhe ringjallet!" dhe, kur të ngriheni nga gjumi, thoni "Lavdi Allahut që na ringjall pas vdekjes!" (Buhari, Tevhid, 13)

Allahu i Lartë, krijuesi i ngjarjes së gjumit dhe zgjimit, edhe me anë të realitetit të "ëndrrës" e cila ndodh mes këtyre dy gjendjeve, u hap mendimeve tona një horizont të veçantë për shpërndarjen e dyshimeve mbi këtë çështje. Duke na i hequr ndjenjat nga një botë për të na i lidhur me zërat dhe ngjyrat e një bote tjetër e për të na shëtitur në të, i tregon njeriut, duke e bërë t'i jetojë personalisht, ekzistencën edhe të botëve të tjera të ndryshme nga kjo botë e rrethuar me membrana tredimensionale. Njeriu i cili kridhet çdo natë në gjumin që është një lloj vëlla i vogël i vdekjes dhe i cili çdo mëngjes hap sytë në këtë botë sikur të ringjallej, do të thotë se i vëzhgon çdo ditë shenjat e kiametit dhe ringjalljes.

Siç shihet, me anë të rënies në gjumë dhe zgjimit, njeriu e jeton praktikisht të ngjashmen e ringjalljes pas vdekjes. Duke e nxjerrë në rend të ditës këtë ngjashmëri mes vdekjes dhe gjumit dhe mes ringjalljes dhe zgjimit, Kur'ani jep këtë mesazh: Allahu, siç e vë në gjumë njeriun, ashtu dhe e bën të vdesë, dhe siç e zgjon nga gjumi, ashtu dhe e ringjall!

b-3 Vërtetim me tregimin e shembujve të ringjalljes të jetuar në të shkuarën

Një rrugë tjetër e vërtetimit të ringjalljes në Kur'an është përmendja e ringjalljeve mrekullore të ndodhura në të kaluarën. Në këto lloj ndodhish të treguara brenda rrëfimeve, duke u mbajtur përgjithësisht fshehur elementët lidhur me personat, ky kuptim kryesisht mësidhënës është shpjeguar me anë të një shembulli të jetuar. E shprehur ndryshe, është treguar se Allahu ka mundësi për t'u ridhënë jetë të vdekurve duke ia treguar të vërtetën e ringjalljes pas vdekjes bashkëbiseduesit me anë të një ngjarjeje të ndodhur historikisht.

Për këto ngjarje të shënuara nga Kur'ani si argumente praktike të mundësisë dhe realizimit të ringjalljes, atyre që thonë se "këto ngjarje i kanë parë bashkëkohësit, kurse pasardhësit nuk kanë për t'i parë që t'u vlejnë si shembull", mjafton t'u kujtojmë këtë pikë:

"Pas vërtetimit të seriozitetit të burimit që i njofton, këto ngjarje nuk kanë ndryshim nga ngjarjet që zhvillohen çdo ditë para syve të njerëzve. Këto ngjarje që ua kujton Kur'ani njerëzve për t'ua përshtatur mendjeve të vërtetën e ringjalljes dhe për ta vërtetuar atë, jo vetëm u bën dritë bashkëkohësve, por ka vlerën edhe të një mesazhi për njerëzit e të gjitha vendeve dhe kohëve."

Këta shembuj të parashtruar me qëllim për të mënjeluar dyshimet dhe lëkundjet mbi ringjalljen, ndërsa nga njëra anë bëjnë të ditur se ringjallja është një ngjarje brenda kuadrit të mundësisë, në të njëjtën kohë, njoftojnë se ringjallja do të jetë patjetër materiale e trupore.

Kur'ani ka paraqitur shembuj nga bota e ndijimeve të jetuar në të kaluarën që e përshtasin të vërtetën e ringjalljes për mendjen e njeriut, me qëllim që të përbëjnë përgjigje për ata që e përcjellin me habi ringjalljen pas vdekjes dhe që kërkojnë të kenë njohuri të sakta mbi këtë çështje.

Disa prej këtyre mund t'i radhisim kështu: ringjallja e Shokëve të Shpellës¹⁹⁹ pasi qenë vënë gjumë dhe patën fjetur treqind e nëntë vjet,²⁰⁰ ringjallja e një izraeliti të vdekur duke e goditur me një gjymtyrë kau,²⁰¹ vdekja kolektive e një grupi izraelitësh në shkretëtirën Sina dhe, pastaj, ringjallja e tyre,²⁰² dhënia jetë në mënyrë mrekullore disa njerëzve nga Hz. Isai dhe, krahas kësaj, fryrja dhe ringjallja e zogjve prej balte të bëra prej tij me lejen e Allahut,²⁰³ ringjallja me kërkesën e Hz. Ibrahimit e katër zogjve të copëtuar.²⁰⁴

c) Ajetet që tregojnë domosdoshmërinë e jetës së ahiretit

Realizimin e jetës së ahiretit, Kur'ani e lidh edhe me një sërë shkaqesh të rëndësishme. Le t'i marrim me radhë për t'i shqyrtuar shkurt këto.

c-1 Shpërblimi i adhurimit

Krijimi i njeriut ka qëllime të rëndësishme dhe është një e vërtetë e hapur se në këtë krijim janë shumë urtësi të Krijuesit të Lartë. Ne jetojmë në një botë që ndryshon pandërprerë dhe që rinohet çdo çast. Shohim se çdo gjë lëviz drejt një pike, drejt një fundi dhe që kjo pikë e fundit ku do të arrihet s'është tjetër gjë veç jetës së ahiretit ku do të fitojnë kuptim qëllimi i krijimit si dhe përpjekjet në këtë drejtim.

Duke u nisur nga kjo, mund të themi se nuk mund të mendohet që Allahu t'i lërë pa shpërblyer aktet e robve të Tij të mirë²⁰⁵, sepse kjo do të thotë shfaqje e një situatë që s'përputhet me urtësinë e Tij. Sepse në një situatë të tillë do të eliminohej dallimi mes të mirës dhe të keqes, mes mbarësisë dhe prapësisë, përpjekja e njeriut që lufton mes të mirës dhe të keqes nuk do të kishte kuptim. Prandaj duhet të ekzistojë një jetë tjetër përtej kësaj jete, pas vdekjes, në mënyrë që njerëzit të mund të marrin përgjegjësen e akteve dhe punëve të mira të tyre. Është për këtë arsye që Kur'ani na e kujton se shpërblimi i atyre që shpalosin mirësi dhe bukuri, do të jetë, në të njëjtën mënyrë, mirësi dhe bukuri:

"A mos vallë do të jetë gjë tjetër nga mirësia²⁰⁶ (mirësia dhe bukuria) rezultati i mirësisë?" (Rahman, 55/60)

¹⁹⁹ Në origjinal: As'habi Kehf.

²⁰⁰ Shih Kehf, 18/9-19.

²⁰¹ Shih Bakara, 2/72-73.

²⁰² Shih Bakara, 2/55-56.

²⁰³ Shih Al-i Imran, 3/49; Maide, 5/110.

²⁰⁴ Shih Bakara, 2/260.

²⁰⁵ Në origjinal: salih.

²⁰⁶ Në origjinal: ihsan.

A është e mundur që Allahu i Lartë të mos japë shpërblim për sakrificat e një personi i cili në këtë botë e ruan veten nga haramet (gjërat dhe veprimet e palejuara, të pabekuara e jolegjitime) për hir të Allahut, i cili jeton me vetëdijen e hallallit (e gjërave dhe veprimeve të lejuara, të bekuara e legjitime) dhe që pranon të përballojë çdo lloj barre për të drejtën dhe të vërtetën? Kur'ani e bën të ditur kështu përgjigjen e Allahut për robtë e Tij të cilët, duke iu drejtuar Zotit të tyre, i luten "t'ua japë shpërblimet që ua ka premtuar" (Al-i Imran, 36194):

"Unë nuk ia humb përpjekjen askujt nga ju që bën të mirë, qoftë burrë, qoftë grua, sepse ju jeni të njëri-tjetrit. Ata që kanë emigruar, që janë përzënë nga vatani, që kanë pësuar tortura dhe dëme në rrugën time, që kanë luftuar dhe janë vrarë në rrugën time për pëlqimin tim, sigurisht që do t'ua mbuloj të metat dhe, si shpërblim nga ana e Zotit të tyre, do t'i vendos në xheneti ku rrjedhin lumenj. Shpërblimet më të mëdha janë pranë Allahut!" (Al-i Imran, 3/195)

Gjithashtu, me këtë rast, në suren Murselat, Allahu i Lartë e ka deklaruar kështu faktin se atyre që e kanë kryer detyrën e robit ndaj Zotit sipas qëllimit dhe orientimit të krijimit, do t'u jepet xheneti me të gjitha të mirat dhe bukuritë e tij si shpërblim për sjelljen e tyre:

"Me të vërtetë, në këtë mënyrë i shpërblejmë Ne ata që sillen mirë..." (Murselat, 77/44-45)

Si përfundim, mund të themi se jeta e ahiretit do të ndodhë patjetër si shpërblim i adhurimit të kryer nga njeriu dhe marrje prej tij e vlerës së vërtetë të akteve dhe veprimeve të tij, ashtu dhe si realizim i qëllimeve dhe synimeve të krijimit:

"Atë ditë njerëzit do të ngjiten grupe-grupe (në gjyqin hyjnor) për t'iu treguar atyre shpërblimi i bëmave të tyre!" (Zilzal, 99/6)

c-2 Realizimi i drejtësisë absolute

Te çdo njeri i vjetër a i ri, i qytetëruar a i paqytetëruar, i ditur a i paditur, mbi çështjen e realizimit të drejtësisë të paarritur në këtë botë, ekziston një vetëdijshmëri, e ngjashme me frymëzimin, mbi ekzistencën e një jete tjetër përtej kësaj bote.

Autoriteti i kësaj ndjenje të fuqishme e cila është e pamundur të shkulet e të hidhet nga natyra krijuese e njeriut, është, në analizë të fundit, Allahu i Lartë, origjinave e origjinave. Prandaj, si domosdoshmëri e kësaj ndjenje të shtresuar në natyrën e krijimit të njeriut, Zoti do ta ekzekutojë plotësisht një ditë vendimin e drejtësisë hyjnore dhe do të krijojë një fushë jete më të përsosur se kjo e sotmja.

Nisur nga kjo, na duhet të qëndrojmë mbi inkosekuencën e një qëndrimi të sjellë në rend të ditës në formën "vuajtja e ndërgjegjes dhe kënaqja e ndërgjegjes janë të mjaftueshëm për njeriun si ndëshkim dhe shpërblim, prandaj nuk ka nevojë për idenë e jetës së pasme, ahiretit"! Pretendimi i një qëndrimi të tillë "për të eliminuar nevojën e ndjerë për jetën e ahiretit" nuk ka asnjë themel të arsyeshëm. Bie fjala, po qe se një person vret një njeri të pafajshëm dhe, menjëherë pas krimit, vdes në një aksident automobilistik, nuk ka kohë (ose kur do të ketë kohë) për të vuajtur në ndërgjegje për krimin që kreu. Ose po qe se një person lufton për drejtësinë dhe të vërtetën dhe vritet, kur do të realizohet shpërblimi i kënaqësisë që duhet të ndjejë ai në ndërgjegje?

Shihet se në këtë botë nuk i jepet ndëshkim i plotë çdo faji dhe shpërblim i plotë çdo mirësie. Është për këtë arsye që pika e fundit ku e çon mendja njeriun, është domosdoshmëria e ndodhjes të ahiretit.

Kur'ani e trajton çështjen e jetës së pasme, ahiretit, dhe llogaridhënien që do të ndodhë në të, në kuadrin e shpërblimit me drejtësi:

"Edhe ai që kryen një mirësi sa një thërrime, edhe ai që kryen një të keqe sa një thërrime, do ta marrë përgjegjësen e saj!" (Zilzal, 99/87)

"Ditën e kiametit Ne do të vendosim peshore të drejta dhe askujt s'do t'i bëhet padrejtësi. Punën e mirë apo të keqe që peshon qoftë edhe sa një kokërr sinapi, e sjellim aty dhe e peshojmë. Ne mjaftojmë si marrës në llogari!" (Enbija, 21/47)

Jeta e ahiretit ka një pozitë themelore dhe qëndrore për sa i përket shfaqjes në kuptim absolut të drejtësisë hyjnore. Kur'ani e thekson në mënyrë të prerë se do të jetë e pamundur që njerëzit të cilët kanë ndjekur gjer në fund të jetës rrugë të ndryshme, të përballen pas vdekjes me të njëjtën pasojë si shpërblim ose ndëshkim, dhe se nuk duhet ta presin këtë nga Allahu:

"Apo mos ata që vazhdojnë t'i kryejnë ato të këqija pandehin se edhe ata do t'i trajtojmë si njerëzit që kanë besuar dhe bëjnë punë të pranueshme e të bukura, se do t'i vlerësojmë si të njëjtë në jetë e në vdekje? Ç'gjykim i keq!" (Xhathije, 45/21)

"A mos tani Ne do t'i vlerësojmë muslimanët si mohuesit (qafirët)? Ç'po ndodh me ju? Ç'konkluzion po jepni kështu?" (Kalem, 68/35-36)

Allahu i Lartë do ta krijojë patjetër atë ditë që e ka premtuar. Sepse po qe se Ai nuk i miraton besimtarët që e kalojnë jetën në përputhje me qëllimin e krijimit dhe nuk i poshtëron mohuesit dhe mëkatarët që i ngrenë kurth jetës dhe prishin rregullin, kjo do të thotë se ka hequr dorë prej drejtësisë dhe urtësisë së Tij.

Shkurt, meqë si shumica e besimtarëve, ashtu dhe e mohuesve nuk e marrin përkatësisht shpërblimin dhe ndëshkimin në këtë botë, do të thotë se përfundimi i është lënë një gjykate të madhe!

c-3 Dhënia fund e kontradiktave

Është një specifikë e njohur se, qysh nga krijimi i njeriut mbi tokë, e vërteta kuptohet në forma të ndryshme që bëhen shkak për mosmarrëveshje mes individëve dhe shoqërive. Këto kuptime të ndryshme janë bërë shkak për lindjen e shumë shoqërive, kulturave dhe bindjeve mbështetur mbi teori të ndryshme. Në çdo periudhë historike, përkrahësit e këtyre bindjeve kanë bërë përpjekje të mëdha për t'i përhapur idetë e pranuar dhe përvetësuara prej tyre!

Në këto kushte, çdo njeri me mend në kokë do të arrijë në përfundimin se këto kontradikta duhet të zgjidhen patjetër një ditë dhe se është e domosdoshme që të dalë në shesh se ç'është e drejtë e ç'është e padrejtë. Por ç'e do se duket sheshit që perdet që i mbulojnë të vërtetat nuk kanë për t'u hapur në këtë botë dhe që çdo gjë nuk do të shpaloset sheshit. Sepse struktura e ngritur mbi këtë botë nuk e lejon këtë. Atëherë, duhet një botë dhe jetë tjetër që do ta plotësonte këtë nevojë.

Qoftë paragjykimet si kryeneçësia dhe urrejtja, qoftë kontradiktat e prodhuara prej qëndrimeve mendore të gabuara është e pamundur të zgjidhen as në kuvendet e fjalës, as dhe në sheshet e luftës. Atëherë, duhet një ditë kur çdo gjë të vendoset me një konkluzion të prerë dhe përfundimtar në mënyrë që njerëzit të mundin ta mësojnë fytyrën e brendshme të të drejtës dhe të shtrembrës që qëndrojnë nën debatet ku kanë qenë zhytur gjatë gjithë jetës, gjë që mund të realizohet vetën para Allahut që e di dhe e vëzhgon çdo gjë më mirë se kushdo.

Kjo specifikë që përbën domosdoshmërinë e jetës së ahiretit, shpjegohet kështu në suren Nahl:

"Ata u betuan me të gjithë fuqinë e tyre se "Allahu nuk e ringjall njeriun që vdes". Jo, ky është premtim i vërtetë që Ai e ka marrë përsipër, por shumica e njerëzve nuk e dinë. Ata do të ringjallen që

e vërteta për të cilën ata ranë në kundërshtim, të zbulohet dhe mohuesit ta dinë se janë gënjeshtarë!" (Nahl, 16/38-39)

Në këtë ajet, Allahu i Madh, pasi e bën të ditur ringjalljen pas vdekjes si një premtim të marrë përsipër prej Tij, tregon edhe se për ç'shkak e ka marrë përsipër. E para, për t'ua bërë të ditur atyre të vërtetën mbi të cilën kanë rënë në kontradiktë, e dyta, për t'ua treguar mohuesve se me të vërtetë janë gënjeshtarë.

Kur'ani e cilëson atë ditë si ditën kur do të trajtohen dhe vlerësohen jo vetëm fjalët dhe aktet, por edhe qëllimet dhe synimet e fshehta të njeriut:

"Atë ditë të gjitha të fshehtat do të dalin sheshit!" (Tarik, 86/9)

d) Disa nga argumentet që tregojnë se ahireti do të ndodhë

d-1 Në gjithësi nuk ka vend për kotësi dhe rastësi

Nuk mund të mendohet që një gjithësi e mbushur plot mësim e urtësi të asgjësohet pa pasur ndonjë qëllim apo synim. Çdokush që i shqyrton me vëmendje materien dhe dukuritë, do të shohë mbi çdo gjë vulën dhe gjurmët e urtësive të Krijuesit të Lartë dhe do të konkludojë me lehtësi se kjo botë nuk ekziston kot së koti, por me një qëllim dhe synim të caktuar.

Është jeta e pasme, ahireti, që i përfton kuptim botës. Sepse është synimi ose kahja ajo që i jep kuptim lëvizjes. Po të mos ishte bota e përjetshme e ahiretit, bota nuk do të kishte një synim final që mund ta quajmë synim të vërtetë dhe çdo gjë do të vërtitej pa qëllim. Është për këtë arsye që Kur'ani përmban shprehje që theksojnë se Zoti nuk e ka krijuar ekzistencën për lojë dhe dëfrim për vete dhe se një gjë e tillë nuk do të përputhej me famën e Tij:

"Sigurisht, Ne nuk i krijuam qiellin, tokën dhe çdo gjë tjetër mes tyre sa për lojë e për dëfrim. Po të dëshironim dëfrim, gjenim pranë shumë gjëra për t'u dëfryer..." (Enbija, 21/16, 17)

Kur'ani, i cili na e vë në lëvizje mendimin (arsyetimin) duke na e tërhequr vështrimin në rregullin e pashoq që sundon në gjithësi dhe përsosmërinë që shfaqet në të, na e bën të ditur se çdo pjesë e ekzistencës është e krijuar mbi një të vërtetë, gjithashtu, se krijimi dhe ngritja mbi të vërtetën të bën të mendosh e të besosh mbi ekzistencën e një jete të re pas vdekjes. Kjo specifikë mbi të cilën një ajet qëndron me përparësi, shprehet kështu në të:

"Është Allahu që i ngre qiejt pa ndonjë shtyllë që mund ta shihni ju dhe që, pastaj, sundon mbi arshin. Ai që i ka bërë diellin dhe hënën t'i nënshtrohen vullnetit të Tij. Secili prej tyre lëviz gjer në një kohë të caktuar. Ja, kështu i tregon Ai provat e Tij!" (Rad, 13/2)

Ndërkaq, ne shohim se kjo botë nuk është e përsosur. Ajo është e paqëndrueshme, e ndryshueshme dhe kalimtare. Hyjniteti i shkëlqyer dhe i përjetshëm i Allahut të Lartë, Zotit të botëve, sundimi madhështor dhe gjithëpërfshirës i Tij nuk mund të ngrihet e të qëndrojë mbi një botë të tillë. Domethënë se duhet një botë tjetër e përhershme, e qëndrueshme, e pashkatërrueshme, e përsosur dhe e shkëlqyer, që të jetë e denjë për Të! Prandaj themi se Allahu i Lartë ka një vend tjetër të përhershëm dhe për të e vë në punë njeriun!

d-2 Dëshira e përjetësisë në shpirtin e njeriut

Dëshira e përjetësisë në shpirtin e njeriut është një argument psikologjik shumë i fuqishëm që tregon ekzistencën e jetës së pasme, ahiretit. Ashtu si prania e një lidhjeje të brendshme dhe krejt të veçantë mes ujit dhe etjes së njeriut për ujë, ndjenja e përjetshmërisë e pranishme në shpirtin e njeriut dhe dëshira e tij për jetën e pasosur përbëjnë, në fakt, një argument të madh të ekzistencës së jetës së pasosur²⁰⁷. Kjo dëshirë psikologjike e fuqizon lidhjen e fundit tonë me të vërtetën e jetës së pasme, ahiretit. Historia njerëzore është e mbushur plot shembuj që tregojnë shfaqjet e kësaj ndjenje të natyrshme tek njeriu.

Në të vërtetë, edhe frika nga vdekja që ndjen njeriu me vështrim të parë duke e konceptuar atë si një "asgjësim", buron nga dëshira e thellë që ka njeriu për përjetësinë. Ky zë që del nga natyra krijimore e njeriut tregon se njeriu është krijuar për përjetësinë. Me këtë ndjenjë të natyrshme tek vetja, ndjenjë e cila e kundërshton asgjësimin, çdo njeri e ndjen se është krijuar jo për një jetë të përkohshme kalimtare, por për një jetë të përhershme, të paasgjësueshme. Kjo ndjenjë dhe vetëdije janë tregues të qartë të ekzistencës së një jete të përhershme pas kësaj jete të përkohshme.

Edhe qenia në formën më të keqe është më e mirë se mosqenia. Filozofi M. Unamuno e shpreh kështu faktin që njerëzit janë gati të pranojnë të gjitha llojet e mundimeve dhe torturave vetëm e vetëm për të shpëtuar nga fatkeqësia e asgjësimit dhe për të vazhduar të ekzistojnë: "Jam gati që, më mirë të digjem në ferr përjetësisht, se sa të asgjësohem, sepse asgjë nuk më është dukur më e frikshme dhe e tmerrshme se sa vetë mosqenia!"²⁰⁸

Të dëshirosh përhershshmërinë e jetës qoftë edhe në një botë tjetër, është një ndjenjë e fuqishme e shpirtit të njeriut, e cila nuk mund të nënvleftësohet. Pa dyshim, kjo ndjenjë e pranishme në thellësitë e shpirtit tonë është reflektim i një ndjenje të natyrshme të pranishme në qenien e njeriut.

Si përfundim, nuk mund të mendohet që kjo botë e cila nuk e kënaq dhe nuk e ngop njeriun as me aspektin e saj material, t'u japë përgjigje kapaciteteve dhe mundësive të tij që e përfshijnë gjithësinë siç është imagjinata dhe dëshira e përjetësisë. Prandaj, njeriu që nuk e gjen përgjigjen e kësaj ndjenje në këtë botë, do ta gjejë në një botë tjetër.

e) Argumenti i emrave dhe attributeve të Allahut që shfaqen në ekzistencë

Meqë vlerën argumentuese të fuqisë dhe drejtësisë absolute të Zotit mbi realizimin e jetës së pasme, ahiretit, e kemi prekur me rastin e trajtimit të çështjeve përkatëse, këtu do ta trajtojmë çështjen vetëm nga këndvështrimi i vlerës argumentuese të urtësisë, bujarisë dhe mëshirës së Tij.

Nga këndvështrimi i urtësisë hyjnore

Fakti që njeriu është pajisur me njohuri dhe aftësi të gjera tregon se ai është krijuar si një qenie kandidate për një jetë të pasosur. Njeriut, i cili ka vendin më të zgjedhur e më të shquar mes të gjitha gjallesave dhe që ndodhet në epiqendër të qenieve, të gjitha aftësitë dhe mundësitë e larta që zotëron, si mendja (arsyeja), ndjenja, vetëdija, vullneti dhe aftësia zgjedhëse, i janë dhënë për të qenë e për t'u

²⁰⁷ E shprehur më qartë, ashtu siç argumenton etja për ujë ekzistencën e ujit, edhe etja për përjetshmëri argumenton ekzistencën e përjetshmërisë. Përkthyesi.

²⁰⁸ Miguel de Unamuno, *Yafllam-n Trajik Duygusu*, përkth. Osman Demirsu, Stamboll, 1986, f. 20.

bërë i denjë për dhuntitë që do t'i jepen në botën e përjetshme. Po të mos qe kështu, këto aftësi dhe mundësi të larta të pranishme te njeriu nuk do të kishin kuptim.

Allahu që nuk i ka krijuar njerëzit kot, pa qëllim, gjithsesi s'ka për t'i lënë kot, pa qëllim. Nisur nga kjo, Krijuesi i Lartë, për ta pohuar domosdoshmërinë e ringjalljes për njeriun si dhe karakterin kategorik të saj, thotë kështu:

"A mos pandehni se ju krijuam kot, si lojë dhe dëfrim, dhe se nuk do t'ju kthejmë prapë tek Ne?" (Dharijat, 51/56) "A mos pandeh njeriu se do të lihet i lirë, pa qëllim?" (Kijame, 75/36)

Të mendosh se jeta e njeriut fillon me hapjen e perdes së lindjes dhe përfundon me mbylljen e perdes së vdekjes, do të thotë të përfytyrosh se, me aktin e krijimit të njeriut, Krijuesi i Lartë ka bërë një punë të kotë, kurse nuk mund të mendohet që dikush me mend në kokë ta miratojë këtë pretendim. Në është kështu, do të thotë se vdekja nuk është mbyllje e jetës së njeriut, por është një intermexo me vlerën e startit për t'u hapur perdeja e një jete të dytë.

Argumenti i kujtesës (ruajtjes) hyjnore

Edhe dukuria e ruajtjes që vihet re në këtë botë është një argument tjetër se jeta e pasme, ahireti, do të ndodhë. Siç dihet, njëri nga emrat e Zotit është Hafidh. Emri Hafidh shpreh kuptimet e ruajtjes (në kujtesë dhe me shënim) të të gjitha punëve të bëra, mbrojtjen, vëzhgimin dhe kontrollin e çdo gjëje nga të gjitha rreziqet gjer në një kohë të caktuar. Allahu i ruan pa asnjë të metë të gjitha fjalët e mira apo të këqija të thëna nga njerëzit si dhe zërat e tyre. Kjo specifikë bëhet e qartë kështu në Kur'an:

"Pranë çdo fjale që nxjerr njeriu nga goja ka një vëzhgues të gatshëm!" (Kaf, 50/18)

Krahas fjalëve të thëna, shënohen edhe të gjitha lëvizjet e njeriut. Se sa thellë do të preket njeriu ditën e kiametit kur t'i shpalosen para syve si një shirit filmik të gjitha lëvizjet, sjelljet dhe veprimet që ka bërë në këtë jetë, Kur'ani na e shpreh kështu: "Mjerë për ne! Ç'libër është ky që s'ka lënë gjë të madhe a të vogël pa shënuar?" (Kehf, 18/49)

Shkenca moderne thotë se fjalët e shqiptuara nga njeriu nuk asgjësohen, por shënohen dhe ruhen në thellësitë e kozmosit. Nga shkencëtarët pohohet se teorikisht është e mundur që të kapen (interceptohen) këto zëra dhe se realizimi i këtij interceptimi do të bëhet i mundur në të ardhmen. Kur të shpiket mjeti (teknologjik) për këtë, dëgjimi në të ardhmen i zërave të së kaluarës do të bëhet realitet. Veç kësaj, shumë shkencëtarë pretendojnë se të gjitha lëvizjet që bëjmë si individë apo kolektive qoftë në dritë, qoftë në errësirë, janë të pranishme në kozmos si trajta të fiksuara dhe se do të bëhet e mundur që, në çastin e dëshiruar, lëvizjet e bëra nga njeriu gjatë gjithë jetës të sillen në një të tërë të përbashkët.²⁰⁹

Sipas kësaj, po qe se i ballafaqojmë të gjitha këto me të vërtetën e jetës së pasme, ahiretit, na del në shesh një përputhje idesh me përmasa kozmike: po qe se s'do të vlente për gjë, shënimi (fiksimi) dhe ruajtja e zërave dhe lëvizjeve është e kotë. Mirëpo në gjithësi nuk ka absolutisht asgjë të kotë e asnjë shpenzim të kotë apo shpërdorim. Kurse këto zëra ruhen për një llogari shumë të rëndësishme.

Prej këtu duam të vijmë në këtë pikë: në këtë gjithësi ku jetojmë, çdo gjë ruhet pa u prishur e pa u humbur. Një Ruajtës (Hafidh) i tillë që e ruan çdo gjallesë në kromozomet e saj gjer në hollësinë më të imtë të karakterit të saj, sigurisht që nuk do ta çojë dëm duke e braktisur në mosqenie një vlerë si njeriu i cili është epiqendra e ekzistencës dhe zëvendësi i Zotit mbi tokë. Si një fare të hedhur në tokë, do t'i japë njeriut një jetë të posaçme në një botë tjetër!

²⁰⁹ Shih Han, Vahiduddin, *el-Islam Jete'hadda*, f. 130-133.

Argumenti i bujarisë së pakufishme të Allahut

Gjithashtu, Zoti Bujar, i cili i bën mirësi dhe bujari të pafundme njeriut në këtë botë, nuk ka për t'i prerë këto mirësi dhe dhunti dhe nuk do t'i kthejë dhuntitë dhe kënaqësitë në ndëshkim dhe mundim. Po qe se mirësitë dhe bujaritë në fjalë nuk do të jenë të përjetshme, kënaqësia bëhet mundim, afërsia dhe dashuria shndërrohen në armiqësi. Prandaj, si një domosdoshmëri e bujarisë së pasosur të Tij, duhet të ketë një botë të përjetshme ku të gjejnë vazhdimësinë e vet të gjitha këto.

Argumenti i mëshirës së pafundme të Allahut

Dhembshuria dhe kujdesi që tregohet këtu edhe për gjërat më të thjeshta, janë argument i veçantë mbi realizimin e jetës së pasme, ahiretit. A është e mundur që Mëshiruesi i Madh i cili u përgjigjet me dhembshurinë e tij kërkesës për ndihmë edhe të gjallesave që duken si më pa rëndësi, të mos e plotësojë këtë dëshirë të njeriut që digjet nga dëshira e përjetësisë?

3. Etapat e jetës së ahiretit

a) Jeta e varrit

Jeta pas vdekjes do të realizohet në dy faza. E shprehur ndryshe, pas vdekjes, njeriu do të kalojë nëpër dy botë. E para, bota e varrit²¹⁰ e cila, si kjo botë, do të marrë fund. Tjetra është bota e ahiretit e cila nuk do të marrë fund në asnjë formë. Jeta e varrit emërtohet edhe *berzah*, jetë e ndërmjetme.

Si fjalë, *berzah* do të thotë perde, pritë (barrierë) dhe pengesë mes dy gjërave. Kurse si terminologji, përdoret me kuptimin e botës ku do të qëndrojnë shpirtat pas vdekjes gjer në kiamet, botë e varrit, korridor mes kësaj bote dhe ahiretit, sallon pritjeje. *Berzah* është një urë mes kësaj bote dhe ahiretit. Në Kur'an, kjo fjalë është përdorur edhe me kuptimin leksikor, edhe me kuptimin terminologjik.²¹¹

Në Kur'an ka shumë ajete që tregojnë për ekzistencën e mundimit dhe ndëshkimit të varrit. Nga këta, në një ajet të sures Mumin thuhet kështu:

"... Ata (familja e faraonit) i jepen zjarrit mëngjes e mbrëmje. Edhe ditën kur do të shpërthejë kiameti, do t'u thuhet (engjëjve të ngarkuar me detyrë): "Njerëzit e faraonit futini në mundimin më të rëndë!"²¹²

Në këtë ajet bëhet fjalë në mënyrë mjaft të hapur për një mundim para shpërthimit të kiametit, gjë që s'është tjetër veç mundimit të varrit. Pasi bëhet e ditur se familja e faraonit futet në zjarr, thënia (teksti arabisht jevme tekumu's-saatu) "dhe ditën kur të shpërthejë kiameti" në vijim e mbështet këtë. Kurse në një hadith profetik që bën të ditur se me vdekjen e njeriut fillon jeta e varrit, thuhet kështu: "Varri

²¹⁰ Varri i cili për një njeri pa besim shihet si një vend i frikshëm ku njeriu kalbet, po të vështrohet me syrin e besimit, shihet si një korridor i këndshëm i hapur për në vendin e përjetësisë.

²¹¹ Për kuptimin leksikor, shih Rahman, 55/20. Për kuptimin terminologjik, shih Muminun, 23/100.

²¹² Mumin, 40/46. Po kështu, shih Mumin, 40/11; Bakara, 2/28.

(berzah) është i pari i vendqëndrimeve të ahiretit. Për atë që shpëton aty, pastaj është më lehtë. Po të mos shpëtojë aty, pastaj do ta ketë më të vështirë!" (Tirmidhi, Zuhd, 5)

Edhe sikur njeriu të varroset në tokë pas një vdekjeje normale, edhe sikur të mbytet e të mbetet në det, edhe sikur të digjet dhe hiri t'i hidhet në ajër, patjetër do ta jetojë jetën e varrit dhe pastaj do të ringjallet. Në këtë botë të ndërmjetme, mohuesit do të kalojnë një jetë të hidhur e me shqetësime, kurse besimtarët do të kalojnë një jetë të lumtur e pa shqetësime në vartësi të punëve të tyre.²¹³ Në hadithe njoftohet se dy engjëj të quajtur munkër dhe nekîr do t'u drejtojnë njerëzve pyetje, si "Kush është Zoti yt", "Kush është profeti yt", "Cili është libri yt", etj., dhe do t'i trajtojnë njerëzit sipas përgjigjeve që do të marrin prej tyre.²¹⁴

Ata që s'e pranojnë mundimin e varrit, kundërshtojnë duke thënë se "vetëm organizma e gjallë mund të mundohet" ose se "mundimin mund ta ndjejë vetëm gjallesa, njeriu i gjallë, kurse i vdekuri ku struktura e gjallë është prishur, nuk ndjen dhimbje e mundim". Meqë njeriu e sheh formën e jetës vetëm me këtë sintezë (organizëm), e pandeh këtë si kusht të pashmangshëm të jetës. E shprehur ndryshe, nuk mendon dot se Allahu mund të krijojë një formë tjetër jete që të mos ketë nevojë për këtë sintezë.

Në fakt, gjëja më e drejtë që duhet të bëjë njeriu në lidhje me çështjen e jetës së varrit e cila shpreh një dimension jete që i kapërcen kufijtë e dijes dhe mundësisë njohëse të njeriut, është që, pa u preokupuar me cilësinë e asaj jete dhe të mundimit në të, t'i miratojë njoftimet e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij dhe të bëjë përgatitje për atje.

b) Ringjallja dhe grumbullimi (hashr dhe neshr): shpërndarja e librave të punëve, hetimi dhe llogaridhënia, peshorja, sirati, hauzi Keuther

Fjala *hashr*, kuptimi leksikor i të cilës është mbledhje, grumbullim në një vend, si term fetar do të thotë *menjëherë pas ringjalljes në ditën e kiametit, mbledhje e të gjitha krijesave dhe çuarje e tyre në sheshin e grumbullimit*.

Kur'ani tregon se hashri është dita kur të gjithë njerëzit do të mblidhen bashkë²¹⁵ dhe do të dalë në shesh se, me të vërtetë, kush ka fituar dhe kush është gënhyer.²¹⁶ Gjithashtu, sipas Kur'anit, trajtimi që do t'u bëhet njerëzve që do të grumbullohen në vendgrumbullimin (mahsher), do të jetë sipas mënyrës së jetesës që kanë bërë në këtë botë. Kështu, në Kur'an²¹⁷ njoftohet se ata që i kanë larguar sytë nga Allahu, atë ditë do të grumbullohen si të verbër, se fytyra e mohuesve do të jetë e zezë dhe e dëshpëruar, kurse fytyra e besimtarëve, e ndritshme dhe e gëzuar.²¹⁸

²¹³ Shih Tirmidhi, Xhenaiz, 70.

²¹⁴ Shih Tirmidhi, Xhenaiz, 70; Musned, 3/126.

²¹⁵ Hud, 11/103.

²¹⁶ Shih Tegabun, 64/9.

²¹⁷ Taha, 20/124-126.

²¹⁸ Shih Al-i Imran, 3/106-107; Abese, 80/38-43.

Ndërkaq, në hadithet e të Dërguarit të Allahut lidhur me gjendjen e atyre që do të grumbullohen në mahsher, njoftohet se mahsheri është një rrafshinë e bardhë dhe e ndritshme, se njerëzit do të grumbullohen lakuriq, zbathur, të pabërë synet dhe pa të meta organesh.²¹⁹

Pas shpërthimit të kiametit dhe ringjalljes, fillojnë fazat e mahsherit që po i trajtojmë shkurt me radhë.

Shpërndarja e librave të punëve

Pasi njerëzit të grumbullohen në fushën e quajtur mahsher, u shpërndahen "librat e punëve" ku janë shënuar çdo fjalë që kanë thënë dhe çdo punë që kanë bërë sa kanë qenë në këtë botë. Cilësia e këtyre librave nuk dihet. Prandaj përngjasimi i tyre me librat apo fletoret e kësaj bote nuk është një veprim i qëlluar. Për këta libra ose shënime të mbajtur nga engjëjt, në Kur'an thuhet kështu:

"Më në fund, janë hapur librat dhe ti i sheh fajtorët të frikësohen nga gjërat e shënuara aty. Ata thonë: "Mjerë për ne, ç'libër qenka ky ku janë shënuar të gjitha pa lënë gjë të madhe a të vogël!" Kështu, ata kanë gjetur përballë bëmat e tyre. Zoti yt s'i bën askujt padrejtësi!" (Kehf, 18/49)

Kur'ani bën të ditur se librat e punëve do t'u jepen njerëzve të caktuar për në xhenet nga e djathta, njerëzve të caktuar për në xhehenem nga e majta ose nga pas. Ata që u jepet libri nga e djathta, emërtohen *as'habi jemin* (të djathtët, të vendosurit), kurse ata që u jepet nga e majta ose nga pas, *as'habi shimal* (të majtët, të shmangurit nga e drejta). Dhënia e librit nga e djathta është lajmërim për një fund të mirë, kurse dhënia nga e majta ose nga pas, lajmërim për një fund të keq.²²⁰

Hetimi dhe llogaridhënia

Në vendin e grumbullimit (mahsher), çdo njeri do të presë shkurt apo gjatë sipas vendit dhe gradës që ka pranë Allahut. Aty njerëzit do të hetohen dhe do t'u kërkohet llogari nga Allahu pa ndërmjetës. Në hadithet profetike bëhet e ditur se ndërsa besimtarët do t'u përgjigjen pyetjeve me lehtësi, mohuesit do të kalohen përmes një hetimi dhe llogarimarrjeje të imtë.²²¹

Gjatë hetimit dhe llogaridhënies, përveç librit të punëve, po të duhet, për njerëzit do të dëshmojnë edhe organet²²² e trupit të tyre, edhe toka.²²³ Gjatë hetimit dhe llogaridhënies kur ai që ka bërë të mirë qoftë edhe sa grimca, do ta marrë shpërblimin e të mirës së tij, dhe kur ai që ka bërë të keqe qoftë edhe sa grimca, do ta marrë ndëshkimin e të keqes së tij, njerëzit nuk do të lihen pa u përgjigjur për këto pesë gjëra:

a) Ku e kanë shpenzuar jetën.

²¹⁹ Shih Buhari, Rikak, 44, 45; Muslim, Xhenet, 14; Tirmidhi, Tefsir, 18. Ndërsa nuk ka kontradikta mbi çështjen e grumbullimit të krijesave që u është paraqitur propozim, mes sunnitëve dhe mutezilitëve ka pasur kontradikta mbi grumbullimin e kafshëve dhe insekteve (të cilave nuk u është paraqitur propozim). Sunnitët kanë thënë se "edhe kafshët do të grumbullohen, por grumbullimi i tyre nuk do të bëhet për ndonjë shpërblim; pasi t'u përgjigjen pyetjeve të Allahut, ato do të bëhen dhé". Kurse pikëpamja e mutezilitëve është kështu: "Siç do të grumbullohen qeniet bashkëbiseduese të propozimit (hyjnor), edhe kafshët do të grumbullohen për të mbetur përgjithmonë." (Shih Bagdati, *Usulu'd-din*, f. 236; Pezdevi, *Ehl-i Sunet Akaidi*, f. 226)

²²⁰ Shih Inshikak, 84/7-11.

²²¹ Shih Buhari, Rikak, 49; Muslim, Zekat, 20.

²²² Shih Fussilet, 41/21.

²²³ Shih Zilzal, 99/4.

- b) Si e kanë kaluar rininë.
- c) Në ç'rrugë e kanë përdorur diturinë dhe si kanë vepruar me të.
- d) Ku e kanë fituar dhe ku e kanë shpenzuar pasurinë.
- e) Ku e kanë përdorur dhe konsumuar trupin.²²⁴

Peshorja (mizan)

Si fjalë, *mizan* do të thotë peshore (terezi, drejtpeshim)²²⁵. Ajo që duhet të kuptojmë ne me peshoren (mizan), është peshimi dhe matja (vlerësimi) e punëve me mënyrën e përcaktuar nga Allahu. Ndërkaq, është e pamundur që ne të japim ndonjë gjykim mbi këtë peshore, cilësinë e të cilës e di vetëm Allahu. Në këtë peshim specifik, fytyrën e brendshme të të cilit nuk mund ta dimë, ata që do t'u rëndojnë më shumë të mirat, do të shpëtojnë, kurse ata, të mirat e të cilëve do të vijnë lehtë, do të shkojnë në xhehenem.²²⁶ Lidhur me peshoren (mizanin), në Kur'an thuhet kështu:

"Ditën e kiametit Ne do të ngremë peshoret. Më në fund, askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi në asnjë formë. Edhe sikur puna e bërë të jetë sa një kokërr sinapi, do ta vëmë në peshore. Ne i mjaftojmë çdokujt si llogaritës!" (Enbija, 21/47)

Sirati

Eshtë një urë mbi xhehenem ku do të kalojë gjithkush dhe ata që s'do të munden të kalojnë, do të bien në xhehenem. Edhe mbi cilësinë e vërtetë të siratit është e vështirë të thuhet diçka e saktë. Vetëm se një kalim i tillë sipas një mënyre që e di dhe e përcakton vetëm Allahu, do të ndodhë patjetër. Në hadithet profetike njoftohet se ata që do të kalojnë të parët mbi sirat do të jenë profeti Muhamed (sal'lallahu alejhi vesel'lem) dhe ummeti, bashkësia e tij, dhe gjatë këtij kalimi njerëzit do të kenë vështirësi apo lehtësi sipas punëve të tyre.²²⁷

Këtë urë mjaft të lehtë për t'u kaluar nga besimtarët dhe ata që kanë bërë punë të mira, kurse mjaft të vështirë për t'u kaluar nga mohuesit, mund ta interpretojmë edhe si "urë të ndërtuar nga njeriu gjatë gjithë jetës së tij në këtë botë me anë të punëve të tij të mira apo të këqija". Punët e këtushme të njeriut i vihen para atij si një urë. Duke u nisur nga kjo konsideratë, ndërsa punët e mira do të kryejnë funksionin e një ure të shëndoshë që ka për ta nxjerrë atë në bregun e shpëtimit (xhenet), punët e këqija do të kryejnë funksionin e një ure të kalbur që do të bëhet shkak për rrëzimin e tij në xhehenem. Të vërtetën Allahu e di!

Hauzi Keuther

Sipas njoftimit të haditheve, në ditën e kiametit, çdo profeti do t'i dhurohet një hauz. Ndërkaq, uji i hauzit që do t'i jepet profetit Muhamed (sal'lallahu alejhi vesel'lem), do ta ketë ngjyrën më të bardhë

²²⁴ Shih Tirmidhi, Sifatu'l-Kijame, 1.

²²⁵ Në esencë, mizan do të thotë "peshore farmacie" si simbol i peshores së pagabueshme. Përkthyesi.

²²⁶ Shih Karia, 101/6-9.

²²⁷ Shih Buhari, Ezan, 129; Muslim, Iman, 81.

se qumështi dhe aromën, më të këndshme se parfumi. Kush do të pijë prej tij, nuk do të ketë më etje kurrë. Profeti Muhamed (sal'lallahu alejhi vesel'lem) do të jetë i pari që në ditën e kiametit do të pijë ujë në këtë hauz, pastaj, me radhë, besimtarët që janë përpjekur në rrugën e Allahut dhe që i kanë shërbyer Islamit. Në hadithe përmbahen njoftime mbi ngjarjet që do të ndodhin pranë këtij hauzi. Ndërsa Profeti (sal'lallahu alejhi vesel'lem) do të jetë duke e pritur ummetin, bashkësinë e tij, kur të shohë se disa persona që i ka parë dhe njohur në këtë jetë do të jenë duke i çuar në xhehenem, do të ndjejë dhimbje dhe do të thotë: "Po ata janë shokët e mi, o Zot!" Atëherë atij do t'i thuhet: "Ata, duke mos e ruajtur dot drejtimin, u kthyen prapë dhe dolën jashtë vije!"²²⁸

Fjala *keuther* që përmendet në Kur'an në ajetin e parë të sures Keuther ku thuhet, "Pa dyshim, Ne të dhamë ty Keutherin" (Keuther, 108/108/1), në tefsiret është komentuar, përgjithësisht, si hauz. Prandaj, për hauzin e Profetit (sal'lallahu alejhi vesel'lem) në kiamet është thënë "Hauzi Keuther".

c) Çështja e shefaatit ose ndërmjetësimit për falje

Fjala *shefaat* që do të thotë *ndërmjetësim*, në terminologjinë fetare shpreh shfaqjen e mëshirës së Allahut në një dimension tjetër përmes përdorimit prej Tij si pretekst të profetëve, dijetarëve, dëshmorëve dhe besimtarëve sipas gradës së tyre²²⁹ për faljen në jetën e pasme, ahiret, të mëkateve të besimtarëve mëkatarë dhe për lartësimin në gradë të besimtarëve jomëkatarë.

"Atë ditë nuk bën dobi shefaati (ndërmjetësimi) i të tjerëve veç atyre nga të cilët Allahu është i kënaqur dhe veç atyre që u jep leje Ai!"²³⁰ Ky ajet tregon se shefaati përmbahet në Kur'an.

Ajetet e Kur'anit të cilët, lidhur me shefaatin, thonë se "nga askush s'do të pranohet ndërmjetësim"²³¹, nuk mund të paraqiten si argumente se nuk do të ketë ndërmjetësim për falje, sepse këto ajete sillen në ato vende të Kur'anit ku bëhet fjalë për fundin e mohuesve. Me këtë theksohet se mohuesit (qafir), politeistët (mushrik) dhe hipokritët (munafik) mbeten jashtë shefaatit, ndërmjetësimit për falje.²³²

Kurse në hadithet profetike ka njoftime të hapura lidhur me shefaatin. Kështu, në një hadith, Profeti (sal'lallahu alejhi vesel'lem) ka thënë se do të ndërmjetësojë për faljen e atyre personave nga ummeti, bashkësia e tij, që kanë bërë mëkate,²³³ kurse një një hadith tjetër ka bërë të ditur se për çdo profet ka një lutje të posaçme që i pranohet, kurse lutjen e vet ai do ta bëjë në ahiret për të ndërhyrë për falje për ummetin e vet.²³⁴ Gjithashtu, në një hadith tjetër, Profeti (sal'lallahu alejhi vesel'lem) ka thënë se, ndërsa në mahsher njerëzit do të jenë duke pritur të vuajtur e të emocionuar që të merren në pyetje, do t'i lutet Allahut që hetimi dhe llogaridhënia të mbarojnë një çast e më parë.²³⁵

Le të mendojmë se në një vend ku sundon një mbret i drejtë dhe i mëshirshëm, dikush ka bërë një faj. Por ky person që i është vërtetuar faji, nuk e ka bërë zakon një gjë të tillë. Ai e ka kryer fajin i shtyrë

²²⁸ Shih Buhari, Fitn, 1, Xhenaiz, 73, Rikak, 45; Muslim, Salat, 53.

²²⁹ Për ata që do të ndërmjetësojnë për falje, shih Ibni Maxhe, Zuhd, 37.

²³⁰ Taha, 20/109. Po kështu, shih Enbija, 21/28.

²³¹ Për shembull, shih Bakara, 2/123, 255.

²³² Shih Araf, 7/53; Gafir (Mumin), 40/18.

²³³ Shih Ebu Davud, Sunet, 21; Tirmidhi, Kijamet, 11.

²³⁴ Buhari, Davaat, 21; Muslim, Iman, 86.

²³⁵ Buhari, Zekat, 52.

nga disa motive egoiste, prandaj është penduar. Ai druhet nga ligjet e mbretit, veten e sheh fajtor dhe ndëshkimin që do t'i jepet, të drejtë. Ja dhe mbreti i mëshirshëm e sheh fajtorin të penduar dhe të frikësuar dhe i dhimbset. Mirëpo mbreti nuk mundet ta falë fajtorin pa arsye, sepse atëherë do t'i shkelte vetë ligjet që kishte vënë, populli do të fillonte t'i nënvleftësonte ligjet dhe njerëzit nuk do të kishin frikë më prej tij. Me këto shqetësime, mbreti ia hedh fjalën një funksionari të lartë apo kryeministrit se mund ta falë fajtorin. Atëherë, kryeministri, duke ndërhyrë dhe ndërmjetësuar pranë mbretit, bëhet pretekst për faljen e fajtorit. Ndërkaq, duke ia dhënë këtë mundësi kryeministrit, mbreti ia rrit autoritetin atij para popullit. Ja, pra, të këtij lloji janë të gjitha rastet e shefaatit për të cilat flitet në Kur'an dhe në hadithet profetike. Nisur nga kjo, ajo që i bie si detyrë njeriut për të merituar një shefaat të tillë, është të jetë i vëmendshëm në kryerjen e detyrimeve të kërkuara prej tij nga Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe, duke pasur frikë nga ndëshkimi i Allahut, t'i kërkojë ndihmë Atij!

d) Xheneti, xhehenemi dhe arafi

Xheneti

Fjala *xhenet*, kuptimi leksikor i të cilës është "vend (kopësht) i mbuluar me drurë dhe gjelbërim", në terminologjinë fetare emërton vendin e jetës tjetër, ahiretit, të pajisur me të mira e dhunti të papritura, ku besimtarët do të mbeten përjetësisht.

Xheneti dhe jeta në të janë të pafund. Pafundshmëria e jetës së xhenetit kurrsesi nuk do t'i velë dhe mërzitë njerëzit, sepse xheneti është vend i të papriturave. Ata që do ta meritojnë këtë jetë, do të zhvishen nga ndjenjat negative, si urrejtja, neveria dhe mërzitja, të ngulitura në krijimin e tyre tokësor mbështetur mbi disa urtësi të caktuara.

Kur'ani bën të ditur se në jetën e pasme, ahiret, njeriu do të pastrohet nga këto ndjenja të vendosura në këtë botë në natyrën e tij për një sërë urtësish. Për shembull, specifika e pastrimit të zemrës nga urrejtja shprehet kështu në Kur'an: "Në xhenet, ndërsa nën ta do të rrjedhin lumenj, Ne do t'ua hedhim prej zemre tërë urrejtjen!" (Araf, 7/43) Kështu, ata do ta jetojnë çdo çast në lumturi dhe hare.

Krahas përshkrimeve të ajeteve të Kur'anit që na e tërheq vëmendjen me shumë veçori të xhenetit,²³⁶ edhe kjo shprehje e Profetit (sal'lallahu alejhi vesel'lem) lidhur me xhenetin është një sihariq mjaft emocionues për ata që e besojnë: "Allahu urdhëron: "Për robtë e mi të mirë, Unë kam përgatitur gjëra që nuk i kanë parë sytë, që nuk i kanë dëgjuar veshët dhe që e kapërcejnë përftytyrimin e njeriut!"²³⁷

Po që se do ta shprehnim me një fjali të shkurtër, xheneti është vendi i të papriturave dhe shfaqje e mëshirës dhe favorit të pakufishëm të Allahut për robtë e vet. Nisur nga kjo, asnjë njeri nuk mundet ta fitojë të drejtën për aty me punën e vet. Pra, punët e bëra nga njeriu kurrë nuk mjaftojnë për ta fituar xhenetin. Për më tepër, adhurimet e një njeriu jo vetëm s'mjaftojnë për xhenetin që do t'i jepet atij në të ardhmen, por s'mjaftojnë as për t'iu përgjigjur një të mjtës së mirësive dhe dhuntive që ia jep Allahu në këtë botë! Me të vërtetë, në një hadith profetik tërhiqet vëmendja mbi këtë specifikë në këtë mënyrë:

²³⁶ Shih Al-i Imran, 3/133; Kehf, 18/21; Jasin, 36/56; Saffat, 37/47; Insan, 76/13; Muhamed, 47/15; Vakia, 56/28-29; Nebe, 78/32; Mutaffifin, 83/25.

²³⁷ Buhari, Tefsir, 32; Muslim, Xhenet, 1.

"Kur i Dërguari i Allahut tha se "asnjë punë e një njeriu nuk mund ta bëjë atë që të hyjë në xhenet", sahabet e pyetën: "A edhe puna jote s'të fut dot ty në xhenet, o i Dërguari i Allahut?" Atëherë, i Dërguari i Allahut iu përgjigj: "Po të mos ishte mëshira dhe falja gjithëpërfshirëse e Allahut, as puna ime mua!"²³⁸

Dhuntia e shikimit të Allahut (rujetullah)

Dhuntia dhe lumturia më e madhe që mund të meritojnë ata që ndodhen në xhenet, do të jetë kur Allahu t'ua tregojë veten atyre. Këtë situatë Allahu (xh.xh.) e lajmëron personalisht vetë: "Ka fytyra që atë ditë do të vezullojnë plot dritë dhe do ta shikojnë Zotin e tyre!" (Kijame, 75/22-23) Kurse në një rivajet (hadith profetik) autentik që e mbështet domosdoshmërinë e kuptimit në këtë mënyrë të këtij ajeti, thuhet: "Pa dyshim, siç e shihni këtë hënë, do ta shihni edhe Zotin tuaj si dhe nuk do ta dëmtoni njëri-tjetrin për shkak të grumbullimit të madh aty!"²³⁹

Në hadithin e mësipërm bëhet e ditur se Allahu do të shihet nga besimtarët siç shihet hëna. Në fakt, kjo shprehje ka për qëllim të mënjanojë, me anë të një përgjigjeje të prerë, ndonjë dyshim mbi çështjen e shikimit të Allahut, pra, është një shprehje që thekson se Allahu do të shihet patjetër, por nuk ka kuptimin se njerëzit do ta shohin (do ta përceptojnë dhe njohin) Individualitetin Hyjnor të Allahut siç është. Një mendim të tillë nuk e lejon as ajeti që thotë se "shikimet nuk mund ta përceptojnë Atë, kurse Ai i percepton shikimet". (En'am, 6/103) Sepse krijesa kurrë nuk mund ta përfshijë Krijuesin. Në këto kushte, çdo besimtar në xhenet do ta shohë Allahun - në një mënyrë të panjohur për ne - në atë masë sa ç'e ka zhvilluar besimin dhe afrimin ndaj Allahut në këtë botë. Sipas kësaj, shikimi i Allahut nga një besimtar kushdo do të jetë i ndryshëm nga shikimi i Allahut prej profetëve.

Xhehenemi

Fjala *xhehenem* që do të thotë "gropë e thellë", në terminologjinë fetare emërton vendin e ndëshkimit në jetën e pasme, ahiret, ku mohuesit do të mbeten përgjithmonë, kurse besimtarët mëkatarë do të qëndrojnë sa për t'u ndëshkuar për mëkatet që kanë bërë.

Në Kur'an, për të tërhequr vëmendjen për aspekte të ndryshme të xhehenemit, ky është përmendur me emërtime të ndryshme, si *nar* (zjarr), *xhahim* (zjarr me shtresa, një shtresë e xhehenemit), *haviye* (vendi më i frikshëm, shtresa e shtatë e xhehenemit), *sair* (flakë, shtresa e dytë e xhehenemit), *ledha* (zjarr, shtresa e gjashtë e xhehenemit), *sakar* (ferr) dhe *hutame* (shtresa e pestë e xhehenemit). Ky ndëshkim do t'i rrethojë përjetësisht ata që e kanë mohuar Allahun me vetëdije.²⁴⁰ Kurse besimtarët mëkatarë nuk do të qëndrojnë aty përjetësisht, por, pasi ta vuajnë dënimin, do të vendosen në xhenet.²⁴¹

Në këtë mes, në mendje mund të vijë një mendim i tillë: Ndëshkimi me një vuajtje të përjetshme i mohimeve dhe kundërshtimeve të kufizuara në një jetë të kufizuar nuk mund të shpjegohet me drejtësinë dhe mëshirën e Allahut.

²³⁸ Buhari, Rikak, 18; Muslim, Munafikun, 71-76.

²³⁹ Buhari, Mevakif, 16; Muslim, Iman, 81.

²⁴⁰ Shih Nisa, 4/169, 4/196; Ahzab, 33/65.

²⁴¹ Shih Buhari, Rikak, 51; Tirmidhi, Birr, 61.

Është një e vërtetë e njohur se çdo qenie ose krijesë ka një vlerë të madhe të fituar në sajë të Krijuesit. Çdo gjë, si një vepër arti e pashoqe e Allahut, i shpall pa pushim, me gjuhën e vet të posaçme, ekzistencën, unitetin dhe emrat e bukur të Allahut. Ja, pra, njeriu i cili e ka bërë profesion mohimin, i zbret nga pozita e lartë këto qenie-nëpunës (të ngarkuar me detyrë) të Allahut dhe i rrëzon në një gradë pa detyrë e pa kuptim. Ndërsa çdo qenie ekzistente thotë, me gjuhën e saj, "Allahu ekziston, është një, është Zoti i çdo gjëje, kurse ne jemi nëpunës të ngarkuar me detyrë të Tij që lëvizim e veprojmë me urdhrin, lejen dhe fuqinë e Tij, jemi letra të shkruara që shprehin kuptime të gjera e që bartin mesazhe të gjera", mohuesi (qafiri), duke e mohuar një të vërtetë të tillë, kryen një faj të tmerrshëm.

Edhe pse një fyerje e tillë mund të ndodhë brenda një kohe të kufizuar, meqë rezultati i saj është një krim i madh, edhe dënimin dhe ndëshkimin e ka të këtyre përmasave. Për shembull, dënimi i dikujt që, duke e shkelur këmbëzën e armës vetëm dy sekonda, vret dy njerëz, nuk është një ndëshkim prej vetëm dy sekondash, por që zgjat një jetë të tërë. Kurse faji i mohuesit është një mijë herë më i tmerrshëm se krimi i vrasjes, sepse me mohimin e tij ai kryen krimin e asgjësimit të kuptimeve dhe mesazheve të përfaqësuar dhe të shpallura nga qenie të panumërta. Shkurt, meqë çdo mohim i mohuesit është mohim i një të vërtete të përhershme, do të rezultojë privimin e tij të përhershëm nga mëshira e Krijuesit të Lartë.

Një specifikë tjetër që duhet theksuar në lidhje me xhehenemin, është kjo: Siç mund të kuptohet lehtësisht nga tabllotë konkrete të vizatuara si nga Kur'ani, ashtu dhe nga hadithet profetike, ndëshkimin dhe vuajtjen e xhehenemit do ta heqë shpirti bashkë me trupin. Ndërkaq, ne nuk mund ta dimë plotësisht fytyrën e brendshme të ndëshkimit të zjarrit, sepse edhe nëse kjo botë për të cilën na flitet neve, mund të ketë ndonjë ngjasim me botën ku jetojmë, është jashtë çdo diskutimi se nuk është identike me të!

Arafi

Fjala *araf*, kuptimi leksikor i të cilës është majë, vend i lartë, mur, mal, emërton një vend të lartë që ndodhet mes xhenetit dhe xhehenemit. Lidhur me ata që ndodhen në araf, në Kur'an thuhet kështu:

"Mes të dy palëve (atyre të xhenetit dhe atyre të xhehenemit) ka një perde dhe njerëz që e njohin çdokënd nga fytyra. Këta që s'kanë hyrë ende në xhenet, duke ndenjur me shpresë, u bëjnë zë atyre të xhenetit duke i përshëndetur: "Paqe juve!" Kurse kur i kthejnë sytë nga ata të xhehenemit, thonë: "Zoti ynë, mos na vendos bashkë me grupin e mizorëve!" (Araf, 7/46-47)

Në fakt, Araf do të thotë interval, vend në mes. Me kuptimin që del nga ajeti, ndodhet mes xhenetit dhe xhehenemit, por mbi cilësinë e tij nuk kemi asnjë njohuri.

Kush janë personat që ndodhen këtu? Ka shumë përgjigje që i janë dhënë kësaj pyetjeje. Por të gjitha përgjigjet kanë të bëjnë me konceptimin. Sepse edhe për arafin, edhe për ata që ndodhen në araf, ne nuk dimë ndonjë rivajet (thënie) tjetër veç asaj që thuhet në Kur'an. Në Kur'an paraqiten tre tablo të veçanta dhe, në këtë mes, bëhet fjalë për njerëzit që ndodhen në arafat.

Në pjesën e parë, zë vend pyetja e banorëve të xhenetit për banorët e xhehenemit. "Banorët e xhenetit pyesin: "Ne e pamë se premtimi i Zotit tonë për ne ishte i vërtetë. Po ju, a patë të vërtetë premtimin e Zotit tuaj për ju?" Kësaj pyetjeje, banorët e xhehenemit i përgjigjen "Po!".

Mu në këtë mes, një thirrës thotë: "Mallkimi i Allahut rëntë mbi mohuesit!" (Araf, 7/44)

Në tabllonë e dytë e marrin fjalën banorët e arafit. Ata shohin nga banorët e xhenetit dhe u thonë: "Paqe juve!" Pastaj i hedhin vështirimet nga banorët e xhehenemit dhe thonë: "Zoti ynë, mos na vendos bashkë me grupin e mizorëve!"

Pastaj ua kujtojnë parësisë që njohin nga banorët e xhehenemit, fjalët që kanë thënë në këtë botë dhe ua përplasnin syve faktin se atyre s'u kanë sjellë dobi as pasuria, as fëmijët. Duket sikur kjo skenë ndërron dhe dëgjohen këto fjalë të banorëve të arafit për banorët e xhenetit: "Hyni në xhenet se për ju nuk ka më frikë dhe ju s'keni për t'u dëshpëruar!" (Araf, 7/49)

Kurse në tabllonë e tretë, banorët e xhehenemit u luten banorëve të xhenetit t'u japin edhe atyre nga të mirat që u janë dhënë: "Lëshonani edhe neve nga uji ose të mirat që ju ka dhënë Allahu!" Kurse banorët e xhenetit u japin këtë përgjigje: "Allahu ua ka bërë haram (ua ka ndaluar) këto mohuesve (qafirëve)!" (Araf, 7/50)

Kjo do të thotë se banorët e arafit, nga njëra anë janë në marrëdhënie me banorët e xhenetit, nga ana tjetër, me banorët e xhehenemit. Që të dy palët i njohin e i dinë nga afër.

Në këtë mes, disa nga sahabet kanë thënë se araf janë ballkonet e siratit, kurse banorët e arafit janë njerëz me mirësi dhe mëkate në nivel të barabartë. Kurse disa sahabe të tjerë kanë thënë se banorët e arafit janë profetët, dëshmorët (shehidët), dijetarët dhe njerëzit me shpirt të lartë pothuaj të engjëllorizuar. Ata vështrojnë që larg, shohin çdo gjë që ndodh në të dyja largësitë dhe marrin pjesë në replikat si më lart. Mirëpo rivajetet (thëniet) me konsiderata të tilla nuk janë pranuar nga analistët.

Në bestytnitë dhe përshkrimet supersticioze²⁴², banorët e arafit konsiderohen njerëz me po aq mirësi sa mëkate. Disa thonë se këta janë engjëj me trajtë njeriu. Po që se pranohet kjo e fundit, shprehja e ajetit, "ve hum jatmeun", "ata kanë shpresë të hyjnë në xhenet", u adresohet njerëzve të caktuar për në xhenet të cilët, megjithëse e dinë se janë caktuar për në xhenet, ndodhen në një çast kur ende s'kanë hyrë në xhenet.

Sipas disa të tjerëve, këta njerëz (njerëzit e arafit) që shohin xhenetin dhe mbushen me shpresë, shohin xhehenemin dhe rrëqethen nga frika, janë persona që, për t'u bërë plotësisht të gatshëm për të hyrë në xhenet, duhet të shijojnë për një farë kohe një shqetësim dhe dëshirim të tillë.

Ndërsa disa mëkatarëve u bëhen dëmshpërblim shqetësimet që kanë hequr në këtë botë, disa të tjerëve u bëhet dëmshpërblim mundimi i varrit që i pastron ata nga mëkatet. Kurse ata që s'pastrohen me këto dy mënyra, në jetën e pasme, ahiret, do të kalojnë nëpër një proces të tillë pastrimi.

Një grup prej këtyre do të vazhdojnë të jetojnë në araf me shpresën e xhenetit dhe frikën e xhehenemit. Kjo formë jetese do të jetë për ta dëmshpërblim dhe pastrim nga mëkatet. Pastaj, me mëshirën dhe bujarinë e Allahut, do të hyjnë në xhenet.

Allahu (xh.xh.) e di të vërtetën dhe fytyrën e brendshme të çdo gjëje dhe vetëm Allahu e di se ç'është arafi dhe kush janë banorët e arafit!²⁴³

4. Rëndësia dhe vlera praktike e besimit mbi ahiretin për njeriun

²⁴² Në origjinal: israilijat (israiliyyat).

²⁴³ Fethullah Gylen, Lëkundjet që solli shekulli (përkth. në shqip nga M. Hoxha), vëll. 4, f. 123-125.

Kur'ani e ka përmendur besimin te jeta e pasme, ahireti, që është njëri prej tri bazave që përbëjnë themelin e kumtimit, tevhid (besimi monoteist islam), nubuvvet (profetësi) dhe ahiret (jeta e pasme), së bashku me besimin te Allahu.²⁴⁴ Fakti që Kur'ani i përmend së bashku këto dy baza besimi në shumë ajete, tregon se besimi te Allahu ngrihet mbi besimin te dita e ahiretit (kiametit, ringjalljes dhe jetës së amshuar) dhe plotësohet me të.

Besimi te ahireti bashkë me besimin te Allahu përbëjnë themelin e sistemit besimor tevhid. Këta dy elementë besimi shprehin vlerë së bashku. Po të lihet mënjanë besimi te ahireti, besimi te Allahu e humb kuptimin. Prandaj, në Kur'an, mohimi i ahiretit është vlerësuar si mohim i Allahut.²⁴⁵

Në Kur'an, pothuaj në çdo sure bëhet fjalë për ahiretin dhe me pretekste të ndryshme aludohet mbi këtë jetë.

Shkaku që i jepet kaq rëndësi jetës pas vdekjes, është se kjo jetë është faktori më i fuqishëm për forcimin nga Kur'ani të parimeve themelore dhe synimeve kryesore të tij. Sepse bindja mbi ringjalljen që i përfton një dimension të veçantë jetës së njeriut, i jep kësaj jete një kuptim dhe seriozitet që s'mund t'ia japë asgjë tjetër. Mund të thuhet se ajo që e bën njeriun njeri dhe që e forcon qenien e tij si qenie morale, është ndodhja e tij brenda një tendosjeje të tillë metafizike lidhur me përtejvdekjen.

E vërteta e jetës së amshuar përbën dimensionin më realist e më të thellë të ekzistencës të reflektuar tek të gjitha formimet (gjenezat) në botë. Nuk ka besim tjetër që ta lartësojë shpirtin e njeriut, ta rregullojë jetën, ta lartësojë njeriun në shkallën e merituar sa ky besim.

Kur'ani i cili, me besimin mbi ahiretin që ka sjellë, e ka vlerësuar çdo fushë hallall ose haram, të bukur ose të shëmtuar të jetës të kësaj bote, pas sjelljeve njerëzore pozitive e negative (konstruktive e destruktive) e shtjellon hapur rolin e besimit te ahireti.

Rëndësia që shpreh besimi te ahireti për sa i përket sigurimit të qetësisë dhe lumturisë së njeriut, ka një vlerë përtej çdo shpjegimi. Këtë mund ta përmbledhim kështu në formën e disa pikave:

a) Shpresa e njeriut që beson te dita e ahiretit, është gjithmonë e freskët, ai s'bie kurrë në pesimizëm. Ky besim e bën të aftë e të fuqishëm atë për të duruar përballë çdo fatkeqësie dhe sëmundjeje që mund ta zërë. Sepse kur një njeri i tillë e beson se të gjitha këto janë prej Allahut dhe i pranon, e di se Allahu do t'ia shpërblejë të gjitha në ahiret dhe qetësohet.

b) Vetëm besimi te ringjallja pas vdekjes e ngushëllon njeriun përballë vdekjes një pas një të të afërmeve të tij. Gjithashtu vetëm ky besim mund t'i qetësojë të sëmurët dhe pleqtë që e shohin se po shkojnë hap pas hapi drejt vdekjes!

c) Edhe zhvillimi i vetëdijes së detyrës dhe përgjegjësisë në kuptimin e vërtetë të fjalës te njeriu varet nga besimi i tij te vendbanimi i ahiretit ku do të bëhen të gjitha llogaritë e mëdha e të vogla. Vetëm njerëzve me këtë besim mund t'u thuhet "bëj ç'të duash", sepse është jashtë çdo diskutimi se njeriu me këtë mendësi do të ndjejë nevojën për të bërë punë që nuk do ta linin të turpëruar e nuk do ta fundosnin nën dhé në botën tjetër! Gjithashtu, personi me këtë besim, duke menduar se "po përgatitet një libër i cili ditën e kiametit do të m'i nxjerrë para të gjitha ç'kam bërë",²⁴⁶ do ta hedhë hapin me llogari dhe kujdes. Bie fjala, kujdesi i një nëpunësi që ka bindjen se fjalët e tij regjistrohen dhe i çohen shefit, nuk

²⁴⁴ Shih Al-i Imran, 3/113-114; Nisa, 4/38; Tevbe, 9/19; Hashr, 58/22.

²⁴⁵ Shih Rad, 13/5.

²⁴⁶ Duke aluduar mbi këtë pikë, në Kur'an thuhet kështu: "Më në fund, janë hapur librat dhe ti i sheh fajtorët të frikësohen nga gjërat e shënuara aty. Ata thonë: "Mjerë për ne, ç'libër qenka ky ku janë shënuar të gjitha pa lënë gjë të madhe a të vogël!" Kështu, ata kanë gjetur përballë bëmat e tyre. Zoti yt s'i bën askujt padrejtësi!" (Kehf, 18/49)

është i njëjtë me kujdesin e një nëpunësi tjetër që nuk e ka një informacion apo bindje të tillë. Shkurt, *besimi te dita e ahiretit është dorëzanësi më i madh i idesë së detyrës dhe përgjegjësisë!*

d) Një urtësi tjetër e kushtimit rëndësi në Kur'an kësaj shtylle besimi, është fakti që ky besim është një parim i nevojshëm në përmirësimin e shoqërisë. Edhe Volteri i cili nuk u besonte të vërtetave metafizike, duke mbetur i detyruar ta pohojë këtë, ka thënë: "Si dy baza që përbëjnë parimet morale, ideja e zotit dhe e jetës tjetër me të vërtetë bartin rëndësi të madhe!"²⁴⁷ Siç shihet, edhe në vështrimin e Volterit, ky besim është forca e vetme që mund ta ngrejë brenda shoqërisë e vetme kornizën morale më të lartë. Po qe se ky besim do të eliminohej, nuk do të gjenim dot ndonjë faktor nxitës dhe inkurajues për punë dhe veprimtari të mira.

e) Natyra njerëzore është e prirur për kënaqësi epshore dhe dëshira trupore. Këto janë vendosur në përbërjen e njeriut për shumë urtësi: vazhdimi i brezit, zhvillimi i jetës, rregullimi i faqes së tokës, etj. Ndërkaq, rrethi i hallallit (legjitimitetit)²⁴⁸ është i gjerë, i mjaftueshëm për kënaqësitë. Njeriu mund ta plotësojë çdo nevojë e ta kënaqë çdo dëshirë brenda rrethit të legjitimitetit pa pasur nevojë të hyjë në haram, pra, të përdorë rrugë dhe mjete ilegjitime. Por ç'e do se këto ndjenja tek njeriu mund të përdoren në drejtime të gabuara dhe, duke e zvarritur njeriun në rrugë jolegjitime, ta shkatërrojnë edhe në këtë botë, edhe në ahiret. Ja, vetëm frika nga llogaridhënia dhe rreziku i ndëshkimit mund ta pengojnë dhe mënjanojnë njeriun nga një rrezik kaq i madh. Ndërkaq, nuk mund të thuhet se zbatimi i ligjeve dhe frika nga humbja e të mirave janë të mjaftueshme për këtë gjë, sepse, disa herë, ligjet mund të mos zbatohen ose, edhe po të zbatohen nuk bëhen dot një zgjidhje përfundimtare. Veç kësaj, edhe humbja e të mirave nuk mund ta zëvendësojë frikën e llogaridhënies, sepse disa herë, personat e rënë ngushtë e gjejnë shpëtimin në vetëvrasje pa çarë kokën për humbjen e të mirave. Atëherë, është kusht që të jetë një forcë efektive që ta bëjë njeriun të druhet dhe të largohet nga dëmet që e presin. Vetëm parapëlqimi i rrugës së të mirës apo së të keqes nuk është i mjaftueshëm. Në këtë pikë është kusht prania e një elementi detyrues në parapëlqim, i cili të jetë i mjaftueshëm për ta drejtuar njeriun te e mira e për ta larguar nga e keqja. Kjo fuqi detyruese në parapëlqim s'mund të jetë tjetër veç besimit te jeta e pasme, ahireti!

5. Ndikimet negative të mohimit të ahiretit në jetën e njeriut

Po qe se këtë çështje e parashtrojmë në formë pikash, mund të themi këto gjëra:

a) Ndikimi negativ i mohimit të jetës së pasme, ahiretit, mbi njeriun është tejet i madh. Në mendjen e njeriut që e pranon vdekjen si një asgjësim, kurrsesi s'mund të formohet siguri dhe qetësi. Njeriut i cili nuk e mendon jetën e amshuar, mendimi i harrimit dhe asgjësimit i formuar çdo ditë me heqjen edhe të një flete tjetër nga kalendari i ngulet në zemër si shigjetë dhe e fut atë në një ankth të papërshkrueshëm.

b) Për dikë që s'ka besim ahireti, gjëja më e bukur dhe më e drejtë në botë është sigurimi i përfitimeve pavarësisht se me ç'rrugë e me ç'mënyrë, sepse para tij s'ka asnjë gjë tjetër që mund t'i zgjojë mall. Dhe, si përfundim i kësaj mendësie, ai vazhdimisht do të hajë hakun e të tjerëve, do të shkelë të drejtat e të tjerëve dhe do të shkaktojë konflikte. Shkurt, nuk do të druhet të përdorë mashtrimet më të shumëllojshme e më të ndyra.

²⁴⁷ Vahiduddin Han, el-Islam Jete-hadda, f. 147 (cituar nga Windelbant, History of philosophy, f. 496).

²⁴⁸ Këtu bëhet fjalë kryesisht për legjitimitetin fetar islam që, gjithashtu, ka shumë gjëra të përbashkëta me legjitimitetin e moralit të përgjithshëm. Përkthyesi.

c) Është e pamundur që mohuesit e ahiretit ta mbajnë veten larg prej dukjes dhe dyfytërsisë, sepse ata janë prej kohësh të gatshëm për të pranuar çdo lloj poshtërsie për të arritur interesa materiale.

d) Në sy të mohuesve të ahiretit, konceptet faj dhe mëkat nuk kanë ndonjë vlerë. Këto kanë vlerë vetëm kur dëmtohen interesat e tyre. Mirësitë dhe dobritë janë për ta vetë kokëtrashësia; po që se e keqja nuk lind ndonjë rrezik për ta, është e justifikueshme.

Është si rrjedhojë e të gjitha këtyre shkaqeve që Kur'ani përpiqet para së gjithash të formojë tek njeriu që kërkon ta edukojë, drojë në lidhje me jetën e pasme, ahiretin. Sepse po ta shohim me vëmendje zhvillimin e ngjarjeve, vëmë re se në themelin e të gjitha teprimeve dhe kundërshtimeve shtrihet ideja e jetesës pa e llogaritur ahiretin. Me të vërtetë, Kur'ani tërheq vëmendjen kështu mbi këtë specifikë:

"Jo, me të vërtetë ata nuk frikësohen nga ahireti!" (Mudeththir, 74/53)

VENDIMI HYJNOR: KADERI

Kuptimi i konceptit kader

a) Kuptimi leksikor

Kuptimi leksikor i fjalës *kader* është "matje, vlerësim, përcaktim, formësim, trajtësim", etj. Folja arabishte (kadera) ka-de-ra do të thotë "caktoi, ndau në pjesë dhe secilit i caktoi pjesën e vet, pati fuqi". Në trajtën (kaddera) kad-de-ra do të thotë "vendosi, e imponoi vendimin dhe e ekzekutoi". Një fjalë tjetër që ka lidhje me kaderin, është fjala *kaza*. Fjala *kaza* do të thotë "urdhër, vendim dhe ekzekutim".

Maturiditët dhe esh'aritët si dy degë të rëndësishme të drejtimit sunnit, i kanë kuptuar konceptet kader dhe kaza për sa i përket kuptimit, në mënyrë të kundërt. Atë që esh'aritët e kanë konsideruar kaza, maturiditët e kanë trajtuar si kader dhe anasjelltas. Kontradikta mes tyre është një mosmarrëveshje leksikore.

b) Kuptimi terminologjik

Sipas maturiditëve, kaderi është vendimi i Allahut, kurse kazaja, ekzekutimi i këtij vendimi nga ana e Tij, pra, kryerja e gjësë për të cilin ka marrë vendim dhe zbatimi i vendimit. Sipas esh'aritëve, kazaja është vendimi eternal i Allahut, vendimi i Tij i marrë në pafillimshmëri. Kurse kaderi është realizimi i vendimit pasi të jenë formuar (krijuar) kushtet përkatëse.

Kaderin dhe kazanë me këndvështrimin e maturiditëve mund ta parashtrojmë kështu:

Kaderi është planizimi dhe programimi nga Krijuesi i Lartë që zotëron dijen e pasosur, që i sheh të shkuarën, të tashmen dhe të ardhshmen si një pikë të vetme dhe për të cilin nuk ka të shkuar, të tashme e të ardhshme, i tërë gjithësisë, nga mikrobota në makrobotë e gjer te njeriu me strukturën e tyre informative dhe vlerësimi dhe shënimi i çdo gjëje që ka për të ndodhur, para se të ndodhë, përfshi edhe procesin e marrjes së këtyre nga plani informativ për t'i ekspozuar në botën e ekzistencës me anë të vullnetit dhe fuqisë së Tij, në një *Libër* me cilësi të panjohur për ne. Kurse kazaja është zbatimi nga Zoti i gjërave të caktuara dhe vendosura prej Tij në pafillimshmëri, kur t'u vijë koha, me anë të vullnetit dhe fuqisë së Tij dhe në përputhje me dijen e tij eternale.

Tema e kaderit si një parim besimi

Mund të themi se domosdoshmëria e besimit te kaderi në Islam buron nga dy argumente. I pari, fakti që në shumë ajete flitet për kaderin dhe prania e haditheve që bëjnë të ditur në mënyrë mjaft të qartë domosdoshmërinë e besimit te kaderi. I dyti, domosdoshmëria e besimit te atributet absolute, të pakushtëzuara e të pakufizuara të dijes, vullnetit dhe fuqisë të Zotit.

Në Kur'an ka shumë ajete që na bëjnë të ditur neve ekzistencën e kaderit lidhur me njeriun. Le t'i marrim dhe analizojnë këtu disa prej tyre.

"Nuk ka as në tokë e as në veten tuaj ndonjë gjë që të dalë në shesh (duke ju bërë të dëshpëroheni ose të gëzoheni) e të mos jetë në një libër para se ta krijojmë Ne. Me të vërtetë, kjo është e lehtë për Allahun. Kjo (ndodh kështu) me qëllim që të mos dëshpëroheni për atë gjë që ju del dore dhe të mos përkëdheleni për të mirat që ju jep Allahu..." (Hadid, 57/22)

"Thuaju: "Neve s'na vjet gjë tjetër veç asaj që ka shkruar Allahu për ne!" (Tevbe, 9/51; En'am, 6/38; Jasin, 36/12)

"Pa dyshim, vetëm Ne mund t'i ngjallim të vdekurit! Ne e shkruajmë çdo punë që bëjnë dhe çdo gjurmë që lënë ata. Dhe e kemi numëruar çdo gjë në një libër krejt të qartë!" (Jasin, 36/12)

Ajeti i parë flet në një mënyrë mjaft të qartë se të gjitha qeniet, dukuritë dhe ngjarjet, përfshi edhe njeriun dhe çdo situatë lidhur me të, para se të dalin në sheshin e ekzistencës, ndodhen të shkruara në një libër. Po kështu, ajeti i dytë tërheq vëmendjen mjaft qartë mbi këtë të vërtetë për sa i përket njeriut, dhe ajeti i tretë, mbi të cilin sapo u përqëndruam, na e bën të ditur neve çdo shkrim (shënim) lidhur me njeriun.

Me këto ajete, Kur'ani na tregon në një mënyrë që të mos ketë nevojë për asnjë koment ose interpretim se çdo gjë ekziston në dijen hyjnore para se të dalë në sheshin e ekzistencës. Le të ndalemi tani këtu dhe le t'i drejtojmë vetes këtë pyetje: A nuk nënkupton, në fund të fundit, thënia e Allahut për diçka, "kjo është kështu", "besojeni se kjo është kështu"? E shprehur më qartë, a nuk nënkupton thënia e Allahut, "çdo gjë që ka për t'ju ndodhur dihet nga Allahu që më parë", "besojeni se çdo gjë që ka për t'ju ndodhur dihet nga Allahu që më parë"?

Sipas opinionit tonë, meqë besimi te Allahu dhe te atributet e Tij të lartë, si dija, vullneti, fuqia, etj., përfshin edhe besimin te kaderi dhe kazaja, në ajetet²⁴⁹ që i bëjnë të ditura bazat e besimit së bashku, kjo shtyllë e besimit (ky element përbërës i besimit) nuk është theksuar veç. E thënë ndryshe, meqë besimi te kaderi, në themel, përfshihet në bazën e besimit te Allahu, nuk është përmendur në Kur'an shprehimisht në mënyrë të veçantë. Sepse, "ata që besojnë se Allahu është krijuesi i gjithësisë dhe se dija dhe vullneti i Tij përfshijnë të pjesët dhe të tërën, kanë besuar edhe te kaderi dhe kazaja. Duke u mbështetur mbi rëndësinë e posaçme të çështjes, domosdoshmëria e besimit te kaderi dhe kazaja është sqaruar në mënyrë të veçantë në hadithet profetike."

Profeti (alejhisssalatu vesselam) e ka shpjeguar duke e shqyrtuar në hollësi çështjen e kaderit që trajtohet në ajete. Si një bazë besimi, besimi te kaderi zë vend në hadithe me shprehje mjaft të hapura. Veçanërisht hadithi profetik i cituar nga Muslimi në fillim të veprës së tij "Sahih", bart një rëndësi të madhe për sa i përket formulimit të besimit islam. Nga ky hadith i gjatë që ka për rrëfyes Hz. Omerin (r.a.), do të mjaftohemi këtu me përcjelljen vetëm të pjesës lidhur me temën tonë:

"... besim do të thotë t'u besosh Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij, ditës së ahiretit dhe kaderit, të mirës dhe të keqes..."²⁵⁰

Në këtë hadith thuhet "... edhe në të keqen (sherr) prej Tij..."; besimi se ashtu si e mira, edhe e keqja e kanë prejardhjen nga Allahu, do të thotë besim se dalja edhe e të mirës, edhe e të keqes dhe fatkeqësisë në sheshin e ekzistencës bëhet me vullnetin dhe fuqinë e Allahut dhe jo se Allahu dëshiron të keqen për njeriun kundër tij, sepse Allahu nuk është kurrë pro as ndaj mohimit, as ndaj ndonjë akti mohues të robve të Tij.²⁵¹

Shkurt, po ta marrim e ta trajtojmë çështjen e kaderit nga një perspektivë e gjerë pa e shtrënguar brenda kallëpeve të ngushtë, vëmë re se bazat e besimit janë të rrethuar me besimin (parimin) e kaderit dhe kazasë. Sepse, Krijuesi i Lartë, duke nisur me njohjen e ekzistencës së vet, e ka vlerësuar dhe përcaktuar që më parë kuptimin dhe qëllimin përfundimtar të jetës që do të krijonte dhe të botës përtej saj, cilëve profetë do t'u zbriste mësimet (libra) për këtë dhe me anë të cilëve engjëj. Të mendosh të kundërtën, do të thotë të pretendosh se Ai vepron spontanisht, si të vijnë ngjarjet, gjë që me të vërtetë është e pamundur.

Pozicioni i vullnetit të njeriut përballë vullnetit hyjnor

Në Kur'an, koncepti kader ka të bëjë jo vetëm me njeriun, por me tërë gjithësinë, nga grimcat e mikrobotës, gjer te makrobota. Pra, çdo qenie, për daljen e së cilës në fushën e ekzistencës brenda linjës shkak-pasojë bëhemi dëshmitarë, formohet brenda një programi hyjnor, kaderit. Po të shqyrtohen me vëmendje ajetet përkatëse, kjo specifikë shihet fare qartë.²⁵²

Duke e marrë në dorë çështjen e kaderit lidhur me njeriun, Kur'ani, e trajton kaderin herë në aspektin e vullnetit të Allahut dhe herë në aspektin e vullnetit të njeriut. Ndërkaq, po qe se kjo nuk shihet si një e tërë, mund të pandehet se këto ajete të paraqitur vëmendjes nga dy kënde të ndryshme, bien në kontradiktë. Por gjendja nuk është aspak kështu. Le t'i marrim me radhë këto ajete.

²⁴⁹ Shih Bakara, 2/177, 285; Nisa, 4/136.

²⁵⁰ Muslim, Iman; Ebu Davud, Sunet, 16.

²⁵¹ Shih Zumer, 39/7.

²⁵² Shih Kamer, 54/49; Rad, 13/8; Junus, 10/44; Neml, 27/75.

a) Ajetet që tregojnë se njeriu është i lirë në aktet dhe veprimet e tij

"Pa dyshim, Ne i treguam atij rrugën e drejtë. Po të dojë, le të jetë falenderues, po të dojë, mosmirënjohës!" (Insan, 76/3)

"Thuaju se e vërteta është prej Zotit tuaj. Tashmë kush të dëshirojë të besojë, të besojë, kush të dëshirojë të mohojë, të mohojë!" (Kehf, 18/29)

"Kushdo që të bëjë një punë të mirë, do ta ketë për të mirë të vet dhe kushdo që të bëjë një punë të keqe, do ta ketë për të keqe të vet. Zoti yt kurrë nuk u bën të keqe robve të vet!" (Fussilet, 41/46)

"Çdo nefs (frymë, vete, njeri) është peng i bëmave të veta!" (Mudeththir, 74/39)

"Thuaju: 'O njerëz, ju ka e vërteta (Kur'ani) nga Zoti juaj; kush të bëjë siç thotë ai, e ka bërë për vete dhe kush të largohet prej tij e të bjerë në rrugë të shtrembër, do t'ia bëjë vetes!' (Junus, 10/108)

Këto ajete, disa prej të cilave i morëm si shembull këtu, tregojnë se njeriu është i lirë në punët dhe veprimet e veta dhe prandaj është përgjegjës për punët dhe veprimet e veta.

b) Ajetet që tregojnë se dëshira volitive hyjnore është bazë

"Po s'dëshiroi Allahu, ju s'mund të dëshironi!" (Insan, 76/30)

"Po të donte Allahu, nuk do ta bënin dot atë gjë!" (En'am, 6/37)

"Po të mos donte Allahu, nuk do të besonin!" (En'am, 6/111)

Siç shihet, në ajetet e grupit të parë (a) theksohet se njeriu është një qenie e lirë, kurse në ajetet e grupit të dytë (b) theksohet se bazë dhe përcaktues është vullneti hyjnor. Mes këtyre dy grupe ajetesh nuk ka ndonjë vështirësi konceptuale të pakapërcyeshme. Në ajetet e grupit të parë, çështja është trajtuar në aspektin e saj që ka të bëjë me vullnetin e njeriut, kurse në ajetet e grupit të dytë, çështja është trajtuar në aspektin e saj që ka të bëjë me vullnetin e Krijuesit të Lartë.

Atëherë, këto ajete mund t'i vlerësojmë me këtë shprehje: Duke marrë për bazë vullnetin hyjnor, njeriu është një qenie që mund të bëjë ç'të dëshirojë. Kuptimi i kësaj është ky: Zoti e ka bërë vullnetin tonë kusht elementar për vullnetin e vet të përgjithshëm. Realizimi ose dalja në skenën e ekzistencës e një gjëje çfarëdo materiale apo jomateriale (moralo-shpirtërore) që e dëshiron njeriu në mënyrë të vullnetshme, nëse mund të shprehemi kështu, varet nga viza e vullnetit hyjnor.

Si domosdoshmëri e zakonit hyjnor (adetullah), njeriu është i lirë të dëshirojë, vetëm se realizimi i gjësë së dëshiruar prej tij varet nga vullneti dhe fuqia hyjnore; dëshirimi i njeriut nuk shpreh asgjë (nuk ka asnjë vlerë) po qe se Allahu nuk e dëshiron po atë gjë dhe nuk jep leje për realizimin e saj. E thënë ndryshe, po qe se dëshira volitive e njeriut nuk merr miratimin dhe lejen e vullnetit hyjnor, nuk realizohet gjë. Çdo gjë që bëhet (realizohet), bëhet brenda lejes dhe vullnetit të Zotit. Asgjë nuk mund të realizohet pavarësisht nga vullneti i Tij. Kështu, në një hadith profetik thuhet kështu:

"Ajo që dëshiron Allahu bëhet. Kurse ajo që s'e dëshiron Ai, kurrë s'mund të bëhet!" (Ebu Davud, Edeb, 106)

Kurse në një ajet ku Allahu na e parashtroi çështjen në të dy aspektet, domethënë, edhe në aspektin e vullnetit hyjnor, edhe në aspektin e vullnetit njerëzor, thotë kështu:

"Ai (Kur'ani) s'është tjetër veçse një këshillë për botët, për ata nga ju që dëshirojnë të orientohen. (Por) Po të mos dëshirojë Allahu, Zoti i botëve, ju s'mund të dëshironi!" (Tekvir, 81/27-29)

Në emër të kuptimit të pozicionit të vullnetit të njeriut përballë vullnetit hyjnor, dëshirojmë të përcjellim këtu interpretimin shumë konciz dhe elegant të F.Gylenit: “Allahu e ka pranuar aktin tonë që është një realitet konvencional, si ftues të dëshirës dhe vullnetit të Tij, i ka dhënë rëndësi atij, ka premtuar se do t’i bëjë realitet projektet më të mëdha duke u mbështetur mbi të dhe e ka krijuar këtë element konvencional si një pretekst për mirësinë dhe mëkatën, e ka bërë bazë atë për shpërblimin dhe ndëshkimin, e ka pranuar si subjekt të cilit i dedikohet e mira dhe e keqja dhe këtij akti relativ i cili nuk shpreh asnjë vlerë në vetvete dhe, sipas rezultateve që kanë lidhje me të, i ka ngarkuar vlera mbi vlera që, po të mos qe kështu, jeta do të ndalonte me të tëra, njeriu do të binte në nivelin e sendeve pa jetë, propozimi do ta humbte kuptimin dhe çdo gjë do të kthehej në kotësi... Prandaj, gjithsesi, do t’u jepte jashtëzakonisht rëndësi atij si dhe kërkesave dhe dëshirave të tij dhe, duke e sjellë atë në gjendjen e një kushti elementar, e një preteksti të respektuar për rregullimin e kësaj bote dhe përjetësisë si dhe në gjendjen e një butoni magjik të një mekanizmi elektrik që do t’i ndriçonte botët, do ta tregonte edhe një dimension tjetër enigmatik të fuqisë së Tij duke krijuar në një pikë uji, detin, në një molekulë, diellin, në një gjë aspak të rrallë, në një gjë që s’ekziston, botët!”²⁵³

Besimi te kaderi - Liria e njeriut

Nuk është e drejtë ta shohësh bazën besimore të besimit te kaderi në Islam si në kundërshtim me lirinë e njeriut, sepse të thuash se një musliman beson te kaderi, në parim do të thotë se ai beson se çdo gjë ekziston me dijen, dëshirën, fuqinë dhe aktin krijues të Allahut, se nuk ka krijues tjetër veç Allahut.

Besimi te kaderi s’do të thotë mohim i përgjegjësisë tek njeriu, sepse Islami na kërkon edhe të pranojmë një qenie të lartë që zotëron vullnetin e përgjithshëm dhe fuqi dhe që e ka krijuar gjithësinë, edhe se Ai i ka krijuar njerëzit si qenie me vullnet, edhe të pranojmë se mirësia dhe ndëshkimi janë ngritur mbi këtë vullnet.²⁵⁴ Kështu, besimi te kaderi dhe te parimi i zgjedhjes bëhen bashkë. Pyetjes nëse besimi i muslimanëve te kaderi bie në kundërshtim me mundësinë e tyre për të bërë zgjedhje me vullnetin e tyre të lirë, i ndjeri Ahmed Hamdi Akseki i është përgjigjur kështu në veprën e tij “Mësime morali”:

“Edhe nëse ka që e shohin besimin e muslimanëve te kaderi dhe kazaja në kundërshtim me parimin e zgjedhjes (e lirisë së vullnetit), kjo mendësi është kategorikisht e gabuar. Pasi të kuptohet ashtu siç duhet se ç’është besimi te kaderi në Islam, do të kuptohet lehtësisht se sa të gabuara janë mendime të tilla. Sepse të thuash që një musliman i beson kaderit, në fakt do të thotë që pranon se krijuesi i të mirës dhe të keqes është Allahu. Pra, muslimani i beson edhe Krijuesit të gjithësisë, zotërues të madhësisë dhe fuqisë, dhe vullnetit të përgjithshëm që i përket Atij, edhe ekzistencës së vullnetit të pjesshëm të dhënë atij (muslimanit) si bazë dhe partner të përgjegjësisë së vet. Feja islame na i mëson që të dyja këto. Nisur nga kjo, pranimi nga njerëzit i një vullneti hyjnor absolut dhe të përgjithshëm në gjithësi, nuk e asgjëson vullnetin e tyre të pjesshëm që është elementi esencial i përgjegjësisë së tyre!”²⁵⁵

Shkurt, Zoti, në çdo punë të të cilit ka urtësi dhe drejtësi, i ka dhënë njeriut një vullnet me qëllim që të mos kërkojë pretekste në gabimet dhe të metat e veta dhe që t’i bëhet njeriut burim për mirësi dhe

²⁵³ Fethullah Gülen, *Ruhumuzun Heykelini Dikerken*, f. 23.

²⁵⁴ Është njeriu që e zgjedh, e parapëlqen aktin, kurse është Allahu që e realizon atë, domethënë, që e nxjerr aktin në skenën e ekzistencës. E shprehur ndryshe, njeriu është ai që e përcaktor ngjyrën e aktit të tij, si të mirë apo të keq, me zgjedhjen e vet të lirë, kurse Allahu është ai që e krijon atë. Në këtë pranim që është pikëpamja e drejtimit sunnit, s’kemi të bëjmë me asnjë lloj kufizimi të vullnetit të njeriut.

²⁵⁵ Akseki, Ahmed Hamdi, *Ahlak Dersleri*, Nur Yay. Ankara, 1991, f. 77.

mëkate. Ky vullnet quhet vullnet i pjesshëm ose mundësi zgjedhjeje e pjesshme. Ja, pra, mundësia zgjedhëse e pjesshme që do të thotë të zgjedhësh, të duash të vësh qëllim dhe të tregosh vendosmëri për arritjen e tij, i del përballë njeriut i cili kërkon t’ia ngarkojë gabimin kaderit, dhe i thotë: “Je përgjegjës, sepse ti je që bërë zgjedhjen!”

Çështja nëse njohja paraprake e një gjëje nga Allahu përbën apo jo shtrëngim

Fakti që çdo akt i mirë apo i keq i kryer apo që do të kryhet nga njeriu, është i njohur dhe i caktuar (vlerësuar) nga Allahu në pafillimshmëri, nuk është diçka në kundërshtim me vullnetin e njeriut ose pavarësisht nga vullneti i njeriut. Sepse në caktimin (vlerësimin) e bërë aty ku është i pranishëm vullneti i njeriut, nga Zoti dihet se në ç’anë do të përdoret vullneti i tij dhe sipas kësaj bëhet vlerësimi dhe caktimi përkatës. Sikur, me këtë vlerësim dhe caktim, Zoti i thotë njeriut kështu: Unë e di se në iks kohë ti do ta përdorësh vullnetin tënd në këtë drejtim. Prandaj dhe këtë akt po e vlerësoj dhe caktoj për ty kështu. Një raport i tillë i dukurve do të thotë jo anullim i vullnetit të njeriut, por mbështetje e tij.

Ashtu siç e ka theksuar me përparësi edhe Ali el-Kaariu, Allahu e ka shkruar diçka në lidhje me vullnetin e njeriut, “do të bëhet kështu e ashtu” dhe nuk e ka shkruar “të bëhet kështu e ashtu”. Në këto kushte, ne nuk e bëjmë një gjë pse Allahu e di në pafillim dhe pse e ka shënuar këtë që di, pra, pse i tillë është kaderi ynë, përkundrazi, Allahu i shënon ato që kemi bërë dhe kemi për t’i bërë sepse i di që më parë. Po qe se Allahu (xh.xh.) do të kishte shkruar jo për ta karakterizuar gjendjen, por me një vendim me anë të të cilit do të zbatohet ajo që duhej, atëherë vullnetit të njeriut nuk do t’i mbetej vlerë.²⁵⁶

Fakti që Allahu e di që më parë një gjë që ne kemi për ta bërë, në asnjë mënyrë s’duhet menduar si shtrëngim. Le të japim tani dy shembuj që do të ndihmonin për kuptimin e çështjes.

Shembulli i parë. Një mësues, meqë i njeh mirë nxënësit e tij, e di që më parë në masën 80-90 përqind se sa pikë do të marrë secili prej tyre në provimin e fundit të vitit. Tani, ashtu siç kjo njohje që më parë e përfundimeve vjetore nga mësuesi nuk ndikon mbi përfundimet dhe notat që do të marrin nxënësit, edhe njohja që më parë e fundit tonë nga Allahu i cili e di gjithçka dhe nga dija e të cilit s’shmanget asgjë, nuk ndikon mbi aktet tona.

Shembulli i dytë. Dukuritë dhe ngjarjet astronomike si eklipset e diellit dhe hënës përcaktohen që më parë dhe shënohen me ditë, orë dhe minuta në raportet dhe kalendarët shkencorë. Tani, a mos eklipset e diellit dhe hënës realizohen në atë orë dhe minutë pse u njohën e u përcaktuan nga shkencëtarët ose u shënuan në kalendarë, apo shënohen në raportet e shkencëtarëve pse dihet që më parë se do të realizohen në atë orë? E vërteta është se eklipsi i diellit dhe hënës nuk ndodhin pse janë shënuar në kalendarë, përkundrazi, shënohen në kalendarë pse dihet që më parë se do të ndodhin. Ja, pra, edhe ne, njerëzit, nuk i bëjmë veprimet tona pse Allahu i ka shënuar në kaderin tonë, përkundrazi, Allahu i shënon veprimet tona pse e di që më parë se si do ta përdorim ne vullnetin tonë.

A mund të paraqitet kaderi si justifikim?

Në Islam ka kader por nuk ka fatalitet²⁵⁷. Ashtu siç pandehin disa, kaderi nuk kërkon që njeriu ta lëshojë veten në rrjedhën e ngjarjeve dhe t’i shohë si të panevojshëm adhurimin dhe marrjen e masave parandaluese. Besimi te kaderi është një nga kushtet e qenies besimtar, por nuk është e drejtë që, duke

²⁵⁶ Shih el-Kaari, Ali, *Sherhu Fikhi’l-Ekber*, Bejrut, 1997, f. 74.

²⁵⁷ Në origjinal: kadercilik (turq.).

e paraqitur atë si justifikim, të lihet pa bërë ajo që duhet bërë. Nisur nga kjo, jo vetëm s'është e drejtë që njeriu të bëjë mëkat dhe pastaj të thotë se ky ka qenë kaderi i tij, por s'është e drejtë as që, duke u mbështetur te ideja e kaderit, të mos vlerësohen shkaqet, sepse njeriu nuk e di se si është kaderi i tij ose, e thënë ndryshe, kaderi i një njeriu është i fshehtë për të.

Është për këtë arsye që njerëzit nuk shpëtojnë dot nga përgjegjësia as duke i mbështetur punët e veta te kaderi para se t'i kryejnë, as pasi t'i kenë kryer.

Në çdo gjë ka një sundim të kaderit dhe kazasë së Allahut, vetëm se duhet ditur edhe kjo se, për realizimin e ecures së kaderit dhe kazasë lidhur me aktet e zgjedhura të njerëzve, vetë aktet e tyre janë bërë ndërmjetës (forcë shtytëse). Prandaj, shmangia e vetes nga përgjegjësia duke ia ngarkuar kaderit një punë që e kemi kryer me kërkesën dhe dëshirën tonë, nuk është mendësi kaderi sipas Islamit dhe një qëndrim dhe trajtim i tillë i çështjes është e pamundur të përputhen me propozimet fetare-juridike të Islamit.

Urtësia e ndalimit të polemikave lidhur me kaderin

Profeti (sal'lallahu alejhi vesel'lem) u tha kështu disa sahabeve, shokëve të vet, kur i pa që po debatonin mbi çështjen e kaderit: "A mos ju jeni urdhëruar për këtë apo mos unë u dërgova tek ju për këtë? Kur ata që qenë para jush nisën të debatonin mbi këtë çështje, u shkatërruan!"²⁵⁸ Me këto fjalë ai tregonte se ishte i shqetësuar nga vënia në diskutim e çështjes së kaderit.

Urtësia e ndalimit nga ana e Profetit e trajtimit të çështjeve lidhur me kaderin në formën e debatit dhe polemikës mund të vlerësohet nga këto tre këndvështrime:

I pari, para së gjithash, çështja e kaderit është një çështje besimi, ndërkaq që trajtimi i çështjeve besimore në mënyrë debatuese e polemizuese nuk është i drejtë, sepse besimi është trajtuar në hadithet profetike si një e tërë bashkë me gjashtë bazat e besimit. Dhe kjo tregon edhe se besimi nuk pranon copëtim, edhe se besimi është një specifikë që kërkon tregimin e nënshtimit ndaj çdonjërit prej bazave të tij. Kurse nënshtimi nuk përputhet me debatin dhe polemikën. Ndërkaq, nuk ka ndonjë të keqe nëse çështja diskutohet, pa u tërhequr në debat dhe polemikë, me qëllim për të marrë njohuri e për të mësuar. Kështu, me këtë mendim dhe qëllim, shumë dijetarë islamë i kanë kushtuar kaderit kapituj të tërë në librat e tyre ose kanë shkruar vepra më vete me këtë temë.

I dyti, njeriu ka kaderin e vet të lidhur me vullnetin e vet, si dhe kaderin e vet që vepron jashtë vullnetit të vet. Ndërkaq, shkaqet e kaderit që zhvillohet jashtë vullnetit të njeriut, nuk njihen nga njerëzit. Duke u nisur nga parimi se "mendja (arsyeja) është krijesë, prandaj nuk mund ta konceptojë (nuk mund ta rrokë, nuk mund ta përfshijë) krijuesin", mendja (arsyeja) e njeriut mund të mos i njohë të fshehtat dhe urtësitë e kaderit që zhvillohet jashtë vullnetit të vet. Si shfaqje të këtij kaderi mund të jepen ngjarje të tilla si koha dhe vendi i lindjes së njeriut, prindërit, seksi, raca fatkeqësitë dhe sëmundjet, të cilat përcaktohen tërësisht nga faktorë jashtë vullnetit të njeriut. Të ngrihesh për të bërë debat dhe polemikë për këto gjëra, të sforcohesh për ta kuptuar të fshehtën e kaderit, mund të çojë në përfundime nga të cilat njeriu të mos dalë dot. Nisur nga kjo, mund të thuhet se është pikërisht ky dimension i kaderit që na e ka ndaluar Profeti të merremi me të.

I treti, tentativa e njeriut për ta zgjidhur në mënyrë të prerë çdo specifikë lidhur me kaderin, do të thotë kërkesë për një gjë që e kapërcen kapacitetin e tij. Sepse kaderi nuk është një temë të cilën njerëzit

²⁵⁸ Tirmidhi, Kader 3.

me mendjen të gatuar me konceptet e kohës dhe hapësirës, të mund ta konceptojnë (rrokin, përfshijnë) në mënyrë tërësore nga pikëpamja diturore dhe teorike. Prandaj, besimtari duhet të mjaftohet me ato gjëra që mundet të kuptojë lidhur me çështjen e kaderit, specifikat që nuk mundet t'i kuptojë, t'ia lërë Zotit dhe të mos hyjë në debate e polemika të panevojshme.

Ndikimet e besimit te kaderi mbi jetën e njeriut

Ka nga ata që thonë me të madhe se besimi mbi kaderin ndikon negativisht mbi muslimanët. Vallë, sa janë të vërteta këto konsiderata dhe pretendime?

Nëse ka diçka që shkon mbrapsht në botën e muslimanëve në kohën aktuale që po jetojmë, do të ishte mirë që këtë ta lidhnim jo me kaderin, por me “teorizimet” mbi fatin dhe fatalitetin të njerëzve që u kërkojnë këllëf dembelizmit dhe indiferentizmit të tyre.

Gjendja e rëndë ku ndodhet sot bota islame, nuk është pasojë e besimit islam mbi kaderin, por e jetesës jo në përshtatje me frymën e Islamit, e përfaqësimit të dobët e të mangët të Islamit, si dhe e faktit që muslimanët nuk e japin atë që pritet prej tyre në punë, përpjekje dhe sakrifica.

Po qe se besimi mbi kaderin dhe kazanë do të kishte qenë pengesë për veprimtarinë e muslimanëve, si mund të realizohej gjithë ai përparim kolosal i arritur në periudhat kulmore të Islamit? Pra, në periudhat kur kjo fe shfaqti një vitalitet të lartë me përfundime të mëdha në përmasa botërore, ky besim kurrë s'u bë pengesë për muslimanët që të përparonin dhe të bëheshin pararendës të qytetërimit. Po të bëjmë një shqyrtim të çështjes nga aspekti praktik i saj, do të shohim se muslimanët e mëparshëm, në zemrat e të cilëve ndikimi i mendimit fetar ishte më i madh, nuk ishin dembelë dhe nuk u mundën nga popujt e besimeve të tjera. Dhe askush nuk mund të pretendojë se ata nuk i besonin kaderit dhe kazasë.

Meqë nga këndvështrimi kozmologjik, besimi mbi kaderin do të thotë “besim se çdo gjë është e lidhur nga Allahu me një rregullim dhe masë të caktuar”, besimi mbi kaderin, duke shtresuar në mendjen e njeriut vetëdijen se në gjithësi nuk ka vend për rastësi, si dhe idenë e rregullit dhe rregullsisë, është bërë për njeriun një parim shtytës për të punuar në mënyrë të vazhdueshme, të programuar e sistematike.

Pas një hyrjeje të tillë, tani do ta marrim dhe trajtojmë nga dy këndvështrime vendin e besimit të shëndoshë mbi kaderin në jetën e njeriut.

a) Për sa i përket programit hyjnor që sundon në gjithësi

Para së gjithash, besimi te kaderi e eliminon idenë e rastësisë. Idetë e rrymave filozofike, si materializmi, bashkohen në pikën se gjithësia ku sundon një rregull dhe harmoni tejet e përsosur, ka ardhur në gjendjen e sotme si rezultat i një zinxhiri rastësish. Muslimanët mund t'i shpëtojnë nga këto lloj idesh të gabuara vetëm besimi mbi kaderin, sepse të thuash se i beson kaderit, do të thotë të besosh se në gjithësi nuk ka vend për rastësi. Kështu, është një e vërtetë e shprehur hapur në Kur'an, se në gjithësi asgjë nuk varet nga rastësitë, përkundrazi, çdo gjë vepron sipas një plani dhe programi të caktuar:

“Te Allahu, çdo gjë është sipas një mase të caktuar!” (Rad, 13/8)

“Pa dyshim, Ne e kemi krijuar çdo gjë me një kader!” (Kamer, 54/49)

Në çdo gjë në gjithësi, nga më e vogla te më e madhja, vëzhgojmë një rregull dhe harmoni. Ligjet e vëna në natyrë nga Krijuesi janë pjesë e kaderit hyjnor (e planit hyjnor), të gjitha ligjet veprojnë brenda

kuadrit të kaderit dhe, siç shprehet Kur'ani, në kaderin e tyre nuk shihet ndonjë ndryshim: “Në krijimin e Allahut ti nuk mund të gjesh ndonjë ndryshim!” (Rum, 30/30)

Sipas këtij parimi, Zoti e administron çdo gjë sipas planit hyjnor dhe rregullsisë së lartë të përcaktuar prej Tij në pafillimshmëri. Atëherë, themi se çdo lloj dukurie dhe ndodhie materiale e jomateriale që ngjan në gjithësi, nuk ngjan rastësisht, pa qëllim e pa synim. Çdo gjë krijohet me anë të dijes eternale (të pafillim), vullnetit absolut dhe fuqisë së pafundme të Allahut që përfshin çdo gjë, dhe në përputhje me rregullin dhe planin hyjnor. Kazaja e Allahut shfaqet gjithmonë në përputhje me kaderin e Tij.²⁵⁹ Me këtë aspekt, vërtetimi i kaderit është vërtetim i tevhidit, besimit monoteist islam mbi Allahun si Zoti i vetëm i gjithësisë. Kështu, në një hadith profetik, duke u shprehur se “besimi te kaderi është rregull i tevhidit”,²⁶⁰ është tërhequr vëmendja mbi faktin se baza besimore mbi kaderin është e lidhur drejtpërdrejt me besimin monoteist (tevhid).

Shkurt, besimi te kaderi na pengon ne t'i shohim të gjitha dukuritë dhe ngjarjet që ndodhin në gjithësi, si “pasoja të shkaqeve”, siç ndodh në determinizëm,²⁶¹ dhe, duke na shmangur nga mendimi determinist, na tregon se pas çdo gjëje është një dorë urtësie dhe fuqie vazhdimisht në veprim.

b) Për sa i përket vendimit hyjnor lidhur me njeriun

Le ta paraqesim këtë çështje në formë pikash me radhë.

1) Kaderi, i cili, me përfshirjen e tij në bazat e besimit, përmban urtësi të rëndësishme, është si një pritë ose barrierë që e mbyll rrugën që mund ta çojë njeriun në mohim, sepse, ndër të tjera, njeriu, me aspektin e tij egoistik²⁶², kërkon të lavdërohet dhe krenohet me vetitë dhe bukuritë që i janë dhuruar atij në krijim, kurse të metave, gabimeve, fajeve dhe krimeve të veta kërkon t'u gjejë pretekste justifikuese ose t'ua ngarkojë të tjerëve.

Po qe se njeriu nuk i njeh kapacitetet dhe bukuritë me të cilat është i pajisur, si dhuratë dhe mirësi të Zotit, i hapet rruga e krenarisë dhe mendjemadhësisë. Ky damar krenarie, ndërsa e shtyn një shumicë njerëzish të mbahen më të madh para njerëzve të tjerë, një pjesë tjetër njerëzish, duke e çuar gjer në idenë fikse të vështirimit të çdo gjëje si meritë dhe përkatësi të vetën, si përfundim, e bën të dënuarin e mendimit për të mos njohur asnjë vullnet dhe fuqi mbi veten.

Në fakt, në natyrën e njeriut ekziston ndjenja e përvetësimit të çdo aftësie dhe bukurie vetiake, e lavdërimit dhe e krenimit me to dhe, përtej kësaj, e kalimit në një egoizëm të pamasë. Ja, në këtë moment, për të mos rënë në krenari për punët e mira të kryera, futet në veprim kaderi i cili, duke i sugjeruar njeriut të mos bëhet krenar se nuk është ai që i ka bërë ato punë, e mbron nga rënia në mendjemadhësi dhe krenari. Sepse, jo vetëm që është vullneti hyjnor që dëshiron kryerjen e atyre punëve, por është përsëri po ajo Fuqi që jep mundësinë dhe forcën e duhur për realizimin e tyre. Në këtë pikë futet në veprim edhe parimi islam i zgjedhjes (vullnetit) të lirë me qëllim që të mos eliminohen

²⁵⁹ Kazaja është realiteti imediat i kaderit. Përkthyesi.

²⁶⁰ Ali el-Muttaki, *Kenzu'l-Ummal*, Muessesetu'r-Risale, Bejrut, 1994, 1/106.

²⁶¹ Edhe në Islam pranohet se dukuritë dhe ngjarjet që ndodhin në gjithësi janë pasoja (rezultate ose përfundime) të shkaqeve të caktuara, por ndryshe nga materializmi dhe determinizmi që i shohin shkaqet si rastësore dhe determinuese, Islami i sheh shkaqet të drejtuara nga urtësia hyjnore dhe më tepër si pretekste, sepse është Zoti, Shkaku i shkaqeve, ai që i drejton shkaqet. Përkthyesi.

²⁶² Në original: nefs-i emmaresi cihetiyle. Përkthyesi.

propozimi dhe përgjegjësia, parim i cili i thotë njeriut se ai është përgjegjës sepse ai e bëri zgjedhjen, duke ia kujtuar, kështu, atij, përgjegjësinë.

Nisur nga kjo, Kur'ani, me ajetin “çdo e mirë që të vjen është nga Allahu, kurse çdo e keqe, nga vetja jote”²⁶³, tërheq vëmendjen mbi faktin se Allahu është zotëruesi i vërtetë i të gjitha mirësive, bukurive dhe dobive, kurse të gjitha të këqijat dhe mëkatet burojnë nga vetja (egoja) e njeriut.

2) Te njeriu që i beson kaderit nuk ndodh as më i vogli pesimizëm dhe lëshim. Pastaj, njeriu që i beson kaderit, kur arrin sukses, nuk heq dorë nga thjeshtësia dhe modestia dhe nuk e humbet veten me dehjen e fitores. Në ajetin e mëposhtëm shprehet në mënyrë koncize se besimi te kaderi jo vetëm që përbën burim force për njeriun përballë fatkeqësive, por edhe e shpëton atë nga krenaria:

“As në tokë e as në veten tuaj nuk ka gjë që t’ju ndodhë (si për t’u gëzuar, ashtu dhe për t’u dëshpëruar), që të mos jetë shkruar në një libër para se ta krijojmë Ne. Pa dyshim, kjo është e lehtë për Allahun. Kjo, me qëllim që të mos dëshpëroheni për humbjet dhe që të mos përkëdheleni e të mos mbaheni më të madh për ato që ju jep Allahu. Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë që lavdërohen shumë!” (Hadid, 57/22-23)

Këtu Allahu (xh.xh.) u ka bërë thirrje njerëzve të besojnë te kaderi për ta lehtësuar hidhërimin dhe dëshpërimin në çastet e fatkeqësive. Sepse, kur kaderi mendohet për sa u përket shqetësimeve dhe fatkeqësive të papërbalueshme nga vullneti i njeriut, bëhet ilaçi shërues pesimizmit, dëshpërimit dhe i stresit të shkaktuar prej këtyre. Njeriu i cili e di se çdo gjë vjen nga Allahu dhe e beson këtë, e pranon me pëlqim çdo gjë të hidhur a të ëmbël të ardhur prej Tij, i nënshtrohet mëshirës dhe urtësisë së Tij, duke bërë durim, shpëton nga hidhërimi i shkaktuar prej shqetësimit dhe fatkeqësisë. Përballë fatkeqësisë, thotë: “Unë jam rob i Allahut dhe, në fund, te Ai do të kthehem. Në dëshirimin e Allahut ka mirësi dhe dobi; në dashtë Allahu, edhe në këtë gjë për mua ka mirësi e dobi. Allahu im, bëmë mua durimtar dhe mbromë nga fatkeqësi më të mëdha!” Dhe gjen qetësi!

Kështu, në Kur'an thuhet: “Kur atyre u vjen në kokë një fatkeqësi, thonë: “Ne jemi të Allahut dhe te Ai do të kthehemi!” (Bekare, 2/156) Dhe: “Mundet që në diçka që nuk ju pëlqen, Allahu të ketë caktuar shumë dobi për ju!” (Nisa, 4/19)

Në një aspekt, për njeriun i cili nuk i sheh dot fatkeqësitë sipas kaderit, bëhet e pashmangshme që të mbetet i mpirë para çdo ngjarjeje shpresëthyesë e persekutuese, që të ankohet vazhdimisht për gjendjen e vet, që ta përplasë kokën andej-këtej, madje, si përfundim, të bjerë në llumin e mëkatit dhe mjerimit. Një njeri i tillë shtypet edhe para fatkeqësisë më të vogël dhe, me ah-e e me oh-e e kthen botën në burg për vete. Sa për besimtarin që i beson kaderit, ai, siç thuhet në Kur'an, as gëzohet sa për të rënë në krenari me gjërat e fituara e të arritura nga punët e kësaj bote, as dëshpërohet për gjënë e humbur.²⁶⁴ Sepse ai e di që çdo gjë s'përbëhet nga dimensionin e kësaj bote, nga kjo botë, por që më e mira dhe më e bukura e çdo gjëje është në jetën tjetër pas kësaj.

3) Një urtësi tjetër e përfshirjes së kaderit në bazat e besimit është se, duke e shpëtuar njeriun nga barra e rëndë e jetës, kaderi ia lehtëson dhe qetëson shpirtin.

Njeriu është një qenie që ka të bëjë me gjithësinë. Ai ka synime dhe dëshira të pafundme. Kurse fuqia dhe vullneti i njeriut nuk mjafton as për një të miliontën e nevojave të tij. Veç kësaj, shpesh herë njeriu nuk e shpëton dot veten nga ndikimi i disa ngjarjeve që i sheh përreth pa ua kuptuar dot urtësinë

²⁶³ Nisa, 4/79.

²⁶⁴ Shih Hadid, 57/22.

dhe shqetësohet. Për shembull, po të shohë një skenë të dhimbshme, për një kohë nuk shpëton dot nga efekti i saj dhe jeta i bëhet e hidhur.

Në këtë moment, e vetmja gjë që i shkon në ndihmë njeriut, është besimi te kaderi. Personi që beson në kuptimin e vërtetë të fjalës te kaderi, e shkarkon te kaderi barrën e krijuar prej nevojave dhe frikërave dhe, kështu, zemra dhe shpirti i lehtësohen. Personi që beson se të gjitha ngjarjet shfaqen në gjithësi, zhvillohen sipas rregullit të një ligji hyjnor dhe se çdo gjë ecën mjaft lehtë me anë të një programi hyjnor, ia lë mundimet dhe vështirësitë që i përjeton të kësaj bote, të Zotit të saj dhe sheh të përfitojë nga të gjitha bukuritë dhe kënaqësitë paraqesore të saj. E shprehur ndryshe, mbështetur në mëshirën e Zotit dhe në bukuritë e punëve dhe ligjeve të Tij, çdo gjë e sheh nga ana e mirë e saj dhe, në vartësi të kësaj, e kalon jetën me një kënaqësi pa dhimbje dhe me lumturi. Edhe nga ky këndvështrim, besimi te kaderi është aq kënaqësindjellës sa nuk përshkruhet. Kush i beson kaderit në këtë kuptim, nuk hidhërohet e nuk dëshpërohet. Me të vërtetë, në një hadith profetik, Profeti (sal'lallahu alejhi vesel'lem), duke tërhequr vëmendjen mbi këtë të vërtetë, ka thënë: “Besimi te kaderi e heq shqetësimin dhe dëshpërimin!”²⁶⁵

Nisur nga kjo, besimi te kaderi ka një vend të pazëvendësueshëm për sa i përket ndikimit pozitiv në jetën e njerëzve të kapur nga sëmundje të rënda. Besimtari i rënë në një vuajtje të pashpresë, i cili nuk ka asgjë në dorë, i lutet kështu Zotit duke e ndjerë veten në siguri: “Allahu im i lartë! I bindem pa kushte vullnetit tënd! Urtësitë e tua janë të pafundme. Po të duash, ti edhe më shëron mua. Edhe dëshirimi apo mosdëshirimi yt është një urtësi që të përket ty! Ne e bëmë ç’kishim në dorë, edhe pasardhësit tanë do ta bëjnë. Kurse vdekja është ligji yt; edhe po të vdesim, ç’rëndësi ka! Sepse ne kthehemi tek Ti!” Si përfundim, njeriu i cili, duke e kuptuar se “çdo gjë e vlerësimit hyjnor (kaderit) është e bukur”, i nënshtrohet vlerësimit hyjnor (kaderit), në çdo gjë sheh urtësinë dhe drejtësinë e kaderit hyjnor.

4) Një ndikim tjetër i besimit te kaderi mbi njeriun është forcimi i vullnetit të njeriut, sepse njeriu i cili beson te kaderi, siç shprehet edhe hadithi profetik, është i guximshëm sepse beson se fatkeqësia që ka për t’i rënë në kokë, do t’i bjerë patjetër, dhe ajo që s’ka për t’i rënë, kurrsesi s’do t’i bjerë!²⁶⁶

Meqë ky besim e shtyn njeriun të mbetet i gjallë, energjik dhe në veprim, personi me një besim të tillë nuk prapset para vështirësive, nuk tregon dembelizëm dhe mefshtësi. Fakti që njerëzit që në të kaluarën kanë hedhur nënshkrimin në suksese të mëdha, kanë qenë përfaqësues të këtij besimi, është argumenti më i hapur i kësaj. H. Zija Ylken i cili e trajton karakterin e kaderit në Islam si “dalje mbi ngjarjet materiale e mbi shkaqet materiale, ngjitje drejt horizonteve”, bën këtë vlerësim lidhur me çështjen:

Në kaderin islam ka vullnet dhe qëllim. Vlerësimi i ndriçimit na jep shpresë dhe qetësi, ne nuk biem në boshllëk dhe pesimizëm. Besimi te kaderi për atë që e ka këtë besim, është shprehje e vetëdijes se nuk ka mbetur vetëm edhe kur çdo gjë t’i jetë konsumuar, kur çdo gjë që mund t’i vinte dore, t’i jetë mbaruar, se nuk është braktisur në shurdhërinë dhe pandjeshmërinë e materies dhe se mbështetja më e lartë ndodhet bashkë me të. Lidhja pas Allahut nuk do të thotë zbritje e vullnetit në zero, përkundrazi, vënie e vullnetit në veprim edhe para situatave të papritura, madje, pamundësive!

Meqë kush i beson kaderit, është mbështetur te Allahu, ia hyn çdo pune në jetë dhe gjatë gjithë jetës ecën nga suksesi në sukses pa e humbur forcën dhe guximin. Edhe sikur të ndodhë që të mos ketë sukses, duke menduar se në atë mungesë suksesi apo dështimi do të ketë një urtësi, përpiqet ta provojë

²⁶⁵ Munavi, Fejzu’l-Kadir, 3/187.

²⁶⁶ Tirmidhi, Kaderi, 10.

të njëjtën gjë edhe në rrugë të tjera; edhe po s'e bëri këtë, mendon se i tillë ka qenë kaderi dhe vazhdon në udhën e vet pa e humbur vendosmërinë dhe vullnetin.

5) Meqë besimtari që i ka besuar kaderit, e di se pjesën e vet të të mirave²⁶⁷ e ka të caktuar, për rrjedhojë, nuk do të mund ta fusë në dorë pjesën e të tjerëve çfarëdo që të bëjë, nuk e dhunon të drejtën e tjetrit, nuk tregon ambicje dhe nuk bën zili.

Prandaj, njeriu që i beson kaderit, duke pasur parasysh edhe tërheqjen e vëmendjes që bën Kur'ani duke thënë, “mos kërkoni gjërat që Allahu ua ka dhënë disave prej jush më tepër se disa të tjerëve” (Nisa, 4/32), nuk i vë syrin gjësë së tjetrit. Sepse ai e di se një veprim i tillë është zemërim ndaj kaderit dhe kazasë së Allahut, shikim me sy të keq i dhuntisë së Tij të përpjesëtuar mes robve të Tij, konsideratë e pakëndshme për drejtësinë e vendosur me urtësi prej Tij, për pasojë, faj të kryer ndaj thelbit të tevhidit, besimit monoteist islam, prandaj shmanget nga ai veprim.

6) Personi që beson se çdo gjë del në shesh me anë të kaderit, kazasë, vendimit dhe vullnetit të Allahut, edhe nëse e bën përgjegjës dikë që ka kryer faj kundër tij, tregohet më tolerant ndaj fajtorit. Besimtari i cili e vlerëson këtë ngjarje edhe nga këndvështrimi i kaderit, e ka më të lehtë ta falë tjetrin.

Në dëmin ose dhimbjen që i ka shkaktuar dikush tjetër, besimtari merr parasysh se është edhe pjesa e mëkateve të veta, pra, duke menduar se gjendja e krijuar mund të jetë edhe ndëshkim për të për një mëkat të kryer prej tij më parë, bën dhe duhet të bëjë një vetëllogari. Me të vërtetë, Kur'ani thotë: “Çdo fatkeqësi që ju bie mbi kokë, është për shkak të bëmave tuaja. (Megjithëkëtë) Allahu (jua) fal (disa nga) mëkatet (dhe nuk jep fatkeqësi si rrjedhojë e tyre).” (Shura, 42/30) Kështu, shpëton më lehtë nga neveria dhe urrejtja që do të ndjente ndaj tjetrit.

Le ta mbyllim temën e kaderit me këto shprehje të njeriut numër një të mendimit dhe aksionit të shekullit tonë, Bediuzzaman:

“Besimi te kaderi është aq i shijshëm, aq lumturindjellës, sa nuk përshkruhet!”

“... në jetën time, në mijëra raste të përvojës sime, unë pashë dhe mësova se po të mos jetë besimi te kaderi, lumturia e jetës së kësaj bote shkatërrohet. Sa herë që t'i kem parë fatkeqësitë e dhimbshme me aspektin e besimit te kaderi, kam vërejtur se fatkeqësia lehtësohej. Dhe habitesha se si mund të jetonte ai që s'i besonte kaderit..”

²⁶⁷ Në original: rizk, pjesë e të mirave e caktuar për çdo gjallesë; në kuptimin më të ngushtë të fjalës, racion ushqimor. Një nga emrat e Allahut është Rezzak (furnizues dhe ushqyes). Përkthyesi.